

Bordi Editorial

PROF. DR. FERIT DUKA, *Universiteti European i Tiranës (UET)* – Drejtor

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI, *Universiteti European i Tiranës (UET)* – Anëtar

DR. BLENDI KAJSIU, *University of Antioquia, Colombia* – Anëtar

PROFESSOR JOHN PARRISH SPRAWL, *Indiana University School of Liberal Arts* – Anëtar

PROF. ASOC. DR. BASHKIM GJERGJI, *Universiteti i Tiranës* – Anëtar

DR. NATHANIEL COPSEY, *Aston University, Britani e Madhe* – Anëtar

Kryeredaktore

DR. BELINA BUDINI

Redaktorë shkencorë

PROF. DR. TONIN GJURAJ, *Universiteti European i Tiranës (UET)* – Anëtar

PROF. DR. ALEKSANDËR DHIMA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

DR. VALBONA NATHANAILI, *drejtore UET Press*

DR. IRENA MYZEQARI

Redaktore gjuhësore

MARSILDA NDINI

Arti grafik

BESNIK FRASHNI

Botime të kolanës “REVISTA SHKENCORE”.

© 2015 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Punimet e paraqitura shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të autorëve.
Redaksia nuk mban përgjegjësi për sa autorët kanë shprehur në shkrimet e tyre.

Universiteti Europian i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

odeta.barbullushi@uet.edu.al

www.uet.edu.al/uetpress

Revista është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare
“UET Press” është pjesë e
Universitetit Europian të Tiranës.

Tiranë, 2015.

përmbajtja

Editorial	
Kulturë vs politikë	5
Dr. Belina BUDINI	
Polarizim pa radikalizim: Radikalizmi politik në Shqipëri, qasje krahasimore ...	10
PhD. Blendi KAJSIU	
Ligjërimi “i pakohë” i anormalitetit shqiptar në revistën Time (1923-2013).....	34
Dr. Belina BUDINI	
Ndërveprimi konjitiv i medias me politikën në realitetin kulturor shqiptar	55
Prof. Dr. Aleksandër DHIMA	
Politikat kulturore dhe studimet folklorike në Shqipërinë komuniste	68
PhD Corina Iosif SËRBU , PhD Inis SHKRELI	
Roli i Marrëdhënieve Publike Politike në promovimin e Qeverisë Shqiptare	86
PhD. Lorena LIÇENJI	
Evolucioni i konflikteve dhe paradigma e re e gjeneratave të luftës	96
Prof. Dr. Kristaq XHARO	
Opinion i Publik dhe spiralja e heshtjes	104
Prof. Elisabeth Noelle- NEUMANN	
<i>Përktheu për POLIS: Dr. Belina Budini</i>	
Përcaktuesit e politikës së jashtme tradicionale turke	117
Dokt. Blendi LAMI	

Ese	
Kulturë kombëtare, kulturë universale!	129
Bashkim SHEHU	
Ne, të tjerët dhe krejt të tjerët	134
Gilman BAKALLI	
Recencë	
Recencë e tekstit të Giovanna Cosenza: “Hyrje në semiotikën e mediave të reja”, shtëpia botuese Laterza, Romë, 2014	140
Albana NEXHIPI, Msc	
Recencë e monografisë së Prof. Dr. Fatos Tarifa: “Hakmarrja është imja; Morfologjia sociale dhe Gramatika morale e Gjakmarrjes” Tiranë: Onufri, 2014.....	149
Prof. Dr. Aleksandër DHIMA	
Abstracts.....	155

EDITORIAL

KULTURË vs POLITIKË

— **Dr. Belina Budini** —

KRYEREDAKTORE

Çështjet e trajtuara në këtë numër të 14-të të revistës POLIS, që i takon vitit 2015, ndajnë mjaft të përbashkëta tematike për sa i përket pikëprerjeve kulturore dhe politike, edhe pse nuk janë produkt i një konference apo simpoziumi shkencor të posatshëm me këtë temë. Të trajtuara shpesh të ndara, në studimet shqiptare, çështjet e kulturës dhe të politikës paraqiten shpesh të ndërthurura dhe kjo ka qenë edhe linja editorial e këtij numri të revistës me titull “Kulturë vs Politikë”. Punimet e këtij numri marrin në shqyrtim problematika të lidhura me kulturën dhe politikën si fusha studimore, pa i konsideruar ato domosdoshmërisht si dikotomotike. Duke nisur që nga artikulli i parë i këtij numri, një kontribut original mbi kulturën e polarizimit politik në Shqipëri, dhe mungesën e kulturës së radikalizmit politik.

Më konkretisht, në punimin e tij, me titull “*Polarizim pa radikalizim: Radikalizmi politik në Shqipëri, qasje krahasimore*”, Blendi Kajsiu, pedagog dhe eksponent i rëndësishëm i shoqërisë civile në vendin tonë, merr në studim një dukuri pak të analizuar siç është radikalizmi politik në Shqipëri, nga një qasje krahasuese me vende të tjera të rajonit. Autori, aktualisht lektor në University of Antioquia, pohon se radikalizmi i lëvizjeve sociale në Shqipëri shfaqet në forma jashtëzakonisht sporadike ose të përkohshme. Sipas Kajsiut, ekzistojnë dy faktorë të ndërvuarur të cilët shpjegojnë mungesën e radikalizmit politik në Shqipëri. *Faktori i parë* lidhet me përvojën traumatike që shqiptarët përjetuan në komunizëm dhe përmasën e lartë të delegjitimit të ligjërimeve majtiste apo atyre nacionaliste, në dallim nga vende të tjera të rajonit si Turqia apo Greqia. *Së dyti*, skena shumë e

bipolarizuar politike që e ka ndarë shoqërinë shqiptare në dy kampe antagoniste: partia Socialiste kundër partisë Demokratike. Në të dhënat dhe analizat e mëpasme, Kajsiu vëren se niveli i këtij bila-polarizimi gjatë 20 viteve të fundit ka qenë më i larti në të gjithë rajonin, faktor tjetër ky, që e ndan Shqipërinë nga vendet e tjera postkomuniste dhe që shpjegon mungesën e partive ekstreme ose lëvizjeve sociale. Për të vërtetuar se si eksperiencia komuniste dhe bipolarizimi janë kombinuar për të minimizuar ekstremizmin politik, autori ka marrë si rast studimi protestat e Nëntorit 2013, duke pohuar se ato përbëjnë një shembull të një radikalizimi të suksesshëm por të limituar social.

Në punimin tim (Belina Budini), me titull *“Ligjërimi “i pakohë” i anormalitetit shqiptar në revistën Time (1923–2013)*, kam trajtuar nga një optikë gjithashtu krahasimore, por ndërmjet periudhash të ndryshme historike, mënyrën e paraqitjes së Shqipërisë nga mediat e huaja. Nga krahasimi ka qenë e mundur të përftohet një linjë vijimësie për sa i përket mënyrës së të ndërtuarit dhe të paraqiturit të Shqipërisë për një trajektore kohore të gjatë, që nga viti 1923 dhe deri sot. Në analizën time, kjo vijimësi konfirmon jo vetëm ekzistencën e një Shqipërie të paraqitur njëlloj, për sytë e audiencave të huaja, por edhe ngulitjen e një forme të ndërtuari dhe të paraqituri të saj. Pamja e krijuar është ajo e një vendi përherë të trazuar dhe anormal, pavarësisht nëse flasim për periudha historike me tipare thelbësisht të ndryshme. Nga një këndvështrim krahasues sipas periudhave kohore, vihet re se ligjërimi i anormalitetit shqiptar, i vendosur që në vitet 1920, gjatë formësimit të shtetit të ri shqiptar, është thelluar më tej gjatë periudhës së regjimit komunist, duke u ricikluar edhe pas viteve '90. Paraqitjet kanë qenë gjithë herët të përqendruara tek çështje të lidhura me aspekte politike më tepër sesa kulturore.

Profesor Aleksandër Dhima në artikullin e tij me titull *“Ndërveprimi konjitiv i medias me politikën në realitetin kulturor shqiptar”* bën një introspektim të mjedisëve mediatiko-politike në Shqipëri, nga pikëprerje të lidhura me antropologjinë e komunikimit. Koncepti i përdorur, ai i organizimit konjitiv të ngjarjeve politike dhe atyre mediatike, është jo vetëm interesant, por edhe i rëndësishëm për studimet e marrëdhënieve të tyre. Në artikull evidentohen elementët kryesorë që kanë ndikuar në realitetin shqiptar si brishtësia e procesit demokratik gjatë periudhës së tranzicionit, mendësia se “politika është profesioni më i lehtë për t’u ushtruar” si edhe faktorë të traditës shqiptare që gjenerojnë efekte autoritare dhe pasoja afatgjata mbi treguesit mediatikë dhe politikë.

Në artikullin me titull *“Politikat kulturore dhe studimet folkloriste në Shqipërinë komuniste”*, bashkë-autoret Corina Iosif Sirbu dhe Inis Shkreli sjellin një kontribut të përbashkët nga një qasje gjithashtu antropologjike, duke u ndalur tek periudha komuniste për të vrojtuar dukurinë e instrumentalizmit nga ideologjia e studimeve folkloriste shqiptare. Sipas punimit, mënyra se si janë perceptuar dhe strukturuar veçanërisht librat e folklorit muzikor theksojnë karakteristikat e “folklorit” si

një strukturë e ideologjisë politike. Autorët kanë përdorur një regjistër të gjerë në vështrimin e tyre, duke kërkuar për elementë të politikave kulturore në lidhje me folklorin gjatë periudhës komuniste, edhe në dispensat e kohës. Hartuesit e këtyre politikave, sipas artikullit e shndërruan në njëlloj shkence kombëtare dhe mbartëse të detyrave ideologjike në folklorin shqiptar, duke nisur nga zakonet, ritualet, mitologjitë, rapsoditë, lirikat erotike, këngët historike, melodi të ndryshme (orkestrinat popullore – kabatë, fyejt).

Në artikullin me titull *“Roli i Marrëdhënieve Publike Politike në promovimin e Qeverisë Shqiptare”*, autorja Lorena Liçenji merr në shqyrtim teknikat dhe instrumentet e marrëdhënieve publike të qeverisë shqiptare si përpjekje jo vetëm për të përcjellë një imazh sa më pozitiv të Qeverisë brenda territorit shqiptar, por edhe përtej kufijve. Punimi merr përsipër të verifikojë hipotezën se aplikimi i strategjive dhe teknikave të marrëdhënieve publike, falë pasqyrimin të favorshëm mediatik, ndikon pozitivisht në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë. Më nga afër janë shqyrtuar aspektet komunikative të aplikuara nga Kryeministri Shqiptar gjatë programeve televizive të stacioneve të huaja në të cilat ai ka qenë i ftuar gjatë vitit 2014–2015, të tilla si “Conflict Zone”, “Agora”, “Francë 24”, “Invasioni Barbariche”. Licenji del përmes interpretimeve të saj në përfundimin se, nëpërmjet strategjive efikase të marrëdhënieve publike politike, qeveria shqiptare ka siguruar një nivel të lartë pasqyrimi mediatik, duke përforcuar reputacionin e saj në arenën ndërkombëtare.

Në artikullin me titull *“Evolucioni i konflikteve dhe paradigma e re e gjeneratave të luftës”*, profesor Kristaq Xharo prezanton debatet aktuale në studimet e konfliktit dhe të sigurisë, duke përshkruar paradigmen për përballjen me gjeneratën e re të luftës, të ashtuquajturën G4L. Duke u mbështetur në debatet bashkëkohore, autori shpjegon se kjo paradigmë kërkon zhvendosjen e vëmendjes nga ligjërimi i luftës vetëm ndërmjet shteteve, për të llogaritur aktorët jo-shtetërore, të cilët duket se i japin tonet konflikteve të botës së sotme. Ndërsa aktorët jo nacionalë – përfshirë grupet terroriste, sikurse kanë dëshmuar edhe ngjarjet më të fundit mbeten aktive, autori konstaton se në këtë situatë edhe vendi ynë nuk është i imunizuar në mundësinë e përballjes me format dhe metodat që shfaqet G4L, si mundësia dominuese e natyrës së re të konflikteve. Sipas tij, strukturat e sigurisë janë ende të formatuara sipas konceptit të përballjes dhe fitores në gjeneratën e deritanishme, atë të përballjes shtet më shtet.

Teoria e spirales së heshtjes nga Elisabeth Noelle-Neumann vjen e përkthyer në shqip për herë të parë, në këtë numër përmbledhës të POLIS 14, me titullin *“Opinionit Publik dhe spiralja e heshtjes”*. Si një prej ligjësisve më tërheqëse të opinionit publik, propozuar nga profesoresha e komunikimit Noelle-Neumann, me përvojë 30 vjeçare me sondazhet e opinionit publik, teoria e “spirales së heshtur” shpjegon rritjen dhe përhapjen e opinionit publik, duke iu referuar presionit në rritje që ndiejnë njerëzit për të fshehur pikëpamjet e tyre, kur mendojnë se janë në pakicë.

Materiali i përkthyer për revistën POLIS, është shkëputur nga libri “A first Look at Communication Theory” me autor Em Griffin, botimi i 7-të. Duke qenë se teksti me të njëjtin titull në gjuhën shqipe, “Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit”, botimi i nëntë, nuk e përfshin këtë teori, Spiralla e heshtur vjen kështu për herë të parë me numrin 14-të, të POLIS në gjuhën shqipe, për studiuesit dhe studentët e interesuar. Kjo qasje mund të gjejë aplikim të vlefshëm edhe në analizimin e dukurive të komunikimit politik, të opinionit publik si edhe atyre politike e sociologjike në tërësi, në kontekstin e Shqipërisë si një vend ku heshtja merr shpesh formën e spirales, duke rezervuar surpriza për politikanët, mediat dhe vetë publikun.

Në artikullin me titull, “*Përcaktuesit e politikës së jashtme tradicionale turke*”, doktoranti Blendi Lami shtjellon përcaktuesit e politikës së jashtme tradicionale turke, duke u fokusuar në operacionalizimin e dy koncepte thelbësore që shpjegojnë politikën tradicionale të jashtme turke: status quo-ja dhe perëndimorizimi. Përveç aspekteve të lidhura drejtpërdrejt me rastin e marrë në shqyrtim, atë të Turqisë, artikulli trajton edhe pozicionimin gjeopolitik turk përkundrejt rajonit dhe më gjerë nga kontesti rajonal dhe global. Sipas autorit, ky qëndrim gjeostrategjik është konsideruar me qëllim të ruajtjes së status quo-së dhe ndjekjes së një paradigme statike.

Në esenë me titull “*Kulturë kombëtare, kulturë universale*”, shkrimtari i njohur Bashkim Shehu trajton konceptet e kulturës kombëtare dhe universale, duke vënë përballë skemat e kërimit empirik dhe të shkencave sociale, me kuptimin kantian: iluminist dhe individualist. Ky kuptim i fundit, sipas autorit na shpie tek ideja e një kulture universale, që e trupëzon edhe atë kombëtare. Duke iu referuar Gëtes, autori i kësaj eseje pohon se në Letërsinë Kombëtare bëjnë pjesë edhe vepra autorësh të huaj, dhe se një antologji e letërsisë kombëtare duhet të përfshijë edhe kryevepra të përkthyer botërore, nga “Hamleti” apo “Don Kishoti” i parë të përkthyer prej Nolit, deri te “Don Kishoti” i dytë i përkthyer prej Petro Zhejit, duke përfshirë këtu edhe punën e përkthyesve më të rinj. Argumentet e qasjes humaniste të autorit të kësaj eseje kanë si pikënisje një kritikë ndaj konceptimit etnicist të kulturës, që përbën pjesën e parë të shkrimit. Ky konceptim i “një të huaji”, sipas tij, “me vështrimin mbërthyer në të kaluarën, mohon individin dhe, tek e fundit, kreativitetin. I vetmi krijim [brenda kësaj qasjeje] është një identitet bunker, një identitet burg”.

Po kështu, në një reflektim mbi tjetrin me titull “*Ne, të tjerët dhe krejt të tjerët*”, kolegu Gilman Bakalli përqendrohet tek marrëdhënia e individit me grupin. Autori nis nga natyra njerëzore kur pohon se për shkak të saj, disa probleme i perceptojmë fare mirë, ndaj të tjerave jemi indiferentë, sepse nuk na përkasin dhe nuk i konsiderojmë si “problemet tona”. Ai merr si shembull reagimet e disa grupeve sociale shqiptare në facebook ndaj ngjarjeve tragjike në Francë në nëntor 2015, të cilat, sipas tij, ishin shumë më të forta emocionalisht në krahasim me sulmet e

vazhdueshme ndaj civilëve në Siri. Punimi në tërësi i vë synim vetes të kuptojë më shumë në lidhje me mënyrën e diferencuar perceptuale, dhe ndjeshmërinë e anëtarëve brenda grupeve dhe të grupeve të ndryshme sociale në raport me njëri-tjetrin.

Së fundmi, recensat e këtij numri mbajnë përkatësisht autorësinë e Aleksandër Dhimes dhe të Albana Nexhipit. Në punimin e saj me titull “*Mekanizma të leximit semiotik të mediave të reja*”, Nexhipi merr në shqyrtim mediat e reja, duke u mbështetur në tekstin “*Hyrje në semiotikën e mediave të reja*”, në gjuhën italiane, botim i vitit 2014, me autore Giovanna Cosenza, të shtëpisë botuese Laterza, Romë. Ndërsa profesor Dhima sjell në recensën e tij vlerësimin për botimin e profesor Tarifës me titull “*Hakmarrja është imja; Morfologjia sociale dhe Gramatika morale e Gjakmarrjes*”, Tiranë: Onufri, 2014.

Polarizim pa radikalizim: Radikalizmi politik në Shqipëri, qasje krahasimore¹

Blendi Kajsii, PhD

UNIVERSITY OF ANTIOQUIA, COLOMBIA

ABSTRAKTI: Që nga rënia e Komunizmit, radikalizmi politik ka qenë pjesë e rëndësishme e skenës politike europiane. Kriza ekonomike e vitit 2008 e çoi më tej këtë trend, duke i dhënë jetë valëve të reja të radikalizmit. Shqipëria duket të jetë një rast i çuditshëm përjashtimor, sepse në dallim nga vende të tjera, nuk ka pasur parti të ekstremit, që prej rënies së regjimit në 1991. I njëjti arsyetim vlen edhe për protestat sociale të cilat vitet e fundit ka qenë sporadike dhe shumë herë më pak radikale sesa protestat e tjera në vendet e rajonit si Bullgari, Greqi dhe Turqi. Ky punim përpaket të vërtetojë se mungesa e radikalizmit politik në Shqipëri është rezultat direkt i të shkuarës së saj traumatike komuniste, kombinuar me një nivel të lart bipolarizimi. Eksperienca e hidhur në komunizëm minimizoi “tërheqjen” ose “prirjen” ndaj ligjërimeve ekstremiste të djathta apo të majta. Ndërkaq, nivelet e larta të bipolarizimit politik, e ndanë skenën politike shqiptare në dy kampe kundërshtarë, ku e cila i çoi në hendeqe edhe më të thella.

Hyrje: Gjëgjëza shqiptare

Gjatë 25 viteve të fundit, që prej rënies së regjimit komunist, pothuajse çdo vend në Ballkan ka pasur të paktën një parti ekstreme, relativisht të suksesshme. Duke u bazuar tek Minkenber (2013a, fq.6), unë e përkufizoj ekstremin e djathtë si një “ideologji politike, elementi kryesor i të cilit është miti i një kombi homogjen,

¹ Do të doja të falënderoja Dr. Shannon Woodcock për komentet e saj dhe sugjerimet për ta përmirësuar këtë punim. Gjithashtu i jam falënderues Dr. Enis Sulstarova, i cili e ka lexuar dhe ka dhënë komentet e tij, në një variant më të hershëm të këtij punimi. Falënderimet i shkojnë edhe Dr. Leonidas Karakatsanis dhe Dr. Mark Herzog, të cilët kontribuan në cilësinë e këtij punimi dhe së fundmi, dy vlerësues anonim të cilët sollën në vëmendjen time disa pika të rëndësishme për këtë punim.

i një nacionalizmi romantik dhe populist i cili vihet kundër konceptit të një demokracie liberale dhe pluraliste dhe të parimeve të saj të individualizmit dhe universalizmit”. Përkundër saj qëndron ekstremi i majtë, partitë e të cilit janë ato që “mohojnë strukturën sociale të kapitalizmit të tanishëm, vlerat dhe praktikën e tij...[duke] advokuar për struktura ekonomike dhe të pushtetit alternativ të cilat përfshijnë një rindarje të burimeve nga elitat politike ekzistuese”(March 2011, fq.23).

Në Europën Lindore, dallimi midis të djathtës dhe të majtës është vështirë të ravijëzohet, duke qenë se shumica e partive radikale përdorin ideologjinë “e kuqe-kafe” e cila kombinon ideologjinë antikapitaliste të së majtës me retorikën nacionaliste të së djathtës (Ishiyama, 2009). Disa shembuj konkret të këtij pohimi teorik mund të jenë partitë radikale të rajonit si Ataka në Bullgari, Partia e Rumanisë së Madhe, Jobbik në Hungari dhe Partia Radikale Serbe në Shqipëri.

Kjo nuk do të thotë se të gjitha partitë politike radikale janë të ngjashme. Radikalizmi politik mund të jetë deri diku progresiv duke qenë se ai kundërshton status kuonë duke vënë theksin te gjithëpërfshirja, hapja dhe solidariteti ose regresiv kur mundohet të provokojë ndjenja urrejtjeje, inati dhe përjashtimi (Voutyras, këtë numër, fq.13, shikoni gjithashtu Karakatsanis dhe Herzog, hyrje).

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të nënvizojë faktin se në dallim nga shumë vende të rajonit, në Shqipëri nuk ka pasur parti radikale të suksesshme, që prej rënies së regjimit komunist në 1991. Rezultati më i mirë elektoral i një partie radikale ka qenë ai partisë Komuniste shqiptare në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001, e cila mori 0,91% të votave të elektoratit (Çeka 2013, fq.58). Ky është një rezultat i papërfillshëm krahasuar me 8.5% të Partisë Komuniste në Greqi në zgjedhjet e përgjithshme të Majit 2012, (Guida zgjedhore 2015,a).

Nëse i referohemi ekstremit të djathtë, Lëvizja nacionaliste dhe monarkiste e Legalitetit, arriti kuotën e 3,25% në zgjedhjet parlamentare të vitit 1997 (Çeka 2013, fq.55), rezultat shumë i ulët, krahasuar me kuotën 16.29% që mori Partia e Veprimit Nacionalist në zgjedhjet e përgjithshme të 2015-ës në Turqi (Guida zgjedhore 2015, b)

Përgjatë 25 viteve të fundit ekstremi i djathtë në Shqipëri ka qenë shumë pak më i suksesshëm se në shumicën e shteteve të tjera të Ballkanit. Shikoni Tabelën 1.

TABELA 1. VOTAT PËR PARTITË E EKSTREMIT TË DJATHTË PËR ÇDO ZGJEDHJE.

Vendi	Zgjedhjet				
	1	2	3	4	5
Shqipëria	4.97	2.30	2.40	0.60	0.34
Bullgaria	1.13	0.54	0.18	0.07	8.14

Kroacia	50	47.51	31.85	6.37	3.50
Rumania	8.82	19.48	15.12	5.42	13.98
Serbia-Mali i Zi	8.60	35.27	28.59	29.46	4.63
Sllovenia	3.22	4.39	6.27	5.40	1.80
Maqedonia	0.00	0.00	6.10	0.24	2.51

Burimi: Bustikova 2014, fq.1742.

Siç shihet nga tabela e mësipërme, Shqipëria është një nga të paktat vende ish-komuniste të rajonit ku votat për të djathtën ekstreme nuk e kanë kapërcyer pragun e 5% të votave të përgjithshme. Lëvizja më e re nacionaliste e quajtur Aleanca Kuq e Zi, e cila tërhoqi një mbulim të gjerë mediatik dhe publicitet gjatë zgjedhjeve të përgjithshme elektorale të vitit 2013, fitoi vetëm 0.59 % të votave (World Elections 2015). Thënë kjo, Shqipëria përbën një rast përjashtimor në rajon dhe më gjerë.

Kjo veçanti e skenës politike shqiptare të bën kurioz duke ditur se vendi gëzon të gjitha kushtet e nevojshme për ti dhënë jetë radikalizmit politik, kushte të cila mund të ndahen në 5 kategori të ndërlidhura me njëra- tjetrën dhe të cilat janë:

Tranzicioni i gjatë dhe i vështirë, nivelet e larta të korrupsionit, ndërtimi i vonuar i kombit, trashëgimia komuniste si edhe zgjedhjet e limituara politike për shkak të integritetit europian. *Së pari*, radikalizmi politik në Europën Juglindore është shpjeguar si një lëvizje proteste kundër një tranzicioni, të shenjuar nga reforma të vështira ekonomike (Anastasakis 2002, fq.5). *Së dyti*, këto lëvizje kanë qenë shprehje e pakënaqësisë me gjendjen aktuale e cila vlerësohej si “traumatike, anarkike, e korruptuar, dekadente dhe moralisht jo e pastër” (Tismaneanu 2007, fq.36).

Së treti, ideologjia e kuqe-e kaftë e shumicës prej partive radikale në Europën Lindore (si Ataka në Bullgari, Rumania e Madhe si edhe Partia Radikale Serbe), e cila kombinon anti-kapitalizmin, nacionalizmin dhe autoritarizmin lidhet drejt për së drejti me ideologjitë nacional-komuniste të regjimeve të mëparshme të rajonit dhe praktikave të tyre autoritare (Mude 2000, fq.13-14; Shafir 2000; Ishiyama 2009). *Së katërti*, krijimi i të djathtës ekstreme është parë si rezultat direkt i një procesi të vonuar të ndërtimit të kombit, ç’ka do të thotë se në Europën Lindore, nacionalizmi ka prevaluar mbi çështjet e tjera të ditës duke i dhënë kësaj forme radikalizmi (Stein, 2000). *Në fund*, disa studiues thonë se konvergjenca politike të aktorëve më të mëdhenj politik, në kontekstin e integritetit Europian, ka limituar zgjedhjet politike, duke krijuar një “efekt vakumi” i cili shërbeu si katalizator i krijimit të së djathtës ekstreme (Bustikova 2009, fq.237).

Këto 5 kushte kanë qenë të gjitha prezente në Shqipërinë post-komuniste. *Së pari*, gjatë tranzicionit të gjatë dhe të vështirë drejt një tregu të lirë, Shqipëria

vuajti nga kriza të thella ekonomike siç ishte ajo e vitit 1997, e cila çoi edhe në një kolaps të shtetit (Pettifer dhe Vickers 2007, fq.19). *Së dyti*, shumica e vëzhgimeve të kryera tregojnë se niveli i korrupsionit në Shqipëri është ndër më të lartit në rajon (Transparency International 2014). *Së treti*, regjimi komunist shqiptar ishte shumë nacionalist dhe totalitar. Thënë kjo, ekziston një trashëgimni nacional-komuniste dhe një kulturë politike autoritare në vend e cila është mjaft joshëse për radikalizmin politik. *Së katërti*, krijimi i kombit në Shqipëri është një fenomen shumë më i vonshëm krahasuar me Rumaninë, Bullgarinë, Serbinë pa përmendur këtu Greqinë. Në fakt, çështja kombëtare shikohet gjerësisht si një çështje e pazgjidhur për shkak të territoreve të banuara nga shqiptarët jashtë kufirit zyrtar. *Së fundmi*, mund të themi se distancë midis dy partive të mëdha, asaj socialiste dhe asaj demokratike, është pothuajse inegzistente që nga viti 1997 (Fuga, 2003). Në bazë të disa matjeve në lidhje me distancën politike midis dy partive të mëdha, për çështje si ajo e integritetit, ndasia ishte shumë e vogël krahasuar me vende si Rumania, Bullgaria, Serbia, Sllovakia dhe shumë shtete të tjera të Europës Lindore (Bustikova 2009, fq. 235). Ndërkohë, Shqipëria ka qenë ndër të paktët vende të Europës Lindore, së bashku me Republikën Çeke, Moldavinë, Ukrainën dhe Malin e Zi, ku partitë e ekstremit të djathtë nuk kanë qenë të suksesshme (Bustikova 2014, fq. 1739). Megjithatë këto vende kanë pasur një numër të lartë partish të ekstremit të majtë, si partia Komuniste e Bohemisë dhe Moravisë e cila fitoi 14,91% të votave në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 në Çeki (Guida Zgjedhore 2015 c), ndërkohë që parti të tilla nuk kanë qenë të suksesshme në vendin tonë.

Ky punim nuk kërkon të thotë se nuk ka pasur radikalizëm politik në Shqipëri që prej rënies së komunizmit. Por ama ka diçka të veçantë rreth radikalizmit të lëvizjeve sociale në Shqipëri. *Së pari* ato janë jashtëzakonisht sporadike ose të përkohshme. Protestat popullore të vitit 1997, të cilat filluan si lëvizje popullore spontane, çuna në kolapsin e skemave piramidale kur pjesa më e madhe e qytetarëve kishin humbur kursimet e tyre, protesta të cilat më vonë u kontrolluan nga partia socialiste opozitare (Mapo 2012). Protestat e vitit 2013, kundër armëve kimike në Shqipëri, e cila do të analizohet më gjatë në fund të këtij punimi, zgjati jo më shumë se një javë. *Së dyti*, protestat sociale në Shqipëri zor se sfidojnë status kuonë dhe në vend të kësaj ato fokusohen në kërkesa të veçanta. Protesta e vitit 1997, kërkoi që qeveria tu kthente kursimet që humbën në skemat piramidale. Protesta e vitit 2013, i kërkoi qeverisë që të mos pranonte ofertën e SHBA-ve për të marrë armët kimike siriane dhe për ti shkatërruar ato në vendin tonë. Për këtë rast të fundit, protestuesit nuk i kërkuan qeverisë që të jepte dorëheqjen. Ky përbën një dallim të rëndësishëm me vendet e rajonit ku mund të gjejmë lëvizje radikale sociale si ajo që filloi në Greqi në vitin 2010, protesta në Gezi Park në Turqi në vitin 2013, ose protestat e viteve 2013-2014 në Bullgari, të cilat prodhuan struktura më të falsifikuara sociale të cilat arritën të sfidonin status kuonë.

Ky artikull pohon se ekzistojnë dy faktorë të ndërvarur të cilat shpjegojnë mungesën e radikalizmit politik në Shqipëri. Faktori i parë është se eksperiencia traumatike që shqiptarët përjetuan në komunizëm ka ulur shanset për krijimin e çdo lloj diskursi ekstrem të majtë apo të djathtë. Për shkak të eksperiencës thellësisht zhgënjyese dhe traumatizuese me komunizmin, votuesit shqiptar u bënë shumë të pandikuar nga çdo lloj diskursi anti-kapitalist apo nacionalist të cilat mund të lidheshin me regjimin e mëparshëm komunist. Ky nuk është rasti i shteteve të tjera komuniste, ose vendeve të tjera të rajonit si Turqia apo Greqia, ku diskurset majtiste apo ato nacionaliste nuk janë deligitimuar në masën siç ndodhi në Shqipëri. Së dyti, skena shumë e bipolarizuar politike e ka ndarë shoqërinë Shqiptare në dy kampe konfliktuale, partia Socialiste kundërt partisë Demokratike, ndarja midis të cilave ka prodhuar hendeqe akoma më të mëdha potenciale.

Për ta vërtetuar pohimin e mësipërm, ky punim është ndarë në tri pjesë kryesore. *Pjesa e parë* analizon se si eksperiencia me komunizmin ishte shumë herë më traumatike se çdo vend tjetër, ç'ka minimizoi hapësirën për krijimin e çfarëdolloj ligjërimi të majtë apo të djathtë. Në pjesën e dytë mundohem të tregoj se niveli i bipolarizimit në Shqipëri gjatë këtyre 20 viteve të fundit ka qenë më i larti në të gjithë rajonin, faktor ky tjetër që e ndan Shqipërinë nga vendet e tjera post-komuniste dhe që shpjegon mungesën e partive ekstreme ose lëvizjeve sociale. Për ta vërtetuar se si eksperiencia komuniste dhe bipolarizimi janë kombinuar për të limituar ekstremizmin politik, unë marr si objekt studimi protestat e Nëntorit 2013, si një shembull i një radikalizimi të suksesshëm por të limituar social.

Eksperiencia traumatike komuniste

Komunizmi shqiptar mund të cilësohet si regjimi më shtypës dhe të izoluar në Europën Lindore. Në terma ekonomike, komunizmi e la Shqipërinë më GDP-në më të ulët në rajon në vitin 1990, ndërsa në terma social komunizmi ishte shumë herë më shtypës se sa ai rumun, cilësuar gjerësisht si një nga regjimet më të egra.


Siç thotë edhe Woodcock (2007, fq. 51), në një krahasim të komunizmit shqiptar me atë rumun:

Mungesa absolute e shakave politike rreth socializmit shqiptar në bisedat post-socialiste, kujtesat dhe në akademi, dallon shumë nga kontekste të tjera si ai romun, ku shakatë rreth periudhës së socializmit ishin shumë të shpeshta edhe gjatë kohës që Causheksu ishte akoma gjallë ...

Për pjesën më të madhe të shqiptarëve, komunizmi nuk ishte diçka me të cilën mund të qeshje apo të bëje shaka (Woodcock 2007, fq.53). Shqipëria ishte i vetmi vend

në Europë e cila mbeti e lidhur me një sistem shtypës politik dhe ekonomik Stalinist deri në kolapsin e sistemit komunist në 1991. Vend i vogël dhe rural, ishin dy kushte çfarë ka lehtësuar kontrollin mbi komplet shoqërinë shqiptare. Me një popullsi rreth 3 milion, “shumë mijë shqiptarë u zhdukën në kampet e punëtorëve, ndërsa 700.000 mijë të tjerë u bënë subjekt i formave të tjera të dhunës qeveritare” (Biberaj 1998, fq.71). Prandaj nuk është habi që gjatë viteve ‘90 komunizmi shikohej shumë herë më negativ se shumë nga vendet e tjera në rajon dhe më gjerë. Shikoni grafikun 1.

GRAFIKU 1. VLERËSIMI I KOMUNIZMIT
(1- SHUMË KEQ - 10 SHUMË I MIRË), 1995-1998.



Burimi: World Value Survey (WVS): vala 3: 1995-1998, V 151.

Siç rezulton edhe nga tabela, Rumania është i vetmi vend që ka pasur një perceptim pak më negativ se komunizmi në Shqipëri në vitin 1998. Është shumë e rëndësishme të vëmë re se studimi në Shqipëri, u zhvillua menjëherë pas krizës së vitit 1997, ku pjesa më e madhe e shqiptarëve humbën kursimet e tyre nga falimentimi i shumë firmave piramidale të cilat çuan në kolapsin total të shtetit. Përtej këtyre ngjarjeve shumë shqetësuese, sërish shqiptarët ndanin akoma perceptime shumë negative të së shkuarës së tyre komuniste.

Një aspekt i rëndësishëm që e veçon Shqipërinë nga vendet e tjera ish-komuniste është fakti se vlerësimi negativ i komunizmit nuk u ul me kalimin e kohës, siç ishte rasti me shumë vende të rajonit. Dy dekada pas rënies së komunizmit ka pasur një rritje të një nostalgjie komuniste (ose Yogo-nostalgjia) në të gjithë Europën Lindore (Todorova 2010). Përherë e më shumë qytetarë në ish-Blllokun Lindor janë bërë shumë kritik ose janë zhgënjyer me të tashmen e tyre post-komuniste, ç'ka ka prodhuar një vlerësim më pozitiv të asaj të shkuare. Shikoni tabelën 2 më poshtë.

**TABELA 2. SITUATA EKONOMIKE:
KOMUNIZMI VS. POST-KOMUNIZMI 2009-2010.**

Vendi	Hungaria (2009)	Slovakia (2009)	Bullgaria (2009)	Rumania (2010)
Më mirë në komunizëm	72%	48%	62 %	63 %
Më keq në komunizëm	8%	29%	13 %	23 %

Burimi: Pew Global Attitudes Project (2009), fq.5 dhe Dragomir (2011).

Situata në Shqipëri duhet të jetë katërçipërisht ndryshe sepse ekziston një konsensus i përgjithshëm tek e gjithë popullata se situata ekonomike në komunizëm ishte shumë më e keqe se pas rënies së regjimit. Shikoni tabelën 3 më poshtë:

**TABELA 3. SI DO TA SHPJEGONIT SITUATËN
E PËRGJITHSHME EKONOMIKE NË SHQIPËRI?**

	Komunizmi (para 1990)		Post-Komunizmi (1991-2010)	
Shumë keq	30%	75%	19%	35%
Keq	45%		16%	
Mirë	2%		31%	
Shumë mirë	0%	2%	1%	32%

Burimi: Rakipi, A. dhe Huibregtse, A. (ed.) (2011), p.62.

Është e rëndësishme të vëmë re se përgjigjet e mëposhtme duhen interpretuar si pakënaqësi ndaj të shkuarës komuniste se sa si një refleksion i kënaqësisë më të tashmen post-komuniste, sepse në të njëjtën pyetësor kur u pyetën për drejtimin ekonomik të vendit që prej 1991, vetëm 8.3% e tyre thashë se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur. Për më shumë shikoni tabelën e mëposhtme:

**TABELA 4. SA TË KËNAQUR JENI ME DREJTIMIN EKONOMIK
QË KA MARRË SHQIPËRIA QË PREJ VITIT 1991?**


Përgjigjet	Përqindjet	
Aspak të kënaqur	27	61,4
Jo të kënaqur	34,4	
Të kënaqur	8.2	8.3
Shumë të kënaqur	0.1	

Burimi: Rakipi, A. dhe Huibregtse, A. (ed.) (2011), fq.63.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se të intervistuarit kishin një përgjigje shumë herë më pozitive për gjendjen aktuale krahasuar me atë komuniste (35% keq krahasuar me 32% mirë). Kur u pyetën që të vlerësonin situatën ekonomike pas komunizmit veçmas, perceptimi ndryshon (61,4% të pakënaqur dhe 8.2% të kënaqur). Thënë kjo, më shumë se sa ishin të kënaqur nga e tashmja, ata kishin arsye për ta urryer të shkuarën e tyre komuniste.

Perceptimet negative të së shkuarës komuniste të kombinuara edhe me zhgënjimin nga klasa politike post-komuniste, prodhuan nivel të lartë legjitimiteti në popullatë për organizatat ndërkombëtare si Bashkimi Europian dhe NATO. Ndërkohë që ideologjia komuniste në Shqipëri vinte theksin tek zhvillimi vendas, të gjitha qeveritë post-komuniste e kanë vënë theksin tek zhvillimi si diçka që vjen prej së jashtmi. Në fakt, slogani i regjimit komunist deri në vitin 1991, në çështjet ekonomike ishte “Më anë të përpjekjeve tona”. Ndarja me komunizmin u reflektua nga slogani i qeverisjes së parë post-komuniste të 1992 “ne qeverisim dhe bota do të na ndihmojë! Sa më shumë që humbnin besimin tek politikanët dhe tek institucionet vendase, aq më shumë filluan ti besonin aktorëve dhe institucioneve ndërkombëtare. Shikoni grafikun 2.


**GRAFIKU 2. PËRQINDJET E ATYRE TË CILËT BESOJNË INSTITUCIONET
VENDASE DHE ATO TË HUAJA, 2013-2014.**



Burimi: IDM 2014, fq.3.

Siç tregon edhe grafiku i mësipërm, nivelet e larta të mosbesimit ndaj institucioneve vendase ishin të lidhura me nivelet e larta të besimit për institucionet e huaja. Për sa i përket mosbesimit për institucionet vendase, si Parlamenti apo partitë politike, Shqipëria nuk paraqet një panoramë shumë të ndryshme nga vendet e tjera të rajonit, ndërsa niveli i lartë i besimit në institucionet e huaja e ndan ata nga vendet e tjera post komuniste dhe vendet e tjera të rajonit. Shikoni paragrafin 3.

**GRAFIKU 3. BESIMI NË PARLAMENTIN EUROPIAN
DHE NË KOMISIONIN EUROPIAN 2014.**



Burimi: Standard Euro barometër 82 (2014), fq. T84 dhe T85.

Është interesante të shikohet se publiku shqiptar ka më shumë besim në Parlamentin European se sa shtetet anëtare të rajonit, të cilat votojnë për të. Niveli i lartë i besimit në institucionet e BE-së, nuk mund të shpjegohet me anë të efektit të anëtarësisë: fakt është se mbështetja për BE-në për shumë vende të Europës Lindore ka rënë pas hyrjes në BE. Barometri europian për Europën qendrore dhe atë lindore, i cili vëzhgoi 19 vende të rajonit në periudhën 1992-1996, përfshirë Rumaninë, Bullgarinë dhe Kroacinë, zbuloi se Shqipëria kishte një imazh më pozitiv për BE-në, më shumë se çdo vend tjetër i marrë në studim (Komisioni European 1996, fq.43).²

Legjitimiteti i rëndësishëm dhe ndoshta në rritje për institucionet ndërkombëtare në skenën politike shqiptare gjatë 20 viteve të fundit ka qenë një faktor tjetër që shpjegon mungesën e ekstremizmit politik në Shqipëri. Institucionet ndërkombëtare si BE-ja apo Ambasada Amerikane në Tiranë kanë qenë gardianët e politikës së moderuar shqiptare.


Ata kanë qenë të shpejt për të denoncuar dhe parandaluar çdo shfaqje të ekstremizmit politik nga e djathta ose e majta. Rasti më i fundit dhe më domethënës i këtij fenomeni ishte presioni i suksesshëm që ambasada amerikane në Tiranë solli në ligjërimin e Aleancës Kuq e Zi, një lëvizje radikale nacionaliste në Janar të 2013. Pasi u takua me ambasadorin e SHBA-ve, lideri i saj deklaroi se lëvizja do të fokusohet tek anti-korrupsioni, duke ripohuar edhe një herë se SHBA-të mbeteshin një dritë udhëzuese për lëvizjen e tij (Shqip 2013a). Larg të qenit radikal, ligjërimi anti korrupsion ka shërbyer kryesisht për të legjitimuar një rregull neo-liberal, veçanërisht gjatë periudhës 1998-2005, (Kajsiu 2015, fq.171).

Perceptimi negativ i sistemit politik dhe ekonomik komunist, kombinuar me legjitimitetin në rritje të institucioneve të huaja lehtësoi konsolidimin e

hemogjenisë liberale në skenën politike shqiptare dhe opinionin publik. Së pari, institucionet e huaja të cilat gëzonin nivele të larta legjitimiteti në sferën publike shqiptare, e mbështetën këtë hemogjeni. Së dyti, ligjërimi anti-komunist legjitimoi një rregull ekonomik neoliberal që promovoi liberalizimin politik edhe ekonomik, privatizimin dhe globalizimin si një përpjekje për të superuar të shkuarën komuniste. (Kajsiu 2015, fq. 52). Ky kombinim shpjegon pjesërisht se pse koncepte si liberalizimi dhe globalizimi shikohen më pozitivisht në Shqipëri krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Kështu në 2014, Shqipëria kishte nivelin më të lartë të të intervistuarve (45%) të cilët e shikonin liberalizimin si diçka shumë pozitive, krahasuar me Bullgarinë (16%) Rumania (18%), Greqia (13%) dhe Turqia (20%), (Standard Eurobarometer 2014, fq. T52 dhe T55).

Perceptimet tepër pozitive të liberalizmit mund të shpjegohen me faktin e vetëm se pjesa më e madhe e shqiptarëve e asocionin liberalizmin me lëvizjen e lirë, diçka kaq shumë të dëshiruar dhe të ndaluar gjatë regjimit komunist. Sigurisht, artikulli i lëvizjes së lirë, liberalizmit ekonomik dhe hapja si procese komplementare shërbyen si support për hemogjeninë ekzistuese neoliberale si edhe e kaluar traumatike dhe e izoluar komuniste. Kjo u reflektua në perceptimet shumë pozitive që shqiptarët kanë në lidhje me globalizmin krahasuar me shtete të tjera. Siç e tregon edhe grafiku 4, shqiptarët kanë përqindjen më të lartë të dakordsisë, për sa i përket përfitimeve ekonomike të globalizmit.

GRAFIKU 4. GLOBALIZMI SI NJË MUNDËSI PËR RITJE EKONOMIKE, 2014.



Burimi: Standard Eurobarometer 82 (2014), fq. T104.

Eksperiencia shqiptare me komunizmin kombinuar me legjitimitetin që fitoi modeli zhvillimor neo-liberal, ulën shanset për krijimin e ligjërimeve anti-kapitaliste, anti-globale ose atyre nacionaliste. Ideologjia komuniste kombinoi glorifikimin kombëtar të historisë së Shqipërisë me Marksizëm-Leninizmin (Lubonja 2012). Ajo përqafoi të majtën dhe të djathtën ekstreme duke qenë

² Do të doja të falënderoja një vlerësues anonim që ma solli në vëmendje këtë pikë.

se refuzimi ndaj kapitalizmit dhe globalizmit u mvesh me ligjërime të forta nacionaliste dhe për pasojë ligjërimet alternative të cilat ishin kritike ndaj tregut të lirë dhe globalizmit ose që kishin nota të forta nacionalizmi, mund të sulmoheshin lehtësisht si mbetje të mendësisë komuniste ose mjaftueshëm jo korrekte për të mërzhitur aleatët perëndimorë të Shqipërisë. Kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur ligjërime, parti apo politikanë nationalist në Shqipëri por mund të thuhet se ata nuk kanë arritur të krijojnë lëvizje të suksesshme politike. E ngjashmja shqiptare e partive të tjera nacionaliste në rajon, e quajtur si Partia e Rilindjes Kombëtare, e cila ka prodhuar shumë nga ligjërimet nacionaliste në media, ka qenë irrelevante në skenën elektorale që prej themelimit të saj në 1995 (Sulstarova 2015, fq. 88).

Është shumë e rëndësishme të theksojmë se mungesa e suksesit të ekstremit të djathtë në Shqipëri i atribuohen dy faktorëve shtesë, përveç atyre që thamë më lart. Së pari, partitë politike tradicionale që ekzistonin para komunizmit si për shembull Balli Kombëtar ose Lëvizja e Legalitetit, e cila përdori ligjërimet e ekstremit të djathtë, nuk gjeti mbështetje në elektorat. Përgjatë 45 viteve të komunizmit ata kanë qenë shënjestra e denigrimit nga propaganda zyrtare, historiografia dhe kinematografia. Një gjeneratë e tërë e shqiptarëve është rritur duke i parë këto forca ose si bashkëpunëtore të Nazizmit gjerman ose si tradhtarët të cilët braktisën dhe vodhën kombin, kur dihet se Mbreti Zog, u largua nga vendi në 7 Prill të 1939. Prandaj nuk është për tu habitur që shumica e shqiptarëve e shohin Leka Zogun, të birin e Mbretit Zog, lider i lëvizjes së Legalitetit “si një figurë komike me një reputacion të dyshimtë biznesi” (Vickers 1999, fq.249).

Së dyti, këto parti politike të djathta nacionaliste nuk ishin shumë joshëse për elektoratin rural shqiptar sepse ata ishin përfaqësuesit e familjeve të mëdha shqiptare dhe besohej se këto parti mbështesnin ndarjen e tokave në kurriz të popullsisë fshatare. Partia e Punës dhe pasardhësja e saj, Partia Socialiste do ta akuzonte shpesh partinë Demokratike në opozitë që po i jepte jetë të djathtës ekstreme, duke synuar heqjen e tokës nga fshatarët duke hequr reformën agrare të ndërmarrë nga regjimi komunist. Në fakt, humbja e zgjedhjeve e vitit 1991 nga Partia Demokratike, iu atribuua kryesisht “besimit të përhapur se ata do të rindanin tokat, ndërkohë që Partia e Punës, premtoi që do ta mbronte popullatën nga privatizimi” (Vickers 1999, fq.222). Unë jam i mendimit se këto dy elemente, mungesa e besueshmërisë tek elektorati rural, limitoi mundësitë për krijimin e këtyre partive nacionaliste dhe tradicionale.

Bipolarizimi politik

Një faktor tjetër që mund të shpjegonte mungesën e partive radikale në Shqipëri është niveli i lartë i bipolarizimit politik që e ka ndarë në mënyrë të suksesshme ligjërimin politik shqiptar si edhe elektoratin në dy kampe antagoniste: Partia

Socialiste në të “majtë” dhe Partia Demokratike në të “djathtë”. Siç ka thënë edhe një analist i njohur, “dy bandat” kanë punuar shumë për të ndarë opinionin publik në dysh, po ashtu edhe shoqërinë civile dhe median, me anë të një filozofie enveriste e cila udhëhiqet nga slogani “ai që nuk është me mua, është armiku im” (Lubonja 2013). Po ti hedhim një vështrim të shpejtë numrave të partive legjislative në Shqipëri përgjatë 22 viteve, kuptojmë se skena politike është dominuar nga një mesatare prej 2.33 partish.³ Shikoni tabelën më poshtë.

TABELA 5: NUMRI I PARTIVE POLITIKE NË SHQIPËRI 1991 - 2013.

Zgjedhjet	1991	1992	1996	1997	2001	2005	2009	2013	Mesatare
Parti me më shumë se 3% të vendeve në parlament	2	3	2	3	3	5	2	4	2,86
Parti legjislative efektive (Laakso dhe Taagepera 1979).	1,81	1,97	1,3	2,31	2,68	3,52	2,22	2,8	2.33

Burimi: Çeka, B (2013), fq.93, Guida Zgjedhore (2015,d) si edhe përlllogaritjet e vetë autorit.

Dominimi i sistemit politik shqiptar nga të njëjtët aktorë politik përgjatë 25 viteve të fundit është shumë e rrallë jo vetëm në botën post-komuniste por edhe në rajon e më gjerë. Krahasuar me 4 vende të tjera të rajonit, Shqipëria ka numrin më të vogël të partive efektive në këto 20 vite, ç’ka do të thotë se bipolarizimi ka qenë më i fortë se në këto vende. Shikoni tabelën 6 më poshtë.

TABELA 6. NUMRI I PARTIVE LEGJISLATIVE EFEKTIVE, 1990-2013.

Shqipëria	Numri i partive legjislative	Periudha
Bullgaria	3,34	1990-2009
Kroacia	3,07	1990-2007
Rumania	3.60	1990-2008
Slovenia	4,23	1990-2008
Shqipëria	2,33	1990-2013

Burimi: Jurek, P (2010), fq.118 dhe përlllogaritjet e autorit.

³ Kjo mesatare do të ishte më afër 2-it nëse do të merrnim në konsideratë faktin se numri i lartë i partive në 2005, rreth 3.52, ishte rezultat i votimit strategjik dhe faktit se PS dhe PDA i ftuan mbështetësit e tyre të maksimizonin votat e koalicionit.

Bipolariteti i skenës politike shqiptare filloi në vitin 1990, menjëherë pas kolapsit të regjimit komunist. Zvetërimi gradual ekonomik, social dhe politik i prodhuar gjatë komunizmit, shërbeu si një pikë ndarjeje midis atyre më tradicionalistëve dhe reformuesve Brenda vetë Partisë së Punës, e cila kontrollonte çdo aspekt të shoqërisë shqiptare. Që nga viti 1991, shoqëria shqiptare u nda në dysh, në dy kampe antagoniste, nga njëra anë ishte blloku antikomunist, kryesisht i përfaqësuar nga të rinjtë dhe pjesa më e arsimuar e vendit e cila ishte shumë kritike ndaj regjimit dhe kërkonte medoemos një ndryshim radikal në vend ndërsa në anën tjetër ishin mbështetësit e regjimit, kryesisht të përfaqësuar nga fshatarësia dhe pjesa më pak e arsimuar e popullatës e cila kërkonte ndryshime graduale, për shkak të një doze më të ulët kritike ndaj të shkuarës komuniste (Vickers 2001, fq.222). Zërat e këtyre të fundit u përfaqësuan nga Partia e Punës e cila në 10 Qershor 1991, u shndërrua në Partinë Social- Demokrate (Vickers 2001, fq.228). Ndërsa të parët u përfaqësuan nga Partia Demokratike e themeluar në 12 Dhjetor 1990, e cila fillimisht “mori përmasat e një lëvizjeje masive grupesh dhe individësh të cilët në kushtet normale nuk kishte gjasa të bënin koalicionin me njëri-tjetrin” (Biberaj 1998, fq.66).

Ajo përfshinte ish- të persekutuarit e regjimit si edhe ish- anëtarët të Partisë së Punës, si Sali Berisha, i cili shumë shpejt u bë lideri kryesor i PD-së (Ibid, fq. 69). Në zgjedhjet e para pluraliste të 31 Marsit 1991, pati përplasje midis këtyre dy kampeve në zonat urbane “fshatarët e ardhur në qytet për të shitur prodhimin e tyre u akuzuan nga qytetasit se ata bënë të mundur fitoren komuniste” (Vickers 2001, fq.223).

Përgjatë periudhës 1992-1997, kur Partia Demokratike mori pushtetin, u përqafuan dhe u legjitimuan një sërë reformash neo-liberale ekonomike dhe politike si privatizimi. Në vitin 1997, Shqipëria u konsiderua një vend model për institucionet e huaja si Banka Botërore (Bezemer 2006, fq.17). Për rrjedhojë PD dhe PS dalluan fort në terma të identitetit dhe politikave të tyre. Ndërkohë që të dyja partitë akuzonin dhe dënonin të shkuarën komuniste, PD-ja ishte shumë herë më kritikuese se sa partia opozitare. Në terma të politikave të ndjekura, PD-ja advokonte dhe implementoi privatizimin e shpejtë si edhe reforma të tjera liberale nën programin “terapia e shokut”, ndërsa PS-ja kërkonte transformime më radikale dhe të limituara të cilat nuk do të çonin në destabilizimin e shoqërisë shqiptare (Fuga 2003, fq.104-5). Këto dallime e ndanë elektoratin në dy kampe antagoniste të cilat nuk ranë dakord se si duhej transformuar vendi dhe për mënyrën se si duhej interpretuar të shkuarën e afërt komuniste.

Më ardhjen e Partisë Socialiste në pushtet (1997-2005), dallimet historike dhe politike midis dy kampeve filluan të zhdukeshin sepse në ndikimin dhe presionin e organizmave të huaja, qeveria socialiste vazhdoi dhe thelloi reformat liberale të cilat i kishte kritikuar kur kishte qenë në opozitë. Në vitin 2003, Shqipëria kishte një sektor privat më të madh se mesatarja e çdo vendi të OECD-së (Kajsiu 2015, fq.104). Në vitin 2002, baza sociale e të dyja partive ishte pothuajse identike në

terma të arsimimit (Kajsiu 2004, fq.35), ndërsa në vitin 2006 dallimi komunist vs. antikomunist u zbeh akoma më shumë për shkak të ndryshimeve të strukturës së leadershipit. Në atë vit partia socialiste “komuniste”, tashmë në opozitë, zgjodhi për lider të saj një antikomunist si Edi Rama, i cili nuk kishte qenë kurrë anëtar partie, ndërkohë që partia antikomuniste, PD, vazhdonte të drejtohej prej Sali Berishës, një ish komunist dhe ish kandidat i Komitetit Qendror i Partisë së Punës (Vickers 2001, fq.238).

Duke qenë se dallimet ideologjike dhe politike u venitën, dy partitë e mëdha, përherë e më shumë po bazoheshin tek marrëveshjet institucionale, rrjetet klienteliste dhe ligjërimet politike polarizuese për të ruajtur dominancën në skenën politike. Përgjatë 25 viteve dy partitë e mëdha e kanë ndryshuar sistemin politik zgjedhor përpara çdo zgjedhjeje në mënyrë që të ruanin pozitat e tyre politike (Çeka 2013, fq.70-71). Të dyja partitë ndërtuan rrjete klienteliste me anë të të cilave ata ruajtën besnikërinë e ndjekësve të tyre. Duke u bazuar tek Kitschelt (2000, fq.849), me klientelizëm i referohem një lloj lidhjeje ku bizneset u sigurojnë politikanëve para në këmbim të kontratave qeverisëse ose mbrojtjeje në treg, ndërkohë që militantët e partisë japin votat e tyre në këmbim të një vendi pune në sektorin publik. Në bazë të parimit të Kitschelt-it, dy partitë e mëdha në Shqipëri mund të përshkruhen si struktura të organizuara klienteliste të cilat u sigurojnë përfitime të veçanta mbështetësve të tyre. Siç e ka thënë edhe një studiues i njohur i skenës politike shqiptare:

Të gjesht një vend pune në hierarkinë shtetërore, ndërmarrjet shtetërore, spitalet, shkollat dhe institucione të tjera publike varen shumë prej lidhjeve që një person ka me partinë në pushtet, në nivel lokal ose kombëtar. (Fuga 2003, fq.240).

Kjo do të thotë se gara politike në Shqipëri ka qenë një lojë me shumatoren zero, ku partia fituese do të shpërndante hisen e fitores së saj me ndjekësit e saj më të zellshëm. Në fakt, gara e fundit midis Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike në pushtet në 21 Janar 2011, rezultoi me vrasjen e 4 protestuesve, të vrarë përballë zyrës së kryeministrit nga garda e republikës, një institucion i mbushur asaj kohe me mbështetës të partisë në pushtet (Likmeta 2014).

Sa më shumë që dy partitë kanë konvergjuar ideologjikisht dhe politikisht, aq më shumë janë përpjekur të polarizojnë skenën politike duke e portretizuar kundërshtarin e tij politik si një “rrezik” për popullin (Kajsiu 2010). Prandaj ligjërimi i urrejtjes ka qenë një nga karakteristikat përcaktuese të ligjërimin politik shqiptar dhe shkëmbimi politik midis dy liderëve është dominuar nga sulme personale dhe fyerjet (Halo, A. et al. 2012, fq. 9). Për këtë arsye, skena politike shqiptare i ngjan asaj të Greqisë në vitet 1990- 2000, ku polarizimi politik midis dy aktorëve politik, PASOK dhe NEA DIMOKRATIA, nuk bazohej aspak në dallimet ideologjike se

sa në identitetet e tyre historike dhe një gare të egër për mbështetje (Chrysogelos 2015, fq.23). Por ndryshe nga Greqia, ligjërimet radikale të majta ose të djathta nuk janë prezente në skenën politike shqiptare për shkak të së shkuarës traumatike komuniste.

Rast studimor: Protestat e Nëntorit 2013, në Shqipëri

Për të kuptuar se si e shkuara komuniste e kombinuar me një bipolarizim politik intensiv mund të limitojë krijimin e radikalizmit politik në Shqipëri, do të marrim në shqyrtim një nga lëvizjet e pakta të suksesshme qytetare e cila u zhvilluan në Shqipëri në javën e dytë të Nëntorit 2013. Një valë e madhe protestash filluan në Tiranë, të cilat shpejt u përhapën edhe në qytetet e tjera të vendit. Protestuesit kërkuan që qeveria shqiptare të refuzonte kërkesën e SHBA-ve, që në emër të organizatës për parandalimin e armëve kimike, për të ofruar territorin tonë si bazë e shkatërrimit të armëve kimike që do të vinin nga Siria (Bengali 2013). Protestat e para filluan në 7 Nëntor, edhe pse me një pjesëmarrje të ulët, në 12 Nëntor ishin disa mijëra persona në shesh. Situata filloi të përshkallëzohej dhe në datat 13 dhe 15 Nëntor, numri i protestuesve u rrit masivisht në Tiranë dhe rrethet e tjera. Një radikalizim dhe mobilizim kaq i shpejtë, surprizoi jo vetëm qeverinë por edhe shumë shoqata civile dhe në 15 Nëntor, kur duhej marrë një vendim përfundimtar, mijëra qytetarë kishin orë që protestonin përballë kryeministrit, ndërkohë që nxënësit e shkollave të mesme dhe universiteteve bojkotuan orët e mësimi për t'ju bashkuar protestës. Gjendur përballë numrit të lartë të protestuesve dhe radikalizimit të protestës, Kryeministri Edi Rama, vendosi të refuzojë kërkesën e protestuesve, duke injoruar përgjigjen e tij të parë "Po në parim" (Rama 2013a). Turmat iu përgjigjen pozitivisht dhe u shpërndanë në mënyrë paqësore.

Protestat e Nëntorit u mikpritën nga një numër vëzhguesish lokal si një gur themeli për demokracinë shqiptare, ndërsa të tjerë e panë si një pikë kthesë në politikën e jashtme dhe të fundit të një servilizmi të pa limituar të qeverisë shqiptare kundrejt aleatit të saj të madh SHBA-të (Baxhaku, 2013; Çipa 2013). Për disa të tjerë e quajtën një moment avangard ku qeveria nuk injoron më vullnetin e qytetarëve (Çavo 2013; Çoçoli 2013) ose si fillesa e rilindjes së qytetarëve shqiptarë, të cilët ishin në gjendje të shikonin përtej ndarjes qeveri-opozitë e cila i ndante dhe i kontrollonte ata (Erebara 2013; Gjoni 2013). Në fund, disa të tjerë e panë si një ndryshim gjenerues në skenën politike shqiptare sepse shumica e mobilizuesve ishin të rinj të cilët përdornin mjetet sociale si FACEBOOK, në vend të formave tradicionale të pjesëmarrjes (Salaj 2013; Erebara 2013). Megjithatë shpresat e fillimit, protestat e Nëntorit nuk prodhuan ndonjë gjë dhe aq motivuan për më shumë radikalizim. Në fakt në 2015, ato nuk përmenden më fare.

Të shpjegosh protestat e Nëntorit

Unë besoj se dy faktorë kyçë (midis të tjerëve) mundësuan protestat e Nëntorit 2013 në Shqipëri kundër armëve kimike siriane. Së pari, dhe mendoj më kryesori ishte heshtja e qeverisë dhe e opozitës në këtë çështje. Së dyti, fakti se vende më të zhvilluara të NATOS nuk pranuan kërkesën e SHBA-ve. Kjo shkaktoi frikë të publiku nga ideja se vendi po përulej nga presioni amerikan për të ndërmarr këtë mision kaq të rrezikshëm që asnjë vend nuk donte ta pranonte dhe ku Shqipëria nuk ishte fare e përgatitur për të tilla gjëra. Këto dy faktorë u kombinuan për të prodhuar frikë dhe irritim të cilat nuk u kanalizuan si gjithmonë në dikotominë qeveri-opozitë. Në vend të saj qytetarët pushtuan rrugët pavarësisht afiliacionit të tyre politik.

Kjo çështje mund të cilësohet si i vetmi moment në të shkuarën post komuniste shqiptare e cila nuk u farkëtua sipas interesave të pozitës dhe opozitës. Pa dashur të përballej me SHBA-të, Partia Demokratike e injoroi çështjen totalisht duke vazhduar me axhendën e saj politike duke zhvilluar protestën e saj, të pa lidhur me çështjen në fjalë, në 10 Nëntor 2013 (Panorama 2013a). Lideri i opozitës foli për këtë çështje vetëm njëherë në një postim në Facebook, në kohën kur situata kishte marrë hov të madh por pa mbajtur një qëndrim të qartë kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri (Panorama 2013,b).

Heshtja e qeverisë shqiptare mbi këtë çështje ishte akoma më shumë hutuese. Që nga momenti kur ajo u shfaq në mediat shqiptare në 26 Tetor 2013, deri në 15 Nëntor 2013, moment kur Edi Rama vendosi të refuzonte këtë kërkesë, pati vetëm dy prononcime të shkurtra të qeverisë mbi këtë çështje. Në 7 Nëntor 2013, ministri i jashtëm, deklaroi në një seancë dëgjuese në Komisionin e Politikës së Jashtme të Parlamentit shqiptar se qeveria ishte duke diskutuar me qeverinë amerikane mbi mundësinë e shkatërrimit të armëve kimike siriane në Shqipëri (Dita 2013). Në prononcimin e tij të parë në 11 Nëntor, Edi Rama, deklaroi se nuk kishte asnjë informacion shtesë në lidhje me këtë çështje të cilën mund ta ndante me publikun përtej asaj që kishte thënë ministri i jashtëm.

Do të doja ta theksoja qartë. Fakti se nuk ka më shumë informacion se ai që ka thënë ministri i jashtëm, vjen për faktin e thjeshtë se nuk ka më shumë informacion (Rama 2013,b).

Çfarë ishte për tu habitur ishte se: deklarata ishte fakti se në 11 Nëntor çështjeve të armëve kimike po u diskutohej gjerësisht jo vetëm në mediat shqiptare dhe në një sërë gazetash ndërkombëtare. Pra me fjalë të tjera, opinioni publik ishte i tej mbushur me informacion jo vetëm nga aktorët lokal por edhe nga media lokale.

Heshtja e opozitës dhe qeverisë mbi këtë çështje prodhoi një situatë të çuditshme ku një çështje publike nuk u farkëtua nga debate qeveri-opozitë. Për rrjedhojë, një numër i lartë qytetarësh u mobilizuan nga të dyja palët e spektrit politik dhe fitoi legjitimitet si një shqetësim që tejkaloi ndarjet politike në vend. Siç ka thënë edhe Lubonja (2013) “Rrallë se është parë në këto 20 vite që kaq shumë figura publike, të ndajnë të njëjtin opinion në lidhje me një çështje si [kjo e armëve kimike]”.

Bipolarizimi dhe moderimi

Duke qenë se protestat filluan të tërhiqnin një numër të lartë pjesëmarrësish gjatë javës së dytë të Nëntorit, Partia Demokratike u detyrua ti mbështeste ata. Menjëherë shumë analistë të afliuar me qeverinë filluan të kritikonin dhe ti deligjetimonin protestuesit si një instrument i Partisë Demokratike për tu rikthyer në fuqi (Baze 2013,b; Stefani 2013). Këto akuza nuk kishin baza sepse disa nga organizuesit kyç të protestës si Aleanca kundër Importit të Plehrave, kishte bashkëpunuar ngushtë me PS-në, në 2012 për të kundërshtuar aprovimin e një ligji që lejonte importimin e mbetjeve në vend nga Partia Demokratike, e cila akuzonte këtë organizatë se po shërbente si vegël në duart e Partisë Socialiste. Megjithatë, pavarësisht akuzave të tilla të pabazuara, organizuesit u munduan të theksonin arsyet se pse nuk duheshin pranuar armët siriane në Shqipëri, pa përmendur asnjëherë kërkesën për dorëheqje të kryeministrit, duke evituar që kjo të ngjante si një përplasje qeveri-opozitë. Kjo çoi në moderimin e protestuesve dhe limitimin e kërkesave të tyre në marrjen e masave specifike dhe refuzimit të propozimit amerikan.

Për të evidentuar se si u shmang ndarja e përhershme qeveri-opozitë mbi këtë çështje, unë kam monitoruar editorialet dhe pjesët e opinionëve të 4 gazetave ditore më të mëdha në vend, një kritikë ndaj qeverisë (Panorama) dhe 3 të tjera afër qeverisë para dhe pas marrjes së vendimit nga qeveria mbi këtë çështje. Gjatë periudhës 10 ditore 5-15 Nëntor, kur debati vlonte por, qeveria dhe opozita heshtnin, pjesa më e madhe e artikujve ishin kundër shkatërrimit të armëve në territorin shqiptar dhe në mbështetje të protestave popullore. Shikoni tabelën 7 më poshtë:

TABELA 7. EDITORIALET DHE OPINIONET ME ÇËSHTJEN E SHKATËRRIMIT TË ARMËVE KIMIKE SIRIANE NË SHQIPËRI, 5-15 NËNTOR, 2013.

Gazetat	Pro marrjes	Pro protestuesve	Asnjëherë
Panorama	1	14	1
Tema	0	3	1
Shqip	1	13	1
Dita	2	3	0
Total	4	33	5

Mungesa totale e qeverisë në debatet publike në këtë çështje prodhoi konfuzion të madh në median pro saj. Një analist i njohur politik dhe mbështetës i qeverisë shprehu frustrimin e tij dhe të shumë mediave pro qeveritare me kryeministrin kur u ankua në një editorial se “të mbrosh Edi Ramën si lider është gjëja më e vështirë në Shqipëri, edhe atëherë kur ti ke vendosur ta mbështesësh. Të mbrosh një lider kur nuk e di se çfarë ai po mendon është pothuajse e pamundur” (Baze, 2013a). Media shqiptare dhe analistët politik, të cilët në funksionin e tyre janë zgjatues të dy kampeve politike, ishin të humbur në një debat publik ku qeveria nuk mbante një qëndrim. Sapo Edi Rama mbajti fjalimin e tij në 15 Nëntor 2013, ku pohonte se Shqipëria nuk ishte në gjendje ti pranonte armët kimike në territorin e saj dhe ku ai shpjegonte arsyet se pse ai më herët kishte thënë “po parimisht” ofertës amerikane, mbulimi mbi këtë çështje ndryshoi në mënyrë dramatike. Shikoni tabelën 8 më poshtë:

TABELA 8. ARTIKUJT MBI PROTESTAT E NËNTORIT NË SHQIPËRI, 15- 25 NËNTOR

Gazetat	Pro - protestuesve	Kundër - protestuesve	Neutral
Panorama	6	0	4
Tema	0	1	2
Shqip	8	4	1
Dita	1	9	0
Total	15	14	7

Një ndërhyrje e vetme nga kryeministri në një fjalim 30 minutësh ishte i mjaftueshëm për ti dhënë një kthesë tjetër debatit në median e shkruar. Megjithëse ai, pranoi kërkesën e protestuesve, kritikën e tij ndaj instrumentalizimit prej Partisë Demokratike, ndryshoi diskutimet në mediat e shkruara (Rama 2013, a). Një numër artikujsh kritikonin protestuesit si të frymëzuar nga opozita duke e rifutur debatin Brenda skemës së vjetër qeveri- opozitë.

Ligjërimi anti-komunist dhe moderimi

Protestat e Nëntorit treguan se mobilizimi politik dhe debati në Shqipëri i ngjan ligjërimeve antikomuniste edhe atëherë kur nuk është farkëtuar nga qeveria apo opozita. Nga 42 artikuj të monitoruar nga data 5 Nëntor deri në 15 Nëntor (shikoni tabelën 8), më shumë se 25% (11 artikuj) i referohen direkt të shkuarës komuniste. Ata që ishin të propozimit amerikan i qortuan protestuesit si rizgjues të frikërave irracionale komuniste ndaj “imperializmit amerikan”, madje një analist i njohur nën titullin “SHBA-të nuk janë” “Imperializmi Amerikan” I Enver

Hoxhës” shprehte shqetësimin e tij rreth kësaj frymë antiamerikane në vend, duke argumentuar se SHBA-të “po viheshin në vendin e imperializmit amerikan” dhe projekti për shkatërrimin e armëve kimike të Asadit, ishte vetëm një rrezik tjetër amerikan për Shqipërinë, siç ishte formuluar njëherë e një kohë edhe nga diktatori Enver Hoxha” (Stefani 2013). Në të njëjtën filozofi, një analist tjetër, në artikullin me titull “Një betejë e pistë paranojash dhe SHBA-të” pohonte se opozita ishte ajo që po ushqente ndjenja antiamerikane tek protestuesit e painformuar shqiptarë (Baze 2013,b).

Analistët politikë të cilët ishin pro protestuesve kundër SHBA-ve, argumentuan se të tilla akuza bazoheshin pikërisht tek ideologjia komuniste që ata po kritikonin. “E vërteta është se kjo lloj Amerikë të cilës ne duhet ti themi gjithmonë “Po” për çdo gjë është krijuar nga politikanët tanë për të na shpëlarë trurin ne, në të njëjtën mënyrë siç bënte edhe diktatori Hoxha kur u krijua BSH dhe Kina” (Lubonja 2013).

Analistë të tjerë e përdorën këtë ligjërim antikomunist për të përqeshur vendimin e kryeministrit për të marrë në konsideratë shkatërrimin e armëve kimike në Shqipëri, madje njëri satirizoi me vargjet e një kënge komuniste ardhjen e gazit saarin në vend: “Shqipëria ka festë të madhe, gazi po vjen nga Siria (Tupja 2013). Dikush tjetër i referohej kryeministrit si “shoku E” duke iu referuar diktatorit Enver Hoxha, duke pasur parasysh heshtjen e tij dhe refuzimin për të diskutuar çështjet e armëve kimike në publik (Lepja 2013).

Pavarësisht dallimeve, të dyja palët nxorën argumentet e tyre duke refuzuar të shkuarën komuniste, duke ripohuar pro amerikanizmin e tyre dhe kredencialet pro demokratike. Ishte diçka për tu shënuar se si shumë qytetarë që protestonin para ambasadës amerikane, kundër propozimit amerikan, ishin shumë të kujdesshëm të mos kryenin asnjë akt që mund të interpretohej si manifestim i anti amerikanizmit. Organizuesit e protestës u kujdesën që të mos kishte slogane antiamerikane dhe pjesa më e madhe e protestuesve po përdornin slogane të cilat nuk sulmonin SHBA-të si p.sh. “Shqipëria është e jona”, “Ne e duam jetën” dhe “Jo armëve kimike”. Për më tepër protestuesit përdorën ligjërimin amerikan dhe simbolet e tyre për të dalë kundra propozimit të SHBA-ve. Slogani “Po ne mundemi, Thuaj Jo” bazuar tek fushata e Obamës, ndërsa një tjetër poster tregonte një gisht, Xhaxha Sam, i thërriste njerëzit të protestonin (Aljazeera 2013).

Megjithatë ishte një moment i qartë radikalizimi social, protestat e Nëntorit të 2013 në Shqipëri ishin shumë të moderuara krahasuar me lëvizje të tjera në rajon. Në Bullgari, protestuesit përdorën humorin dhe karnavalet për muaj me radhë, duke u bazuar tek një traditë e vjetër, ngulitur në shpirtin e të shkuarës socialiste midis asaj që ata premtonin dhe asaj çka ofronin në fund (Koycheva, këtë numër fq. 9).

Në rastin shqiptar, protestat zgjatën vetëm një javë dhe u kërkuar dorëheqja e qeverisë. Ndryshe nga Bullgaria, protestat në Shqipëri mund të mbijetonin vetëm

me anë të izolimit të së shkuarës dhe jo të mbështetjes në traditën komuniste. Nuk ka grupe anti-globale apo anti-kapitaliste në protestat e Nëntorit siç ishte rasti i grupit Suni islamik, i quajtur Myslimanët anti kapitalist të cilët organizuan tryezat e tokës gjatë protestave në GEZI park në Stamboll (Damar, këtë numër, fq.9).

Në fund, protestat e Nëntorit të 2013 në Shqipëri nuk patën impakt në skenën politike shqiptare, sapo kryeministri plotësoi kërkesën e tyre, ata u shpërndanë, krahasuar me protestuesit në Turqi, të cilët i hapën rrugë aleancave të reja politike surprizuese midis Kurdëve dhe Sekularistëve ndërkohë që protestat e Dhjetorit 2008, në Greqi hodhën bazat për lëvizjen kundër masave të BE-së, dhe suksesin politik të SYRIZA (Karakatsanis, këtë numër, fq.12-13).

Përfundime

Në këtë artikull unë kam diskutuar se mungesa relative e radikalizimit politik dhe social në Shqipëri, krahasuar me vende të tjera në rajon, mund të jetë rezultat i dy faktorëve të ndërruar. Së pari, eksperiencia traumatike e shoqërisë shqiptare me komunizmin zvogëloi hapësirat për ligjërimi të majta apo të djathta të cilat mund të risillnin në mendje të shkuarën diktatoriale. Kjo çoi në forcimin e heomogjenisë neoliberale e cila u vendos pas rënies së komunizmit dhe legjitimitetit të institucioneve ndërkombëtare të cilat shërbyen si ruajtës të moderimit të skenës publike shqiptare. Së dyti, sistemi politik thellësisht i bipolarizuar dhe klientelist në Shqipëri e ndau sferën publike në dy kampe antagonistë (socialiste dhe demokratike) duke zvogëluar krijimin e lëvizjeve sociale dhe politikisht radikale.

Sigurisht që kanë ekzistuar radikalizime sociale në të shkuarën komuniste shqiptare: nga 1997 deri në Nëntor 2013, deri tek euforia nacionaliste përgjatë ndeshjeve ndërkombëtare të futbollit. Diçka të përbashkët që kishin këto ishte natyra e tyre spontane dhe kontestimi i limituar i status kuosë politike dhe ekonomike që vjen si rezultat i faktit se protestat sociale janë pjesë e bipolarizimit të thellë politik dhe nga ana tjetër ata nuk mund të bazohen tek ligjërimi alternative të djathta apo të majta të cilat do tu mundësonin atyre të superonin bipolarizimin ekzistues. Dikush mund të spekulonte se në të ardhmen, me zhdukjen e legjitimitetit komunist dhe sistemit klientelist bipolar do të jetë i dobët, ne mund të jemi dëshmitarë të lëvizjeve më të fuqishme politike dhe sociale në vend. Një krizë e thellë ekonomike që mund të limitonte sistemin klientelist momental kombinuar me ardhjen e gjeneratave të reja do të krijonte shtigje të reja për radikalizimin politik dhe social. Mbetet për tu parë se si ky radikalizim do të jetë produktiv dhe progresiv, duke vënë theksin tek solidariteti, përfshirja, drejtësia sociale apo do të jetë agresiv, regresiv dhe do të promovojë përjashtim, inat dhe urrejtje.

Edhe pse ky punim u fokusua tek Shqipëria, teza që ajo propozon mund të përdoret edhe në vende të tjera të rajonit dhe më gjerë. Duke u bazuar në rastin

shqiptar, mund të ndërtoj hipotezën se radikalizimi politik dhe social është i limituar në ato vende ku shumica preferon të tashmen post komuniste në vend të së shkuarës komuniste dhe ku ekziston një nivel i lartë bipolarizimi. Problemi është se vetëm pak vende të botës post komuniste mund ti përmbushnin këto dy kushte. Por ama është e mundur ta riformulojmë të njëjtën hipotezë në mënyrë të tillë që të testohet kundra një numri të madh rastesh. Sërish të bazohesh në eksperiencën shqiptare, mund të pritet se radikalizimi politik dhe social mund të jenë relativisht të suksesshëm në vende ku shumica preferon të shkuarën komuniste kundrejt të tashmes post komuniste dhe ku ekziston një nivel i ulët bipolarizimi. Ndërkohë që ky punim thotë se Shqipëria e pohon këtë hipotezë, kërtime të mëtejshme mund ta testojnë në një numër më të madh rastesh.

Bibliografia

- Aljazeera (2013). "Albanians protest over Syria chemical weapons dismantling proposal", November 13. Gjendet: <http://america.aljazeera.com/articles/2013/11/13/albanians-protest-syria-chemical-weapons-dismantling-proposal.html> [parë në 5 Gusht 2015].
- Anastasakis, O. (2002) "The Politics of Extremism in Eastern Europe: A Reaction to Transition". *Papeles del Este*, Vol. 3, fq.1-15.
- Avci, G. (2011). "The Nationalist Movement Party's Euroscepticism: Party ideology Meets Strategy". *South European Society and Politics*. Vol. 16, No. 3, fq. 435-447.
- Baze, M. (2013a). "Një humbje 'a forfait' për Edi Ramën. *Tema*, 12 Nëntor. Gjendet: <http://www.gazetatema.net/web/2013/11/12/nje-humbje-a-forfait-per-edi-ramen/> [parë në 17 Mars 2016].
- Baze, M. (2013b). "Një betejë e ndyrë me paranoja dhe SHBA". *Tema*, Nëntor 14.
- Baxhaku, F. (2013). "Kushti VI për në Perëndim". *Shqip*, 16 Nëntor.
- Bengali, S. (2013). "Albania asked to host destruction of Syria's chemical arsenal". *Los Angeles Times*, 10 Nëntor. Gjendet: <http://articles.latimes.com/2013/nov/10/world/la-fg-us-albania-20131110> [parë në 5 Gusht 2015].
- Bezemer, J.D. (2006). "Growth But Not Development: The Ponzi Economy and Its Lessons". In: D.J. Bezemer, ed. *tek Eagle's Wings: The Albanian Economy in Transition*. New York: Nova Science Publishers, fq.17-33.
- Biberaj, E. (1998). *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*. Boulder, Colorado: Westview Press.
- Bustikova, L. (2014). *Revenge of the Radical Right*. Comparative Political Studies 2014, Vol. 47(12) 1738-1765.
- Bustikova, L. (2009). "The Extreme Right in Eastern Europe: EU Accession and the Quality of Governance". *Journal of Contemporary European Studies*, 17:2, 223-239.
- Chrysosgelos, A. (2015). Foreign policy change in a polarized two-party system: Greece and Turkey's EU candidacy. *Southeast European and Black Sea Studies*, 15:1, fq.19-36.
- Çavo, Z. (2013). "Për të ndryshuar zakonet e vjetra". *Shqip*, 18 Nëntor.
- Çeka, B. (2013). *Tezë Doktorature: Marrëdhënia Mes Sistemeve Zgjedhore, Sistemit Partiak dhe Sjelljes Zgjedhore në Shqipëri*. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale,

- Departamenti i Shkencave Politike. Gjendet: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/08/Doktorature-Blendi-Ceka-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Shkencave-Politike.pdf> [parë në: 10 Shtator 2015].
- Cipa, A. (2013). "Rënia e yes-menëve larton demokracinë reale". *Shqip*, 16 Nëntor.
- Çoçoli, F. (2013). "Vullneti qytetar dhe standardi Rama". *Shqip*, 23 Nëntor.
- Dita (2013). "Bushati përgjigjet për armët kimike: Rama, bisedë telefonike me Kerry". 8 November. Gjendet: <http://www.gazetadita.al/bushati-viti-i-ardhshem-deciziv-per-statusin-merita-eshte-e-perbashket/> [parë në 16 Mars, 2015].
- Dragomir, E. (2011). "In Romania Opinion Polls Show Nostalgia for Communism". *Balkan Analysis.com*. Gjendet: http://www.balkananalysis.com/romania/2011/12/27/in-romania-opinion-polls-show-nostalgia-for-communism/#_edn1 [parë në 14 prill, 2015].
- Election Guide (2015). *Albania*. ElectionGuide: Democracy Assistance and Election News. Gjendet : <http://www.electionguide.org/elections/id/1664/> [parë në 5 Gusht 2015].
- Election Guide (2015a). *Greece*. Election Guide: Democracy Assistance and Election News. Gjendet: <http://www.electionguide.org/elections/id/1627> [parë në 2 tetor 2015].
- Election Guide (2015b). *Turkey*. Election Guide: Democracy Assistance and Election News. Gjendet : <http://www.electionguide.org/elections/id/2748/> [parë në 25 Shtator 2015].
- ElectionGuide (2015c). *Czech Republic*. ElectionGuide: Democracy Assistance and Election News. Gjendet: <http://www.electionguide.org/elections/id/558/> [parë në 25 Shtator 2015].
- Election Guide (2015d). *Albania*. ElectionGuide: Democracy Assistance and Election News. Gjendet : <http://www.electionguide.org/countries/id/3/> [parë në 2 Tetor 2015].
- Erebara, Gj. (2013). "Përpjekja pa fund për mohimin e protestës". *Shqip*, 23 Nëntor.
- European Commission (1996). *Public Opinion and the European Union (19 Countries' Survey)*. Central and Eastern Eurobarometer, No. 6.
- Fuga, A. (2003). *Majtas jo djathtas: ndryshimi te socialistët shqiptarë në këndvështrimin e filozofisë politike bashkëkohore*. Tirana: Ora.
- Giugal, A., Johnston, R. & Constantinescu, S. (2011). "Democratic Musical Chairs? Romania's Post-1989 Electoral Geography". *Space and Polity*, 15 (2), fq. 143-161.
- Halo, A., Toska, S., Shameti, S., Lafe, E., Danaj, S., Rusi, A., Ndoj, D. (2012). *Analiza e Ligjërimit Politik. Raporti Nr.1: Monitorimi i Deklaratave të Figurave Kryesore Politike - Sali Berisha dhe Edi Rama*. Tirana: Fondacioni Shoqëria e Hapur SOROS.
- IDM (2014). Open Government Partnership Project: Opinion Poll "Trust in Government". Tirana: Institute for Democracy and Mediation. Gjendet: http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Factsheet_opinion_poll_eng.pdf [parë në 2 Tetor 2015].
- Ishiyama, J. (2009). Historical legacies and the size of the red-brown vote in post-communist politics, Communist and Post-Communist Studies, 42(4), fq. 485-504.
- Jurek, P. (2010). "The Institutionalization of Party Systems - Bulgaria, Romania, Croatia and Slovenia in a Comparative Perspective". *Politics in Central Europe* 6 (1), fq.110-123.
- Kajsiu, B. (2015). *A Discourse Analysis of Corruption: Instituting Neoliberalism Against Corruption in Albania, 1998-2005*. Surrey: Ashgate.
- Kajsiu, B. (2012). "The Instrumentalisation of Media in Albania". *Sudost-Europa*, Issue 1, fq. 31-52.
- Kajsiu, B. (2010). "Down with Politics! The Crisis of Representation in Post-Communist Albania". *East European Politics and Societies*. 24 (2), fq. 229-253.

- Kajsiu, B. (2004). "Albanian Political Parties" in Karasimov, G. (ed) *Political Parties and the Consolidation of Democracy in South Eastern Europe*. Sofia: Friedrich Ebert Stiftung, fq.9-38.
- Kitschelt, H. (2010). "Linkages between Citizens and Politicians in Democratic Polities". *Comparative Political Studies*. 33 (6/7), fq. 845-879.
- Lepaja, F. (2013). "Kopshti ynë me lule". *Shqip*, 13 Nëntor.
- Likmeta, B. (2014). "Albania remembers fatal riot victims". *BalkanInsight*, 21 January. Gjendet <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-remembers-january-deadly-riot-victims> [parë në 3 Gusht 2015].
- Lubonja, F. (2013). "Pse kemi frikë se do na sjellin helmin në shtëpi". *Panorama*, 13 Nëntor.
- Lubonja, F. (2012). "Shqiptarët dhe nacional-europianizmi". *Panorma*, 19 December. Gjendet: <http://www.panorama.com.al/shqiptarët-dhe-nacional-europianizmi/> [parë në 21 Maj 2015].
- Manaj, A. (2013). "Referendumi i mbyll gojën të gjithëve". *Shqip* 14 Nëntor
- March, L. (2011). *Radical Left Parties in Europe*. London and New York: Routledge.
- Mapo (2012). "Lubonja, unë, '97, apokalipsi". Mapo, 29 Mars. Gjendet: <http://www.mapo.al/2012/03/lubonja-unë-97-apokalipsi> [parë në 25 Shtator 2015].
- Minkenberg, M. (2013a). "From Pariah to Policy-Maker? The Radical Right in Europe, West and East: Between Margin and Mainstream". *Journal of Contemporary European Studies*, 21:1, 5-24.
- Minkenberg, M. (2013b). "The European Radical Right and Xenophobia in West and East: Trends, Patterns and Challenges". In Melzer, R. and Serafin, S. (eds.) *Right Wing Extremism in Europe*. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung.
- Mudde, C. (2007). *Populist Radical Right Parties in Europe*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Mudde (2000). "Extreme-right Parties in Eastern Europe". *Patterns of Prejudice* 34 (1), fq. 5-27.
- Panorama (2013a). "Rama-Meta blejnë vota që të qeverisin si në xhungël. Ne do e ndalojmë me çdo çmim". Nëntor 11. Gjendet <http://www.panorama.com.al/nis-grumbullimi-para-pd-gati-protesta-kundër-blejës-së-votës/> [parë në Mars 18, 2015]. është arrogancë". 11 Nëntor. Gjendet <http://www.panorama.com.al/basha-heshtja-e-qeverisë-për-armët-kimike-arrogancë/> [parë në 18 Mars 2015].
- Panorma (2013c). "AKIP, 10 arsyt përse Shqipëria duhet ti refuzojë armët kimike", 9 Nëntor. Gjendet: <http://www.panorama.com.al/akip-10-arsyet-pse-shqipëria-duhet-ti-refuzojë-armët-kimike/> [parë në 7 Gusht 2015]
- Pettifer, J, Vickers, M. (2007). *The Albanian Question: Reshaping the Balkans*. New York: I. B. Tauris.
- Powell, Eleanor N. -Tucker, Josua A. (2009): New Approaches to Electoral Volatility: Evidence from Postcommunist Countries. Working paper,
- Rakipi, A. and Huibregtse, A. (ed.) (2011). *Twenty Years After: People on State and Democracy*. Tirana: Albanian Institute for International Studies (AIIS), p. 61.
- Rama, E. (2013a). "Rama: Shqipëria, të pamundur operacionin e armëve kimike". *Shqiptarja.com*, 15 November. Nëntor <http://shqiptarja.com/home/1/rama-shqipëria-të-pamundur-operacionin-e-armëve-kimike-187164.html> [parë në 15 Mars 2015].
- Rama, E. (2013b). "Armët Kimike, Rama: Diskutimet në Kuvend dhe me Protestuesit. *Shqiptarja.com*, Nëntor 12. Gjendet : <http://shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=186696&IDKategoria=1> [parë në 15 Mars, 2015].
- Shafir, M. (2000). "Marginalization of mainstream? The extreme right in post-communist Romania" in: P. Hainsworth (Ed.) *The Politics of the Extreme Right: From the Margins to the Mainstream*. London: New York: Pinter, fq. 247-267.
- Shqip (2013a). "Ambasadori Arvizu takon Kreshnik Spahiun: Patriotizmi gjë e mirë, por të mos rrëshqasë në nacionalizëm". 29 January. Gjendet <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/01/29/ambasadori-arvizu-do-të-takohet-me-kreshnik-spahiun/> [Parë në 21 Maj 2015].
- Shqip (2013b). "Armët kimike, vijon protesta para Kryeministritë. Protestuesit "përzënë" Berishën e Bashën", 14 November. Gjendet: <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/11/14/proteste-para-parlamentit-kundër-armëve-kimike-meta-nuk-ka-vendim-dëgjohet-zëri-juaj> [parë në 18 Mars 2015].
- Standard Eurobarometer 82 (2014). *Tables of Results: Public Opinion in the European Union*. European Commission. Gjendet: http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/eb/eb82/eb82_first_en.pdf [parë në 17 Korrik 2015].
- Stefani, A. (2013). "SHBA-ja nuk janë "imperializmi amerikan" i Enver Hoxhës". *Shqip*, 11 Nëntor.
- Stein, J. (Ed.) (2000) *The Politics of National Minority Participation in Post-Communist Europe*. Armonk, NY/London: M. E. Sharpe.
- Sulstarova, E. (2015). *Ligjërimi Nacionalist Shqiptar dhe studime të tjera*. Tirana: Pika pa sipërfaqe.
- The Pew Global Attitudes Project (2009). "Two Decades After the Wall's Fall: End of Communism Cheered But Now with more Reservation", fq. 5.
- Tismaneanu, V. (2007). "Leninist Legacies, Pluralist Dilemmas". *Journal of Democracy*, 18 (4), fq. 34-39.
- Todorova, M. (2010). "Introduction: From Utopia to Propaganda and Back", in Todorova, M. and Gille, Z. (eds), *Post-communist Nostalgia*. New York: Berghahn Books, F. fq. 1-16.
- Transparency International (2014). Corruption Perception Index 2014: Results- Eastern Europe and Central Asia. Gjendet : <http://www.transparency.org/cpi2014/results> [Parë në 20 Korrik 2015].
- Tupja, E. (2013). "Gaz dhe hare". *Panorma*, 10 Nëntor.
- Vickers, M. (2001). *The Albanians: A Modern History*. London and New York: I. B. Tauris.
- Woodcock, S. (2007). "The absence of Albanian jokes about socialism, or Why some dictatorships are not funny" in *The Politics and Aesthetics of Refusal*, edited by Caroline Hamilton, Will Noonan, Michelle Kelly and Elcine Mines Cambridge Scholars Press, Newcastle, 2007.
- World Elections (2015). "Albania 2013". *World Elections: Elections, Referendums and Electoral Strategy Around the World*. Gjendet: <https://welections.wordpress.com/2013/06/28/albania-2013/> [parë në 17 Korrik 2015]
- World Value Survey (WVS). Online Data Analysis: Wave 3:1995-1999. V151-Rating: Political System. Gjendet: <http://www.worldvaluessurvey.org/WVSOnline.jsp> [parë në 25 Korrik 2015].
- World Value Survey (WVS). Online Data Analysis: Wave 4: 2000-2004. Available at: <http://www.worldvaluessurvey.org/WVSOnline.jsp> [parë në 17 Korrik 2015].

Ligjërimi “i pakohë” i anormalitetit shqiptar në revistën Time (1923–2013) —

Dr. Belina Budini

PËRGJEGJËSE E DEPARTAMENTIT TË KOMUNIKIMIT DHE
MARRËDHËNIEVE PUBLIKE.

ABSTRAKT. Argumenti kryesor i këtij artikulli është se subjekti i Shqipërisë në mediat e huaja, përfaqësuar nga revista amerikane Time, është ndërtuar dhe paraqitur si përsëritje ndërmjet viteve 1923–2013. Megjithatë këtu është vënë në qendër periudha 1990–2013, të dhënat dhe kërkimet për dy periudha më të hershme, atë ndërmjet viteve 1923–1944 dhe 1945–1989, flasin për rimarrje të subjektit të Shqipërisë në të njëjtat terma sasiore dhe përmbajtësore nga ana e revistës më të rëndësishme të aktualitetit të përgjithshëm në botë. Metoda e përdorur për të analizuar të dhënat është analiza e përmbajtjes së mediave si edhe analiza e agjencisë. Për sa i përket analizës së përmbajtjes, të dhënat sasiore tregojnë se hapësira dhe vendi kushtuar subjektit të Shqipërisë në rubrika, tematika, frekuenca dhe kënde shikimi mbeten konstante nga njëra periudhë në tjetrën.

Po kështu edhe analiza e tekstit flet për konstruksione të ngjashme si edhe ligjërime të njëjta, atë të anormalitetit shqiptar gërshtuar me ligjërimin e superioritetit amerikan. Gjuba dhe mënyra e formulimit të tekstit gazetaresk evoluojnë, për të mbetur të njëjta, në raport me subjektin e Shqipërisë që përshkruhet vazhdimisht si “vend i vogël”, “i harruar”, “i vobektë”, “i degdisur”, “i trazuar”...

Fjalët kyç: Ligjërime i anormalitetit shqiptar, Superioriteti amerikan, Paraqitje të Shqipërisë nga shtypi perëndimor, Revista Time, Raportim ndërkombëtar.

1. Hyrje: Shqipëria e “përbershme” e mediave të huaja

“Shqipëria” që mediat perëndimore paraqesin mund të mos jetë Shqipëria e dëshiruar apo e njohur së brendshmi. Nevoja për ta njohur, kuptuar dhe shpjeguar perspektivën e mediave dhe audiencave të huaja, ishin arsyet për të ndërmarrë kërkime të thelluara e sistematike të Shqipërisë në mediat e huaja. Në spektrin e mediave perëndimore, për vetë rëndësinë e tyre, zgjedha mediat amerikane dhe përzgjedha si rast studimi revistën TIME, një lloj “butik mediatik” ku janë ekspozuar historikisht edhe “ornamentet” e temës shqiptare.

Gjetjet ishin të atilla që i tejkaluan në kohë dhe shtrirje hamendësimet paraprake. Vijimësia e një pamje, një mënyre të ndërtuar dhe të paraqituri të Shqipërisë për një trajektore kohore të gjatë, që nga viti 1923 dhe deri sot, konfirmon jo vetëm ekzistencën e një Shqipërie tjetër, në sytë e audiencave të huaja, por edhe ngulitjen e një forme të ndërtuar dhe të paraqituri të saj.

Pamja e krijuar është ajo e një vendi përherë të trazuar dhe anormal, pavarësisht nëse flasim për periudha historike me tipare thelbësisht të ndryshme. Kështu e sheh revista TIME Shqipërinë e ilustruar me Ahmet Zogun, dhe hera herës edhe me Faik Konicën apo Fan Nolin. Kështu vijon ta shohë edhe Shqipërinë e ilustruar me Enver Hoxhën dhe nganjëherë me Mehmet Shehun dhe Hysni Kapon. Madje kështu vazhdon ta shohë edhe Shqipërinë e sotme, të ilustruar me politikanët aktualë.

Shqipëria aktuale për të cilën flet revista TIME vijon të jetë një Shqipëri kaotike, e çuditshme dhe konfliktuale, e cila kalon nga një krizë në tjetrën. Për pasojë, i tillë është përfytyrimi i krijuar edhe për vendin dhe njerëzit në tërësi, ashtu si edhe për peizazhin urban dhe rural shqiptar, madje edhe për karakteristikat gjeografike dhe antropologjike.

Në sfond historik, periudha e tretë e punimit, ajo nga viti 1990 deri në vitin 2013, ofroi një tablo botërore ndryshimesh, me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe rënien e komunizmit në botën e lindjes ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Anormaliteti i kësaj periudhe, në këtë kuptim, mund të pritej të ishte një lloj normaliteti i ri. Mirëpo ligjërime të mediave të huaja dhe të revistës Time, për këtë periudhë, vijon të jetë ai i anormalitetit shqiptar, pra i një anormaliteti të vjetër. Kujtojmë se edhe në kontekstin e zhvillimeve botërore me Shqipërinë e rreshtuar në kampin komunist, gjatë periudhës së mëparshme, notat e ligjërit ishin pikërisht ato të anormalitetit shqiptar. Madje këto lloj paraqitjesh mediatike mbizotëronin edhe përpara Luftës së Dytë Botërore. Nga një këndvështrim krahasues sipas periudhave kohore, vihet re megjithatë se ligjërime të anormalitetit shqiptar është thelluar më tej gjatë periudhës së regjimit komunist, duke u ricikluar edhe pas viteve ‘90.

2. Ligjërimi i anormalitetit

Ligjërimi i anormalitetit shfaqet rregullisht përgjatë periudhës së fundit, duke nisur me artikujt dedikuar Shqipërisë fill pas rënies së regjimit komunist në fillim të viteve '90, duke vijuar me mbulimin e vitit të trazuar 1997, pa përjashtuar as artikujt që prekin Shqipërinë në kuadër të Luftës së Kosovës në vitin 1999, dhe deri në vitin 2011 kur sërish shfaqet skenari i krizës dhe anormalitetit politik në vend me protestën e 21 janarit në sfond.

Formulimet ekstremizuese që karakterizonin mënyrën e të paraqiturit të Shqipërisë gjatë regjimit komunist, karakterizojnë gjithashtu edhe ligjërimin e anormalitetit që përbën mënyrën e paraqitjes së Shqipërisë edhe për periudhën e re, atë pas-komuniste. Kështu, ndërsa në periudhën pararendëse Shqipëria cilësohej si “vendi më i zymtë dhe i izoluar prapa Perdes së Hekurt”¹, të njëjtat nota ekstremizuese në ligjërim vihen re edhe në periudhën pas-komuniste, ku Shqipëria cilësohet si “shteti i harruar ballkanik i Shqipërisë, një nga më të varfrit e Europës” në një artikull të vitit 1997², ndërsa më herët, në vitin 1990 cilësohej “Vendi më i varfër dhe më i prapambetur i Kontinentit”³; por skenari i anormalitetit mbetet aktual si ligjërim për Shqipërinë edhe në vitet 2000 kur *Time* e përshkruan kështu Shqipërinë: “Shqipëria e vockël doli nga diktatura komuniste në 1990, vetëm për t’iu përunjur një bote të ashpër gangsterësh, makinacionesh financiare mashtruese dhe qeverisjeje të paafte, e nëpërkëmbur nga kapitalizmi pa rregulla dhe politika moskokëçarëse”⁴.

Arsyet që gjenden për të mbuluar Shqipërinë, sidomos në fillim të viteve '90, lidhen pikërisht me karakterin përjashtimor që *Time* u jep ngjarjeve ose zhvillimeve nga Shqipëria, si në artikullin me titull po aq përjashtimor “Shqipëria dhe pas saj nuk mbetet më asnjë”, artikull që hapet me pohimin përjashtimor sipas të cilit “Vetëm një qeveri komuniste në Europë arriti ta përmbante tërmetin politik. Tani, gjashtë muaj më pas, lidhshipi i Shqipërisë së vockël po e liron më së fundi darën e vet të stalinizmit ultra-ortodoks”⁵.

Faktet përjashtimore nënvizohen edhe në artikullin e korrikut më 1990, me titull “Shqipëria, tjetra në radhë për të rënë?”, artikull i cili thekson se “Kur qindra shqiptarë u përballën me të shtënat e armëve të policisë javën e shkuar për të kërkuar strehim në një dyzinë ambasadash të huaja në Tiranë, të paktë ishin diplomatët që e vunë në dyshim dëshirën e tyre për të braktisur bastionin e fundit të komunizmit doktrinar në Europën Lindore”⁶.

Ndërsa në fund të këtij viti, në dhjetor 1990, skenari përjashtimor bëhet më i sigurtë në artikullin me titull: “Shqipëria: Mirupafshim Stalinizëm”, që nis kështu:

¹ Revista *Time*, “Albania: By Remote Control”, 14 maj 1951.

² Revista *Time*, “Army Tries to Restore Order in Albania”, 27 janar 1997 (Time.Com).

³ Revista *Time*, “Albania and then there were none”, 21 maj 1990 (Time US).

⁴ Revista *Time*, “The Trouble with Democracy: Albania's Worrisome Vote”, 21 Maj 2011 (Time.Com).

⁵ Revista *Time*, “Albania and then there were none”, 21 maj 1990 (Time US).

⁶ Revista *Time*, “Albania Next to Fall?”, 16 korrik 1990 (Time US).

“Rënkimi që u dëgjua javën e shkuar ishte zëri i diktaturës së fundit marksiste të Europës, që hyri në koshin e plehrave të historisë”⁷. Një vit më pas, më 1991, arsyeja për të raportuar rreth Shqipërisë lidhet me faktin tjetër përjashtimor se “Pas dekadash izolimi komunist, Shqipëria mban zgjedhjet e saj të para të lira”⁸.

Të njëjtin vit, në vazhden e dinamikës së ngjarjeve, *Time* qëmton fakte të tjera përjashtimore me vlerë lajmi, si në artikullin me titull “Shqipëria: Nuk ka marrë fund ende”, ku nënvizohet fakti se “Edhe pse komunistët fituan një shumicë prej 162 vendesh, nga 250 të tilla në Asamblenë Popullore... fitorja e tyre shpërtheu dbunën më të egër që vendi ka parë në më tepër se një vit trazira në rritje”⁹.

Një periudhë tjetër e zhvillimeve nga Shqipëria që merr mbulim është ajo e vitit 1997. Edhe kësaj radhe, arsyeja për të mbuluar Shqipërinë, lidhet sërish me skenarin e anormalitetit të krijuar në vend dhe që *Time* e përshkruan kështu në artikullin me titull “Toka pa rend dhe pa ligj”: “Europa e ktheu vështrimin në juglindje të vet javën që shkoi për të parë t’i zhduket qytetërimi para sysh. Shqipëria vazhdimisht e mjeruar papritur nuk ishte më një shoqëri e organizuar por në gjendje kaosi. [...] ato që kishin nisur si revolta spontane në disa qytete të jugut e kthyen gjithë vendin në një skenë filmash lufte si ato të Mad Max: fëmijë që tundin granadat dhe tytat e automatikëve, që i nxjerrin ato në shitje me shumicë, dhe qitje frenetike, të vazhdueshme me armë, një kolaps i vërtetë, i autoritetit civil. Shqipëria e vogël, e rrahur nga dielli, është shndërruar në një shtet të Anarkisë”¹⁰.

3. Analizë e të dbënave sasiore: sa shfaqet Shqipëria

Për sa u përket specifikave që lidhen me zhvillimet e revistës *Time*, për këtë periudhë subjektin e Shqipërisë nuk e gjejmë vetëm në versionin e *Time US*, ku sigurisht vijon të jetë dhe me numrin më të madh të artikujve, por që prej vitit 1997 edhe në *Time.Com*, që është varianti online i revistës. Një prani të vogël të subjektit të Shqipërisë ka edhe në publikimet alternative, konkretisht në revistën *Time* për Evropën, Lindjen e Mesme dhe Afrikën në variantin *Time Europe, Middle East and Africa* që prej vitit 2001, si edhe në publikimin tjetër për Azinë në variantin *Time Asia* që prej vitit 2002.

Por as subjekti shqiptar në vetvete nuk është më një i vetëm dhe i njëjti për këtë periudhë, pasi në fund të viteve '90 zhvillimet në Kosovë projektuan një subjekt të dytë shqiptar për publikun e mediave ndërkombëtare, që edhe pse nuk ishte Shqipëri në kuptimin e njësisë administrative politike, del shpesh me të njëjtin emër dhe madje me

⁷ Revista *Time*, “Albania: Goodbye Stalinism”, 24 dhjetor 1990 (Time US).

⁸ Revista *Time*, “Time Magazine Contents Page”, 8 prill 1991 (Time US).

⁹ Revista *Time*, “Albania: It's not over by a long shot”, 15 prill 1991 (TIME US).

¹⁰ Revista *Time*, “No Law or Order in the Land”, 24 mars 1997 (TIME US).

Temat e mbulimit të Shqipërisë 1990-2013 (*Time US*, *Time.com*, *Time Europe*)

Në kuadër të zhvillimeve të jashtme:	81	Në kuadër të zhvillimeve të brendshme:	46
Lufta dhe zhvillimet në Kosovë:	63	Politikë e brendshme:	32
Zhvillimet në Maqedoni:	18	<i>Ndryshimet demokratike:</i>	17
		<i>Trazira dhe konflikte politike:</i>	15
		Politikë e jashtme (marrëdhëniet me fqinjët; me USA, etj):	10
		Dukuri shqiptare, fenomene sociale:	4

të njëtin flamur¹¹. Po kështu edhe kur flitet për shqiptarët e Maqedonisë dhe faktorin shqiptar atje. Kësisoj subjekti Shqipëri, duke llogaritur vetëm rastet kur ky subjekt shfaqet në titullin ose në paragrafin e parë të artikullit dhe duke përfshirur rastet kur tema kryesore lidhet me zhvillimet shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoni, është i pranishëm në 46 artikuj në total, ndër të cilët 25 artikuj të *Time US*, në 16 artikuj të *Time. Com*, në 3 artikuj të *Time Europe* dhe në 2 artikuj të *Time Asia*.

Përndryshe, numri i artikujve në total që trajtojnë subjektin e Shqipërisë edhe kur ai lidhet me zhvillime shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni është 127 artikuj për periudhën 1990-2011, nga një monitorim në të katërt horizontet e *Time*: *Time US* me 48 artikuj, *Time.com* me 67 artikuj, *Time Europe* me 10 artikuj dhe *Time Asia* me 2 artikuj. Duhet mbajtur gjithashtu parasysh fakti që *Time US* mbulon gjithë periudhën nga viti 1990 deri në 2012, ndërsa *Time.Com* vetëm atë nga viti i krijimit 1997 deri në 2013, ndërsa *Time Europe* dhe *Time Asia* janë krijuar edhe më vonë, e para në vitin 2001, dhe e dyta në vitin 2002.

3.1. Rënie e raportimeve në raport me fqinjët

Në rënie për këtë periudhë është mbulimi i Shqipërisë edhe në raport me disa vende të tjera të rajonit ku ka pasur zhvillime të reja, si për shembull në raport me Serbinë e cila del e përmendur në 835 artikuj në total (si përmbajtje e gjerë), ndërsa Shqipëria në vetëm 264 artikuj (si përmbajtje e gjerë gjithashtu).

Nga ana tjetër ruhet prirja e mbulimit më të ndjeshëm të subjektit të Shqipërisë si edhe në periudhat e mëparshme në raport me Malin e Zi, për shembull, që del i përmendur në 197 artikuj, ose në raport me Maqedoninë me të cilën është pothuajse në të njëjtat ujëra, megjithëse ka pasur rritje të raportimeve nga Maqedonia që del me 281 artikuj.

Një subjekt i ri në vendet e Ballkanit që merr mbulimin më të lartë është Kosova, e cila duke filluar nga viti 1999, dominon axhendën e *Time* mbi Ballkanin dhe për periudhën 1990-2013 shfaqet në 1241 artikuj, duke tejkaluar jo vetëm Shqipërinë, por edhe Greqinë, Rumaninë dhe Kroacinë.

¹¹ Në të vërtetë simboli i flamurit shqiptar del mjaft shpesh në *Time*, jo kur flitet për Shqipërinë, por kur flitet për zhvillimet shqiptare në Kosovë ose në Maqedoni si shenjë ose simbol i shqiptarizimit.

Prezencë të ulët vijon të ketë edhe Bullgaria që shfaqet në 290 artikuj në total, ndërsa Ballkani vetë si emërtim përmendet në 938 artikuj në total, pothuajse aq sa Jugosllavia për aq sa ka ekzistuar si e tillë, me 908 përmendje.

Subjekti i Amerikës është sigurisht mbizotërues në revistën amerikane, me 25.366 përmendje për këtë periudhë, ndërsa Europa del e përmendur sa gjysma e SHBA-ve, me 12.018 artikuj përgjatë 1990-2012. Rikthimi i theksit tek Amerika është i ndjeshëm për këtë periudhë në raport me periudhën pararendëse ku Europa përmendej rreth 15 mijë herë dhe Amerika rreth 20 mijë herë, me një diferencë prej 5 mijë njësisht për një kohëzgjatje prej 44 vjetësh.

Me përjashtim të disa periudhave kohore kur ka pasur përqendrim të numrit të artikujve për Shqipërinë si për shembull në vitin 1990 me 9 artikuj, në 1991 me 8 artikuj, si edhe në vitin 1997 me 10 artikuj në *Time US* dhe *Time. Com*, pjesën tjetër të kohës prania e Shqipërisë është e ulët, sporadike ose nuk ekziston.

Në kuadër të Luftës në Kosovë, pra në vitin 1999, prania e subjektit të Shqipërisë mbetet e ulët, edhe pse ka 17 artikuj ku del në kontekstin e subjektit të përbashkët Kosovë-Shqipëri, por jo si subjekt i mëvetësishëm.

Koha ndërmjet këtyre kulmeve mbetet kryesisht me frekuencë të rrallë artikujsh. Vlen të përmendet vetëm viti 2007, kur me rastin e vizitës së Bush subjekti i Shqipërisë trajtohet si përmbajtje kryesore në 5 artikuj dhe rubrika të zhanreve të ndryshme, tre prej të cilave fotografike: 2 "*Quotes of the Day*" dhe një "*Washington Photo Blog*", ndërsa një prej artikujve publikohet në *Time US* dhe tjetri në *Time. Com*. Një lloj përjashtimi përbën edhe viti 2011, kur Shqipëria del në 3 artikuj, dy në *Time.Com* dhe 1 në *Time US* lidhur me zhvillimet politike në Shqipëri.

Për sa i përket vendit që zënë artikujt për Shqipërinë në përmbajtjen e *Time*, të dhënat flasin edhe në këtë periudhë për relevancën e subjektit Shqipëri. Ashtu si në periudhën pararendëse, nuk ka numër të madh artikujsh për Shqipërinë, por atëherë kur shfaqet, subjekti i Shqipërisë qëndron në krye të hierarkisë së temave të tjera të trajtuara në numrat përkatës të publikuar.

Pavarësisht vendosjes lart në krye të rubrikave, artikujt me subjektin e Shqipërisë në *Time*, për këtë periudhë janë kryesisht të shkurtër sa i përket numrit të fjalëve. Rreth 30 prej tyre konsistojnë në tekste prej më pak se 400 fjalësh dhe vetëm 3 artikuj janë të gjatë, dy prej të cilëve i përkasin *Time.Com* dhe njëri *Time US*. Artikujt e tjerë janë mesatarë në gjatësi, që do të thotë nga 400 deri në 800 fjalë. Kjo prirje ishte e kundërt në periudhën paraardhëse, ku artikujt megjithëse edhe më të rrallë, për shkak të izolimit të vendit, konsistonin në tekste më të gjata.

Mirëpo, e njëjta prirje është vërejtur në periudhën e parë, atë ndërmjet viteve '23-'44, ku numri i artikujve për Shqipërinë është më i lartë krahasuar me periudhat e tjera, por numri më i madh i tyre, 40 artikuj, konsistonin në tekste të shkurtra dhe vetëm 6 artikuj të gjatë. Sa i përket rasteve kur Shqipëria del në kontekstin e zhvillimeve në Kosovë, artikujt janë trajtuar shumë më gjatë: 28 është numri i artikujve të gjatë nën këtë kategorizim, ndërsa 1 prej artikujve në kuadër

të zhvillimeve në Maqedoni është i gjatë, me të tjerët në kategorinë e artikujve mesatarë.

Sigurisht, në interpretimin e të dhënave të mësipërme duhen mbajtur parasysh zhvillimet teknologjike dhe organizative trajtuar në punimin e zgjeruar. Kalimi në epokën dixhitale edhe për revistën amerikane *Time* në raport me Shqipërinë nuk ka ardhur fort i lumtur, pasi në këtë periudhë ka mbyllje të zyrove rajonale si ajo e Vjenës që ishte përgjegjëse edhe për mbulimet nga Shqipëria dhe më gjerë Ballkani.

Pa një redaksi rajonale dhe vëmendje të vazhdueshme ndaj Shqipërisë, kuptohet që mbulimet kanë vijuar të jenë sporadike dhe të vakëta. Me pak përjashtime, që lidhen me zhvillimet në Kosovë dhe trazira politike e shoqërore të konsideruara madhore për Shqipërinë si ndryshimet demokratike në vitet '90-'91, viti 1997, 1998 si edhe viti 1999 dhe 2011, kur tekstet e artikujve për Shqipërinë kanë qenë të gjatë dhe mesatarë, në vitet pa zhvillime pikante, mbulimi ka konsistuar kryesisht në artikuj të shkurtër.

4. Ngjarjet dhe temat: Vetëm politike, jo të mediave europiane

Rubrika në të cilën dalin artikujt për Shqipërinë është kryesisht ajo e ngjarjeve nga bota, pra, rubrika *World*. Në rubrikën e *Letrave, Nga Botuesi, Zbavitje dhe Politikë* ose *Kombëtare* dalin fare pak artikujt si për sa i përket botimit *US* ashtu edhe variantit të revistës në *Time.Com*.

Mirëpo për këtë periudhë, në variantin online, shfaqet një risi, që janë rubrikat në foto, të cilat shoqërohen edhe më tekste shpeshherë. Në interpretimin e të dhënave që lidhen me tematikat rreth subjektit të Shqipërisë vlen kështu të llogariten edhe përmbajtjet fotografike. Sa u përket përmbajtjeve në video, nuk rezulton të ketë të tilla të publikuara në variantin online të *Time.Com*.

Për këtë periudhë pjesa më e madhe e artikujve, të grupuar sipas tematikave kryesore që i bashkojnë, trajtojnë zhvillime politike të brendshme. Ndryshimet demokratike në sistemin qeverisës dhe dalja e Shqipërisë nga izolimi përbëjnë në këtë aspekt temën e parë të madhe rreth subjektit të Shqipërisë, kryesisht gjatë viteve 1990 dhe 1991. 15 është numri i artikujve që i bashkon kjo temë kryesore në kuadër të politikës së brendshme të Shqipërisë, në *Time US*. Po kështu, interesimi vijon të jetë në politikën e brendshme edhe më tej, si për shembull në 5 artikujt të publikuar në *Time US* në vitin 1997 dhe 1998, si edhe 5 artikujt të tjerë të publikuar në *Time.Com*. Konflikti ose kriza politike janë tema e përbashkët e 3 artikujve të tjerë që vijnë pas janarit të vitit 2012, në *Time US* dhe në *Time.Com*.

Sa u përket zhvillimeve të jashtme ose rajonale, ato që i përkasin Kosovës përbëjnë temën më frekvente, sidomos në vitin 1999, por edhe zhvillimet që prekin faktorin shqiptar në Maqedoni në vitin 2001. Megjithatë numrin e artikujve që

prekin subjektin e Shqipërisë në kuadër të zhvillimeve në Kosovë dhe në Maqedoni nuk e kemi inkuadruar si trajtim të drejtpërdrejtë të temës në Shqipëri, vlen të përmendet fakti që frekuenca e artikujve në fjalë është mjaft e lartë.

Në secilin prej publikimeve për këtë periudhë numri i artikujve që e prekin subjektin e Shqipërisë nga këndi i zhvillimeve në Kosovë e tejkalon numrin e artikujve me temën e drejtpërdrejtë të zhvillimeve të brendshme në Shqipëri. Kështu, për shembull nga 48 artikujt të *Time US*, vetëm 25 trajtojnë drejtpërdrejt Shqipërinë, edhe pse Shqipëria si subjekt del herë në titull, herë në paragrafin e parë të këtyre artikujve. 23 artikujt të tjerë e kanë Shqipërinë në plan të parë në kuadër të zhvillimeve në Kosovë.

Sa i përket zhvillimeve të brendshme të Shqipërisë që marrin mbulim, si tematika mund të grupohen në temën e transformimeve demokratike, të trazirave dhe krizave politike, ku 17 është numri i artikujve në *Time US* për shembull që trajtojnë ndryshimet demokratike, 15 numri i artikujve që trajtojnë kriza dhe konflikte politike në Shqipëri, në vitin 1997, 1998 dhe 2011, ndërsa pjesa tjetër e artikujve të interesuar drejtpërdrejt në subjektin e Shqipërisë e bëjnë këtë nga një perspektivë sociale ose në kuadër të politikës së jashtme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të Shqipërisë.

Të pyetur në lidhje me përzgjedhjen e tematikave për mbulim nga ana e tyre, gazetarët e *Time* ofrojnë në intervistat e tyre për këtë punim secili perspektivën e vet. Ja çfarë thotë James Graff, që ka raportuar për Shqipërinë në vitin 1991, për faktin që është përqendruar më tepër në tema politike në artikujt e vet, por jo histori sociale apo të tjera:

*"Mendoj se kjo ka të bëjë kryesisht me faktin se ne ishim në gjendje të realizonim vetëm pak histori, ndaj duhet të ishim shumë përzgjedhës në krahasim me gazetatat e përditshme dhe gjithnjë duke pasur parasysh që ne punonim me stafe mjaft më të limituara sesa të përditshmet. Redaksia e caktuar për zonën për të cilën po flasim është natyrisht më e vogël për një të përjavshme amerikane sesa për një të përditshme europiane dhe madje më e vogël edhe sesa e mediave të tjera amerikane si për shembull New York Times. Për më tepër, mendoj se tema si ajo e prostitucionit, kriminalitetin, etj, u shfaqën si tema të lajmeve në mediat perëndimore pas largimit tim nga zyra e Vjenës për Time"*¹².

Dëshmia e korrespondentit shqiptar të *Time*, Raxhimi shërben gjithashtu për të shpjeguar zgjedhjet editoriale të revistës në drejtim të përzgjedhjes së subjekteve që trajton në lidhje me Shqipërinë:

"Tema sociale si ajo e prostitucionit për shembull është vështirë të shitet si histori nga Shqipëria në Amerikë, kur histori të tilla lidhen më tepër me vende si Rumania apo ish-Bashkimi Sovjetik, apo dhe Çekia. Shqipëria si vend i vogël, nuk përbën ndonjë kampion domethënës as për këto dukuri. Lidhet pastaj edhe me faktin se nuk mbajnë njerëz stabël në Shqipëri, por as nuk janë të interesuar të kenë, pikërisht për shkak të

¹² Intervistë me James Graff, Shef i zyrës së Vjenës dhe korrespondent senior i *Time* 1990-1995; 20 dhjetor 2012.

vogëlsisë. Ndaj shkrimet për Shqipërinë bëheshin në kohën e Luftës së Kosovës dhe 1997-ës, në kontekste të tjera, të përcaktuara mirë. Duhet mbajtur gjithashtu parasysh edhe elementi i narracionit. Kërkohej zakonisht një rrëfim në strukturë, një histori që duhet të ishte dhe interesante, edhe e re. Lufta e Kosovës e kishte këtë, pasi nuk dihej përfundimi (ose të paktën trajtohej si e tillë), kriza e 1997-ës kishte historinë e re¹³.

4.1. Fotot: mbizotërojnë temat politike

Për këtë periudhë në *Time.Com* shfaqet edhe risia e fotove-lajm ose rubrikave që kanë në plan të parë fotografinë. Subjekti i Shqipërisë është përzgjedhur në tetë rubrika të tilla për t'u trajtuar si subjekt i mëvetësishëm.

Kështu, tetë është numri i rubrikave në foto që kanë Shqipërinë si subjekt kryesor, prej të cilave tre janë vendosur nën emërtimin "*Quotes of the Day*", pra përbëjnë citime të ditës, që lidhen me aktualitete të caktuara dhe shoqërohen me fotografi të mëdha dhe thënien e vënë në thonjëza që përbën mesazhin e një figure të caktuar në raport me Shqipërinë si përmbajtje kryesore.

Tre thëniet që *Time* ka përzgjedhur të huazojë i përkasin njëra kryeministrit Sali Berisha gjatë vizitës së Bush në Shqipëri dhe daton në 11 qershor 2007, tjetra vetë presidentit Bush gjatë kësaj vizite. Fjalët e Berishës në *Time* janë "*Ky është miku më i madh dhe më i shquar i të gjitha kohërave që ne kemi pasur*", fotoja që paraqet portretet e afërta të Berishës dhe të Bushit (në plan të parë është Berisha dhe në plan të dytë është Bush) është realizuar nga *Associated Press*. Ndërsa në foton që shoqërohet me fjalët e Bush deklaruar gjatë vizitës në Shqipëri vetëm silueta e Berishës është prezente, ndërsa Bush është në plan të gjatë.

Citimi i tretë është ai i një virgjëreshe shqiptare, pra një gruaje shqiptare të betuar për të qenë burrë sipas një zakoni të vjetër, që mban datën 26 qershor 2008, dhe shoqërohet me një foto të publikuar së pari në New York Times. "*Më ka pëlqyer jeta si burrë. Nuk kam pishman*" janë fjalët e cituara të Qamile Steme, 88 vjeçe në faqen online të *Time.Com* ku paraqitet një portret i afërt i saj, i karakterizuar nga rrudhat e theksuara në fytyrë dhe një shikim i menduar, ndërsa në kokë mban një qeleshe tradicionale.

Një rubrikë tjetër fotografike ku trajtohet subjekti i Shqipërisë, që mban emërtimin "*Washington Photo Blog*", prek sërish temën e vizitës së ish presidentit amerikan Bush në Shqipëri. Në rubrikën "*Washington Photo Blog*" të datës 13 qershor 2007, gjen vend një foto e madhe detaj, e cila paraqet orën që mban në dorë presidenti Bush shoqëruar me diçiturën shpjeguese: "*Ende bën tik-tak. Presidenti Bush ekspozon orën e tij, duke refuzuar thashethemet dhe zhurmën e krijuar sipas të cilave ora iu vodh në Shqipëri*". Fotoja është realizuar në Zyrën Ovale të Presidentit nga Christopher Morris enkas për revistën *Time*.

Nga ana tjetër protesta e 21 janarit 2011, me makinat në zjarr në bulevardin e qytetit është subjekti i një fotoje të realizuar nga Visar Kryeziu, vendosur në rubrikën *Today in Pictures* me diçiturën shpjeguese "*Një makinë digjet në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, pas një proteste opozitare që kërkon dorëheqjen e qeverisë dhe zgjedhje të reja*."

Në rubrikën "*Photo Essays*" me temën e vendeve të shenjta përreth botës, Shqipëria shfaqet vetëm si një prej subjekteve në kuadër të një sërë vendesh të tjera në 10 shkurt 2009. Ndër 16 vendet më të shenjta në botë, Kisha e Shënës Ndoit në Laç zë vendin e 7-të. Fotoja paraqet një fëmijë që prek shkëmbin e Kishës së Laç-it që besohet se shëron sëmundje, sipas fjalëve të diçiturës që shoqëron foton.

Në kuadër të një serie tjetër fotosh, nën rubrikën "*Photo Gallery*", publikuar online në 11 mars 2008, subjekti është ekskluzivisht ai i Mitrovicës me 16 foto të realizuara. Ndërsa në rubrikën "*Pictures of the Week*" të datës 15 shkurt 2008 kur Kosova u deklarua e pavarur, fotoja e madhe në sfond kuq e zi paraqet shqiptarë të Kosovës të reflektuar në xhamin e një dritareje ku qëndron flamuri shqiptar në Prishtinë. Fotoja është realizuar nga Armend Nimani për AFP/ Getty.

Këto nuk janë fotot e vetme të subjektit të Shqipërisë në *Time*, mirëpo janë marrë në shqyrtim duke qenë se dalin në rubrika fotografike dhe jo si shoqëruese ose ilustruese të artikujve për Shqipërinë, të cilët janë marrë në konsideratë për tematikën si një njësi e vetme. Megjithatë, mbulimi me fotografi i subjektit të Shqipërisë nuk është nga më të pasurit, duke qenë se në përgjithësi artikujt rreth Shqipërisë janë paraqitur të shoqëruar me fotografi, në mungesë të tyre ose duke qenë se hapësira kushtuar subjektit të Shqipërisë ka qenë shpesh e kufizuar dhe artikujt kryesisht të shkurtër për t'u shoqëruar edhe me foto.

Gjithsesi, përmbajtja e fotove që u evidentuan më lart flet për një qasje më njerëzore ndaj subjektit të Shqipërisë, edhe pse për nga tematikat ato janë pothuajse të gjitha politike ashtu si edhe tematikat e artikujve për Shqipërinë, me përjashtim të temës së Gruas së betuar për të mbetur burrë dhe vizitës në Kishën e Laç-it si vend i shenjtë. Portreti ose plani i afërt është karakteristik për këto foto, por nuk mungojnë as pamjet e turmës dhe as ato masive.

5. Analizë e të dhënave cilësore: Shqipëria si përjashtim për gjithçka

Gjatë studimit dhe matjeve rezulton se paraqitjet me nota ekstreme ose përjashtimore karakterizojnë jo vetëm ligjërimin në *Time* rreth subjektit të Shqipërisë politike, pra si shtet dhe si stad zhvillimi politik, por e njëjtë është paraqitja edhe kur evidentohen ose vihen në dukje karakteristika antropologjike e shoqërore apo edhe tipare gjeografike të subjektit Shqipëri. Kështu në artikujt e parë që shoqërojnë tablonë e rënies së komunizmit në '90-ën refugjatët shqiptarë paraqiten "*të ndotur*,

¹³ Intervistë me Altin Raxhimi, stringer/fikser në *Time* nga Shqipëria; 5 shtator 2012.

Metaforat e përdorura për Shqipërinë (1990-2013)

Metafora	Shprehja në anglisht	Referenca
1. "Kafaz"	"Albania, Climbing out of the Cage"	<i>Albania: Climbing Out of the Cage</i> , 14 janar 1991
2. "Darë e stalinizmit"	"Ultra-orthodox Stalinist grip"	<i>Albania and then there were none</i> , 21 maj 1990 (TIME US)
3. "vend që ngjan me filmat e Maksit të Çmendur"	"country turned into a Mad Max Movie"	<i>No Law or Order in the Land</i> , 24 mars 1997 (TIME US)
4. "Shtet i Anarkisë"	"Albania had become the state of Anarchia"	<i>No Law or Order in the Land</i> , 24 mars 1997 (TIME US)
5. "Pykë e territorit ballkanik"	"Albania is a wedge of Balkan territory"	<i>Albania and then there were none</i> , 21 maj 1990 (TIME US)
6. "Bastion i fundit i komunizmit doktrinar"	"Eastern Europe's last redoubt of doctrinaire communism"	<i>Albania Next to Fall?</i> , 16 korrik 1990 (Time US)
7. "Jo-Perlë e Adriatikut"	"It doesn't exactly have e reputation as the Pearl of the Adriatic"	<i>17 Uighurs Exiled in Limbo... But with Beaches</i> , 11 qershor 2009 (Time.com)

të rraskapitur por triumfatorë" ndërsa mbërrijnë në portin e Brindizit në Itali, por për shqiptarët nuk mungojnë as cilësimet që përmendëm më lart në kuadër të ligjërimit politik, të tilla si "gangster", "nacionalist" apo "esktrmist".

Nga ana tjetër, varfëria është kategoria sipas të cilës më dendur i gjen të përshkruar shqiptarët edhe në këtë periudhë, ashtu si edhe në periudhat e mëparshme. Në 1991, *Time* shkruan se "Shqiptarët iu larguan mungesave gjithnjë e më të theksuara në furnizime me ushqime dhe bukë në atdheun e tyre të varfëruar dhe kërkuan azil përmes Kanalit të Otrantos në Adriatik."¹⁴ Mirëpo gjendja ose statusi ekonomik e shoqëror në të cilin vendosen shqiptarët edhe dy dekada më vonë nuk ndryshon shumë nga e mësipërmja, kur në 2007 *Time* i referon shqiptarët dhe Shqipërinë kështu: "Bush do të jetë presidenti i parë në fuqi që viziton vendin e humbur Ballkanik, më të varfrin në Europë, dhe shqiptarët e kanë tejkaluar vetveten në përgatitjet për ta pritur: dhjetëra mijëra janë dyndur në kryeqytetin e neglizhuar, Tiranë, për të kapur një grimcë nga kalimi i çiftit të parë amerikan"¹⁵. Në formulimin e mësipërm bie sërish në sy tabloja masive që ndërtohet për shqiptarët, që ashtu si në ato pak fotografi që shoqërojnë artikujt, paraqiten si turmë, si masë njerëzish, duke parashikuar madje përpara se kjo të ndodhë si në rastin e mësipërm pikërisht mbledhjen apo grumbullimin e tyre në turma, kësaj radhe soditëse dhe admiruese të vizitorëve të rrallë amerikanë.

Si përjashtim ekonomik trajtohet Shqipëria edhe në një artikull me titull "That's Rich: Hermès Is Selling A \$91,500 Crocodile T-shirt", artikull që Shqipërinë e përmend në këtë kontekst: "Agjencia Awl që arriti të shkrepë një foto të etiketës që mbante çmimin e bluzës (fotot nuk lejohen në dyqanet Hermes) tërhiqte vëmendjen se vetëm taksa e shitjes së bluzës mund të shkonte 8000 \$, që përbën thuhajse GDP-në për capita (për frymë) të Shqipërisë"¹⁶. Sigurisht subjekti kryesor i artikullit të mësipërm nuk është Shqipëria,

¹⁴ Revista *Time*, "Albania: Futile Flight On the Adriatic", 18 mars 1991 (Time US).

¹⁵ Revista *Time*, "Albania: Please Occupy Us!", 10 qershor 2007 (Time.Com).

¹⁶ Revista *Time*, "That's Rich: Hermès Is Selling A \$91,500 Crocodile T-shirt", 28 mars 2013 (Time.Com).

por ajo del në kontekstin e një përjashtimi, për të ilustruar në këtë rast një absurd tjetër që konstaton revista në çmimet e ekzagjeruara të markave të modës.

Për sa i përket paraqitjes gjeo-fizike dhe panoramike të Shqipërisë, termat më të përdorur janë "vend i humbur", "tokë e harruar", "vend i vockël", me një kryeqytet "të rrënuar" dhe "të neglizhuar", etj. Kështu në vitin 2007, në artikullin që flet për ardhjen e presidentit amerikan në Shqipëri, koordinatat që *Time* përcakton për vendin që do të vizitohet nga Bush janë "një vend i humbur Ballkanik, më i varfri në Europë"¹⁷. Asgjë nuk ka ndryshuar për *Time* në raport me Shqipërinë e dhjetë viteve më parë, kur Shqipëria cilësohej po njëllëj: "Ky vend shpesh i harruar i Europës Lindore" në artikullin me titull "Crackdown on the Adriatic" publikuar në 3 mars 1997, dhe "Shteti i harruar ballkanik i Shqipërisë, një nga më të varfrit e Europës"¹⁸. Përshkrimi gjeografik për Shqipërinë në vitin 1990 e pozicionon atë në "një skaj të territorit ballkanik, në jug të Adriatikut"¹⁹.

Po kështu, midis panoramës së vjetër dhe të re të Shqipërisë, pra mënyrës si paraqitej dhe vazhdon të paraqitet Shqipëria gjeo-fizike gjen plot elementë të pandryshueshëm në kohë, po të marrim për shembull paraqitjen që i bëhet kryeqytetit Tiranë, e cila në vitin 1928 përshkruhej si "kryeqyteti i pistë shqiptar" ose "kryeqytet i shëmtuar, i rrënuar" dhe ngjashmërisht e gjen në *Time* të etiketuar edhe në 2007, si "Tirana, kryeqyteti i neglizhuar" apo në 2005 si "kryeqyteti i rrënuar i Shqipërisë"²⁰.

Po kështu, në të dy panoramat gjen elementë të tillë "piktoreeskë" si një gomar i cili shëtit njëllëj në mes të një qyteti shqiptar edhe në 1938, edhe në 1991, ku në artikullin me titull "Albania: Zog and Jerry", publikuar në 9 maj 1938, mbi gomerët "kockë e lëkurë" ka "burra fytyrë-vrenjtur dhe të varfëruar", ndërsa në artikullin me titull "The Balkans: Campaigning, Albanian-Style", 8 prill 1991, mbi gomerët që "çapojnë duke ardhur vërdallë në kot në mes të turmës së njerëzve në qendër të qytetit të drobitur të Mamurrasit, 19 milje në veri të kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranës" janë ngarkuar dru zjarri. Duke iu referuar qytetit të Mamurrasit prej nga ka zgjedhur të raportojë rreth subjektit të Shqipërisë dhe zgjedhjeve të vitit 1991, gazetari James Graff, shkruan "Në Mamurras, ku Europa duket si një kontinent i largët"²¹.

6. Analizë e agjencisë: Superioriteti amerikan tek paraqitjet e Shqipërisë

Ligjërimi i superioritetit amerikan është i pranishëm si lexim mbizotërues edhe në artikujt e periudhës 1990-2012, edhe pse nuk është aq eksplisit sa ç'ishte për shembull gjatë periudhës së parë 1923-1944, kur gjuha e përdorur ishte më e

¹⁷ Revista *Time*, "Albania: Please Occupy Us!", 10 qershor 2007.

¹⁸ Revista *Time*, "Army Tries to Restore Order in Albania", 27 janar 1997.

¹⁹ Revista *Time*, "Albania and then there were none", 21 maj 1990 (Time US).

²⁰ Revista *Time*, "Albania: Koran and Bible", 10 shtator 1928; "Albania: Agent Provocateur", 21 mars. 1927; Albania: "Please Occupy Us!", 10 qershor 2007, *A Mayoral Makeover*, 2 tetor 2005.

²¹ Revista *Time*, "The Balkans: Campaigning, Albanian-Style", 8 prill 1991 (Time US)

drejtpërdrejtë në të shprehurit e paternalizmit amerikan përkundrejt Shqipërisë, siç e kemi ilustruar edhe në seksionin e këtij punimi që analizon periudhën në fjalë. Mirëpo, edhe pse përmes gjuhës denotative del më pak i shprehur, leximi konotativ i përmbajtjeve të artikujve për Shqipërinë pas '90-ës zbulon qartë linjat e të njëjtit *ligjërimit të anormalitetit shqiptar* gërshetuar me *ligjërimin e superioritetit amerikan*.

Në lidhje me këtë tezë, i intervistuar për këtë punim, historiani dhe profesori amerikan Robert Herzstein, që ka studiuar revistën *Time* dhe themeluesin e saj, Henry Luce, shprehet se: "*David Halberstam më pati thënë një herë se Luce ishte zëri i kapitalizmit Kristian Amerikan dhe pa dyshim që përkrahte gjerësisht një axhendë globale të kapitalizmit dhe demokracisë amerikane. Të gjitha revistat e tij e reflektojnë këtë anësi. Mendoj se duhet të jeni dakord gjithashtu se subjekti i Shqipërisë edhe në këtë rast merrte më tepër rëndësi se ç'diktonin përmasat e saj gjeografike për shkak të implikimeve me Jugosllavinë. Nga ana tjetër kuptohet që kishte një interes amerikan në përpjekjen për ta shkëputur Jugosllavinë e Titos nga Rusia*"²².

Është e qartë tanimë se edhe kur trajton Shqipërinë, *Time* i drejtohet publikut amerikan dhe kësioj subjekti i Amerikës është i pranishëm pothuajse gjithnjë. Kjo mbivendosje vihet re jo vetëm në artikujt me tema të përbashkëta si për shembull artikujt që trajtojnë marrëdhëniet e SHBA-së me Shqipërinë si tema e Luftës së Kosovës në të cilën përfshirja e SHBA-ve ishte e drejtpërdrejtë, apo tema që prekin çështje si transferimi nga Amerika në Shqipëri i ujugurëve të Guntanamo-s. Në këto raste supremacia amerikane është vetë subjekti. Mirëpo, Amerika dhe ligjërimi i superioritetit të saj përkundrejt subjektit të Shqipërisë është i pranishëm edhe në subjekte artikujsh ku Amerika duket se nuk hyn fare.

Pikërisht verdikti ose interpretimi i ngjarjeve dhe zhvillimeve nga perspektiva amerikane është gjurma e pranisë amerikane në artikujt e revistës për Shqipërinë. Gjurmë të tilla të shprehjes së superioritetit amerikan në artikujt për Shqipërinë gjen kësioj në çdo artikull. Sa herë që Shqipëria del nën etiketën "*Tiny Albania*" dhe kjo ndodh pothuajse në çdo artikull përcaktimi si "vend i vogël" sigurisht që bëhet në raport me "*vendin e madh*" që është vetë Amerika prej nga referojnë gazetarët e *Time*. I pari lexim superioriteti përftohet kësioj nga përdorimi i rregullt i këtij referenti të Shqipërisë së vogël përkundrejt Amerikës së madhe superioriteti i të cilës është inherent në ligjërimin e mësipërm.

Po kështu, përmes artikujve që trajtojnë zhvillime të demokracisë shqiptare si regjim politik, lexohet qartë shqetësimi amerikan ose "meraku paternalist" i SHBA-ve për "foshnjën shqiptare" të demokracisë liberale me frymëzim amerikan. Sinjalet e alarmit për gjendjen ose zhvillimet në Shqipëri, të lidhura këto sigurisht edhe me pasqyrimin ose shtrirjen e tyre të mundshme në vendet fqinje dhe në pjesën tjetër të rajonit të Ballkanit, sinjale të cilat qëndrojnë pas përzgjedhjes ose vendimit nga ana e revistës për të raportuar rreth subjektit

²² Intervistë me Prof. Dr. Robert Herzstein, Historian i *Time*, Biograf i themeluesit dhe kryeredaktorit Henry Luce; 19 mars 2013.

të Shqipërisë, janë gjithashtu shenja ligjëruese të preokupimit të SHBA-ve si "kujdestare" ose "gardiane" e demokracive të brishta ose vendeve në tranzicion drejt demokracisë ku bën pjesë edhe Shqipëria.

Për të mbështetur interpretimin e mësipërm, po u referohemi titujve në tablonë e të cilëve dominojnë pra ngjyrat e merakut për subjektin e demokracisë shqiptare si në artikullin me titull "*Telashet me Demokracinë: Vota shqetësuese e Shqipërisë*"²³, ose "*Shqipëria, krizë në kryeqytet*"²⁴, po ashtu edhe në artikullin me titull "*Protestat vdekjeprurëse nuk i japin fund lojës për pushtet në Shqipëri*"²⁵. Kjo nuk është e vetmja periudhë kur në fokusin e *Time* janë "avaritë" e demokracisë shqiptare. Artikujt për Shqipërinë në *Time* gjatë vitit 1997, por edhe në vitet pasuese 1998 dhe 1999 kishin në qendër të njëjtin shqetësim amerikan të shprehur në titujt: "*Shkollë Demokracie*" në vitin 1999, ose "*Shqipëria sërish në zgrip*" në 1998, apo "*Tokë pa rend dhe pa ligj*" në mars të vitit 1997²⁶.

Interesimi i *Time* për lëvizjen demokratike në Shqipërinë e fillim viteve '90 është gjithashtu i natyrshëm në kuadër të zhvillimeve ndërkombëtare që lidhen me përmbysjen e regjimeve komuniste, ndaj në këtë periudhë ndeshim edhe tituj me aspiratën e rendit demokratik gati perfekt të tillë si "*Shqipëria dhe pastaj nuk mbetet më asnjë*", publikuar në maj të vitit 1990 ose "*Shqipëria, radha e saj për të rënë*", publikuar në korrik 1990²⁷.

Po kështu, titujt e periudhës në vijim flasin për përpjekjen e brendshme në Shqipëri në drejtim të demokratizimit si për shembull titulli "*Shqipëria: Duke dalë nga kafazi*" i janarit 1991 ose shqetësimi se në Shqipëri ende mund të mos ketë marrë fund ndërrimi i pushtetit, shqetësim ky i shprehur në artikullin me titull "*Nuk mund të qubet e mbyllur*" publikuar në pranverën e të njëjtit vit²⁸. Të njëjtin shqetësim përkthen edhe artikulli me titull "*Shqipëria, bllokazhi i Kastës së Vjetër*" që komenton situatën në Shqipëri pas një rezultati zgjedhor jo siç pritej kështu: "*Megjithë fitoren e vakët në zgjedhjet e para të lira në Shqipëri pranverën e shkuar, udhëheqësit e vjetër komunistë e kanë të vështirë të mbajnë pushtetin ndërsa vala e reformave përfshin vendin më të varfër dhe më të izoluar të Europës*"²⁹.

Nga ana tjetër, notat e superioritetit amerikan në raport me subjektin e Shqipërisë dalin qartë në artikullin rreth vizitës së Bush në Shqipëri në vitin 2007, i mbështetur në cilësime ligjërimore të Shqipërisë si "*vend i vogël*", "*vend i harruar*", "*vend i prapambetur*" të dhëna si "justifikim" ose "arsye" për nderimet

²³ Revista *Time*, "*The Trouble with Democracy: Albania's Worrisome Vote*" në 21 maj 2011.

²⁴ Revista *Time*, "*Albania, Crisis in the Capital*" publikuar më herët në 7 shkurt 2011, *Time* US.

²⁵ Revista *Time*, "*Deadly Protests Don't End Albania's Power Play*", 28 Janar 2011 në variantin online.

²⁶ Revista *Time*, "*Democracy School*", 5 korrik 1999; *Albania back to the brink*, 15 shtator 1998; *No Law or Order in the Land*, 24 mars 1997 (*Time* US).

²⁷ Revista *Time*, "*Albania and then there were none*", 21 maj 1990 (*Time* US); *Albania Next to Fall?*, 16 korrik 1990 (*Time* US).

²⁸ Revista *Time*, *Albania: Climbing Out of the Cage*, 14 janar 1991; *Albania: It's not over by a long shot*, 15 prill 1991 (*Time* US).

²⁹ Revista *Time*, *Albania: A setback for the Old Guard*, 16 dhjetor 1991 (*Time* US).

e jashtëzakonshme që Shqipëria është e gatshme t'i rezervojë një presidenti amerikan me të cilin një pjesë më e iluminuar e botës dhe vetë SHBA-të nuk ishin fort të lumtur në këtë periudhë.

Përmbajtja e artikullit thekson se gjithashtu faktin që në Shqipëri nuk regjistrohej asnjë zë kritik ndaj Bush, por vetëm entuziazëm dhe fanfarë politike dhe popullore, ndërsa titulli i artikullit "*Shqipëria: Ju lutem na pushtoni*" përkthen pikërisht gatishmërinë e Shqipërisë që sipas *Time* bëhet me shumë dëshirë "vasale simbolike" e SHBA-ve.

Po kështu, edhe në artikujt që prekin temën e ujugurëve të Guantanamos të cilët janë pranuar të strehohen në Shqipëri, me habi lexohet edhe "gatishmëria" pa kushte nga ana e palës shqiptare për t'i pranuar ata në territorin shqiptar megjithë komplikacionet ndërkombëtare të çështjes, në kushtet kur nuk mund të kthehen më në vendet e tyre, kur Amerika kërkon t'i largojë nga territori i vet dhe asnjë vend tjetër nuk i pranon. Megjithatë, subjekti i Shqipërisë në këtë rast trajtohet si përjashtim edhe për sa i përket guximit të saj, duke fituar ndonjë notë simpatie dhe simbolikë fuqizuese për këtë akt³⁰.

Së fundi, për sa i përket Luftës së Kosovës ku përfshirja dhe interesimi i faktorit amerikan kanë qenë gjithashtu të drejtpërdrejta, dalja në pozita superioriteti e subjektit amerikan përballë atij shqiptar është sërish mjaft evidente. Sigurisht subjektet e Kosovës dhe Shqipërisë janë të ndryshme, mirëpo për aq sa Shqipëria ishte pjesë e subjektit të Luftës së Kosovës, edhe në faqet e *Time* vihet re marrja në mbrojtje e faktorit shqiptar dhe paraqitja e një tabloje thujse të unifikuar mes Shqipërisë dhe Kosovës. Kështu, për shembull në një artikull me titull "*Mos e vish kostumin gala në Tiranë*", trajtohet pikërisht pozita tepër e mjeruar e shqiptarëve gjatë momentit të eksodit të shqiptarëve të Kosovës, të shpërngulur nga trojet e tyre, drejt vendeve fqinje dhe Shqipërisë.

Edhe pse vendi prej nga ku është shkruar artikulli ishte Kukësi dhe krahinat përreth ku kishin zbarkuar shqiptarët e Kosovës, gjithsesi në titull del Tirana e cila cilësohet si e papërshtatshme për të veshur rroba të shtrenjta dhe për t'u ekspozuar me makina luksoze³¹. Në një artikull që ngjan me një thirrje nga ana e revistës për t'u solidarizuar me gjendjen dhe kushtet në të cilat gjenden shqiptarët e shpërngulur nga shtëpitë dhe vendi i tyre në luftë, gazetari Frank Pellegrini shkruan se e fundit gjë që u nevojitet viktimave të eksodit është vizita e yjeve të Hollivudit me rroba të shtrenjta dhe makina luksoze, ndërsa citon një refugjate të quajtur Hatixhe Ajeti të shprehej në lidhje me vizitën e Richard Gere: "*Oh, një aktor i famshëm. Sa keq. Unë kam nevojë për një doktor*"³².

³⁰ Revista *Time*, "17 Uighurs Exiled in Limbo... But with Beaches", 11 qershor 2009 (Time.com); Albania: "Please Occupy Us!", 10 qershor 2007 (Time.com).

³¹ Revista *Time*, "Don't Wear your Tuxedo in Tirana", 20 maj 1999 (Time.com).

³² Po aty.

7. Disa prirje në mbulimin ndërkombëtar të mediave amerikane

Prirja e parë: Rënia e mbulimit ndërkombëtar

Një nga prirjet për të cilat flitet më tepër në lidhje me shtypin amerikan dhe raportimin ndërkombëtar është rënia e ndjeshme në mbulim që ngjarjet botërore marrin në faqet e mediave të shkruara. Sipas një studimi, në kushtet e një konkurrence të fortë për vëmendjen e lexuesve, edhe shtypi amerikan po përqendrohet në histori ose lajme me vlerë praktike më tepër sesa në ngjarje të komplikuar globale apo të vendeve të largëta³³. Po kështu, në një artikull mjaft të cituar me titull "*Goodbye World*", Peter Arnett, korrespondent ndërkombëtar i CNN, shprehet se "*lajmet e huaja po zhduken gradualisht nga faqet e shtypit dhe lajmet e brendshme po e dominojnë çdo faqe të tij*"³⁴. Prirja që ai sheh në shtypin amerikan është largimi nga praktikat dhe përvoja e raportimit ndërkombëtar drejt lokalitetit praktik, atij që mund të shesë kopertinat³⁵.

Prirja e dytë: afërsia gjeografike, marrëdhëniet bilaterale përcaktojnë mbulimin.

Në një analizë që eksploron natyrën dinamike të rrjedhës ndërkombëtare të lajmeve në kohë, tre studiues gjurmojnë vizibilitetin e shteteve të huaja në mediat amerikane.³⁶ Ata kanë monitoruar dy media të mëdha amerikane si NYT (1950-2006) dhe NBC Nightly News (1968-2006). Ata vlerësuan pesë faktorë kontekstualë që influencojnë vizibilitetin e vendeve të huaja në lajme ndër të cilët: afërsinë gjeografike, marrëdhëniet tregtare bilaterale, zhvendosjen e trupave amerikane, të ardhurat e GDP-së për frymë dhe popullsinë. Në përgjithësi, mediat amerikane mbulojnë vende në të cilat Shtetet e Bashkuara kanë kontakte diplomatike më domethënëse.

Prirja e tretë: Ligjërimi i vijueshëm i superioritetit amerikan.

Korrespondenca e huaj në gazetarinë amerikanë është organizuar formalisht në fund të viteve 1830, dhe qysh prej asaj kohe qëllimi i gazetarëve amerikanë të dërguar për të mbuluar zhvillime të huaja ka qenë kontekstualizimi dhe inkuadrimi historik i këtyre ngjarjeve, pra dhënia kuptim atyre për publikun amerikan³⁷.

³³ Wagner, Cynthia G, *U.S Press loses touch with the world*: The Futurist, World Future Society: Volumi 33, Issue 3, Mars 1999: Fq. 20.

³⁴ Peter Arnett, *Goodbye World*, American Journalism Review, Nëntor 1998.

³⁵ Arnett është korrespondent ndërkombëtar i CNN, ka mbuluar luftën e Gjirin Persik dhe për 10 vjet edhe Luftën e Vietnamit, ndërkohë që është fitues i Cmimit Pulitzer në vitin 1966.

³⁶ Timothy M. Jones, Peter Van Aelst, Rens Vliegenthart, *Foreign Nation Visibility in U.S. News Coverage A Longitudinal Analysis (1950-2006)*, Communication Research June 2013 vol. 40 no.3 417-436.

³⁷ Nuk mungojnë studimet mbi format e hershme të gazetarisë ndërkombëtare për sa u përket mediave të shkruara amerikane. Modeli i lajmeve të jashtme në gazetatat e Shteteve të Bashkuara përpara vitit 1938, ishte "news digest" ose "ripërtyppja e lajmeve" që konsistonte në një përmbledhje të shkurtër informacionesh, të cilës zakonisht i mungonte sfondi dhe konteksti dhe shpesh ishte një ripërtyppje e materialeve të nxjerra nga gazeta të tjera të huaja. Njëkohësisht, që nga viti 1838, në gazetatat amerikane u shfaq edhe një formë e re e lajmeve të huaja që ishte korrespondenca e huaj, e përgatitur sistematikisht nga reporterë amerikanë të dërguar jashtë.

Ligjërimi dominant në korrespondencat amerikane, sipas studiuesve, ishte ai i superioritetit amerikan, sidomos në terma politike, që konstruktohej rregullisht përmes propozimit se Shtetet e Bashkuara kishin një mision të shenjtë për të përmbushur ndaj pjesës tjetër të botës, që mund ta realizonin përmes ndërhyrjes “shpëtimtare” dhe “bamirëse” ose përmes iluminimit (ndaj Europës)³⁸. Praktikant e zakonshme të mënyrës si siguroheshin lajmet ndërkombëtare në fillim të viteve 1900, sipas Joci Cole dhe John Maxwell Hamilton, autorë të një studimi të korrespondencës së huaj 1900-1921, ishte përmes strinxherëve të huaj dhe historive të ricikluara që korrespondentët i gjenin në gazetata lokale. Madje as NYT nuk kishte ende mbulim origjinal të lajmeve të jashtme³⁹.

Prirja e katërt: *etnocentrizmi, kapitalizmi, individualizmi si hitparada e amerikanizmit.*

Në funksion të analizës dhe interpretimit të përmbajtjeve mediatiqe, është me rëndësi që të njihen edhe vlerat që media vë në qendër të raportimeve të veta. Disa nga temat kryesore ose kodet që përshkojnë raportimet e mediave amerikane janë identifikuar nga Herbert Gans. Etnocentrizmi, individualizmi, moderacioni janë disa prej tyre. Sipas Herbert Gans, i cili ishte i pari që e shtroi këtë pyetje në vitin 1979, vlerat e qëndrueshme që përshkojnë lajmet në industrinë amerikane të mediave “mund të grupohen në tetë njësi: etnocentrizmi, demokracia altruiste, kapitalizmi i përgjegjshëm, pastoralizmi i qytetit të vogël, individualizmi, moderacioni, rendi shoqëror dhe lidhësi nacional”⁴⁰.

Në krye të listës qëndron pikërisht etnocentrizmi që flet për orientimin amerikan si i kudogjendur (pra me përhapjen më të gjerë) për sa i përket kronikës së raportimeve ndërkombëtare të mediave amerikane. Etnocentrizmi manifestohet si në përmbajtjen e raportimeve ndërkombëtare, ashtu edhe në vendin ose hapësirën që u lihet atyre në raport me raportimet e brendshme. Siç është cituar të shprehet gazetarja amerikane e njohur e CNN, Christiane Amanpour, “Nëse në një ngjarje nuk gjenden ushtarë amerikanë, nuk gjenden as media amerikane”⁴¹.

Po kështu, vlera e individualizmit është një nga më të shprehurat në raportimet e mediave amerikane. Fokusi në aktorët individualë më tepër sesa tek strukturat apo proceset sociale, si edhe më tepër sesa tek grupet apo çështjet e politikave, është gjithashtu karakteristikë e mediave amerikane. Sipas Gans (1979) rreth 90% e lajmeve kanë të bëjnë me njerëzit dhe se çfarë bëjnë e çfarë thonë ata. Lajmet përqendrohen kryesisht në zyrtarët publikë individualë, liderët e biznesit,

personalitetet e mirënjohura dhe shkencëtarët, si edhe në bëmat e historitë e njerëzve të zakonshëm. Po kështu lajmet janë të personalizuar në kuptimin që “preferojnë këndet e interesit njerëzor në trajtimin e ngjarjeve duke nënvlerësuar konsideratat institucionale dhe politike që përbëjnë kontekstin e tyre social”⁴².

Gans e sheh shprehjen e individualizmit edhe në trajtimin që media amerikane i bën komunizmit dhe socializmit. Ai argumenton se “komunizmi dhe socializmi shihen me frikë pasi dobësojnë individualen, ndërsa kapitalizmi vlerësohet më pak për atë çfarë është në vetvete sesa për lirinë që u ofron të paktën disa individëve”⁴³. Tema e individualizmit është e lidhur gjithashtu pra me atë të kapitalizmit të përgjegjshëm, si zgjatim i saj. Një nga temat e tjera që përshkon mediat amerikane është ajo e moderacionit. Gans sugjeron se lajmet janë kritikë ndaj individëve, grupeve ose ideve që shihen si ekstreme: fanatikët ateistë ose fetarë, anëtarët e kundërkulturave, ideologët ose ata që shohin vetëm interesin e tyre vetjak, etj. Tema e fundit për sa u përket mediave komerciale amerikane është lidhësi kombëtar dhe presidenti i SHBA-ve si mbrojtësi dhe garantuesi i rendit politik dhe social, madje si lideri moral i kombit.

8. Në vend të përfundimeve: qasje propozuese

Qasja e Marrëdhënieve Publike dhe Diplomatie të një vendi në tranzicion si Shqipëria, me burime dhe mundësi të kufizuara, ndryshon krejtësisht nga qasja e një vendi të zhvilluar. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me faktin se prioritetet e tyre strategjike janë krejt të ndryshme. Ky dallim lidhet sidomos me faktin që vendet perëndimore dhe ato në stad tranzicioni kanë target publikë të ndryshëm. Vendet perëndimore ose ato të zhvilluara u drejtohen direkt publikëve të huaj, ndërsa vende si Shqipëria janë më të prirur t’i përqendrojnë komunikimet e tyre dhe i përdorin marrëdhëniet publike ndërkombëtare për të aksesuar qeveritë e huaja dhe aktorët e burokracisë perëndimore.

Është bërë e zakonshme tanimë, sidomos për vendet e Botës së Tretë, që t’ua lënë në dorë firmave të huaja të marrëdhënieve publike (PR) paraqitjen e vendit të tyre. Sigurisht që qëllimi i tyre diktohet nga nevoja e këtyre vendeve për burime financiare dhe ekonomike, duke qenë se lëvizjet e kapitalit janë kryesisht në duart e vendeve të zhvilluara dhe me anë të marrëdhënieve të besimit të vendosura direkt me qeveritë e tyre, aspirojnë të fitojnë mbështetje për zhvillim të qëndrueshëm (Kunczik, 2003). Mirëpo përpjekjet për të fituar së pari publikun e huaj, mund të jenë një mënyrë edhe më eficiente për të mbërritur mandej tek qeveritë e këtyre vendeve.

⁴² Po aty, fq 30.

⁴³ Gans Herbert, *Deciding What's News: A Study of CBS Evening News, NBC Nightly News, "Newsweek" and "Time"*. London: Constable, 1979. Fq.154.

³⁸ Dell’Orto, Giovanna, *Giving Meaning to the World: The First US Foreign Correspondents, 1838-1859*, Greenwood Press: Westport, 2002. Fq. 121.

³⁹ Cole, Jaci; Hamilton, John Maxwell, *A Natural History of Foreign Correspondence: A Study of the Chicago Daily News, 1900-1921*, Journalism and Mass Communication Quarterly, Vol. 84, No. 1, Spring 2007.

⁴⁰ Gans Herbert, *Deciding What's News: A Study of CBS Evening News, NBC Nightly News, "Newsweek" and "Time"*. London: Constable, 1979. Fq. 154.

⁴¹ Philo C. Wasburn, *The social construction of international news, We're talking about them, they're talking about us*, London: Greenwood Publishing Group, 2002. Fq. 30.

Nuk mund të nënvlerësohet këssoj roli dhe rëndësia e mediave të huaja, si mjete nga më të fuqishmet që garantojnë ekspozimin ndaj publikut të huaj dhe qeverive të tyre, respektivisht. (Wang, 2006).

Anashkalimi i publikut të huaj perëndimor dhe përqendrimi i marrëdhënieve publike ndërkombëtare nga ana e vendeve të pazhvilluara vetëm tek autoritetet qeveritare të vendeve perëndimore shihet si përpjekje e pamjaftueshme për të paraqitur dhe për të avancuar imazhin pozitiv të një vendi.

Sipas Kunczik (2003), “imazhet e vendeve influencojnë lëvizjet e kapitalit ndërkombëtar” (f.3). Të ndërtosh një imazh të besueshëm është “kriter” për të aplikuar për fonde, hua, financime, etj. Sipas këtij autori, “besimi” është faktor i rëndësishëm në mobilizimin e burimeve, si për shembull në marrjen e mbështetjes politike dhe/ose materiale nga një vend tjetër” (f.6). Besimi është pra ekuivalent i parave (f.6).

Qasja e PR-it direkt me qeveritë e huaja

Të nxitur këssoj nga nevoja për të vendosur besim, vendet në zhvillim angazhohen në marrëdhënie publike ndërkombëtare me ndihmën e firmave apo agjencive të huaja të specializuara në PR. Këto agjenci sigurojnë aksesin e autoriteteve dhe zyrtarëve të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës apo vendeve të tjera të zhvilluara. Nëse në rastin shqiptar duket se kufizohen këtu, me arritjen e ndonjë fotografie apo shtrëngimi duarsh, këto agjenci apo firma PR mund të ndihmojnë gjithashtu në organizimin e vizitave të pjesëtarëve të mediave të huaja në Shqipëri, takime me editorë dhe dreka me grupe biznesi, zhvillime seminaresh dhe tryezash me natyrë financiare dhe ekonomike që trajtojnë çështje të lidhura me oportunitetet dhe mundësitë që ofron vendi pritës, etj.

Qasja e komunikimeve direkte me publikun e huaj

Në njërën anë, diplomacia tradicionale mbetet ende një rrugë e vlefshme për të zgjidhur dhe avancuar mjaft çështje, sidomos ato me natyrë bilaterale që lidhen me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të një vendi. Në anën tjetër, i domosdoshëm dhe shpesh i efektshëm mund të jetë edhe përdorimi i mjeteve dhe rrugëve të PR-it për të aksesuar direkt qeveritë e vendeve të zhvilluara nga ana e qeverive të vendeve në zhvillim.

Mirëpo, duket se vetë vendet e zhvilluara nga ana e tyre kanë zgjedhur një qasje tjetër, atë të komunikimeve të hapura drejtuar audiencave dhe publikut të huaj, jo vetëm atij qeveritar por edhe më gjerë. Në fakt, qeveritë e vendeve të zhvilluara gjithnjë e më tepër janë nën tryshninë e opinionit publik, ndaj në kushtet kur revolucioni në teknologjitë e informimit dhe të komunikimit bën që lajmet dhe idetë të qarkullojnë më shpejt dhe të shpërndahen më gjerë, këto rrugë nuk mund të injorohen më.

Studiuesit pohojnë se për çdo vend është thelbësore që “të kuptojnë nevojat e publikëve të huaj dhe ta përshtatin strategjinë e tyre të komunikimit, në mënyrë të arsyeshme, me këto audienca” (Wang, 2006, f.27).

Duhet marrë pra, në konsideratë audiencat publike të këtyre vendeve që përbëhen nga mediat në radhë të parë e mandej nga grupe të ndryshme të publikut të huaj që nga investorët e financuesit dhe deri tek vetë qeveritarët, pa dyshim.

Bibliografia

- Arnett, P. *Goodbye Wold*, American Journalism Review, Nëntor 1998.
- Dell'Orto, G. *Giving Meaning to the World: The First US Foreign Correspondents, 1838-1859*, Greenwood Press: Westport, 2002.
- Cole, J. dhe Hamilton, J. M. *A Natural History of Foreign Correspondence: A Study of the Chicago Daily News, 1900-1921*, Journalism and Mass Communication Quarterly, Vol. 84, No.1, Spring 2007.
- Gans, H. *Deciding What's News: A Study of CBS Evening News, NBC Nightly News, "Newsweek" and "Time"*. London: Constable, 1979.
- Kunczik, M. *Transnational public relations by foreign governments*. In K. Sriramesh & D. Vercic (Eds.), *Handbook of global public relations* (pp.399-424). Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum, 2003.
- Philo C. Wasburn, *The social construction of international news, We're talking about them, they're talking about us*, London: Greenwood Publishing Group, 2002.
- Revista Time, “Albania: By Remote Control”, 14 maj 1951.
- Revista Time, “Army Tries to Restore Order in Albania”, 27 janar 1997 (Time.Com).
- Revista Time, “Albania and then there were none”, 21 maj 1990 (Time US).
- Revista Time, “The Trouble with Democracy: Albania's Worrisome Vote”, 21 Maj 2011 (Time.Com)
- Revista Time, “Albania and then there were none”, 21 maj 1990 (Time US).
- Revista Time, “Albania Next to Fall?”, 16 korrik 1990 (Time US).
- Revista Time, “Albania: Goodbye Stalinism”, 24 dhjetor 1990 (Time US).
- Revista Time, “Time Magazine Contents Page”, 8 prill 1991 (Time US).
- Revista Time, “Albania: It's not over by a long shot”, 15 prill 1991 (TIME US).
- Revista Time, “Time Magazine Contents Page”, 8 prill 1991 (Time US).
- Revista Time, “No Law or Order in the Land”, 24 mars 1997 (TIME US).
- Revista Time, “Albania: Futile Flight On the Adriatic”, 18 mars 1991 (Time US).
- Revista Time, “Albania: “Please Occupy Us!””, 10 qershor 2007 (Time.Com).
- Revista Time, “That's Rich: Hermès Is Selling A \$91,500 Crocodile T-shirt”, 28 mars 2013 (Time.Com).
- Revista Time, “Army Tries to Restore Order in Albania”, 27 janar 1997
- Revista Time, “Albania and then there were none”, 21 maj 1990 (Time US)
- Revista Time, “Albania: Koran and Bible”, 10 shtator 1928; “Albania: Agent Provocateur”, 21 mars 1927; Albania: “Please Occupy Us!””, 10 qershor 2007, *A Mayoral Makeover*, 2 tetor 2005.
- Revista Time, “The Balkans: Campaigning, Albanian-Style”, 8 prill 1991 (Time US)
- Revista Time, “The Trouble with Democracy: Albania's Worrisome Vote” në 21 maj 2011.
- Revista Time, “Albania, Crisis in the Capital”, 7 shkurt 2011, Time US.

- Revista Time, "Deadly Protests Don't End Albania's Power Play", 28 Janar 2011 në variantin online.
- Revista Time, "Democracy School", 5 korrik 1999; *Albania back to the brink*, 15 shtator 1998; *No Law or Order in the Land*, 24 mars 1997 (Time US).
- Revista Time, *Albania: Climbing Out of the Cage*, 14 janar 1991; *Albania: It's not over by a long shot*, 15 prill 1991 (Time US).
- Revista Time, *Albania: A setback for the Old Guard*, 16 dhjetor 1991 (Time US).
- Revista Time, "17 Uighurs Exiled in Limbo... But with Beaches", 11 qershor 2009 (Time.com)
- Revista Time, "Don't Wear your Tuxedo in Tirana", 20 maj 1999 (Time.com).
- Timothy M. Jones, Peter Van Aelst, Rens Vliegenthart, *Foreign Nation Visibility in U.S. News Coverage A Longitudinal Analysis (1950-2006)*, Communication Research June 2013 vol. 40 no. 3, 417-436.
- Wang, J. (2005). *Localizing public diplomacy: The role of sub-national actors in national branding*. *Journal of Place Branding*, 2.
- Wang, J. (2006). *Telling the American story to the world: The purpose of U.S. public diplomacy in historical perspective*. *Public Relations Review*, 33
- Wagner, Cynthia G, *U.S Press loses touch with the world: The Futurist*, World Future Society: Volumi 33, Issue 3, Mars 1999: fq. 20.

Ndërveprimi konjitiv i medias me politikën në realitetin kulturor shqiptar¹

Prof. Dr. Aleksandër Dhima

ABSTRAKT. Qëllimi i studimit është të nxjerrë në pah disa nga mangësitë e realitetit mediatik shqiptar lidhur me kumtin politik dhe të parashtojë disa mendime/rekomandime për përmirësimin e imazhit në sferën përkatëse, meqenëse zgjidhja e këtij problemi është pjesë integrale e kërkesave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në këtë studim trajtohen çështje teoriko-praktike që kanë të bëjnë me tiparet dhe elementet thelbësorë të komunikimit politik dhe me handikapin e komunikimit komunitar në realitetin kulturor shqiptar. Nëpërmjet analizës antropologjike të performancës aktuale të aktorëve politikë, studimi rreket të vërë në bashkëlidhje "prerjen" e tyre kulturore dhe "regjimin" kinse transparent (por, gjithsesi të brishtë) të publicitetit të mesazhit politik, sidomos gjatë fushatave elektorale.

Përmes analizës së indikatorëve kulturorë që bëhen shkak për varësinë defektoze aktuale midis medias dhe politikës në vend, studimi synon të tregojë nëse ka shanse reale për një ndryshim efektiv të kahes së bashkëveprimit midis medias dhe politikës dhe, nëse po, cilat do të ishin disa nga mekanizmat e mundshëm për një ndryshim të tillë. Impakti i gjetjeve mund të shërbejë si bazë metodologjike për shpjegimin e gjendjes aktuale të bashkëveprimit të medias me politikën dhe si nxitje për vektorë të rinj investigimi në të ardhmen.

Fjalë kyç: komunikimi politik, performanca e aktorëve politikë, publiciteti i mesazhit politik.

¹ Artikulli është pjesë e Projektit kërkimor, të aplikuar nga Prof. Dr. Aleksandër Dhima për marrjen e statusit Senior Researcher në nëntor 2013, dhe të miratuar prej Komisionit të Granteve, ngritur për këtë qëllim nga Universiteti Europian i Tiranës, me kryetar Prof. Dr. Arjan Gjonçaj. Asistente e Projektit është Dr. Irena Myzeqari.

Hyrje

Në qerthullin shumë përmasor të problematikës në *antropologjinë e komunikimit*, një ndër temat me theks aktual mbetet *bashkëlidhja e medias me politikën*, e cila trajtohet përgjithësisht në fokusin konjitiv të përvojës njerëzore. Pikat e referencës së kësaj problematike që shqyrtohen në punim lidhen me aspekte metodologjike zbatuese, si *organizimi konjitiv* dhe ndikimi i tij në përjetimin e ngjarjeve, *impakti i medias mbi politikën* në realitetin e sotëm shqiptar dhe pozita e njeriut shqiptar përballë *komunikimit mediatik*.

Media është burimi themelor i informacionit rreth çështjeve politike dhe, si e tillë, ka kontroll mbi çka ne njohim aktualisht rreth *sistemit politik* dhe mbi gjithçka që ne s'mund ta zbulojmë pa ndihmën e saj. Prej kësaj bëhet i pashmangshëm gjykimi që media ka më shumë se “një farë ndikimi” mbi skenën politike, ndaj studiuesit po anojnë kohët e fundit nga opinionin se media ka më tepër impakt mbi politikën, sidomos në kushtet e konfliktualitetit që vërehet në shtypin e shkruar dhe në televizion, ndonëse të dyja palët i “gëzohen” *audiencës* së tyre.

Nga ana tjetër, media është përpjekur të krijojë një rrjet standardesh të rëndësishme për politikën, duke shpërndarë perceptimet e botës politike në mjedisin e popullit të thjeshtë dhe të liderëve politikë. Media përfaqëson një metodë njohjeje specifike të botës që na rrethon: kapërcimin virtual të kufijve në shpërndarjen e informacionit. E konsideruar si e tillë, ajo merr një rëndësi të madhe në jetën shoqërore të gjithsecilit, aq më tepër kur ajo shihet si një mjet ndërlidhës dhe, pse jo, propagandistik në politikëbërje.

Media mund të gjykojë, të miratojë ose të kritikojë vendimet e politikës, ajo mund të mbështesë ose të ndërpresë karrierat politike, informacioni që prodhon media e ndihmon publikun në mbajtjen e qëndrimeve të caktuara ndaj politikës në përgjigjet apo opinionet mbi ngjarjet dhe aktorët politikë. Prandaj, për partitë politike është shumë e rëndësishme t'i bëjë mediat “për vete”. Megjithatë, *audienca mediatike* në Shqipëri ka “filtrat” e veta, çka lidhet më së shumti me nivelin intelektual, kulturor dhe social të saj. Kjo qasje përthihet prej politikave editoriale në interes të botuesve dhe biznesmenëve që qëndrojnë pas tyre.

Kjo gjendje e fakteve na ka nxitur t'i studiojmë më tej disa dukuritë e sotme të realitetit mediatik shqiptar, në bashkëlidhje të natyrës konjitive me politikën, nëpërmjet një hulumtimi të dokumentuar mbi shkaqet, pasojat si dhe mbi mundësitë për instalimin e vlerave të reja kulturore në këtë sferë.

Metodologjia e studimit

Për përmbushjen e qëllimit të këtij studimi është paraparë zbatimi i disa principeve metodologjike si më poshtë:

Së pari, gjatë hulumtimit në terren u ndoqën metoda kërkimore *sasiore* dhe *cilësore*, mbështetur në hulumtimin e mediave kryesore (të shkruara dhe vizive) në vend në harkun kohor 1991–2013, meqenëse për këtë ekzistojnë tashmë të dhëna të botuara.

Së dyti, analiza e dokumentacionit ekzistues ka karakterin e një metodologjie *empirike*, duke zbatuar induksionin në *vëzhgimin e drejtpërdrejtë* të medias shqiptare si dhe deduksionin në kuadrin teorik që përfshin *analizën tekstore* të personaliteteve (vendase dhe të huaja) të sferave të medias, kulturës dhe politikës.

Së treti, një tipar i rëndësishëm metodologjik në trajtimin e temës lidhet me përkufizimin e *handikapit kulturor* vendas mbi *bashkëlidhjen konjitive* të medias me politikën, nëpërmjet të cilit do të mund të kuptohej roli i medias në kontekstin politik dhe të synohet analiza e ngjarjeve më të thukëta që komprometojnë impaktin pozitiv të medias në shoqërinë shqiptare.

1. Organizimi konjitiv dhe ndikimi i tij në përjetimin e ngjarjeve jetësore

Organizimi konjitiv ka të bëjë me mënyrat se si një person apo komunitet njerëzish e percepton, mendon dhe modelon vizionin e tij mbi botën rrethuese përmes ndërveprimit të faktorëve gjenetikë dhe atyre të transmetuar përmes kulturës, ku bën pjesë-ndër të tjera edhe këndvështrimi mbi “botën politike”. Sferat e *organizimit konjitiv* kanë të bëjnë kryesisht me aftësitë individuale në përpunimin e informacionit në trurin njerëzor, me inteligjencën vetiake dhe arsyetimin, si *output* i formimit kulturor/edukimit, si dhe me memorien selektive në brendësimin e mesazhit. Pra, procesi komunikues është një dukuri shkëmbimi të ndërsjelltë midis informacionit që duhet të përcillet, transmetimit adekuat të mesazhit dhe *feedback*-ut të përgjigjes.

Individët janë të aftë të përthithin të dy tipat e informacionit të koduar: *kodimin e hershëm* që ndodh në tru dhe lidhet me kujtesën historike, sjelljen dhe bashkëveprimin aktual, si dhe *kodimin e vonë* që diktohet nga faktorë të jashtëm dhe lidhet me mënyrat e të folurit, përshkrimin e ngjarjeve konkrete dhe veprimet e strukturave sociale aktuale (P. Bohannon, 1995: 157). Të dy llojet e informacionit nuk janë të pavarur nga njëri-tjetri, prandaj individët mbeten të njëjtë në gjykim, si rezultat i ndërveprimit të këtyre dy faktorëve, ndonëse veçoritë kulturore mund të pësojnë ndryshime të vazhdueshme (A. Dhima, 2013: 143–146).

Në mënyrë të veçantë, *organizimi konjitiv i ngjarjeve politike* nënkupton mënyrat se si i konceptojnë njerëzit mesazhet politike dhe se si përftohet ose modifikohet më vonë perceptimi vetjak apo komunitar nga ky lloj “strukturimi”. Metodologjia e sotme e *antropologjisë konjitive* mundëson gjithashtu lidhjen e *simboleve me idetë*, duke u mbështetur jo vetëm në dallimet, por sidomos në ngjashmëritë e *organizimit*

strukturor (A.K. Romney & T. Indow, 2002: 14610). Kjo prirje e re synon studimin e mënyrave të lidhjes së “skemave” të krijuara në mendje me veprimin njerëzor, çka na detyron të vlerësojmë nën një optikë të re *emocionalitetin* dhe *motivimin* në procesin e “brendësimit” të mesazhit politik.

2. *Pushteti i medias*

Në kohën e sotme, *pushteti i mediave* është i pashmangshëm dhe i rëndësishëm për të gjitha shoqëritë njerëzore. Ky *pushtet* vjen edhe si pasojë e kërkesave sociale të njeriut pasmodern, sepse mediat janë një mjet i fuqishëm në dhënien e informacionit në kohë të shpejtë dhe reale.

Media bëhet veçanërisht e rëndësishme në rastet e dhunës politike dhe në kohë zgjedhjesh. Kjo është arsyeja pse liderët politikë përpiqen të mbajnë nën kontroll gjithçka që mbulojnë mediat në situata të tilla kulmore. Një ndër rolet thelbësore të medias është të informojë publikun e gjerë me lajme dhe ngjarje të ditës në bashkësitë e tyre, në kuadër vendor, shtetëror dhe botëror.

Pushteti i medias po bëhet sa vjen e më i madh. Vetë media ka pësuar një evoluim shumë të shpejtë, falë përparimit teknologjik. Ky *pushtet*, pavarësisht se ka kohë që konsiderohet si “pushtet i katërt” (kryesisht nga gazetarët dhe shoqatat e përfaqësimit të interesave të tyre, më pak dhe duhet thënë pa shumë dëshirë nga politikanët), ndikon mbi të gjitha pushtetet e tjera. Mediat, vërtet kanë marrëdhënie varësie të ndërsjellë me politikën, por ato kanë evoluuar më shpejt se sa politika, sepse kanë ditur të mbrojnë më mirë interesin publik. Media ka një pushtet të madh mbi shoqërinë njerëzore, sepse ajo di kaq mirë të krijojë kontakte, të japë informacionin që kërkojnë njerëzit në çdo kohë, të fitojë besimin e tyre dhe të krijojë programe pa fund për argëtim, çka i mungon politikës.

Individët ndihen më afër njëri me tjetrin nga nevoja e brendshme për t’u mbështetur në opinione të përbashkëta dhe shtypi (sidomos ai i shkruar) i përgjigjet kësaj ndjesie, në të njëjtën kohë, *pushteti i medias* ka të bëjë me përfaqësimin dhe shumëllojshmërinë e opinionëve, ai mundëson që disa nga këto opinione të “triumfojnë” më shpejt nëpërmjet vendosjes së një konsensusi të gjerë.

Një qasje e re na ndihmon për t’i analizuar ngjarjet që ndodhin, atë që do të quhej “paradigma e ndërveprimit të aktorëve politikë nëpërmjet komunikimit të medias”. Natyrisht, ky rol dhe funksion i ri i medias në kapërcyellin e shekullit u forcua edhe më tepër me dhënien e licencave për hapjen e televizioneve private që, dashje pa dashje, nëpërmjet *retorikës* dhe *gjuhës* së përdorur, zhvilluan dhe sollën një frymë të re të komunikimit që zgjoi interes të lartë të aktorëve politikë, si një mjet efektiv dhe i shpejtë për t’u ndodhur më pranë *audiencës*, përkatësisht elektoratit. Kjo jo pa arsye, pasi *komunikimi politik* do të zinte kohën më të madhe të edicioneve informative si dhe pjesën kryesore të *diskursit* mediatik. Nga sa u

parashtrua, del se është plotësisht e kuptueshme pse politikanët synojnë tërheqjen e vëmendjes ndaj informacioneve që janë “të dëmshme” për interesat e tyre.

Mbulimi mediatik i ngjarjeve politike, nga më të thjeshtat (politika e ditës) deri te fushatat elektorale, ndikon ndjeshëm mbi opinionin publik, madje shumë më tepër se sa takimet informale të politikanëve në mjedise të mbyllura, pa praninë e medias. Edhe kandidatët që dëshirojnë të tërheqin më tepër vëmendjen e opinionit publik parapëlqejnë mbulimin mediatik të fushatës së tyre propagandistike. Zgjedhjet ndikohen, pikë së pari, nga dy faktorë: nga forca dhe imazhi politik, por edhe nga fakti tjetër i rëndësishëm se si e interpreton media *performancën* e kandidatit.

Megjithatë, media-edhe pse është e rëndësishme për politikën ka anët e veta “negative” për të: ajo mund të gjykojë, të miratojë ose të kritikojë vendimet e politikës, ajo mund të “sfumojë” aktivitetin e partive politike, siç ndodhi së fundi me “*Aleançën Kuq e Zi*”. Informacioni politik që prodhon media e ndihmon publikun në mbajtjen e qëndrimeve të caktuara ndaj politikës. Ne mund të sjellim shembuj nga vendi, madje dhe nga bota, kur media ka qenë shkak kryesor i ndërprerjes së karrierave politike. Rasti më flagrant i kohëve të fundit në rrafsh botëror lidhet me dëmtimin moral dhe me ndërprerjen e karrierës politike të drejtorit menaxherial të Fondit Monetar Ndërkombëtar (IMF), Dominique Strauss-Kahn, i cili për shkaqe skandalesh të mediatizuara u detyrua të heqë dorë nga kandidimi për president të Republikës Franceze.

3. *Komunikimi politik në realitetin kulturor shqiptar*

Në trajtimin e këtij problemi duhen mbajtur parasysh të paktën tre elementë kryesorë:

Së pari, procesi demokratik në Shqipëri filloi në kushtet kur nuk kishte *disidencë*, kur për 50 vjet njerëzit ishin përballur me kuptimin dhe zakonet e asaj që njihet si “demokracia popullore”, kur në tekstet dhe në propagandën e kohës s’flitej për *demokraci pluraliste*, kur tema e lirive dhe e të drejtave të njeriut ishte e ndaluar, kur shkencat politike ishin “në pelena” dhe ato zhvilloheshin vetëm nga një grup i kufizuar njerëzish me koncepte të njëanshme, kur nuk kishte as te njerëzit e thjeshtë e as tek intelijenca, përfshirë edhe atë universitare, një vizion të plotë e kulturë të gjerë të demokracisë perëndimore. Në këto rrethana mori jetë procesi i kalimit në *demokracinë pluraliste*. Ky kalim dhe vetë procesi i instalimit dhe i konsolidimit të saj kërkonte një klasë të re politike dhe një lidhshmëri të ri. Ato u formuan vërtet, por u krijuan spontanisht, në mënyrë të rrëmbyer, pa standarde dhe pa koncepte të qarta. Në këto rrethana, klasa e re politike u blatua pa pasur një vizion e kulturë të mjaftë për thelbin e funksionimit të sistemit të ri politik.

Së dyti, demokracia është komunikim dhe bashkëpunim. Në këtë kontekst, rol të veçantë zë padyshim *komunikimi politik*. Por, politika në vendin tonë mendohet si “profesioni” më i lehtë për t’u ushtruar, duke harruar shpesh se *komunikimi politik* është dialog dhe jo monolog, dëgjim dhe jo imponim, pjesëmarrje e jo përjashtim, zgjerim i hapësirave të lirisë e jo ngushtim i tyre, është më shumë argumentim dhe jo urdhërim e ndëshkim, është më tepër autonomi se sa shtërngim centralizues, më shumë kulturim e qytetari në komunikim se sa fyerje e shmangie nga e vërteta dhe përgjegjshmëria.

Së treti, sjellja politike, ende e pa konsoliduar në “binarët” e demokracisë, përcaktohet më tepër nga pikëpamjet personale të lidershit politik se sa nga ideologjitë dhe rrafshet e pjesëmarrjes politike të komunitetit. Në literaturën e specialitetit identifikohen tre burime themelore që krijojnë efekte ndikuese dhe pasoja afatgjata mbi *sjelljen politike*: familja, autoritetet dhe rrethi shoqëror që mund të afektojë gjithashtu *orientimin politik*. Miqësitë personale, ndonëse jo domosdo, kanë përparësinë e të qenit pjesë e së njëjtës breznë, që zhvillon kolektivisht një rrjet unik përmbajtjesh shoqërore, pak a shumë të njëjtin mentalitet kulturor, *norma* dhe *vlera* që përjetohen dhe zhvillohen bashkërisht në rrafsh komuniteti (H.R. Kitayama & S. Markus, 2003: 277-283).

Elementëve të mësipërm u shtohen edhe disa të tjerë që kanë të bëjnë me shkallën dhe efektivitetin e daljes në media si dhe me përzgjedhjet individuale ndaj forcave të caktuara politike. Këta faktorë kanë një veprim afatshkurtër dhe karakterizohen nga një jetëgjatësi e kufizuar, sidoqoftë, ata mund të jenë vendimtarë në modifikimin e *orientimit politik* në momente të caktuara. Shumë studiues janë të mendimit se sidomos masmedia ka një impakt të ndjeshëm në mjedisin elektoral. Ky mjet i fuqishëm i komunikimit duket se ka qenë një faktor vendimtar edhe gjatë tranzicionit drejt politikave demokratike liberale. Nga ana tjetër, organizimi, përmbajtja, debatet dhe menaxhimi i një fushate elektorale me ndihmën e medias mund të “zhvendosin” disa mjedise politike që mbështeten në kandidatë të caktuar, të cilët përcjellin shkallë të ndryshme efektiviteti dhe suksesi në ndikimin te votuesit.

Fushatat elektorale krijojnë përgjithësisht iluzionin e një *komunikimi politik efektiv*. Megjithatë, në to ka më shumë parulla e premtime politike se sa thirrje për dialog e bashkëpunim, p.sh. në përgatitjen dhe bashkërendimin e programeve zhvillimore të vendit. Dukuri e mprehtë dhe tepër negative në këtë periudhë është *mungesa e dialogut mes pozitës dhe opozitës*. Se sa pak hapësirë bashkëpunuese ka pasur, këtë e di edhe njeriu më i painformuar. Edhe pse tashmë është kapërcyer një marrëdhënie armiqësore, që i karakterizonte këto raporte në fillimet e procesit demokratik, përsëri dialogu është ende i mangët, ka një mosbesim mes palëve, çka ndikon seriozisht në stabilitetin politik të vendit.

Prej rënies së komunizmit në vitin 1991-1992, tranzicioni nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë solli në Shqipëri ndryshime të mëdha

sociale dhe politike. Kjo periudhë karakterizohet nga përpjekje të vazhdueshme për të vendosur një regjim demokratik, pjesë e të cilit është padyshim zhvillimi i mjeteve të komunikimit në vend dhe, me këtë, Shqipëria futet në një realitet të ri në fushën e komunikimit, realitet i cili nuk përkon aspak me të kaluarën e viteve të komunizmit. Krijimi i një rendi të ri të komunikimit nuk mund të shihet ndaras *komunikimit politik*, ashtu si ky i fundit nuk mund të trajtohet pa fokusin konjitiv të mediave. Ndërvlerësia e kësaj lidhjeje është element i rëndësishëm i *komunikimit në politikë*.

Në Shqipërinë paskomuniste, *gjuha* e parë e komunikimit që u përcoll nga media ishte *shprehja e mendimit të lirë*, çlirimi nga ankthi për të shprehur atë që mendon dhe ndjen, *gjuhë* e cila u rrok më së tepërmi nga opozita e sapokrijuar e asaj kohe dhe u konvertua në *komunikim politik* nëpërmjet sloganit “*Liri, Demokraci*”. Sipas A. Fugës, “*dëgjimi i lajmeve nga më të larmishmet ngopi një mungesë të kahershme, duke i dhënë individit një dimension të ri, larg kolektivizmit të forcuar dhe duke ndjellë dëshirën për të përmbushur atë boshllëk me çdo lloj informacioni, të nevojshëm e të panevojshëm*” (A. Fuga, 2008 b:22).

Në vitet e mëvonshme, ky rol dhe funksion i medias u forcua edhe më tepër me shtimin e shtypit të shkruar dhe me dhënien e licencave për hapjen e televizioneve private që krijuan figurat e tyre editoriale dhe që, me dashje ose pa dashje, nëpërmjet *gjuhës* dhe *retorikës* së përdorur, zhvilluan dhe sollën një frymë të re të komunikimit, në sajë të së cilës siç shprehet Gluckmani midis shumë tipareve të tjera spikati kërkesa e të mësuarit të *gjuhës politike* (M. Gluckman, 1968:219). Kjo jo pa arsye, pasi *komunikimi politik* do të zinte kohën më të madhe të edicioneve informative. Ajo që është për t’u vënë re në këtë periudhë ka të bëjë jo vetëm me përdorimin e medias vizive, por edhe të medias së shkruar për *komunikim politik*, ku interes më të madh për publikun fituan ato të përditshmet që kishin krijuar imazh, stabilitet dhe *audiencë* të lartë.

Parapëlqimi për transmetimin e mesazheve politike në Shqipëri mori një kahe të re në “erën televizive” mbas vitit 2005. Kjo prirje komunikimi u forcua edhe më tepër me krijimin e figurave të reja editoriale të tipit “*talk show*”. Pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj dukurie është “çlirimi i mendimit të lirë”, i cili shpeshherë është shoqëruar për fat të keq me “shfrenim mediatik”, çka ngjan të jetë më komod dhe më i pranueshëm në mediat e sotme elektronike.

Nga viti në vit, vëmë re se si funksioni dhe roli i medias në procesin e *komunikimit politik* forcohet edhe më shumë. E, natyrisht, mbeten për t’u analizuar dallimet e medias gjatë sistemit që jemi mësuar ta quajmë “diktatorial” dhe atij sistemi në të cilin ndodhemi, të mbiquajtur “demokratik”. Pyetjet që ngacmojnë kërshërinë tonë janë: Nëse gjatë sistemit komunist media drejtohej sipas koncepteve dhe konteksteve të udhëheqësisë shtetërore, cilat janë ato koncepte që udhëheqin median në ditët e sotme? Mos ndoshta “udhëheqësit” janë shndërruar në “pronarë” mediash? Sido që të jetë, tashmë ekziston një lloj pavarësie që ka si qëllim informimin e qytetarëve,

ndërsa në sistemet diktatoriale mungonte tërësisht pavarësia e mediave, për arsye të ndikimit politik ekstrem të pushtetit mbi shoqërinë (Ll. Filo, 2001: 63). Mediat komuniste ishin nën presionin e një sistemi totalitar, pasi ato cilësoheshin si pjesë e atij sistemi që diktonte politikat editoriale të tyre. Megjithatë, jo në të gjitha rastet, mediat i janë bindur sistemit.

Shqipëria është një vend që ka kaluar jo pak vështirësi në ecurinë e proceseve politike. Sigurisht që rolin vendimtar në konsolidimin, forcimin, promovimin e një shteti serioz e luan politika dhe aktorët e përfshirë në të. *Gjuha politike* e përdorur ka qenë dhe vazhdon të mbetet e ashpër, fyese dhe madje kërcënuese, duke degjeneruar deri në përplasje fizike, jo të pakta kanë qenë rastet kur ne, si spektatorë, kemi parë “ndeshjen” e radhës në televizion dhe kemi qenë dëshmitarë të “luftës verbale” ndërmjet “të zgjedhurve nga populli”.

Me zhvillimin e teknologjisë, *komunikimi politik* është bërë *media-addicted* (i varur nga media). Nuk është vetëm media tradicionale ajo që shfrytëzohet, por sot mediat virtuale, si *email*-et, *facebook*-u, *twitter*-i, *blog*-et etj., po përdoren për komunikime të shpejta dhe me pak kosto. Kjo është “moda e re” e politikanëve që po gjen përdorim edhe në vendin tonë. Ajo çfarë i mungon jetës politike në Shqipëri është përballja në debat “ballë për ballë” e kandidatëve apo politikanëve: gjithsecili replikon në distancë dhe “hedh” ftesa për debat, por këto të fundit mbeten spontane. Progres-raportet e hartuara nga institucionet evropiane kanë theksuar vazhdimisht problemin e mungesës së *dialogut politik* në Shqipëri. Kërkesat e vazhdueshme për t’u ulur në tryezë të përbashkët kanë rënë në “vesh të shurdhër” apo janë përdorur si justifikime për të sulmuar palën kundërshtare. Si rezultat, kjo dukuri është bërë pjesë e *komunikimit politik* të tyre, sigurisht në favor të vetes.

Me sa duket, forma në të cilën është zhvilluar deri tani ky lloj komunikimi mund të quhet *komunikim politik made in Albania*. Përditë flasim për integrim të Shqipërisë, për “ecje me hapa të shpejtë drejt BE-së”. Por, si mund të ketë *integrim* pa *komunikim*? Si mund të jemi “një zë” kur të gjithë bëjnë “zhurmuesin”? Për sa kohë do të jenë të mbyllura hapësirat bashkëpunuese dhe nuk do të ketë tolerancë, *komunikimi* do të vazhdojë të jetë *moskomunikim* dhe pasojë e tij do të jemi ne, të cilët kemi zgjedhur të udhëhiqemi nga “të pa-komunikueshmit”.

Mbas “vitit të mbrapshtë” 1997, Shqipëria hyri në një realitet të ri mediatik, me krijimin e një rendi të ri të komunikimit, i cili nuk mund të shihet ndaras *komunikimit politik*, ashtu si ky i fundit nuk mund të trajtohet pa fokusin konjitiv të mediave. Ky fokus do të kërkonte një analizë të veçantë, e për më tepër hulumtime serioze në labirintin e çështjes nëse “media prodhon politikë apo politika është produkt mediatik”. Natyrisht, kjo është një ndërmarrje e vështirë, sepse kërkon një konceptim të gjerë për kulturimin demokratik të njerëzve. Sa më parë të realizohet *ndërgjegjësimi për ndryshim*, aq më shpejt do të çlirohem nga dukuritë negative të kohës së sotme dhe aq më lehtë do të bëhet kalimi i shumëpritur i demokracisë shqiptare, nga e brishtë në të konsoliduar e funksionale. Kjo kërkon një konceptim

të gjerë për edukimin demokratik të njerëzve, sepse vërtet ka rëndësi instalimi i institucioneve demokratike dhe rregullimi ligjor i tyre, por *demokracia* funksionon kur edhe njerëzit i njohin institucionet demokratike dhe sillen ndaj tyre po ashtu në mënyrë demokratike.

4. Pozita e njeriut shqiptar përballë komunikimit politik mediatik

Për sa kohë njerëzit janë të ndryshëm dhe kanë kulturë, nivel arsimor dhe interesa të ndryshme, mesazhi i medias ka për disa rolin e “plumbit magjik”, ndërsa për të tjerë ky mesazh “filtrohet”. Komunikimi është shoqëror, sepse ai është i lidhur ngushtë me organizimin e shoqërisë. *Mesazhet e mediatizuar* (gojore, të shkruara ose pamore) janë *ligjërimi shoqëror*, në kuptimin e vërtetë të këtij termi. Të rrënjosura në praktikën shoqërore, përtej kuptimit fillestar të tyre, ato përcaktojnë gjithashtu *statuset* dhe *rolet*, kristalizojnë qëndrimet si dhe bartin me vete mënyrat e shfaqjes. Dje, sot e përherë, që nga koha kur është krijuar media, ndikimi i saj në shoqëri përbën një çështje diskutimi, sidomos ndër teoricentët e qasjes social-kulturore të komunikimit. Njerëzit shohin në media atë çfarë ajo sjell dhe mendojnë shpesh për atë se çfarë konsideron media si të rëndësishme. Megjithatë, nga ana tjetër, shohim se si njerëzit ndahen në grupe: disa ndikohen, ndërsa të tjerë jo kur përballen me “filtra”.

Gazeta i drejtohet lexuesit, por ai jo gjithnjë arrin të dekodojë qartë mesazhin që kërkon të japë shkrimi. Madje, kjo ndodh jo vetëm në masën e gjerë të lexuesve, por edhe te një grup i ngushtë interesi. Frazat e përdorura dhe terminologjia jo e saktë bën që shkrimi të mbetet “i pakapshëm”. Një dukuri, që është studiuar gjatë në gazetari, lidhet me të ashtuquajturën “errësirë gazetareske” (U. Eco [1968] 2011). Mungesa e qartësisë gjuhësore sjell mangësi komunikimi mes palëve. Sipas studiuesve, këtë fakt e gjejmë sidomos në kronikat politike. Në shumë raste, vështirësia e leximit, për shkak të shumë *nënkodeve* të pranishëm në shkrime, krijohet nga vetë gazeta.

Sipas disa kritikëve, kjo bëhet qëllimisht nga botuesi për dy arsye: *së pari*, sepse ai (botuesi) për shkaqe politike apo ekonomike kërkon “të mbajë anën” e dikujt; *së dyti*, botuesi kërkon që këtë “mbajtje ane” ta bëjë në mënyrë të fshehtë, jo haptazi. Sa më afër një grupi interesi të jetë gazeta, aq më e qartë është ajo (gjuhësisht) në shprehjen e idesë. Kështu, gazetat e partive politike nuk kanë nevojë për “errësirë gjuhe”; ato e shprehin qartë pozicionin e tyre pro së Majtës apo kundër saj dhe anasjelltas. Pa parë titullin e gazetës, nëse u hedhim një sy vetëm kryeartikujve të faqes kryesore, mund të themi pa nguruar nëse gazeta në fjalë është “*Rilindja Demokratike*” apo “*Zëri*”. Këtë përfundim e kemi arritur pasi kemi bërë një grup intervistash me lexues të rregullt të këtyre gazetave. Grupit në fjalë i kemi fshehur gazetën dhe thjesht kemi lexuar titujt kryesorë të faqeve të para të tyre: vetëm 2 nga

20 të intervistuarit kanë gabuar në dhënien e përgjigjes së saktë se për cilën gazetë politike bëhej fjalë, ndërsa 17 përgjigje ishin të sakta. Të njëjtit grup lexuesish i kemi ofruar titujt kryesorë të gazetave të cilësuar si “të pavarura” dhe të gjithëve u është kërkuar të thonë titullin e gazetës pasi u janë lexuar titujt e shkrimeve. Rezultati ka qenë krejt i kundërt me anketimin e parë: vetëm 3 nga 20 personat e pyetur kanë dhënë përgjigje të saktë mbi disa prej gazetave.

Nga vitet 1920-1930 u shfaq teoria e “plumbit magjik”. Sipas saj, mesazhet mediatike vepronin si “plumba” në trurin e njerëzve dhe krijonin asociacione mes emocioneve të forta dhe koncepteve të veçanta. Përkrahësit e kësaj teorie mendonin se media, me mesazhet e saj, mund të sillte ngado *audiencë*, pavarësisht *statusit shoqëror* dhe përgatitjes së njerëzve të përfshirë në të. Por, për Lesuellin, “*fuqia e propagandës mediatike nuk duhet kërkuar në mesazhin mediatik apo në teknikat e transmetimit, por te gjendja mendore e njerëzve*”. Ky autor hedh poshtë kështu teorinë e “plumbit magjik”, duke u shprehur se “*gjendja ekonomike, emocionale, psikologjike, shpirtërore dhe politike, në të cilën ndodhet individi, ndikon në feedback-un e tij ndaj mesazhit të medias*” (H.D. Lasswell [1935] 1965:3).

Media ka fuqinë e plotë të na thotë se “çfarë duhet të shohim” dhe, për pasojë, “të jemi të detyruar të mendojmë mbi atë çfarë shohim”. Ndërkohë, media ndikon në sjelljen e individit në mënyra të ndryshme, në varësi të formimit të tij kulturor. Nisur nga kjo paradigmë, ne ndërmorëm një anketim të dytë: të gjithë të anketuarit u vunë përballë pyetjes: “*Cili televizion është më i besueshëm për ju?*” Për këtë u pyetën 50 persona, që ishin anëtarë të *Partisë Demokratike*, dhe 50 të tjerë, anëtarë të *Partisë Socialiste*. Rezultatet e anketimit u përpunuan sipas dy grupeve përkatëse, sipas “ngjyimeve” të tyre politike: të anketuarit “blu” kishin në 80% të përgjigjeve “*TV Klan*” si televizionin më të besueshëm, ndërsa 15 % e tyre kishin zgjedhur *TVSH*-në. Ndërsa të anketuarit “rozë” kanë zgjedhur në 70% të përgjigjeve “*Top Channel*-in” dhe në 25% ishin për “*Vizion Plus*-in”. Të njëjtëve persona u është bërë pyetja: “*Cili televizion nuk i besoni?*”. Përgjigjet e kësaj pyetjeje lidhen, në fakt, me përgjigjen e pyetjes së parë: për të anketuarit “blu” janë të pabesueshëm ato televizione të cilëve u besojnë të anketuarit “rozë” dhe anasjelltas.

Pra, *audienca* ka “filtrat” e vet, me anë të të cilave merr “atë që do” nga media vizive apo e shkruar. Pyetja që iu bë në vazhdim të anketuarve ishte po për median e shkruar dhe sërish kishim një ndarje mes mediave sipas ngjyimeve politike. Të anketuarit quajnë “gazetë të mirë” atë që “u shkon për shtat” bindjeve të tyre politike. Por, kjo çështje ka të bëjë shumë edhe me nivelin intelektual, kulturor dhe social të *audiencës*: nëse kemi një *audiencë* të pa arsimuar, pa “filtra”, që nuk thellohet të mendojë se çfarë “fshihet” pas një lajmi, atëherë teoria e “plumbit magjik” apo e “gjilpërës hipodermike” do të vërtetohej mjaft mirë.

Situata mediatike aktuale në vend përqaset mjaft me paradigmat vepruese të të ashtuquajturit “model i propagandës”, i përpunuar nga *Instituti i Analizës së Propagandës* pranë *shkollës së Çikagos*. Fergusoni shprehej se “*mediat e mëdha, të*

kontrolluara nga investues që duan të përfitojnë, nuk inkurajohen në shpërndarjen e lajmeve për t’u bërë armiqësorë me qeverinë” (Th. Ferguson, 1995: 400). Në këtë këndvështrim, edhe media shqiptare ka politika editoriale në interes të botuesve dhe biznesmenëve, të cilët kanë pronësuar tashmë rreth 85% të organeve mediatike. Biznesmenët pronarë të medias ia kanë dalë ta kthejnë informimin në komunikim interesash.

Mediat po fitojnë dora-dorës tiparet e të qenit demokratike, ato të marra së bashku- duan të jenë të pavarura, të lira, por secila prej tyre e ndarë nga të tjerat sjell shfaqje propagandistike dhe shfaq ndikim prej grupeve të politikës dhe biznesit. Pra, ndryshe nga pamja e jashtme, mbizotëruese është përmbajtja dhe të tjera janë mekanizmat e ndikimit të saj mbi opinionin publik. Siç jam shprehur edhe më parë, “*disa nga tiparet e medias shqiptare që e afrojnë atë me modelin e propagandës janë: drejtimi nga biznesi, si operatorë dhe aktorë kryesorë në fushën e medias, trafiku i ndikimeve nëpërmjet medias, kalimi nga media të pozicionuara ideologjikisht në media pro dhe kundër qeverisë, seleksionimi i lajmeve sipas interesit të pronarëve të medias, kalimi nga censura në vetëcensurë*” (A. Dhima, 2011: 34).

Në bazë të arsyetimit dhe argumenteve të sjella më sipër, vërtetohet hipoteza që njerëzit, për sa kohë janë të ndryshëm, mendojnë dhe logjikojnë ndryshe, ata kanë “filtra”, interesa, arsimim dhe kulturë të ndryshme. Kjo do të thotë se mesazhi mediatik për dikë do ketë efektin e “plumbit magjik”, ndërsa për dikë tjetër nuk do mund ta ketë atë, pasi ai “filtruhet” përpara se të japë *feedback*-un.

Përfundime

Në këtë studim u përqendruam *së pari* në problematikën e *komunikimit politik* që zë pjesën dhe kohën më të madhe të edicioneve informative dhe të *diskursit mediatik*, sepse individët ndihen më afër njëri me tjetrin nga nevoja e brendshme për t’u mbështetur në opinione të përbashkëta dhe media (sidomos ajo e shkruar) i përgjigjet kësaj ndjesie, në të njëjtën kohë, pushteti i medias ka një “faj” të konsiderueshëm në përfaqësimin dhe shumëllojshmërinë e opinioneve. Ky *pushtet* do të mundësonte, përkundrazi, që disa nga këto opinione të “triumfojnë” më shpejt nëpërmjet vendosjes së një konsensusi të gjerë.

Së dyti, meqenëse media në Shqipëri ka evoluuar më shpejt se *politika*, mbasi ka ditur të krijojë kontakte shumëdimensionale me njerëzit, të japë informacionin e kërkuar në çdo kohë, të fitojë besimin e tyre dhe të sajojë programe pa fund për argëtim, çka i mungon politikës, mu për këtë arsye, ajo meriton të ketë një pushtet edhe më të madh për mbrojtjen e interesit publik. Por realiteti mediatik tregon se media ka spekuluar shpesh me këtë “përparësi të detyruar”, çka vërtetohet me fakte konkrete në studim nëpërmjet analizës së situatave mediatike zgjedhore në harkun kohor 1991-2013.

Së treti, media edhe pse është e rëndësishme për politikën ka anët e veta “negative” për të: ajo mund të gjykojë, të miratojë ose të kritikojë vendimet e politikës, mund të “sfumojë” aktivitetin e partive politike, informacioni politik që prodhon media e çorienton publikun në mbajtjen e qëndrimeve kritike ndaj politikës. Në studim sillen shembuj, kur media ka qenë shkaku kryesor i ndërprerjes së karrierave politike.

Së katërti, në studim evidentohen elementët kryesorë mediatikë që kanë ndikuar në efektet e deritanishme të *komunikimit politik* në realitetin shqiptar: a) *brishhtësia e procesit demokratik* gjatë periudhës së tranzicionit; b) *mendësia* (që mund të tejkalohet me vështirësi) se “politika është profesioni më i lehtë për t’u ushtruar”; c) falë shfrytëzimit të literaturës së specialitetit mbi *traditën shqiptare*, në studim identifikohen burimet themelore që gjenerojnë efekte autoritare dhe pasoja afatgjata mbi këta indikatorë.

Bibliografi

- Bennett, Peter and Jerry Slater (2008). *Communication and Culture; The Essential Introduction*. London: Routledge (3rd ed.).
- Beqja, Hamit (2000). *Tranzicioni demokratik dhe psikologjia e shqiptarëve të sotëm*. Tiranë: Mësonjëtorja e Parë.
- Berisha, Ibrahim (2007). *Media, agjentët e komunikimeve*. Prishtinë: Pen/ Qendra e Kosovës (bot. i 2^{te}).
- Bohannon, Paul (1995). *How Culture Works*. New York: The Free Press.
- Castells, Manuel (2010). *The Information Age; Economy, Society and Culture*. Oxford: Wiley-Blackwell (2nd ed.) Vol.1: The Rise of the Network Society.
- Croteau, David R. and William D. Hoynes (2003). *Media Society; Industries, Images and Audiences*. Newbury Park-CA: Pine Forge Press/ Sage Publ. (3rd ed.).
- D’ Andrade, Roy Goodwin (1995). *The Development of Cognitive Anthropology*. New York: Cambridge University Press.
- Devereux, Eon (2003). *Understanding the Media*. London-New York: Sage.
- Dominick, Joseph R. (2010). *Dinamika e komunikimit masiv*. Tiranë: UET Press; origjinali: *The Dynamics of Mass Communication; Media in Transition*. New York: Mc Graw-Hill/ Higher Education, 2009.
- Dhima, Aleksandër (2011). *Modeli i propagandës; Qasje antropologjike në realitetin mediatik*. “Polis” (Tiranë/ UET) nr.10: 23-37; id. (2013). *Antropologji e komunikimit; Qasje në realitetin shqiptar*. Tiranë: Kumi.
- Eco, Umberto (2011). *The Absent Structure*. New York: Random House; origjinali: *La struttura assente*. Milano: T. Bompiani, 1968.
- Ferguson, Th. (1995). *The Golden Rule*. Chicago: University of Chicago Press.
- Filo, Llambro (2001). *Historia për sistemet e qeverisjes*. Tiranë: Afërdita.
- Flew, Terry (2008). *New Media; An Introduction*. South Melbourne: Oxford University Press; origjinali: 2004.
- Fuga, (2008,a). *Media, politika, shoqëria*. Tiranë: Dudaj; id. (2008,b). *Brirët e dhisë*. Tiranë: Ora.

- Gluckman, Max (1968). *The Utility of the Equilibrium Model in the Study of Social Change*. In: “American Anthropologist” (Hoboken-NJ) Vol.70, No.2:219-237.
- Goodman, P. & O. Nordhaug (2008). *Are cultural differences in Europe on the decline?* In: “European Business Forum” (Brussels) Vol.2, No.8:48-53.
- Gudykunst, William (ed.) (2005). *Theorizing about Intercultural Communication*. Thousand Oaks-CA: Sage.
- Hofstede, Geert (2004). *Culture and Organizations; Software of the Mind*. Boston: McGraham-Hill (2nd ed.).
- Jandt, Fred E. (2010). *An Introduction to Intercultural Communication: Identities in a Global Community*. Los Angeles-Washington DC: Sage (5th ed.).
- Kitayama, H.R. and S. Markus (2003). *Culture, Self, and the Reality of the Social*. In: “Psychological Inquiry” (Philadelphia-PA) Vol. 14, No.3:277-283.
- Lasswell, Harold Dwight (1965). *World Politics and Personal Insecurity*. New York: The Free Press; origjinali: 1935.
- Mc Nair, Brian (2009). *Hyrje në komunikimin politik*. Tiranë: UET Press; origjinali: *An Introduction to Political Communication*. London: Taylor and Francis Group, 1995.
- Pearce, Barnett (2008). *Making Social Worlds; A Communication Perspective*. New York: Wiley-Blackwell.
- Romney, Kimbell A. and Tarow Indow (2002). *A Model for the Simultaneous Analysis of Reflectance*. In: “Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America” (Washington DC) Vol.99:14607-14610.
- Scupin, Raymond (2011). *Cultural Anthropology; A Global Perspective*. Englewood-NJ: Prentice-Hall Inc. (8th ed.).

1. Hyrje

Prezenca e studimeve folklorike në programin mësimor të disiplineve shoqërore akademike, fillimisht është e lidhur me ndërtimin e shtetit komb të ri në Europën Lindore dhe në Ballkan gjatë periudhës së mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe pas instalimit të regjimit komunist në këtë rajon¹.

Kjo periudhë ishte koha kur “Kombi” për një kohë të gjatë vendoset në kontekstin politik dhe në kornizën epistemologjike që referonte “folklorin nacionalist” duke nxitur këdo që studiointe historinë e kësaj disipline të kishte parasysh çështjen.

Në tërë vendet e bllokut Sovjetik, gjenerata e dytë reformatore e “komunistëve nacionalistë” zëvendësoi gjeneratën e parë të liderëve ortodoksë Stalinistë (Johnson 2001:190). Bashkë me ta edhe angazhimi ndërkombëtar proletar ishte braktisur dhe interesat kombëtare u vendosën në plan të parë.

Në rastin Jugosllav në mënyrë që të ndalohej nacionalizmi armiqësor, u drejtuan tek një variant i kontrolluar i federalizmit socialist, që më vonë pas fundit të vitit 1960, filloi të kthente elitat partiake të secilës Republikë në mbrojtjen e flaktë për kombet e tyre.

Në Rumani marrëdhënia midis komunizmit dhe nacionalizmit ka një fillesë dinamike të ndryshme, por më konkretisht u zhvillua nga Ceausescu në atë që disa shkencëtar e konsiderojnë si “forma më ekscentrike e nacional Komunizmit” (paty: 191).

Në Bullgari, deri në fund të vitit 1950, varianti u shfaq më i zbutur sepse vendi mbeti një satelit besnik i Moskës dhe në këtë situatë shkalla e lejuar e nacionalizmit ishte e kufizuar.

Edhe pse e instrumentalizuar ndryshe, *nacional komunizmi* ishte një fenomen socialist përtej kufijve. Emergjenca e ideologjisë në vendet socialiste kishte nevojë për një pamje të re në axhendën nacionale, për rrjedhojë furnizoi “folklorin” si shkenca që lidhej thellësisht me çështjet nacionaliste.

Në këtë mënyrë me metodat më komplekse dhe më depërtuese “kombi” gjendej në zemër të disiplinës dhe identitetit të praktikuesve të vet – dhe në disa hapësira akoma vazhdon të jetë.

Si pasojë institucione të reja u ndërtuan dhe parrulla të reja politike u vendosën. Këto orientuan disiplinën por kryesisht drejt një “folklori të ri” të popullit proletar. Zyrtarisht u përqendrua tek kultura popullore e traditat dhe rriti nacional komunizmin. Kështu “prodhimi i flokut” u fillua nën kontrollin e rreptë të partisë por gjithmonë me ndihmën e ekspertëve të folklorit.

Studiuesit e bllokut komunist Sovjetik (Rumunë, Jugosllavë, Bullgarë dhe Shqiptarë) u përqendruan të shqyrtonin kulturën e klasës punëtore, lëvizjet e rinisë

¹ Por prania e fushës së traditës në ndërtimin e shtetit-komb e ka origjinën në historinë e Europës në shek. XVIII.

Politikat kulturore dhe studimet folklorike në Shqipërinë komuniste

Corina Iosif Sîrbu, PhD

AKADEMIA E SHKENCAVE, INSTITUTI “ARHIVA DE FOLCLOR”, CLUJ-NAPOCA, RUMANI. KËRKUESE SHKENCORE/ANTROPOLOGE KULTURORE

Inis Shkreli, PhD

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE DHE EDUKIMIT, LEKTORE/ANTROPOLOGE KULTURORE NË DEPARTAMENTIN E SHKENCAVE SOCIALE TË APLIKUARA

ABSTRACT: Edhe në ditët e sotme, në vendet ish komuniste studimet folklorike mbetet disiplina më e rëndësishme në kurrikulat akademike. Nga këndvështrimi historik ky kuptim lidhet me procesin e ndërtimit të nacionalizmit shtetëror, dhe si rrjedhojë fusha e folklorit është instrumentalizuar dhe përmirësuar nga pushteti komunist për të ndërtuar ideologjinë e tij. Studimet folklorike dhe veçanërisht muzika tradicionale si pjesë e “folklorit kombëtar” mësohej/mësohet në shkolla dhe në universitete si pjesë e kulturës kombëtare. Mënyra se si janë perceptuar dhe strukturuar këto libra të folklorit muzikor thekson karakteristikat e “folklorit” si një strukturë e ideologjisë politike. Në këtë mënyrë mund të themi se mësimi i muzikës tradicionale influençoi kulturën e masës e cila u zhvillua edhe pas rënies së regjimit komunist. Ky artikull fokusohet në njohuritë e folklorit në Shqipëri gjatë periudhës komuniste, kohë kur kjo disipline u instrumentalizua në funksion të ndërtimit të shtetit-komb.

Fjalë kyç: Politika kulturore, kurrikulat akademike, folklori, komunizmi, nacional-komunizmi.

dhe fshatarësinë e kolektivizuar. Këto ishin tre kategoritë kryesore të vlerave të popullit e cila partia udhëhiqte për tu vënë nën studim. Pra shpresohet se këto kategori do të furnizonin ekspertët gjatë përpjekjeve për të modernizuar shtetin socialist.

Në Shqipëri kjo disiplinë lindi nga një interes për vetlegjitim. Ajo u zhvillua fillimisht si një “shkencë kombëtare” me një nevojë të dukshme për mjete konceptuale që të kapej në analizën e vendit. Kështu ndryshe nga rasti Britanik i kohës së Tylor apo në SHBA gjatë periudhës së Morganit, ku disiplina u formulua si “shkenca e kulturës”, në Shqipëri u formulua si “shkenca e njerëzve” = *etnologji*.

Në thelb do të ishte një lidhje e vërtetë, natyrore, dhe cilësore midis popullit dhe tokës ku ai jetonte. Detyra/misioni i kërkuesve ishte të manifestonin “shpirtin” e njerëzve që ndodhej në arte, mite, besime dhe rituale.

Nacionalizmi dhe lëvizja nacionaliste nuk zhvillohej vetëm në kontekstin politik, që duke ndërruar fytyrë prodhonte kërkesën për një “shkencë nacionaliste”, por në të njëjtën kohë pozicioni dhe roli i “shkencëtarëve nacionalistë” kishte veçantitë e tyre².

Në këtë kontekst folkloristët e perceptojnë vetveten dhe njëkohësisht në publik janë të perceptueshëm si pjesë e elitës intelektuale të vendit të tyre dhe për të cilët shoqëria i ngarkon me detyrën që të studiojnë, konsolidojnë, sajojnë dhe së fundi të mbrojnë “kauzën” e grupit shoqëror të cilit i përkasin. Kjo përkatësi e dyfishtë është faktor i fuqishëm i ideologjizimit të diskursit folklorik. I vetmi ndryshim qëndron se folkloristi në njërin rast mund të angazhohet në ideologjizim por nuk është krejtësisht i vetëdijshëm për këtë fakt, dhe në rastin tjetër folkloristi ideologjizon diskursin e vet qëllimisht. Këto dy raste ideologjizimi nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Përkundrazi kombinimi i efekteve të tyre është rezultati i vendeve për të cilat po flasim. Pikërisht ky kombinim reciprok stimulues i ideologjizimit të pandërgjegjshëm dhe të qëllimshëm vendosi termin e “sindromës së përkatësisë së dyfishtë” (Naumović 1998 in Mihăilescu, Iliev, Naumović, 2008: 14). Kjo sindromë shpjegon faktin se në asnjë nga këto vende të Ballkanit, folklori/antropologjia nuk kanë shkuar përtej kritikave post-nacionaliste ashtu siç bëri Perëndimi me kritikën e antropologjisë post-koloniale (Todorova 1997).

Pikërisht mungesa e kritikës së mëparshme në kërkimin shkencor, veçanërisht në Shqipëri na nxiti të ndalemi tek lidhja midis studimeve folklorike si një fushë projekti të shtetit komb me veprimet ideologjike të pushtetit komunist që lidhen me ndërtimin e traditave si një burim kombëtar specifik. Mbi këtë temë do të

² Kjo reflektohet tek ajo çfarë quhet sindroma e përkatësisë së dyfishtë ku shkencëtarët e konsiderojnë veten se i përkasin grupit me të cilin ndajnë të njëjtën gjuhë, traditë, vlerat thelbësore dhe interesat e njëjta politike. Si pasojë folkloristët nuk përballen me *distancën* e profesionit, distancë kjo që mënjanon dhe nuk ndikon në pjesëmarrjet vëzhguese afatgjate. Përkundrazi supozohet se folkloristët duhet të vëzhgojnë pikpamjet e një populli, duhet të shmanjin afërinë emocionale dhe jo ta ndërtojnë atë me kujdes. Ata duhet të kujdesen të mbajnë distancë me intervistuesit e tyre në mënyrë që ti kuptojnë më mirë dhe jo ti afrohen më tepër (Iosif 2007)

bashkojmë kërkimin tonë me problematikën e studimeve akademike folklorike pas instalimit të regjimit Komunist në Shqipëri³.

2. Koordinatat e ndërtimit të folklorit si bazë e identitetit kombëtar

Aftësia e artistit si dhe shija artistike për të “projektuar” artin universal (në këtë rast arkitekturën) brenda specifikës së zonës dhe për të integruar në të “një specifikë” shqiptare (këtu nuk merren parasysh ndryshimet kulturore të zonave në Shqipëri, si dhe ato të fshehura) shprehet pikërisht nëpërmjet kësaj karakteristike krijuese.

“Me vlerat arkitektonike dhe artistike monumentet e kulturës përfaqësojnë shembuj të aftësive krijuese të popullit tonë [...]... Zhvillimi ekonomik dhe përparimi shoqëror pasqyrohen tek ato me përdorimin e formave dhe teknikave të reja, me evolucionin e vazhdueshëm të shijeve artistike. Sukseset e popujve të tjerë në këtë drejtim nuk mbetën të huaja për popullin tonë, por u përvetësuan në mënyrë krijuese, në përshtatje me kërkesat e jetës dhe me kushtet e vendit. Mjeshtrit dhe artistët shqiptarë dhanë edhe ata një kontribut me vlerë në zhvillimin e arkitekturës dhe të artit të vendeve të tjera, qoftë me shembujt e krijimeve të tyre në Shqipëri, qoftë me punën e kryer drejtpërdrejt në vendet fqinjë. Shembujt e zgjedhur në këtë album synojnë të japin një tablo të përgjithshme të zhvillimit të arkitekturës sonë dhe të tregojnë vendin dhe rolin e saj të veçantë në kuadrin e qytetërimit mesdhetar (Strazimiri, Nallbani, Ceka, 1973: 1).”

Në rastin tonë realitetet estetike të ndërtimeve të quajtura “vepra ndërtuese” ose “krijime” janë në të njëjtën kohë të lidhura me nevojat historike ose shoqërore të formimit/ndërtimit. Këto realitete artistike shfaqen ndonjëherë në shkrime të ndryshme sikur të ishin më të rëndësishmet në raport me realitetet mbrojtëse, me ato ekonomike apo në raport me ato që lidhen me relievin gjeografik.

“Veprimtaria krijuese e ndërtuesve duket në përshtatjen e planimetrisë sipas funksionit të vendbanimit dhe të cilësive mbrojtëse të terrenit në vendosjen e kullave në pikat e mundshme

³ Ky punim në boshtin e tij analizues zgjeron kërkimet e zhvilluara në vendet ish komuniste, kërkime këto të kryera mbi këtë temë. Rezultatet e këtyre kërkimeve u publikuan në Halle në vitin 2008, në botimin me titull *Studying Peoples in the People's Democracies II. Socialist Era Anthropology in South-East Europe* (Mihăilescu, Iliev, Naumović, 2008)

të sulmit, dhe të portave në mënyrë të tillë që të lehtësonin qarkullimin e banorëve. Muret rrethuese ishin gjithashtu një shfaqje e fuqisë ekonomike dhe e nivelit kultural të qytetit. Përdorimi i muraturave poligonale, trapezoide apo katërkëndëshe, përveç se nga terreni dhe materiali i ndërtimit, përcaktohet dhe nga synimet për të krijuar efekte estetike” (*po aty*, 1973:2).

Ja ku po sjellim dhe një shembull tjetër:

“Banesa qytetare shqiptare ruan vlera të rëndësishme arkitektonike. Në tipet e saj më të përkryer gjejmë jo vetëm një koncept të qartë funksional, por dhe trajtime arkitektonike të goditura nga ky koncept. Punimi me shije i çdo detaji, njohja e thellë e gurit dhe e drurit, proporcionet dhe lidhja organike me ambientin rrethues e ngrenë këtë krijimtari popullore në nivelin e veprave me vlerë” [...].

“Në disa qytete të Shqipërisë, si Gjirokastrë, Korçë dhe Krujë ruhen pjesë të pazareve karakteristike, të cilët plotësojnë më mirë kuadrin arkitektonik e urbanistik të qytetit postmesjetar shqiptar” (*po aty*, 1973:8)

Disa koncepte të tjera kyçe të cilat shfaqen në tekstet e kësaj fushe, në lidhje me mënyrën se si “traditat” (objekti i studimit të folkloristikës, por pjesërisht dhe të historisë) bëhen pjesë e ideologjisë, bëhen edhe pjesë e diskutimit të këtij artikulli:

Rezistenca heroike e popullit shqiptar, është ajo që ka siguruar **vazhdimësinë e ekzistencës** së saj në territorin e Shqipërisë së sotme. Evokimi i rezistencës heroike si rregull shfaqet në çift me krenarinë, - kjo i referohet kombeve të vogla.

Vazhdimësia e traditës, e cila interpretohet si dëshmi e **vazhdimësisë historike**.

Ja ku po paraqesim një shembull mbi këtë çështje.

“Vazhdimi i traditave në arkitekturën e vendit tonë duket më qartë në ndërtimet e kultit të krishterë të shek. XVI-XVIII [...] Qëndresa heroike e popullit tonë nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër pushtuesve turq ka lënë gjurmët e veta materiale në krijimin e një sistemi fortifikimesh, qendra e të cilit është Kruja. Këtu hyjnë një sërë fortifikimesh në kufijtë lindorë të vendit dhe kështjella që mbronin rrugët kryesore të vendit, si Stellushi dhe Guri i Bardhë (Mat), Guri i Skënderbeut (Prrenjas), Petrela etj. Janë në përgjithësi qendra ushtarake me sipërfaqe të vogla,

të rrethuara me mure, që përmbledhnin një numër të kufizuar godinash me karakter ushtarak dhe pothuaj gjithmonë sterën e ujit të pijshëm. Jashtë mureve vendoset shpesh qendra zejtaro-tregtare, e quajtur varosh. Arkitektura e thjeshtë e këtyre qendrave dhe ndërtimet e kufizuara me karakter civil lidhen me jetën e organizuar në shërbim të luftës për mbrojtjen e vendit” (*po aty*, 1973:5-6).

Skema e tekstit në fjalë, e cila shfrytëzohet jo vetëm në këndvështrimin e analizës së fushës/specialitetit por edhe (sidomos) në atë të një linje të politikës kulturore, mund të lexohet në koncepte kyçe të cilat përdoren si:

Specifike
Vazhdimësi historike
Heroizëm
Pasuri kulturore

Por për shkak se teksti është shkruar para rënies së komunizmit, periudhë e artë e shprehjes së identitetit nëpërmjet riprodhimit të traditave, modeli na shfaqet me periudhën komuniste. Tashmë shfaqen koncepte të reja si:

Periudha historike e lavdishme
Lufta për çlirimin kombëtar⁴

Nuk na intereson fakti që këto koncepte me natyrë jopolitike përdoren në një tekst arkitekture, kjo ndodh në të tëra kulturat, pavarësisht historisë së tyre, por ajo çfarë na intereson është *mënyra* se si këto koncepte shfaqen në diskutim si dhe lloji i imazhit që krijojnë ato. Kjo vlen për tu analizuar. Por këto që thamë më sipër,

⁴ “Si një ndërtim karakteristik dallohet banesa e fortifikuar e Veriut, e njohur me emrin kulla shqiptare. Ajo është prodhim i një realiteti historik, ku mbizotëronte pasiguria e shkaktuar nga arbitrariteti i pushtuesit turk, i feudalëve dhe i veprimt të zakonit të hakmarrjes. Kjo përcaktoi formën e mbyllur me një lekonizëm elementësh arkitektonikë. Krahas këtij tipi në fshatin shqiptar ruhen edhe mjaft tipe të tjera banesash: në zonat fushore banesa të thjeshta të ndërtuara me qerpiç dhe me skelet druri, në zonat kodrinore banesa të hapura të ndërtuara zakonisht me gurë, ndërsa në zona malore përgjithësisht banesa të mbyllura me një ose dy kate. Në zonat e veriut takohen dhe banesa të ndërtuara krejtësisht prej druri. Në pasurinë tonë kulturele një vend të rëndësishëm zënë edhe monumentet historike, në të cilat u zhvilluan ngjarje të shënuara të historisë së vendit tonë. Shtëpia e vogël dhe e thjeshtë tiranase na ngjall sot emocionet e lidhura me një periudhë të lavdishme, të përshkruar që nga 8 Nëntori i vitit 1941, kur u themelua Partia Komuniste Shqiptare. Vendi i ngritjes së flamurit në Vlorë, godina ku u mblodh Kongresi i Lushnjës, shtëpia e formimit të Rinisë Komuniste, shtëpia e Labintotit, godina ku u mblodh Kongresi i Përmetit dhe një numur i madh ndërtesash që lidhen me ngjarjet e Luftës Nacional Çlirimtare, janë kthyer në objekte vizitash, ku kalojnë përpara rinisë sonë ngjarje nga periudhat më të lavdishme historike. Duke çfletuar faqet e albumit lexuesi do të njihet edhe me punën që zhvillohet për konservimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës” (*po aty*, 1973:8-9).

pikërisht mbi tekstin e paraqitur, nuk është domosdoshmërisht e nevojshme ti analizojmë. Në këtë kontekst mund të evidentojmë vetëm idenë dhe pastaj ta lëmë të hapur problemin.

3. *Strukturat shtetërore dhe fushat studimore të folklorit*

Në periudhën menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, Folklori u studiuua për herë të parë në një hapësirë më të gjerë, veçanërisht në drejtimin shkencor. Ky proces i koleksionimit u nda në dy plane, *tematika* dhe *gjinia*. Por ajo çfarë është më e rëndësishme në këto studime janë: tematika, metoda dhe këndvështrimi i folklorit i bazuar në teoritë Marksist-Leniniste.

Këto teori konsideronin folklorin e trashëguar dhe atë të krijuar rishtazi, gjatë dhe pas “Luftës Nacional Çlirimtare” si veprimtari popullore, historiko-shoqërore që reflektonte historinë Shqiptare me kontradiktat klasore.

Pas “Çlirimit” interesi i Partisë Komuniste u drejtua tek tekstet shkollore të cilat ilustronin krijime të ndryshme të folklorit gojor. Këto tekste u shërbenin drejt për së drejti kulturës së re shqiptare, edukimit patriotik dhe revolucionar të masës punëtore. Pra, folklori u vendos në një vend të rëndësishëm si një trashëgimi me vlera ideo-estetike pozitive në shërbim të formimit të “njeriut të ri”.

Kështu modeli i “njeriut të ri” u ndërtua duke filluar nga “modeli ideal” (në kuptimin Weberian) i individëve modernë (emancipimi), vlerat shoqërore të të cilëve kishin origjinë në fushën e traditave shqiptare.

Ndërkaq gjatë viteve 1948-1959 u themeluan institucione të ndryshme për çështjet folklorike, dhe u bënë kërkime shkencore të rëndësishme. Këto institute hapën sistemin e kërkimit folklorik dhe prodhimin e shumë botimeve. Për publikimin e këtyre teksteve folklorike u vendosën disa parime kryesore që lidheshin me:

1. katalogizimin e teksteve
2. periodizimin e teksteve
3. rendin tematik dhe historik
4. rendin gjinor dhe rajonal.
5. gjithmonë të udhëhequra nga ideologjia Marksiste-Leniniste (Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1972:45).⁵

E ndërkohë Folklori u bë një disiplinë e veçantë mësimore në shkollat e arsimit të përgjithshëm, të arsimit të mesëm e atij të lartë profesional e veçanërisht të arsimit të lartë filologjik e muzikor.

⁵ Në të vërtetë këtu po paraqesim/flasim (për) teknikat tipologjike si dhe ideologjinë.

Tipet e publikimeve ishin të ndara midis antologjisë dhe katër seksioneve folklorike:

1. Folklori Gojor - këngët lirike (me tërë llojet e saj) dhe epike, këngët liriko-epike, këngët rituale, këngët e migrimit, përrallat, baladat, legjendat, anekdotat, gjëgjëzat⁶.
2. Folklori muzikor - antologji, transkriptime të këngëve dhe valleve (këngë, melodi vallesh dhe melodi instrumentale).
3. Folklori koreografik (vallet popullore) - antologji, transkriptime me foto.
4. Folklori Dramatik (lojërat popullore⁷, argëtimet, shfaqjet popullore) - antologji me foto (*po aty*, 1972:3).
4. Tekstet shkollore dhe Tipologjitë e gjinive folklorike që shfrytëzoheshin në tekstet shkollore.

Folklori muzikor shqiptar (Morfologjia) - autor Ramadan Sokoli. Teksti u hartua për shkollat e mesme artistike muzikore, Fakultetin e Muzikës dhe aplikohet në kursin e Folklorit (Sokoli, 1965).

Folklori muzikor (Organologjia) - me autor Ramadan Sokoli. Teksti u hartua për shkollat e mesme artistike muzikore dhe Fakultetin e Muzikës, aplikohet në kursin e Folklorit (Sokoli, 1970).

Veglat muzikore të popullit shqiptar - me autorë Ramadan Sokoli dhe Pirro Miso. Ky tekst ashtu si dhe libra të tjerë shkollorë është shpërndarë në shkollat muzikore si dispensë. Teksti u përdor për shkollat e mesme artistike muzikore dhe Fakultetin e Muzikës, kursi Folklor.

Folklori shqiptar - antologji e cila ka filluar të botohet që prej vitit 1959, dhe është përpunuar e ribotuar në format të ndryshme deri në vitin 1977. Teksti u botua nga autorë të ndryshëm dhe u shpërnda në shkollat të mesme (lënda e letërsisë) si dhe në fakultetet, Pedagogji, Filologji-Histori dhe u përdor në kursin e Folklorit (Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1972, Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1977).

Leximi letrar - tekst mësimor për arsimin fillor dhe tetëvjeçar. Përbante këngë popullore, poema, legjenda, ballada, gjëgjëza, përralla dhe u përdor në lëndën e leximit (Dedi, 1977; Dilo, Nela, Gaçe, [1972], [1973], [1974], [1984], [1986], [1988]; Zheji, 1968, Zheji, Polovina, 1965, Bajraktari, Dizdari, Tabaku, [1981], [1983], [1984], [1985], [1987], [1988]; Harxhi, Bimbashi, Reso, [1983], [1984], [1988]).

Këngë popullore legjendare - Ky tekst u përdor për lëndën Folklor në tërë shkollat e mesme, ato profesionale dhe të përgjithshme (Llagami, 1975).

⁶ Ky është modeli i antologjive që janë përdorur në shkollat e mesme dhe fakultete.

⁷ Këto praktika tradicionale nxisin infiltrimin e folklorit tek fëmijët. Një strategji që rezultoi e suksesshme për transmetimin e natyrshëm të epistemologjisë së Folklorit tek brezat e rinj.

Monumentet arkitektonike Shqiptare - Ky libër është përdorur si tekst shtojcë në Fakultetin e Arteve Figurative dhe në Fakultetin e Arkitekturës (Strazimiri, Nallbani, Ceka, 1973).

Monumentet - revistë shkencore e Institutit të Monumenteve të Kulturës e cila është përdorur si tekst shtojcë në Fakultetin e Arteve Figurative dhe në Fakultetin e Arkitekturës (I.M.K, 1972).

Albania and Albanians in world art - me autor Ferid Hudhri. Libri është përdorur dhe vazhdon të përdoret si tekst ndihmës në Fakultetin e Arteve Figurative për lëndën e Historisë së Artit. (Hudhri, 1990).

Historia e Artit Shqiptar - teksti është përdorur në kursin e Historisë së Artit, në Fakultetin e Arteve Figurative (Meksi, Riza, Dharmo, Gjergji, Kuqali, 1990).

(Tipologjitë)

Këngët - lirike - këngë djepi, këngët e fëmijëve, këngët e dashurisë, këngët e dasmës, këngët e vajit.

Këngët epike - këngë kreshnike, këngë - vajtimi, këngë - epike.

Këngët epike-lirike-këngët historike (para dhe gjatë pushtimit Otoman si dhe pas Pavarësisë deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore).

Baladat - legjendare, baladat realiste, baladat me karakter lirik, baladat me karakter erotik, këngët e kaçakëve/cubave.

Këngët e mërgimit.

Këngët e punës.

Këngët e Nizamëve.

Këngët shoqërore - këngët e shfrytëzimit nga bejlerët dhe feudalët.

Këngë për jetën dhe natyrën.

Proza Popullore - Mitologjia dhe përrallat me personazhe mitologjike (ciklopë, floçka e ujit, zana, mena - gjarpëri i shtëpisë totem, shtriga, me kafshë dhe rol magjik në përralla) shemb. "Përralla e Qerosit", "E bukura e dheut", "Cmiri ndër dy motra etj".

Gojëdhënat/legjendat-shemb. gojëdhëna e "gurit të prerë"⁸, gojëdhënat e Argjiros së Gjirokastrës, gojëdhëna e "Liqenit të Kuq në Shpat"⁹ (Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1972:50-78).

Këngë legjendare - kënga e murimit "Murimi në Kala", kënga e besës së dhënë "Kënga e Dhoqinës", kënga e rinjohjes së burrit me gruan dhe motrës me vëllanë në periudhë lufrash "Kënga e Ymer Agës", "Gjon Petrika", këngë me temë rrëmbimi të një vajze nga një djalë i dashuruar me të "Larg ma livdoshin një vashë", këngë me bazë zakonore "Martesa e Halilit", vajtim "Ajkuna qan Omerin" (Llagami, 1975:3-44).

⁸ Që ndodhet afër Pazarit në Shllit të Matit të cilën Skënderbeu me një të rënë të shpatës e ka ndarë në katër pjesë.

⁹ Që është i kuq si gjaku dhe u derdh nga një luftim në kohën e Turkut.

Fabulat - me kafshë shtëpiake.

Anekdotat - me tematikë marrëdhëniet shoqërore, rituale, zakonore, familjare, klerike, feudale, me subjekt historik, me personazhe të njohura, p.sh. anekdotat për Ali Pashë Tepelenën, anekdotat kundër luftërave të Tanzimatit (Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1977:202-205).

Fjalë të urta - me subjekte, koha, ekonomia, natyra, mjeshtëri të ndryshme, bujqësi, blegtori, fenomene të natyrës, puna, marrëdhëniet shoqërore, morali, besa, gjatë kolonizimit Otoman, rituale etj.

Gjëegjëzat - me temë për subjekte të gjalla, objekte, objekte abstrakte - për njerëzit, për punën ose mjetet e punës, për botën bimore, kafshët, insektet, fenomenet natyrore dhe për shpendët.

Tekstet e reja folklorike u përgatitën nga kërkuesit shkencorë të Institutit të Folklorit në Tiranë, të cilët theksuan boshtin ideologjik të çështjeve folklorike. Puna e tyre reflektonte idetë e Partisë dhe të Enver Hoxhës për thellimin e revolucionit kombëtar¹⁰.

Në strukturën e punimeve vihet re mungesa e metodologjisë së mbledhjes, klasifikimit, analizave dhe transkriptimit të materialeve. Struktura e punimeve ndërton imazhin e modelit studimor nacional-komunist shqiptar si një tipologji e etnologjisë deskriptive dhe analitike jokrahasuese, i cili bazohet kryesisht në përshkrimin etnografik të dukurive folklorike dhe pothuajse shpesh anashkalon analizat etnologjike e të thella. Kjo çështje meriton për tu thelluar por për momentin mbetet një problematikë e hapur sepse burimi informativ është i vështirë të gjendet. Pjesa më e madhe e folkloristëve të kësaj gjenerate kanë vdekur dhe ndërkaq të tjerët kanë emigruar jashtë Shqipërisë.

Ndërkohë në vitin 1959, Folklori u përfshi si tekst i Historisë (ku fliste për historinë dhe traditën e popullit shqiptar) dhe Letërsisë Shqipe. Më vonë mënyra e shpërndarjes ndryshoi sepse tekstet folklorike u shumëfishuan dhe si rrjedhojë u përgatit një tekst i veçantë për lëndën e Folklorit, i cili ishte më i lidhur me letërsinë dhe artet. Tekstet e Institutit të Lartë të Arteve patën dy tipe dispensash të veçanta, njëra për melodinë dhe tjetra për vallet.

Tekstet e reja u pasuruan me objekte folklorike, me rryma të ndryshme të Europës, me teoritë e Partisë, Partia dhe Enver Hoxha për folklorin dhe se si Marksizëm-Leninizmi e vështroi folklorin.

Autorët e këtyre librave paraqesin se studimet e vërteta folklorike filluan vetëm pas "Luftës Nacional Çlirimtare". Ata e cilësojnë punën e autorëve para viteve 1944 si antishkencore dhe gjykojnë mungesën e përfshirjes së "socializmit shkencor" i

¹⁰ Në vitin 1950 themelohet Komiteti i Arteve dhe Kulturës pranë Kabinetit të Muzikës, në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës. Ndërsa në vitin 1957, u themelua Instituti i Historisë dhe Linguistikës pranë Universitetit të Tiranës. Ky institut mbledhi shumë materiale terreni nga tërë zonat e Shqipërisë. Punonjësit e institutit kryesisht mbledhën materiale folkloristike (tekste këngësh dhe vallesh) të krijuara para vitit 1944. Në 1960 u themelua Instituti i Folklorit më tre degët e saj, folklori gojor, folklori muzikor dhe folklori koreografik (Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1972:2-4).

cili në thelb përmban teorinë dhe taktikën e demokracisë proletare, strategjinë dhe metodën për të përmbysur kapitalizmin e pabarazisë klasore. Kritika e studiuesve të nacional-komunizmit ndaj autorëve të Folklorit para Luftës së Dytë Botërore fokusohej tek interpretimi që i bëhej konceptit të Folklorit dhe krijuesve të Folklorit si “krijimtari folklorike e krijuar nga shtresat e ulëta shoqërore dhe nga fshatarësia”. Ky këndvështrim ilustronte përkatësinë e një Folklori nga klasa fshatare por nuk konsideronte luftën e klasave, ose “shtypjen klasore”. Arkitektët e Folklorit komunist njëkohësisht janë kritikë dhe për teoritë e ndryshme të antropologëve dhe filozofëve. Studiuesit e Folkloristikës si Zihni Sako, Dhimitër Shuteriqi, Qemal Haxhihasani dhe Agron Fico në tekstin Folklori Shqiptar (1972), shprehen se:

“Teoritë e antropologëve dhe filozofëve si, Hegel, Durkheim, Politis janë reaksionare, të prapambetura, revizioniste, shoviniste sepse ata krijojnë folklorike nuk i konsiderojnë si krijime popullore, por si prodhime nga njerëzit primitivë” (1972:6-7).

Si rezultat për autorët e pas viteve 1944, këndvështrimi i autorëve të “Para Çlirimit” në ndikimin e teorishtëve “reaksionarë” nuk pushtonte ndërgjegjen e masës popullore, e cila përfaqësonte në vetvete një armë dhe shprehte interesat e vërteta të Partisë Komuniste proletare e cila theksonte luftën e klasave dhe të revizionizmit, si luftë ideologjike kundërsht armiqëve të jashtëm e të brendshëm (Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1972:7).

Folklori për autorët e nacional-komunizmit konsiderohet si dija e popullit, vlerësimi i fenomeneve shoqërore të shprehura në krijimtarinë folklorike, e cila buron nga eksperiencia shekullore për luftën klasore dhe kundër pushtuesve.

Chris Hann (2006:400) na kujton se në vendet e Evropës Lindore “etnologjia” (si dhe në rastin tonë) “folklori” që prej fillesës së saj, është konsideruar *nacionaliste*, ide kjo që e ka origjinën nga paraardhësi i tyre (autorëve të teksteve) gjerman Johann Gottfried von Herder. E ndërsa vetë Herder nuk ishte romantik, me idetë e tij për “etnitë” rreth *Volk* dhe *Geist*, influencoi fuqishëm romantizmin politik “të kombeve të reja” dhe tek themeluesit e tyre.

Mbi këto koncepte teorike autorët e çuan folklorin Shqiptar në drejtim “të shkencës kombëtare” si mbartëse e detyrave thelbësore. Për shembull, përf forcimi në këndvështrim të përgjithshëm i “eksperiencës shekullore” e cila bazohet në zakonet, ritualet, mitologji, rapsodi, lirikat erotike, këngët historike, melodi të ndryshme (orkestrinat popullore - kabatë, fyejt). Në këtë mënyrë provohej se edhe nëse masa popullore nuk dinte të lexonte dhe të shkruante, Folklori nuk vinte nga njerëz pa dije por nga një kulturë kolektive ndjenjat e të cilës transmetoheshin nga rapsodët e bartësit (*po aty*, 1972:7-9).

4. Marksizëm-Leninizmi dhe Folku në dispensa

Teoritë Marksiste dhe Leniniste që shfrytëzohen në dispensat e Folklorit, theksojnë artin popullor si veprimtari shpirtëror që reflektojnë botën e vërtetë të një populli. Materializmi dialektik dhe historik ndërtuan teori ideologjike të reja dhe si rezultat punime të ndryshme u bazuan tek interpretimi ideo-artistik i Folklorit si dhe tek teoritë Marksiste dhe Leniniste. Sipas teorishtëve Marksiste-Leniniste, arti dhe krijimet folklorike që prej kohëve të lashta deri në ditët e sotme nuk i përkasin njeriut primitiv. Vizioni i tyre për Folklorin paraqitet në një frazë të tillë si:

“Këto krijime u zhvilluan në vazhdimësi si dhe u ndikuan drejtpërdrejt nga teknikat prodhuese të materialeve jetësore. Pra këto krijime folklorike që reflektojnë jetën sociale të një populli, gjatë kohërave u zhvilluan dhe u rritën në marrëdhënie me transformimet shoqërore” (*po aty*, 1972:13).

Nga ana tjetër Partia Komuniste Shqiptare dhe Enver Hoxha theksonin nevojën e vlerësimit të Folklorit tradicional si dhe atij të mëvonshëm, duke e përcaktuar atë si veprimtari historiko-shoqëror. Kështu Folklori shqiptar shton trashëgiminë e parimeve Marksiste-Leniniste në studimet folklorike. Prej kësaj do të dilte në pah *popullorja* apo *folklori* i cili shprehte opinionin e ri revolucionar të ideologjisë proletare Marksisto-Leniniste. Në këtë drejtim Folklori shqiptar nuk do të konsiderohej më si një eveniment i përditshëm por do të shprehte dhe do i shërbente Partisë Komuniste.

Gjatë tranzicionit socialist nënkuptohet se kultura karakterizohej nga një frymë e fortë dhe e thellë popullore. Periudha socialiste ishte fuqimisht popullore. Pra përmbajtja e Folklorit vërteton ideologjinë e viteve të regjimit, por kjo lloj ideologjie do të konservohet edhe për studimet folklorike të sotme, post komuniste.

Ndërkohë në tekste vërehet një ndryshim midis konceptit të “folklorit” dhe “krijimtarisë popullore”. Folklori konsiderohet si prodhim i popullit i shprehur në mënyrën më të zakonshme popullore. Në këtë kategori klasat shoqërore nuk theksoheshin. Termi “folklor” që u shfaq brenda kushteve të reja shoqërore u shpreh mbi bazat e mësimëve të Hoxhës dhe teorishtëve folklorike të Marksit dhe Leninit. Folklori i të shkruarës dhe Folklori i së tashmes komuniste duhet të zbulonte pozitiven brenda trashëgimisht duke nënvizuar luftën e klasave, sigurisht të ndihmuar nga motivet popullore. Mësimet e Hoxhës udhëhiqnin shqyrtimin e prodhimit të Folklorit të kaluar (pra atij para 1944) ku duhet të gjehejshin idetë inovative, si adhurimi i atdheut, konturet patriotike, aleanca me fshatarësinë, etj.

Në tekste gjenden tre lloje epikash:

1. Para pushtimit Otoman.
2. Gjatë pushtimit Otoman.
3. Gjatë Luftës Nacional Çlirimtare.
4. Baladat për dëshmorët e Luftës Nacional Çlirimtare dhe për ndërtimin e socializmit.

Në këto epika karakteri demokratik përdoret si element bazë, si dhe lufta e klasave dhe ajo ndaj pushtuesve. Në njërin nga tekstet jepet një shembull.

“Në këtë pikë këngët edukojnë dhe frymëzojnë masën punëtore, të besojnë tek forcat e tyre, theksojnë patriotizmin, drejtësinë, dhe luftën për një jetë më të mirë” (Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1977:79). Po japim disa shembuj nga tre llojet e epikës shqiptare, marrë nga tekstet shkollore.

1. Baladat përpara pushtimit Otoman¹¹
2. Baladat gjatë pushtimit Otoman¹²
 - Fillimi i shekullit XVII¹³
 - Baladat për lëvizjen kombëtare/ pavarësi¹⁴
3. Baladat gjatë Luftës Nacional Çlirimtare.
 - Baladat për pushtimin Italian¹⁵.
4. Baladat për dëshmorët e Luftës Nacional Çlirimtare dhe për ndërtimin e socializmit.

Sakrificat e popullit, patriotizmi, vendosmëria e popullit, idealizimi i Skënderbeut dhe simbole të tjera që përshkruhen në balada, shërbejnë për ti dhënë një imazh

të mirë Shqipërisë përpara Europës. Këto konsideroheshin si elementë autoktonë shqiptarë dhe i shërbenin ideologjisë.

Elementët që theksojnë ideologjinë e këtyre baladave janë Shqipëria, atdheu, Shqiptar, populli, mbrojtja e vendit me popullin e bashkuar, përpjekja e popullit për pavarësi, shpirti patriotik dhe ndërgjegjia e masave popullore për idetë kombëtare.

Më pas vijojnë balada të cilat u krijuan gjatë dhe pas 1944, ku si simbol vendosen Partia Komuniste me Enver Hoxhën, veprimtaritë e tyre gjatë luftës, si dhe ideali për liri e demokraci.

Lufta dhe rezistenca e popullit, besimi tek lavdia, dashuria për udhëheqësit, urrejtja për pushtuesit dhe tradhëtarët e kombit, shfrytëzimi ekonomik i klasave shoqërore (feudalët dhe borgjezët), revolucioni, patriotizmi, virtytet për fshatin dhe qytetin kjo është epika e re e politizuar e cila quhej **“partishmëria”** dhe këto elemente qëndrojnë në bosht të karakterit të saj. Tashmë rapsodët nuk fokusoheshin në rigjenerimin e traditës, por ata shtrinin horizontin e tyre drejt kompleksitetit të luftës, problematikës dhe ilustrimeve të luftës. Me këtë lloj epike gjatë periudhës së pas luftës (1944), filloi gjerësisht progresi i Folklorit të ri, periudhë kjo që shënon fazën më të lartë të krijimtarisë gojore. Këngët e Luftës Nacional Çlirimtare ndryshe nga këngët tradicionale bënë jehonë për ngjarjet e luftës dhe ato revolucionare, jehonë e cila qëndronte në përhapjen e ideologjisë Marksiste-Leniniste¹⁶.

Frazat më të përdorura në këngët popullore drejtuar Enver Hoxhës ishin “pishtar i lirisë”, “kasolle më kasolle”, “fshat më fshat”, “brinjë më brinjë”.

Duke analizuar këtë moment duhet të theksojmë perspektivën për ndryshimin e kulturës fshatare (tradicionale) në projektin e ndërtimit të identitetit (etnik) kombëtar Shqiptar, duke vlerësuar karakterin dhe tiparet e sjelljes që përmbante kultura fshatare. Imazhet e promovuara nga gjinitë e ndryshme të letërsisë gojore bëhen burimet kryesore për kulturën kombëtare¹⁷.

Duke parë tekstet e këngëve, tendenca e autorëve ishte të vendosnin këngë nga tërë krahinat e Shqipërisë. Në përgjithësi nuk kishte preferenca të veçanta, përveç përjashtimit që bëhej për qytetin e Gjirokastrës, ku u lind dhe u rrit Enver Hoxha. Ky qytet theksohej shumë në tekstet e këngëve.

Por koleksioni folklorik i influencuar nga ideologjia e Partisë u transformua. Tekstet folklorike u pasuruan me fjalor të ri me nocione të reja ideologjiko-politike, gjuha muzikore u transformua, u bënë kompozime të reja, karakteri i epikës-

¹⁶ “Enver, mbledhjen e drejtëve/ fraksionet i demaskove, dhe Partinë e formove/ luftën e organizove, Shqipërinë e çlirove”, ose “Kësi trimash ka Shqipëria/ jua lulëzoi mendjen Partia/ mos me lanë tradhëtarë mi dhe/ me ba deken si mele”; “Enver Hoxha hane-hane/ zure luftën me krale/ nëpër gërxhe, nëpër male/ pa buk e pa ujë fare”; “për të dashurën Parti/ që ka heqë të keqi/ si në mal e në veri/ me qull” e bukë në hi/fishek e bomba në gji/ luftën me di mbretëri” (po aty, 1972: 240).

¹⁷ Do këndoij këngën e trimit/ të shkruar në poezi/ Gjyrokastër n’atë brinjë/ Gorica na vjen karshi/ç’u vra Muzo Asqeriu/ vjen haberi në Parti; O djema për Shqipërinë/ Sa të çdukim skllavërinë/ Për fshatar e puntorin; Vëndin do ta lulëzomë/ socializmin do të ndërtojmë/ dhe komunizmin më vonë (Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1977:252-254).

dramatike po shprehej me emocione optimiste, vallet që kërceshin në familje u bënë valle të kërcyera në publik me masën, orkestrinat popullore u zgjeruan në formacione muzikore më të mëdha dhe u përzien me instrumente të gjinive të ndryshme duke marrë trajtën e orkestrave normale.

Refrenet e këngëve u bënë më të gjata duke influencuar formën recitative të ritmit, duke rritur vitalitetin e melodisë dhe duke e lidhur atë në mënyrë organike me revolucionin¹⁸. Kështu vallet u bënë më dinamike dhe u pasuruan me hapa të tjerë koreografikë.

Ky koleksion i ri i Folklorit u përformua në festivale dhe ndiqej nga një audiencë e madhe nga shtesa të ndryshme të popullsisë. Ndërkaq u rrit lëvizja amatore në fshatra dhe qytete. Repertori i tyre ishte më shumë folklor i përpunuar mbi bazat e punimeve artistike individuale dhe jo atyre kolektive, karakteristikë e folklorit gojor. Ndryshimi midis folklorit tradicional dhe atij të përpunuar nga amatorët apo profesionistët dalloheshin sepse folklori origjinal në të shumtën e kohës ekzekutohet në grup ndërsa koleksioni folklorik i ri socialist ekzekutohet mbi bazat e punës dhe literaturës artistike individuale.

Profesionalizimi i individit në fushën e spektakleve të folk medias prodhoi gjini të reja folklorike, në muzikë dhe valle, dhe si rrjedhojë u vendosën profesionalizma të reja (Buchanan, 2002). Në fakt profesionalizmi i spektakleve, i artistëve dhe menaxherëve të Folklorit të ri është i lidhur me kulturën urbane shqiptare, kryesisht ose përgjithësisht me zhvillimin e medias europiane në fushën e spektakleve folklorike.

5. Folklori fshatar “Volk” për ndërtimin e shtetit-komb

Gjatë Luftës së Dytë Botërore “e cila ishte lufta e masave”, përbërja e popullatës që mori pjesë në luftë ishte fshatare, për këtë arsye Partia i dha rëndësi të veçantë tërheqjes së fshatarësisë në luftë. “Ajo ishte fuqia thelbësore për këtë luftë” kështu shprehte kryetari i shtetit Hoxha në një raport të mbajtur në Kongresin IV të Forumit Demokratik (Sako, Shuteriqi, Haxhihasani, Fico, 1977:27). E ndërsa kjo popullsi fshatare hynte në luftë, në të njëjtën kohë sillte dhe Folklorin e saj (fshatar). Kështu në luftë u krijuan këngët patriotike partizane të bazuara në motivet folklorike që ishin krijuar nga rapsodët dhe improvizuesit¹⁹. Pas luftës këto këngë u kënduan në shkolla dhe në festivale deri në fund të periudhës komuniste. Pra, ideologjikisht dhe artistikisht ky variant Folklori hyri në shoqërinë shqiptare në shkallë shumë të lartë. Megjithatë

¹⁸ Shiko tekstet e këngëve tek Leximi letrar 7 (antologjia) (Dilo, Nelaj, Gaçe, 1988).

¹⁹ Pjesa më e madhe e melodisë së këngëve partizane janë idem me melodinë e këngëve partizane Jugosllave. Autorësia e këtyre këngëve mbetet një diskutim i hapur, përderisa shqiptarët dhe jugosllavët kanë bashkëpunuar ngushtësisht gjatë Luftës së Dytë Botërore.

fenomeni subjektiv ku Folklori fshatar përbën një pjesë të rëndësishme për kulturën kombëtare, mbetet akoma edhe në ditët e sotme si shprehja e përgjithshme, parimet Marksiste-Leniniste kanë mbetur të atashuara me populloren dhe jo populloren.

Për shkak të faktorëve të ndryshëm historikë (kryesisht rënia e shteteve feudale dhe përfshirja e popullatave agrare kulturalisht dhe etnikisht jo homogjene në perandoritë e mëdha kulturore), kombi që kërkonin këto shoqëri ishte më tepër një *subject kolektiv (i unifikuar) i pavarësisë*, sesa një *subjekt individual i lirisë* (Mihăilescu 1991 in Mihăilescu, Iliev, & Naumović, 2008:10). Pra “krijimi” i subjekteve kolektive nacionaliste ishte një detyrim i lëvizjeve nacionaliste, përtej dhe para çdo konsiderate se si duhet të jetë ky subjekt i “karakterit kombëtar”.

Demografikisht, ky subjekt kolektiv duhet të ishte fshatarësia ose përfshirja në një mënyrë apo tjetër e këtyre popullatave rurale. Në këtë rast shteti/komb duhet të ndërtohej me fshatarësinë. Edhe këtu ndërhyr “folklori nacionalist” për të rimodeluar këtë fshatarësi nacionaliste: në Shqipëri folklori duke qenë “disiplinë shtet-formuese” duhet të bëhej kryesisht një *disiplinë fshatar-formuese*. Kështu Folklori nacionalist ishte i përfshirë në problematikën për të *sunduar me fshatarësinë e re (po aty: 2008, 11)* dhe “kombi” i cili kishte si faktor dhe simbol kryesor fshatarësinë kishte lidhje me idenë e etnisë së popullit (Verdery 1995: 105).

Autorët pasi sqarojnë konceptin dhe karakterin e folklorit, me shembuj nga vëllezërit Grimm, rapsodët, etj., ilustrojnë folklorin kolektiv me rapsodë të njohur nga Shqipëria; Selim Hasani nga Brataj, (Vlorë)²⁰, familja Kondi nga Vranishti, (Korçë)²¹, familja Dardeshi nga Begjuneci, (Dibër) të cilët përmenden si valltarë shumë të mirë. Në tekste bartësit nuk paraqiten vetëm si të tillë por ata paraqiten edhe si kompozitorë dhe krijues këngësh e vallesh (hapash) të reja të këngëve historike. Kështu investimi i tyre bëhet kriter dallues në Folklorin e ri të hapësirës së re socialiste, gjëndje kjo që bazohet në mësimet e ideologjisë së re komuniste.

Pra, siç shihet Folklori (manifestim popullor) gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore pati rinovim të fuqishëm. U shfaqën këngë të reja historike, që flasin për pavarësi dhe liri, proverba dhe anekdota të cilat demaskojnë shtypjen dhe keqtrajtimin. Por siç thamë më lart nuanca të reja u shfaqën, sepse Folklori po përdorej si qëllim për një çështje të re.

Në këtë mënyrë Folklori u bë një instrument i fuqishëm për edukimin, revolucionin, për të shprehur kombëtarën, duke u trajtuar si përmbajtja ideologjike e re për revolucionin e popullit dhe më adaptja për të komunikuar me masën.

²⁰ Hasani këndonte tekste të stilit polifonik.

²¹ Përmendej/përmendet për aftësitë e tyre si këngëtarë dhe valltarë.

6. Konkluzione

Pse duhet të hetojmë në ditët e sotme rolin e “kulturës popullore/folklorike” dhe rëndësinë e studimeve folklorike gjatë regjimit komunist? Politikat komuniste që lidhen me kulturën fshatare dhe me ideologjinë komuniste të cilat lidhen me “traditën” si një model për ndërtimin e “njeriut të ri”, influencuan fuqishëm për evoluimin e shoqërisë Shqiptare para dhe pas rënies së regjimit komunist. Interesi i pushtetit komunist për Folklorin si një fushë e kulturës së masës, udhëhoqi drejt formimit për konsumin e rëndësishëm të “folklorit”.

Në të njëjtën kohë kulturat fshatare, të konvertuara në “traditat kulturore” gjatë periudhës së regjimit akoma mbeten një nga fushat më të rëndësishme të shkencave shoqërore në Shqipëri.

Kjo situatë karakterizon tërë vendet ish komuniste, por “rasti Shqiptar” mund të konsiderohet si një shembull për rezultatin e takimit të shoqërisë shumë tradicionale, ideologjisë komuniste dhe ndërtimin e interesit të përgjithshëm për kulturat urbane.

Shqipëria konsiderohet në ditët e sotme si një zonë e cila ruan akoma trashëgimninë kulturore europiane, polifonia vokale, epika etj. (rasti i Iso-polifonisë popullore shqiptare që zë vend (2005), në listën e “Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit”, të mbrojtura nga UNESCO).

Duke ndjekur rrjedhën e dekadave historike të fundit, të udhëhequra nga historia komuniste, imazhi publik i këtij vendi dhe vetpërfaqësimi i identitetit shqiptar bazohet tek ideja “e traditës e cila akoma gjallon” dhe tek ideologjia për riprodhimin e modelit ekzistues të shoqërisë.

Bibliografia

- Bajraktari, B. & Dizdari, Z. & Tabaku, F. (1981). Leximi 4. Tiranë: SH.B.L.SH.
- Buchanan, A. D. (2002). Soccer, Popular Music and National Consciousness in Post-State-Socialist Bulgaria, 1994-96. *British Journal of Ethnomusicology* 2:1-27.
- Dedi, I. ([1972], [1973], [1974], [1977]). Leximi letrar 7 (antologjia). Tiranë: SH.B.L.SH.
- Dilo, E. & Nelaj, I. & Gaçe, M. ([1984], [1986], [1987], [1988]). Leximi Letrar 5, 6, 7. Tiranë: SH.B.L.SH.
- Hann, C. (2006). Nation and Nationalism in Central and Eastern Europe. In G. Delanty, and K. Kumar (eds.), *The SAGE Handbook of Nations and Nationalism*, pp.399-409. London: SAGE Publications.
- Harxhi, B. & Bimbashi, E. & Reso, I. ([1983], [1984], [1985], [1986], [1987], [1988]). Leximi 1, 2, 3, 4. Tiranë: SH.B.L.SH.
- Hudhri, F. (1990). *Albania and Albanians in world art*, Athens: Christos Giovanis A.E.B.E
- Iosif, C. (2008). The Politics of Tradition: Practices of Ethnological Museology Under Communism. In *Studying people in the People's Democracies II. Socialist Era Anthropology in South-East Europe*, ed. Mihăilescu, V, I. Iliev, & S. Naumovič. Berlin: LIT VERLANG.

- I.M.K. (1972). *Monumentet*. Tiranë: I.M.K.
- Johnson, L. R. (2001). Eastern Europe. In A. J. Motyl (ed.), *Encyclopedia of Nationalism*, pp. 165-200. Vol. I. San Diego, CA: Academic Press.
- Llagami, T. (1975). Këngë popullore legjendare. Tiranë: SH.B.L.SH.
- Meksi, A. & Riza, E. & Dharmo, Dh. & Gjergji, A. & Kuqali, A. (1990). *Historia e Artit Shqiptar I*, Tiranë: SH.B.L.U.
- Mihăilescu, V. & Iliev, I. & Naumovič, S. (2008). *Studying Peoples in the People's Democracies II. Socialist Era Anthropology in South-East Europe*, Berlin, LIT VERLAG.
- Mihăilescu, V. (1991). Nationalité et nationalisme en Roumanie. In Mihăilescu, V. & Iliev, I. & Naumovič, S. (2008). *Studying Peoples in the People's Democracies II. Socialist Era Anthropology in South-East Europe*, Berlin, LIT VERLAG.
- Naumovic, S. (1998). Romanticists or Double Insiders? An Essay on the Origins of Ideologised discourses in Balkan Ethnology. In Mihăilescu, V. & Iliev, I. & Naumovič, S. (2008). *Studying Peoples in the People's Democracies II. Socialist Era Anthropology in South-East Europe*, Berlin, LIT VERLAG.
- Sako, Z. & Shuteriqi, Dh. & Haxhihasani, Q. & Fico, A. (1972). *Folklori shqiptar*. Tiranë: SH.B.L.SH.
- Sako, Z. & Shuteriqi, Dh. & Haxhihasani, Q. & Fico, A. (1977). *Folklori shqiptar 1*. Tiranë: SH.B.L.SH.
- Sokoli, R. (1965). Folklori muzikor shqiptar (Morfologjia). Tiranë: SH.B.L.SH.
- Sokoli, R. (1970). Folklori muzikor (Organologjia). Tiranë: SH.B.L.SH.
- Sokoli, R. & Misso, P. (1991). Veglat muzikore të popullit shqiptar. Tiranë: SH.B.L.SH.
- Strazimiri, B. & Nallbani, H. & Ceka, N. (1973). *Monumente të arkitekturës në Shqipëri*, Tiranë: I. M. K.
- Todorova, M. (1997). *Imagining the Balkans*. New York: Oxford University Press.
- Verdery, K. (1995). National Ideology and National Character in Interwar Romania. In Banac, I. & Verdery, K. (eds.), *National Character and National Ideology in Interwar Eastern Europe*, pp.103-34. New Haven: Yale Center for International and Area Studies.
- Zheji, Gj. (1968). Leximi letrar 6. Tiranë: SH.B.L.SH.
- Zheji, Gj. & Polovina, A. (1965). Leximi letrar 7, 8. Tiranë: SH.B.L.SH.

si është realizuar komunikimi i objektivit kryesor, atij të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Fjalët kyç: marrëdhënie publike, strategji komunikimi, komunikim politik, menaxhim reputacioni.

Roli i Marrëdhënieve Publike Politike në promovimin e Qeverisë Shqiptare

PhD. Lorena Liçenji

ABSTRAKT. Pas vitit 2013, Qeveria shqiptare ka përdorur gjerësisht teknikat dhe instrumentet e marrëdhënieve publike si përpjekje jo vetëm për të përcjellë një imazh sa më pozitiv të Qeverisë brenda territorit shqiptar, por edhe përtej kufijve.

Qëllimi i këtij punimi është të marrë në analizë funksionin që kanë luajtur marrëdhëniet publike në përpjekje për të përmirësuar reputacionin e Shqipërisë në "sytë" e Bashkimit Europian. Njëkohësisht, synimi i këtij punimi është të identifikojë strategjitë e komunikimit të përdorura nga Kryeministri si përfaqësues i Qeverisë shqiptare. Kush ka qenë publiku i shenjëstruar i marrëdhënieve publike qeveritare dhe cilat kanë qenë teknikat e përdorura për të përçuar imazhin pozitiv dhe të "Rilindur" në arenën publike ndërkombëtare?

Pikërisht nëpërmjet identifikimit të strategjive të marrëdhënieve publike do të arrijmë të analizojmë efikasitetin që ato kanë pasur dhe nëse kanë ndikuar sadopak mënyrën e perceptimit të Shqipërisë nga vendet anëtare të Bashkimit Europian.

unimi synon të verifikojë hipotezën se aplikimi i strategjive dhe teknikave të marrëdhënieve publike, falë pasqyrit të favorshëm mediatik, ndikon pozitivisht në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë. Kjo hipotezë do të vërtetohet nëpërmjet analizës së strategjive komunikative të përdorura nga Kryeministri Shqiptar gjatë programeve televizive të stacioneve të huaja në të cilat ai ka qenë i ftuar gjatë vitit 2014-2015. Emisionet televizive të marra në shqyrtim kanë qenë disa si: "Conflict Zone", "Agora", "France 24", "Konventa e Industrialistëve të rinj", "Invasioni Barbariche".

Për realizimin e këtij punimi është zgjedhur përdorimi i metodës cilësore e kombinuar me shqyrtimin e kuadrit teorik mbi marrëdhëniet publike politike. Nëpërmjet analizës përmbajtësore të emisioneve në të cilat Kryeministri shqiptar ka qenë i ftuar do të identifikojmë fjalët kyç që janë përdorur për të përshkruar Shqipërinë dhe mënyrën se

Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë funksionin dhe efikasitetin e përdorimit të marrëdhënieve publike për përmirësimin e reputacionit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Hipoteza kryesore e këtij punimi sugjeron që aplikimi i strategjive dhe teknikave të marrëdhënieve publike nga qeveria shqiptare ka ndikuar në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë. Kjo hipotezë do të vërtetohet nëpërmjet analizës së strategjive komunikative të përdorura nga Kryeministri Shqiptar gjatë emisioneve të rrjeteve televizive të huaja në të cilat ai ka qenë i ftuar gjatë periudhës 2014-2015.

Në funksion të verifikimit të hipotezës kryesore do të merren në analizë marrëdhëniet publike të jashtme, pra rastet kur vetë Kryeministri i vendit ka qenë i ftuar në evenimente apo emisione të televizioneve të huaja.

Për realizimin e këtij punimi është zgjedhur kombinimi i të dhënave të mbledhura nga burimet primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë mbështetur në analizën përmbajtësore të intervistave dhe ato dytësore në analizën e literaturës mbi marrëdhëniet publike politike dhe në veçanti ato mbi reputacionin dhe menaxhimin e imazhit të një kombi.

Emisionet televizive të marra në shqyrtim kanë qenë disa si:

- "Conflict Zone", Deutsche Welle, shtator 2015.
- "Agora" Rai Tre, qershor 2015.
- "France 24", maj 2014.
- "Konventa e Industrialistëve të rinj", qershor 2015
- "Invasioni Barbariche", La7, shkurt 2015.

Nëpërmjet analizës përmbajtësore të emisioneve në të cilat Kryeministri shqiptar ka qenë i ftuar do të mund të identifikojmë fjalët kyç të përdorura për të përshkruar Shqipërinë dhe mënyrën se si është realizuar komunikimi i objektivit kryesor, atij të ndërgjegjësimit të audiencës ndërkombëtare mbi domosdoshmërinë e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Për të realizuar këtë studim është konsideruar e nevojshme identifikimi i faktorëve që kanë influencuar procesin e komunikimit të qeverisë shqiptare dhe njëkohësisht teknikat e zgjedhura për të komunikuar objektivat e synuara.

1. Rëndësia dhe funksioni i marrëdhënieve publike politike

Termi marrëdhënie publike ka një interpretim të gjerë dhe ndër vite është pasuruar me përkufizime të ndryshme, por përgjatë punimit do të fokusohemi tek qëllimi i funksionimit të marrëdhënieve publike politike, që është ai i krijimit të ndërgjegjësimit mbi një subjekt apo figurë politike dhe krijimi i marrëdhënieve të mira me publikët e interesuar.

Fillesat e teknikave moderne të marrëdhënieve publike datojnë në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit të XX-të me veprimtarinë e pionerit të parë Ivy Lee (Dominick, J. R, 2010). Historia tregon se kanë qenë qeveritë amerikane ato që kanë përdorur me efikasitet dhe rezultate mbresëlënëse praktikatat e mira të marrëdhënieve publike duke njohur më së miri potencialin e jashtëzakonshëm të medias në përpunimin e opinionit publik.

Është pikërisht ndërtimi dhe menaxhimi i reputacionit të një organizate, qeverie apo partie politike ajo që paraqet një ndër qëllimet kryesore të funksionimit të marrëdhënieve publike. Marrëdhëniet publike janë një proces që përfshin një sërë aspektesh të ndryshme duke nisur nga hulumtimi dhe analiza, plani i programit, komunikimi dhe feedback-u, por ajo që konsiderohet lajtmotivi i marrëdhënieve publike është synimi për të prezantuar një person, kompani ose subjekt në dritë më të mirë të mundshme (Marconi, 2010)

Sipas PR News *“Marrëdhëniet publike janë funksion menaxhues që vlerëson qëndrimet publike, identifikon kursin e veprimit dhe procedurat e një individi ose organizate me interesin publik dhe ekzekuton një program veprimi për të fituar durimin dhe kuptimin e publikut”*

Objekтиви kryesor i marrëdhënieve publike politike është arritja e qëllimeve të caktuara politike dhe influencimi i politikës (Strömbäck & Kioussis, 2011,b). Nisur nga ky përkufizim identifikojmë komunikimin dhe bashkëpunimin me publikun si një ndër elementët më të rëndësishëm të marrëdhënieve publike. Komunikimin do ta konsiderojmë jo vetëm si objektivin, pra qëllimin e funksionimit të marrëdhënieve publike, por edhe si mjetin e përdorur për realizimin e objektivit.

Falë zhvillimit me hapa të shpejtë të teknologjive të informacionit edhe marrëdhëniet publike i janë përshtatur këtij ndryshimi të vazhdueshëm. Në vitet e fundit aplikimi i instrumenteve të marrëdhënieve publike në Shqipëri ka hasur një përdorim të gjerë jo vetëm nga sipërmarrjet dhe bizneset, por edhe nga aktorët politikë.

Nëpërmjet përdorimit me efikasitet të procedurave dhe teknikave të komunikimit qeveria shqiptare ka mundësuar përcjelljen e një imazhi pozitiv jo vetëm për publikun e brendshëm, por edhe atë të jashtëm. Tashmë marrëdhëniet publike janë bërë pjesë e rëndësishme e strategjive të komunikimit që synojnë përmirësimin e imazhit dhe reputacionit të një individi apo organizate. Pikërisht nëpërmjet

krijimit të një imazhi pozitiv dhe përcimit të mesazhit tek opinionit publik synohet përmirësimi i reputacionit të qeverisë shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Autorët Griung dhe Hunt deklarojnë se marrëdhëniet publike mund të konsiderohen si menaxhim i komunikimi midis organizatës ose figurës politike dhe publikëve të saj.

Nëpërmjet menaxhimit me efikasitet të komunikimit, organizata, individi ose institucioni synon të arrijë audiencën e synuar dhe të ndryshojë qëndrimet dhe sjelljen e tyre.

Prej shumë kohësh televizioni është parë si media më e fuqishme dhe më e lakmuar për shkak të përhapjes, por edhe të audiencës dhe nivelit të lartë të presupozuar të ndikimit. Pikërisht si pasojë e përhapjes së gjerë së saj, në dhjetëvjeçarin e fundit edhe rëndësia e marrëdhënieve publike është rritur ndjeshëm, jo vetëm në kontekstin ndërkombëtar, por edhe në atë shqiptar. Nëse ju i referoheni fushatave të fundit zgjedhore të zhvilluara në Shqipëri, specialistët e marrëdhënieve publike politike kanë regjistruar një prezencë konstante dhe frytdhënëse në veprimtarinë e qeverisë shqiptare.

Qeveria shqiptare e drejtuar nga koalicioni i majtë, në dy vitet e para të veprimtarisë së saj ka ndërthurur teknikat e marrëdhënieve publike të drejtuara publikut të jashtëm dhe atij të brendshëm.

Në këtë punim do të përqendrohemi në mënyrë të veçantë në marrëdhëniet publike politike për vetë faktin se ato bashkëveprojnë me institucionet më të rëndësishme politike dhe me aktorët politikë. Marrëdhëniet publike politike mund ti konsiderojmë një nëndegë specifike të marrëdhënieve publike të cilat fokusohen më shumë në sferën politike, në institucionet politike dhe aktorët e tyre përfaqësues.

Në ndihmë të verifikimit të hipotezës së ngritur duhet të vlerësojmë dhe një nënkategori tjetër të rëndësishme sikurse është ajo e diplomacisë publike, duke ju referuar me këtë term komunikimit të ndërmarrë nga qeveria ndaj publikut të jashtëm me synimin kryesor që të ndikojë jo vetëm mënyrën e tyre të menduarit, por edhe vendimet në politikbërje (Malone, 1985). Pikërisht nëpërmjet strategjive efikase të marrëdhënieve publike politike qeveria arrin jo vetëm të përforcojë reputacionin e saj në arenën ndërkombëtare, por kjo mund të reflektohet edhe në përmirësimin e raporteve ndërkombëtare. Fushata e marrëdhënieve publike e ndërmarrë nga qeveria shqiptare është projektuar për të përmirësuar sjelljen e vendimmarrjes ndërkombëtare ndaj qeverisë shqiptare.

2. Strategjia e marrëdhënieve publike të qeverisë Shqiptare

Funksioni i marrëdhënieve me publikun konsiston në krijimin, ruajtjen ose ndryshimin e imazhit publik, në prodhimin dhe formësimin e ndërgjegjes si dhe në ndikimin mbi opinionet dhe vendimet e qytetarëve (Marconi, 2010). Përdorimi me efikasitet dhe profesionalizëm i teknikave të marrëdhënieve publike

ndihmon në ruajtjen dhe vendosjen e reputacionit të mirë, por edhe në lehtësimin e komunikimit dypalësh ndërmjet qeverisë dhe palëve të interesit.

Çdo strategji komunikimi përbëhet nga dy elementë kryesorë: *së pari*, përcaktimi i qartë i objektivave dhe *së dyti*, hartimi i një plani dhe strategjie për të realizuar më së miri objektivat e caktuara.

Përpara se të merret në analizë strategjia e ndjekur nga qeveria shqiptare për të rindërtuar imazhin e saj në arenën ndërkombëtare duhet të kryejmë një analizë të situatës që ka çuar në nevojën e aplikimit të këtyre teknikave.

Duke ju referuar kontekstit shqiptar konstatojmë se në vitin 1992, janë hapur zyrat e para të marrëdhënieve me publikun funksioni i të cilave kufizohet në komunikimin njëdrejtimësh me shtypin mbi aktivitetet e institucioneve të ndryshme, duke mos marrë në konsideratë feedback-un e audiencës. Në këtë periudhë marrëdhëniet publike vlerësoheshin si një funksion gazetaresk. Kanë qenë zhvillimet e viteve të fundit në Shqipëri, rritja e investimeve të huaja dhe përhapja e televizioneve private që ndikoi në rritjen e nevojës për aplikimin e funksioneve të marrëdhënieve publike. Duke nisur nga viti 2013, qeveria Shqiptare ka adoptuar *modelin simetrik dydrejtimësh*, model i cili vë theksin kryesor tek krijimi i dialogut me publikët duke synuar mirëkuptimin reciprok.

Për Grunig (2007) ekspertët e marrëdhënieve publike synojnë ekspozimin sa më të gjerë të mesazhit, ofrimin e materialeve për mediat dhe interpretimin e saktë nga ana e publikut të mesazhit. Studiuesit konstatojnë se është përhapja efektive ajo që çon në ndryshimin e opinionit ndaj një çështje të caktuar, por për të arritur një rezultat pozitiv duhet të merren parasysh edhe faktorët që ndikojnë në efektivitetin e mesazhit si kombësia, kultura, arsimi i audiencës së synuar. Pikërisht nëpërmjet informimit mbi dallimet kulturore të kulturave të ndryshme mund të ndërtohen ura lidhëse midis vendeve dhe të gjendet një fushë e përbashkët. Por kush rezulton të jetë plani i marrëdhënieve publike për qeverinë shqiptare?

Duke ju referuar analizës përmbajtësore të programeve televizive të marra si objekt studimi, mund të identifikojmë disa nga elementët përbërës të planit të marrëdhënieve publike, si më poshtë:

- Të ketë shikueshmëri të lartë.
- Të nxisë mbështetjen e aktorëve politikë ndërkombëtarë.
- Të sigurojë mbështetje për aksionet e ndërmarra.
- Të sigurojë mbështetje financiare.
- Të fitojë simpatinë e opinionit publik.

Ndër objektivat kryesore që kanë shoqëruar programin e marrëdhënieve publike duhet të theksojmë dy më të rëndësishmit:

Objektivat informues: ato të cilat kanë pasur qëllim ekspozimin e publikut, ndërkombëtar por edhe atij shqiptar, ndaj informacioneve, për të rritur nivelin e

ndërgjegjësimin ndaj performancës së qeverisë shqiptare. Strategjitë e komunikimit të përdorur nga Kryeministri venë shpesh theksin tek aksionet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura.

Objektivat motivues: të ndryshojë qëndrimi dhe sjellja e aktorëve politikë ndërkombëtarë ndaj qeverisë shqiptare.

Edhe pse zhanri i emisioneve në të cilat ka qenë pjesëmarrës kryeministri ka qenë i ndryshëm dhe tematikat e trajtuara kanë qenë të ndryshme, vihet re një nivel i lartë i përsëritjes të fjalës “Europë” si në rastet: Conflict Zone 25 herë, Invasioni Barbariche 12 herë dhe Francë 24, 27 herë.

TABELA 1. OBJEKTIVAT E IDENTIFIKUARA PËRGJATË EMISIONEVE

	Objektiva Informues	Objektiva Motivues
Agora	Projekti European i bën të gjithë më të fortë. Ne duam të futemi më çdo kusht në Bashkimin European.	Duhet të përballemi me problemet e emigrimit. Duhet më shumë Europë. Duhet të rindërtohet projekti European
Invasioni Barbariche	Ne kemi pasur një tranzicion dramatik. Ne nuk e ndjejmë mungesën e sindikatave. Ne kemi një regjim fiskal minimal.	Kemi nevojë për një strategji Europiane. Kemi nevojë për një projekt të vërtetë. Europa është zgjidhja e vetme kundër krizave.
Konventa e Industrialistëve të rinj	Në Shqipëri nuk ka sindikata. Jemi një vend më i gjallëruar se Italia. Jemi të integruar kulturalisht dhe ekonomikisht.	Për një sipërmarrës Italian Shqipëria është ajo që keni ëndërruar. Hapini biznesin për një orë me një euro.
Conflict Zone	Ne duam të jemi pjesë e Europës Ne kemi ndërmarrë reformat që na janë kërkuar nga Bashkimi European. Në tetor do të kalojmë reformën në drejtësi. Reforma do të jetë radikale.	Duhet strategji e përbashkët. Duhet të punojmë bashkë Duhet të bashkëpunojmë dhe bashkëveprojmë me BE-në, Përfitimet duhet të jenë reciproke.
France24	Ne jemi duke ndërtuar një shtet të së drejtës. Ne jemi një vend i pasur me burime. Ne kemi fituar besimin e tregut.	Projekti i Bashkimit European është më i miri që mund të kemi imagjinuar. Kemi nevojë për më shumë Europë. Shtetet e Bashkuara të Europës

Përgjatë analizës së kryer rezulton se synimi kryesor i qeverisë Rama është ndryshimi i perceptimit ndërkombëtar mbi Shqipërinë, krijimi dhe ruajtja e imazhit, ndërtimi i markës dhe identitetit. Kjo mund të verifikohet nga zgjedhja e fjalëve kyçe dhe çështjeve të trajtuara në emisionin “Conflict Zone” si: “bashkëpunim rajonal, bashkëpunim tregtar, strategji e përbashkët, ne duam të jemi pjesë e Europës, aspirojmë të jemi pjesë e Europës, ne duhet të bashkëpunojmë, ne nuk kemi mafie”.

Nëpërmjet analizës së tekstit vëmë re një përkujdesje të veçantë të Kryeministrit shqiptar në zgjedhjen e fjalës së duhur dhe përshtatjen me natyrën e audiencës. Sikurse vihet re tek tabela e mësipërme në intervista të ndryshme përdoren përemrat vetorë “Ju” dhe “Ne” duke vënë dëgjuesit në dijeni se mesazhi ju drejtohet atyre dhe njëkohësisht duke shkurtuar distancat.

Në emisionin “Agora” të transmetuar në rrjetin Italian Rai 3 tema kryesore është ajo e emigrimit, por edhe në këtë rast vëmendja përqendrohet tek Bashkimi European, “*problemet e emigrimit duhet të përballen në zyrat e Bashkimit European, për këtë duhet më shumë Europë. Duhet të rindërtohet projekti European, projekti European i bën të gjithë më të fortë, ne duam të futemi me çdo kusht në Bashkimin European*”.

E njëjta linjë ndiqet edhe tek intervista e dhënë për France 24 “*Projekti i BE-së është më i miri që civilizimi ynë mund të ketë imagjinuar. Dëshira e popullit shqiptar është ti bashkohet familjes Europiane, kemi nevojë për më shumë Europë, ne jemi një vend i pasur me burime, me popullsi të re, shtetet e bashkuara të Europës*”.

Ajo që vihet re përgjatë analizës së tekstit është fakti që stili dhe forma e planit të marrëdhënieve publike ndërkombëtare është në të njëjtën linjë dhe në përputhje me marrëdhëniet publike të realizuara brenda vendit. Kryeministri shqiptar i përgjigjet pyetjeve të gazetares pa u zgatur në detaje të tepërta, por gjithmonë duke përdorur përsëritjen e herëpashershme të fjalës kyç “Europë”

Ndër objektivat kryesorë të qeverisë Rama rezultojnë ndërgjegjësimi i publikut ndërkombëtar, pasqyrimi mediatik dhe formimin e një opinioni të përgjithshëm pozitiv. Njëkohësisht vlen të theksohet edhe përdorimi me efikasitet i fjalimit informues dhe motivues që Kryeministri shqiptar mbajti më 6 qershor 2015 në takimin e industrialistëve të rinj në Itali. “*Mungesa e sindikatave e bën Shqipërinë një vend më të gjallëruar se Italinë, sot kemi 21 mijë Italianë që jetojnë në Shqipëri. Shqipëria është ajo që ju ëndërroni dhe nuk mund të keni në Itali, për një orë jeni në Shqipëri dhe për tetë orë hapni një biznes më tetë euro, jemi të integruar kulturalisht dhe ekonomikisht*”. Ajo që vihet re përgjatë prezencës mediatike është përpjekja e liderit për të qenë konciz dhe i përqendruar te mesazhi.

Në rastin e marrë në studim, Kryeministri i është përshtatur stilit të drejtpërdrejtë dhe ironik të intervistuesit Mentana duke njohur më së miri nivelin e lartë të popullaritetit të tij si reputacionin e tij si gazetar profesionist. Pikërisht për faktin që aktiviteti organizohej nga Industrialistët e rinj dhe investitorët potencial për Shqipërinë, aspekti përmbajtësor i fjalimit të Kryeministrit tregon një njohje të mirë të karakteristikave themelore të audiencës dhe të dëshirave dhe nevojave të tyre. Kjo realizohet nëpërmjet përdorimit të termave dhe shprehjeve që janë të njohura për audiencën, por edhe duke përdorur me kujdes humorin, i nevojshëm për të tërhequr vëmendjen e audiencës.

3. Menaxhimi i Reputacionit nëpërmjet strategjive të komunikimit

Komunikimi është procesi dhe mjeti nëpërmjet të cilit synohet arritja e objektivave të caktuara. Nisur nga analiza e emisioneve në të cilat Kryeministri ka qenë i ftuar rezultojnë se mesazhi i transmetuar i është përshtatur formatit televiziv dhe është formuluar në mënyrë të qartë e të kuptueshme.

Kryeministri shqiptar për të komunikuar me audiencën ndërkombëtare ka zgjedhur ato media që sigurojnë një shikueshmëri të lartë dhe që janë më eficiente në arritjen e audiencës së synuar. Kryeministri i është përshtatur më së miri formatit në të cilin ai ka qenë i ftuar duke mbajtur qëndrim dhe duke u kundërpërgjigjur gazetarit të emisionit “*Conflict Zone*” apo duke u fokusuar më shumë tek sfera personale e private tek emisioni “*Invasioni Barbariche*”.

Sikurse u nënvizua më sipër, qëllimi kryesor i marrëdhënieve publike është që nëpërmjet informacionit të ofruar, publiku të ndryshojë mendim dhe qëndrim ndaj një personi ose çështje të caktuar. Funkcioni i marrëdhënieve publike politike konsiston jo vetëm në dhënien e këshillave ndaj aktorit politik, por edhe si prodhues dhe shpërndarës i mesazhit. Për të realizuar një shpërndarje efikase të mesazhit Shramm konsideron të rëndësishme njohjen e publikut të cilit i drejtohet komunikimi. Objektivi i një fushate imazhi është ta bëjë subjektin të duket nga një këndvështrim interesant dhe të ndikojë atë që publiku ndjen për subjektin (Marconi, 2010). Për të realizuar këtë qëllim njohja e karakteristikave të audiencës është pjesë thelbësore e procesit të motivimit. Që mesazhet e përcjella nëpërmjet fjalimeve të jenë efektive ato duhet të marrin parasysh bindjet dhe shqetësimet e audiencës. Një ndër elementët e rëndësishëm për të siguruar kredibilitetin e mesazhit, përpos ekspertizës së personit dhe sinjeritetit, është edhe karizma e individit që përcjell mesazhin. Individit duhet të ketë një nivel të lartë sigurie dhe të projektojë tek audienca imazhin e kompetentit dhe lidershit.

Për profesionistët e marrëdhënieve publike imazhi është sinonim i perceptimit, dhe për këtë arsye ata konsiderojnë si detyrën e tyre kryesore krijimin dhe ruajtjen e një imazhi pozitiv. Kuptimi i nevojave dhe interesave të auditorit lejon që në bazë të tyre të përcaktohen objektivat e organizimit të publikut (Muca, 2009). Çdo komunikim politik synon ndryshimin e opinionëve ekzistuese dhe mbështetjen ndaj një figure politike, partie ose qeverie. Një ndër këndvështrimet dominuese në marrëdhëniet Publike është qasja e “inxhinierisë së miratimit” (Edward Barnays) për të krijuar një klimë të favorshme dhe pozitive opinion kundrejt individit, produktit, institucionit ose idesë që ai përfaqëson. Bindja dhe retorika duhet të konsiderohet më shumë se qarkullim një drejtimësh i informacionit. Bindja duhet të jetë dialog midis këndvështrimeve të ndryshme në tregun e opinionit publik.

4. Funksionet e intervistës në media

Intervista konsiderohet një element i rëndësishëm në mbulimin mediatik të aktivitetit politik. Intervista është një teknikë e përdorur gjerësisht nga aktorët politikë, jo vetëm për funksionin informues që ajo luan, por edhe për shkak të dukshmërisë që i ofron aktorit politik. Evolucion i teknikave moderne të marrëdhënieve publike bën që aktorët politikë të jenë gjithnjë e më shumë të disponueshëm ndaj intervistave duke u shfaqur të sigurt, të aftë dhe kompetentë. Është e vërtetë që intervista ofron mundësi për tu paraqitur të sigurt, por krijon edhe mundësi për të vënë në vështirësi aktorin politik. Për të mundësuar një analizë gjithëpërfshirëse do të identifikojmë teknikat e përdorura nga i intervistuari për tu përgjigjur pyetjeve apo për të shpëtuar nga situata. Disa nga këto teknika janë (Watts, 1997):

- Injorohet pyetja
- Pyetja merret por nuk kthehet përgjigje
- Kërkohen sqarime të mëtejshme mbi pyetjen
- Sulmohet intervistuesi
- Refuzohet të jepet përgjigje
- Krijohet konfuzion nëpërmjet arsyetimit politik
- Jepet një përgjigje e pjesshme
- Përsëritet një përgjigje e mëparshme
- Konfirmohet që pyetjes i është dhënë përgjigje më parë
- Kërkohet falje.

Duke ju referuar emisioneve të marra në analizë konstatojmë se në emisionin “*Conflict zone*” Edi Rama shpesh kundërshton intervistuesin, kërkon sqarime të mëtejshme mbi pyetjet dhe kundërpërgjigjet me pyetje. Ajo që haset në këto intervista është njohja paraprake e stilit të intervistuesit dhe përshtatja ndaj tij. Janë pikërisht përgjigjet e shkurta, pa ngurrim dhe të drejtpërdrejta ato që projektojnë një imazh të fortë dhe një kredibilitet të lartë të figurës politike.

Gjatë intervistave televizive, personaliteti i liderit ka impaktin më të madh, pasi folësi jo vetëm dëgjohet, por edhe shihet duke rritur në këtë mënyrë nivelin e influencës të mesazhit tek audienca.

Konkluzione

Sikurse vihet re edhe përmes analizës së prezantuar, marrëdhëniet publike janë bërë gjithnjë e më komplekse, por edhe më delikate me përhapjen dhe zhvillimin e teknologjive të reja të komunikimit. Në kuadër të përdorimit me efikasitet të teknikave të marrëdhënieve publike edhe fushatat e komunikimit të ndërmara nga

qeveria shqiptare vlerësohen të rëndësishme në krijim, ruajtjen ose ndryshimin e imazhit publik, në prodhimin dhe formësimin e ndërgjegjes, por edhe në ndikimin mbi opinionet dhe vendimet.

Përgjatë realizimit të këtij punimi dhe krahasimit të kuadrit teorik me atë praktik konstatojmë se përdorimi me efikasitet dhe profesionalizëm i strategjive dhe taktikave të marrëdhënieve publike mund të ndihmojnë në tejçimin e imazhit pozitiv dhe në demokratizimin e një vendi.

Punimi është përqendruar në veçanti tek analiza e procesit të komunikimit të përdorur nga Qeveria Shqiptare për të prezantuar Shqipërinë nën dritën më të mirë të mundshme. Prania e liderit në mediat e huaja rezultoi jo vetëm si objektivi i marrëdhënieve publike, por edhe si mjeti i përdorur për realizimin e objektivit.

Marrëdhëniet publike janë përdorur si teknikë për të realizuar ndërgjegjësimin e opinionit publik ndërkombëtar mbi arritjet dhe ecurinë e reformave të ndërmara nga qeveria Rama duke u fokusuar tek objektivi kryesor, ai i krijimit të marrëdhënieve të mira me klasën politike të vendeve anëtarë në Bashkimin Europian.

Pikërisht nëpërmjet strategjive efikase të marrëdhënieve publike politike qeveria shqiptare ka siguruar një nivel të lartë pasqyrimi mediatik duke përforcuar reputacionin e saj në arenën ndërkombëtare, por kjo mund të reflektohet edhe në përmirësimin e raporteve ndërkombëtare. Fushata e marrëdhënieve publike politike e ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare është projektuar për të përmirësuar sjelljen e vendimmarrjes ndërkombëtare ndaj qeverisë shqiptare, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut ndërkombëtar, për të siguruar pasqyrim mediatik dhe formimin e një opinioni të përgjithshëm pozitiv.

Bibliografia

- Culberston, H. M. & Chen, N. (1996) *International public relations. A comparative Analysis*, New York, Routledge.
- Dominik, J. R (2010) *Dinamika e Komunikimit Masiv*, Tiranë, Uet Press
- Desideri, P. (1984) *Teoria e prassi del discorso politico*, Roma, Bulzoni
- Franklin, B. & Pill, E. & Mosdell, N. & Hogan, M. (2009) *Key Concept in Public Relation*. London. Sage
- Heath, R. L. (2001) *The sage handbook of Public Relations*. USA. Sage.
- Muca, S. (2009) *Marketingu Politik*. Tiranë, Naimi
- McNair, B. (2009) *Hyrje në Komunikimin Politik*. Tiranë, Uet Press.
- Simon, A. (2007) *Competitive Identity. The new brand management for Nations, Cities and Regions*. London, Palgrave Macmillan.
- Strömbäck, J. & Kiousis, S. (2011) *Political Public Relation. Principles and Applications*. New York. Routledge.
- Valentini, C. (2013) *Political Public Relations in the European Union: EU Reputation and Relationship Management Under Scrutiny*. Public Relations Journal Vol.7, No.4.
- Watts, D. (1997) *Political Communication Today*. Manchester. Manchester University Press.

Evolucioni i konflikteve dhe paradigma e re e gjeneratave të luftës

Prof. Dr. Kristaq Xharo

ABSTRAKT: Në mesin e një morie librash dhe debateve për formën e konflikteve të armatosura në të ardhmen dhe refleksioneve të tyre në natyrën e reagimeve, teoria e një Gjenerate të Katërt të Luftës (G-4L) duket dukshëm të jetë një më të diskutuarat. Ajo është afruar si e ardhmja e përballjes në konflikte, e preferuar nga aktorët jo-shtetërorë, dhe e karakterizuar nga mpleksja e karakteristikave midis luftës dhe politikës, trupave nën uniformë dhe civilëve, çështjeve të pages dhe konfliktit, fushë-betejës dhe procesit të sigurisë. G-4L u propozua për herë të parë nga historiani ushtarak William Lind në vitin 1989, dhe është konsideruar si një nga “idetë më të mëdha” ose “parashikimet më të mëdha” në diskursin strategjik bashkëkohor, por edhe që nuk e kam marrë vëmendjen e duhur. Ndoshta kjo distancë për shkak të nënkuptimeve për dy prej pohimeve të saj kryesore. E para sipas kësaj teorie (G-4L) qëndron tek distanca që ajo krijon nga ligjësia e doktrinë së Klausevitzit për “Trininë e Luftës” rreth së cilës janë të ndërtuara të gjitha llojet e forcave në Perëndim dhe në Lindje, e cila kufizon ligjërimin e luftës vetëm në mes shteteve-që duket se nuk është tipari kryesor në konfliktet e sotme moderne. E dyta, ndoshta edhe më kryesoret qëndron në faktin se shtetet (pa dallim), me forcat e tyre ushtarake të trajnuara për të luftuar në format konvencionale për të luftuar shtet me shtet, do të jenë të sfiduara në përballje me këtë paradigmë të re.

Edhe pse fillimisht nuk gjeti vëmendje të mjaftueshme, teoria ka rimarrë vëmendje pa ngjarjeve të 11 shtatorit dhe me zhvillimet më të fundit ajo është rikthyer në qendër të debatit. Në çdo drejtim, në nivel jo shtetëror, në të cilën aktorët kanë kryer sulmet, institucionet e sigurisë, përfshirë edhe forcat e Armatosura kanë dështuar së pari në parandalimin dhe pastaj në arritjen e fitores vendimtare mbi palën përgjegjëse. Aktorët jo nacionalë – përfshirë grupet terroriste, sikurse kanë dëshmuar edhe ngjarjet më të fundit mbeten aktive. Në këtë situatë edhe vendi ynë nuk është i imunizuar në mundësinë e

përballjes me format dhe metodat që shfaqet G-4L, si mundësia dominuese e natyrës së re të konflikteve. Strukturat e sigurisë janë ende të formatuara sipas konceptit të përballjes dhe fitores në gjeneratën e përballjes shtet-me-shtet. Përndryshe ato janë në llojin e saktë të asaj çka teoria e G-4L parashikon që do të jetë e paefektshme në fushën e saj të lojës. Në këto kushte strukturave të sigurisë do t’ju vlente për tu përgatitur e menaxhuar në këtë sjellje të re të luftës, qoftë edhe si masë paraprake.

Fjalët kyç: Gjenerata e Katërt e Luftës (G-4L), koncepti i sigurisë, terrorizmi, evoluimi i strategjisë.

1. Hyrje. Çfarë janë gjeneratat e luftës dhe si ndryshojnë ato?

Në njohurinë e lexuesit Gjeneratat e Luftës përfaqësojnë koncepte teorike që ndihmojnë në shpjegimin e evoluimit të pamjes së luftës/konflikteve në periodha të caktuara historike. Gjeneratat e filluan historinë e tyre me Traktatin e Paqes së Westphalise në 1648, Traktat që shënoi përfundimin e një morie luftërash (16) në një periudhë 30-vjeçare (1618-1648), gjatë së cilës u përgjysmua gjysma e kontinentit. Veç të tjerash, ky Traktat u bë i famshëm edhe për qëndrimin ndaj konflikteve. Shteti fitoi monopolin mbi luftën. Deri në atë periudhë luftërat shfaqeshin si konflikte me tipare të ndryshme, që nga ana fisnore, tribale, religjioze, civile, etj.- duke përdorur të gjitha llojet e formave dhe mjeteve. Pas kësaj periudhe, shtetet e shohin luftën veç në formatin e angazhimit të forcave të armatosura dhe të shoqëruara me një dallim kategorik midis trupave nën uniformë dhe civilëve.

Gjenerata e Parë e Luftës (G-1L) vendoset midis viteve 1648-1860. Ajo përfaqëson luftën lineare në vija dhe shfaqet në taktiken e kolonave, ku betejet ishin të deklaruara dhe teatri i luftimeve gati tërësisht i njohur. Në G-1L, teatri i luftimeve, sipas një rregulli të ngurtë, krijoi kulturën klasike të luftimit. Shumë karakteristika që dallonin “ushtaraket nga civilët” - uniforma, mënyra e përshëndetjes, gradat apo rangjet-ishin produkte të G-1L dhe kishin për qëllim të përforconin kulturën formale ushtarake. Evolucioni i natyrës së luftës lidhet drejtpërsëdrejti me evolucionin e shteteve. Baylis dhe Wirtz në Strategjia në Botën Bashkëkohore shprehin se “... shtetet bëjnë luftën, luftërat bëjnë shtetet”(2013:61).

“Gjenerata e Dytë”. Rreth shekullit të 19-të, teatri klasik i luftimeve filloi të shthurej. Formacione dhe ushtri masive, armët e para të zjarrit, pak më vonë edhe armët me vjaska, por më tepër mitralozat bëjnë që vijat e frontit dhe kolonat taktike, në fillim të shiheshin si pengesa dhe më vonë si “vetëvrasje”. (G-2L) u shfaq pikërisht në këtë periudhë dhe si një përgjigje ndaj këtyre sfidave. Armiku duhej dërmuar me sulme frontale brutale, që të shkaktonin shumë viktima, ndërkohë që zhvillimet teknologjike u përdorën për të zhbllokuar këtë situatë në fushën e betejës. (Sheehan, 2013:80). Futja për herë të parë e aviacionit në luftë

i dha fushë-betëjës përmasa tre dimensionale, tokë, det, ajër. Pranohet që ishin teoricienët ushtarakë francezë zhvilluesit e kësaj teorie.

“Gjenerata e tretë” (G-3L) u zhvillua nga teoricienë ushtarak gjermanë, dhe është njohur me termin e “luftës rrufe” apo edhe “lufta manovër”. Gjenerata e tretë bazohet në shpejtësinë e veprimit, surprizën, në zhvendosjen e trupave në kohë të shkurtër, më shumë se fuqinë e zjarrit. Taktikisht, gjatë mësymjes, “gjenerata e tretë” kërkon të manovrojë në shpinë të kundërshtarit dhe ta detyrojë atë të kapitultojë: në vend të motos “afrohu dhe shkatërro” përdoret “krahë merr dhe e detyroji të kapitultojë”. Në mbrojtje përpiqet të tërheq kundërshtarin e pastaj në befasi ta godasë atë. Gjenerata e tretë e luftës është një shmangie totale prej konceptit të luftës lineare. Shumë më tepër se në luftërat e mëparshme G-2L ishte luftë midis ideologjive (Sheehan 2013: 82). Nuk kërkohej vetëm kapitullimi i kundërshtarit, por edhe ndryshimi i regjimit politik.

2. Metodologjia

Qëllimi i këtij artikulli është analizimi i tipareve të gjeneratave të ndryshme të luftërave dhe implikimeve të tyre në ambientin e sigurisë. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, artikulli paracakton një sërë objektivash, ku më kryesorët janë: Identifikimi dhe analizimi i gjeneratave të ndryshme, identifikimi dhe analizimi i faktorëve të qëndrueshëm dhe atyre të ndryshueshëm nga gjenerata në gjeneratë. Identifikimi dhe analizimi i implikimeve të tyre në mjedisin bashkëkohor të sigurisë, duke u ndalur dhe në rastin e Shqipërisë. Pyetja kryesore e artikullit është: Cilat janë tiparet kryesore të gjeneratave të luftërave dhe implikimet e tyre në mjedisin bashkëkohor të sigurisë? Për të përmbushur qëllimin e artikullit, realizimin e objektivave dhe dhënien përgjigje për pyetjen kërkimore, punimi bazohet në një qasje cilësore, duke u mbështetur tek analiza e tekstit dhe ajo interpretativiste. Nga analiza, që dominon në historinë e luftës, pa mohuar aspak peshën e faktorëve strategjikë ushtarakë, arrihet në idenë që gjeneratat janë refleksion i përcaktuar dhe ndikuar nga faktorët politikë, ekonomik dhe social. Në këtë rrjedhim, ashtu si gjeneratat paraardhëse, edhe Gjenerata e Katërt e Luftës (G-4L), nuk erdhi në skenë si një instrument strategjik, i përcaktuar njëherë e përfundimisht, por pas një evolucioni dhe refleksioni ndaj këtij mjedisi. Ashtu si paraardhësit e vet, konceptet ideore që veshin hapësirën e G-4L nuk janë të shkëputura dhe as të izoluara, por të mpleksura me ato të tre gjeneratave më të hershme. Analistët teorizojnë, që së bashku dhe veç e veç gjeneratat fokusoheshin në përdorimin masiv të forcave, më pas në përdorimin masiv të fuqisë së zjarrit dhe më në fund në kombinimin e forcave, mjeteve, fuqisë së zjarrit drejt manovrës (Lind 1989:22). Në thelb, ajo çfarë në ato dukej dhe pranohej të kishin të përbashkët, në të vërtetë, ishte synimi për të mundur kundërshtarin në mënyrë konvencionale.

Lind dhe autorë të tjerë nënvizojnë që ndryshimet midis gjeneratave të luftës moderne janë esenciale, që ne të kuptojmë çfarë i detyron ato t’i lenë vendin njëra-tjetrës. Arsyeja më e cituar është evolucioni i teknologjisë. Të tjerë mendojnë, që ndërsa ndryshimet teknologjike qartësisht kanë një impakt të rëndësishëm, por ato nuk mund të ngrihen më shumë se në nivelin e problemit. Faktorët e vërtetë të ndryshimit të gjeneratave janë ndryshimet e thella ekonomike, sociale dhe politike.

Ndoshta shembulli më klasik i këtij ilustrimi është kalimi nga G-1L në G-2L. Ndërsa evolucioni i armëve të artilerisë, mitralozëve, pengesave xheniere sollën taktikat e transheve në Frontin Perëndimor, këto zhvillime teknologjike të marra veçmas ishin të pamjaftueshme të jepnin atë fuqi zjarri si tiparin më dallues të Gjeneratës së Dytë, e shfaqur në vitet 1914-1918. G-2L kërkoi jo thjeshtë një armatim të përmirësuar, por evolucion në të gjithë strukturën shoqërore, politike dhe ekonomike, për të iniciuar dhe mbështetur atë. Ajo kërkoi struktura trans-nacionale që fokusonin në balancat e fuqisë, format e aleancave dhe u shfaq si një dukuri e tmerrshme përmes tyre, në katër vjet të Luftës Totale, në mënyrë të pabesueshme dhe me pasoja fatkeqe të papara (Quester, 1977:114). Për më tepër, G-2L kërkoi mbështetjen e një shoqërie industriale, e projektuar për të prodhuar, transportuar dhe përdorur sasi gjigande municioni për tu konsumuar. Më së fundi, ajo kërkoi zhvillimin e një sistemi social që e mbështeti me ide, koncepte, doktrina e strategji. Teknologjia, edhe pse e rëndësishme ishte qartësisht e ndërruar nga strukturat politike, ekonomike dhe sociale e pozicionuar në rrethanat e Luftës.

Bazuar në një korrelacion midis çdo gjenerate dhe shoqërisë prej nga u ngrit ajo, është logjike të mendojmë që gjenerata e katërt do të marr formë nga shoqëria që po përjeton. Duke qëndruar në këtë kënd vështrimi, shumë autorë duke shkruar për tiparet e konflikteve mendojnë që G-4L është pozicioni që marrin oponentët e luftës konvencionale në referencë me përballjen me teknologjinë moderne të kundërshtarit. Për të kuptuar ndikimin potencial në G-4L lind e nevojshme të kuptojmë efektet politike, sociale dhe ekonomike të shoqërisë po ashtu si dhe ndryshimet në teknologji, që në vigjilje të Gjeneratës së Tretë të Luftës. Mund të thuhet se shoqëria globale është në mes të një tranzicioni nga modernizmi drejt post modernizmit. Arkitektura e rendit botëror po ndryshon dhe së bashku me të do të ndryshojë edhe instituti i luftës, sikurse ka ndodhur më parë. Shteti modern po zhvillohet në emër të globalizmit dhe po ju kalon aktorëve jo-shtetërorë të cilat po ndikojnë dreket edhe në natyrën e luftës.

Luftërat moderne janë bërë nga forcat e armatosura të organizuara në struktura hierarkike dhe të specializuara. Luftërat post-moderne po dëshmojnë periudhë të një rritje në numër dhe në lloje të aktorëve jo-nacionale në skenën globale. Ndërsa kostumi tradicional i shteteve në sistemin global vazhdon të jetë ende në të njëjtin vend, ndryshime masive që po ndodhin po bëjnë që rregullat e lojës pothuaj të jenë ndryshuar (Wirtz, 2013:404). Për më tepër, sot në botë luajnë aktorë trans-nacional në formën e medias, lëvizjeve religjioze, grupeve terroriste, kartelevë të

drogës, dhe influenza të tjera në marrëdhëniet globale. Më së fundi, grupe sub-nacionale përpigën të evoluojnë nga konteksti i brendshëm në atë trans-nacional.

3. Si shfaqet G-4L?

Gjenerata e katërt (G-4L). Më 1989, njohësit e parë të G-4L, i sfiduan lexuesit të mendonin që kalimi i 70-viteve, që nga shfaqja e G-3L, ishte mjaftueshëm për të parandier kohën e ndryshimit të gjeneratave. Vetëm pas pak vitesh nga koha që ishte botuar ky artikull, bota kish pësuar ndryshime dramatike në strukturën politike, ekonomike dhe sociale. Të gjitha këto ndryshime, detyrimisht do të reflektonin dukshëm edhe në mënyrën se si do të perceptoheshin e zhvilloheshin konfliktet në një të ardhme jo të largët. Ndryshimet e menjëhershme përcaktonin taktikat, ndryshimet e afërta do të reflektonin doktrinat dhe ndryshimet në vizion do të dizajnonin strategjitë. Të gjitha së bashku do të paraqisnin atë që studiuesit do ta njihnin si ndryshimin e natyrës së konflikteve/luftërave të vendosura në gjatësinë e kohës do ta njihnin si gjenerata.

Në aspektin ekonomik, bota po bëhet jo vetëm më e gërshetuar, por edhe njëkohësisht më e rëndë, e ndërthurur në termat e marrëdhënieve të tregtisë, dhe e ndarë në termat e shpërndarjes së produkteve për shoqërinë. Për vendet e pasura, por edhe ato të varfër, ky integrim ekonomik ka rezultuar në një reduktim të qëndrueshëm dhe të rëndësishëm në sovranitetin e tyre. Integrimi i shpejtë në ekonominë botërore rezultoi në kufizime madhore të aftësive nacionale për të ushtruar instrumentet e tyre tradicionale të sovranitetit - duke përfshirë deri edhe kapacitetet e tyre ushtarake.

Në pikëpamje sociale po zhvillohet një rrjet global dukshëm në çdo fushë të komunikimit e të influencës. Këto rrjete lidhin njerëzit së bashku në rrugë jo-tradicionale. Si rezultat, jo më gjatë arrihet të menaxhohen probleme kryesisht si më parë përmes kanaleve diplomatike dhe ushtarake. Në të njëjtën kohë, ndërsa kufijtë nacionalë bëhen gjithnjë e më pak të dallueshëm, besnikëria në grupet nën-nacionalë bazuar në lidhje etnike, religjioze apo kulturore vijnë përherë në rritje. Ne jetojmë një gjeneratë të mësymur tërësisht me mjetet që rezervon epoka e informacionit. Në të njëjtën kohë, shtetet e gjejnë veten të copëtuar në dy drejtime - në ngritje për sigurinë, tregtinë dhe organizimin shoqëror në hapësirën globale dhe në tatëpjetë për lëvizje sub-nacionale që synojnë të copëtojnë shtetet. *Mesa duket, shprehet M. Cini - ka një paradoks strategjik në epërsitë teknologjike të shteteve të avancuara, të cilat shpesh e gjejnë veten të penguar ose, madje të mposhtur nga kundërshtarë shumë më të vegjël se to (2013:191).*

Çdo element i G-4L, paraqitur nga van Creveld dhe Atquilla, por edhe Ponfeldt më vonë mund të shihen në evolucionin e rebelimit. Ndërsa një studim në rreze të gjerë të konflikteve do të siguronin një numër të madh shembujsh të këtij tipi të

luftës, por më të qarta do të jepnin këtë ide nëpërmjet pothuaj gjithë konflikteve të kohëve të fundit. Të gjitha rastet në të cilat shfaqet G-4 përfaqësojnë një spektër që ka të gjitha ngjyrat politike, ekonomike, sociale dhe ushtarake. Dhe ajo që është e rëndësishme, dhe shumica e analizave tregojnë që konceptet taktike të G-4, rrallë që mund të gjenden të shkëputura. Për më tepër, ato ekzistojnë në vazhdim të taktikave të gjeneratave të mëparshme. Sa herë që diskutojmë për demokracitë perëndimore, liderët e kryengritjeve fokusojnë në një fitore politike nëpërmjet ndryshimit të vullnetit të vendimmarrësve politikë të armiqve të tyre (Shapiro & Radken 2013, 358). Duke përdorur teknikën e G-4, kontradiktat e brendshme mund të ndryshojnë politikën nacionale të demokracive perëndimore. Pastaj sapo forcat perëndimore janë tërhequr ata mund të vazhdojnë objektivat e veta lokale duke përdorur metodat e gjeneratave të mëparshme.

Dalja e G-4L ka ndodhur përpara sulmeve të 11-shtatorit. Elementë të saj ndoshta u filluan që në konfliktet “dytësore” gjatë Luftës së Ftohtë. Më pas ato duket se u shfaqën në Somali në vitin 1993, ndërsa 11-shtatori ndoshta shënoi kthesën e qëndrimit të publikut botëror ndaj një natyre të re të luftës (Farrel, 2013: 383). Metodën që përdor G-4L i gjejmë në konfliktet në Afrikë, në Azi, në një pjesë të Amerikës Latine. Edhe ngjarjet më të fundit në Lindjen e Mesme, që depërtuan deri në qendër të Europës Perëndimore. Strategjia e G-4L përpigën të godasë vullnetin e kundërshtarit për t’u përballur. Ky ndryshim nuk mund të arrihet përmes përdorimit të metodave tradicionale të superioritetit në fushën e luftimit. Për më tepër G-4L synon të plotësojë superioritetin përmes përdorimit të gjithë rrjeteve që ishte e mundur në epokën tonë, epokën e informacionit.

Taktikisht, metodat e G-4 synojnë: - të jenë aktiv në një arenë komplekse të konflikteve të intensitetit të ulët, - të përfshijnë taktikën dhe metodën nga gjeneratat e mëparshme, - të luftojnë përmes një spektri politik, social, ekonomik dhe rrjeteve militare, të shfrytëzojnë gjithë hapësirën përmes networks, të tërheqin aktorë të papërcaktuar në hapësirat nacionale, globale, trans-nacionale dhe sub-nacionale.

4. Si të përballemi me G-4L?

Në luftërat e rregullta, fitorja lidhet me shkatërrimin përfundimtar të armikut në fushën e betejës. Problemi me G-4L është se megjithëse e pranojnë që ekziston një kundërshtar i armatosur, përballja me këtë kundërshtar në fushë-betejë nuk është objektivi kryesor i luftës (Lind 1989, 22). Sidoqoftë kundërshtari në G-4L mund të shfaqë një numër objektivash që parashikohen në doktrinat konvencionale dhe kontingjentet që përfaqësojnë këto objektiva janë të gatshëm të sakrifikohen deri në vdekje për kauzën e tyre. Ndërsa fuqia kryesore e oponentëve në G-4L, qëndron e mbuluar, e mpleksur dhe në situatë gati të pamundur për tu përballur

konvencionalisht. Veçanërisht kur kundërshtarët janë të përbetuar për të vazhduar një luftë të gjatë, përballja konvencionale kthehet edhe më e vështirë.

Nëse mendohet që partizanët e G-4L përpiqen të godasin përmes spektrit të aktiviteteve humane, përgjigja duhet të jetë një koordinim me të gjithë aktorët që përballen me probleme globale. Ashtu si veprime të përbashkëta, duhet të tërhiqen gradualisht në të gjithë hapësirat jo thjesht të “Joint operation” por në një angazhim permanent. Sipas analisteve, strukturat e sigurisë ku ndodhen edhe Forcat e Armatosura në vendet e Perëndimit dhe të Lindjes vazhdojnë të operojnë me teori e metoda të gjeneratës së Tretë të Luftës, atë të përballjes shtet-aleancë/shtet-grup shtetesh. Në këtë mjedis ndodhet edhe vendi ynë. Ashtu janë edhe doktrinat e strategjitë. Përndryshe, aktorët jo-nacionalë që dominojnë forcat e G-4L, duket se kanë marrë atë, që ju hoqi traktati i Westphalisë gati 500 vjet më parë - monopolin e luftës (Friedman 2006, 86). Duke marrë monopolin dhe iniciativën G-4L po zotëron shumë më tepër inteligjencë, aftësi analitike, kapacitete shpërndarëse për të shërbyer në një sistem komandimi lartësisht fleksibël.

Vendi ynë, si në nivel nacional edhe në nivel aleance është i ballafaquar me kontekstin e metodave të luftës së G-4L. Parandalimi i rreziqeve dhe aftësia për tu përballur, siç pohuam edhe më lart, shkon përtej faktit për të pasur vetëm forca të armatosura dhe shërbime të tjera të sigurisë në nivele optimale. Ato do të mbesin përherë një sfidë. Por ajo që është edhe më e rëndësishme është sensibilizimi i popullatës për rreziqe të tilla në kontekstin e ri. Terroristët nuk mund të kenë vazhdimësi pa pasur proces rekrutimi: kështu që hapi i parë është që shoqëria të jetë e paralajmëruar për identifikimin dhe metodat që përdorin terroristët, duke bërë të mundur që të kufizojnë atë që konsiderohet avantazhi më i madh për këta kundërshtarë: befasia dhe mpleksja me civilët. *Së dyti*, asnjë institucion i sigurisë sado i sofistikuar të jetë nuk mund të arrijë atë që mund të realizojë, atë që mund të arrijë çdo shoqëri, pra mundësimin e ekspozimit të terroristëve. Ata jetojnë dhe organizohen brenda të njëjtit ambient social, që nuk është i hermetizuar nga ambienti i përgjithshëm.

Në të njëjtën kohë fakti që G-4L vjen si një gjeneratë e re, nuk e përjashton mundësinë e përfshirjes së elementëve të gjeneratave më të hershme duke nënkuptuar, që gjithë strukturat e sigurisë duhet të përgatiten për tu përballur edhe me aspekte të mjedisit të G-4L. Miksi i gjeneratës së luftës, me mbivendosjen politike, ekonomike, sociale, ushtarake dhe në arenën e masmedias do të determinoj tipin e luftës, që ne po hyjmë.

5. Konkluzione

Në përfundim, problemi me G-4L do të kërkojë një fjalor të ndryshëm, qasje dhe psikologji të re. Duke i trajtuar kërcënimet jo-nacionale vetëm thjeshtë si

aktivitet kriminal nuk do ta bëjë procesin e përballjes më të lehtë. Kur siguria kombëtare është e kërcënuar, përballja kërkohet të jetë e përgjithshme. Ne do të duhet të përdorim lente të tjera për vlerësimin e rrezikut. Në nivel operacional, në G-4L, edhe instrumentet e tjerë të fuqisë kombëtare duhet të angazhohen në mënyrë të integruar në këtë sfidë. Strukturat e Policisë, Forcave të Armatosura, Shërbimet e Inteligjencës janë në të njëjtin front që nga vija e parë deri në të fundit. Bashkëveprimi midis tyre është imperativ, duke kombinuar mjetet dhe metodat konvencionale dhe jo-konvencionale në fushën ku tashmë po luan G-4L.

Bibliografi

- Lind, W., Nightengale, K., Schmitt, S., Sutton, J., & Wilson, G. (1989). The Changing Face of War: Into the Fourth Generation. *Marine Corps Gazette*, October, pp.22-26.
- Baylis, J. (2013). *Strategjia në Botën Bashkëkohore*. Tiranë: UET Press.
- Col. Dr. Frans Osinga, On Boyd, Bin Laden, and Fourth Generation Warfare as String Theory. Aksesuar në: <http://www.au.af.mil/au/awc/>.
- Clausewitz, C. (1968). *On War*. London: Penguin Books Ltd.
- Hammes, Th. (2004). *The Sling and the Stone: On War in the 21st Century*. WI: Zenith Press.
- Colin, G. (2007). Irregular Warfare “One Nature, Many Characters”. *Strategic Studies Quarterly*, Winter, pp.46.
- Luthar, S. S., Cicchetti, D., & Becker, B. (2000). “The construct of resilience”: A critical evaluation and guidelines for future work. *Child Development*, 71(3), pp.543-562.
- Davis, P. & Jenkins, B. (2002). *Deterrence and Influence in the Counterterrorism: A Component in the War on al Qaeda*. Santa Monica: RAND.
- Nofi, A. (2006). *Recent Trends in Thinking about Warfare*, pp.91.
- Friedman, Th. (2006). *The World Is Flat*. Penguin Books.

Opinionit Publik dhe spiralja e heshtjes —

— Prof. Elisabeth Noelle-Neumann —

Përktheu për POLIS: Dr. Belina Budini

ABSTRAKT. Një prej ligjësisve më tërheqëse të opinionit publik, propozuar nga profesoresha e komunikimit Elisabeth Noelle-Neumann, me përvojë 30 vjeçare me sondazhet e opinionit publik. Teoria e saj e spirales së heshtur shpjegon rritjen dhe përhapjen e opinionit publik, duke iu referuar presionit në rritje që ndiejnë njerëzit për të fshehur pikëpamjet e tyre, kur mendojnë se janë në pakicë. Materiali i përkthyer për revistën POLIS, është shkëputur nga libri “A first Look at Communication Theory” me autor Em Griffin, botimi i 7-të. Duke qenë se teksti me të njëjtin titull në gjuhën shqipe, “Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit”, botimi i nëntë, nuk e përfshin këtë teori, *Spiralja e Heshtur* vjen për herë të parë me numrin 14 të POLIS, në gjuhën shqipe, për studiuesit dhe studentët e interesuar. Kjo qasje mund të gjejë aplikim të vlefshëm edhe në analizimin e dukurive të komunikimit politik, të opinionit publik si edhe atyre politike e sociologjike në tërësi, në kontekstin e Shqipërisë si një vend ku heshtja merr shpesh formën e spirales, duke rezervuar surpriza për politikanët, mediat dhe vetë publikun.

Në Amerikë ishte koha kur do të thirreshin zgjedhjet presidenciale të vitit 1980. Sondazhet tregonin se presidenti Jimmy Carter dhe sfiduesi i tij Ronald Reagan ishin kokë më kokë gjatë dy muajve të fundit të fushatës. Mirëpo, sipas Elisabeth Noelle-Neumann, profesore e kërkimeve të komunikimit në Universitetin Mainz në Gjermani, shumica e sondazheve bënë pyetjen e gabuar. Në vend që të pyesnin “Për kë keni ndërmend të votoni”, ata duhet të kishin pyetur: “Kush mendon ju se do t’i fitojë zgjedhjet?”.

Ata do të kishin zbuluar se edhe kur preferencat ishin të barabarta, pritshmëria që Reagan do të fitonte po rritej nga java në javë. Noelle-Neumann pohon se perceptimi i njerëzve për klimën politike dhe veçanërisht parashikimi i tyre mbi zhvillimet e ardhshme, janë tregues të shpejtë dhe të besueshëm të asaj që do të ndodhë në zgjedhje. Kjo u pa edhe në rastin e presidentit Carter. Mbrëmjen përpara

votimeve, anketuesi demokrat Pat Caddell shkoi te Presidenti dhe i dha njoftimin e trishtuar se gara kishte përfunduar për të. Miliona votues i kishin kthyer votat e tyre në minutat e fundit për Reagan-in. Të nesërmen votimet në të vërtetë e zhytën Carter-in në një humnerë republikane.

Spiralja e heshtjes e Noelle-Neumann është teori që shpjegon rritjen dhe përhapjen e opinionit publik. Si themeluese dhe drejtore e “Qendrës Kërkimore të Opinionit Publik” në Allensbach (versioni gjerman i organizatës amerikane të sondazheve Gallup), ajo kishte pranuar fuqinë e opinionit publik. Ashtu si filozofi i shekullit të shtatëmbëdhjetë, John Locke, ajo e shihte opinionin publik si forcë konkrete që i mban njerëzit të rreshtuar. Locke nënvizonte tri forma të ligjit: hyjnore, civile dhe opinionin. Ai pohonte se ligji i opinionit është i vetmi ligj të cilit i nënshtrohen në të vërtetë njerëzit¹. Noelle-Neumann e përkufizon opinionin publik si “qëndrime të cilat dikush i shpreh pa rrezikuar të izolojë veten”.²

Termi spiralja e heshtjes i referohet presionit në rritje që ndiejnë njerëzit për të fshehur pikëpamjet e tyre, kur mendojnë se janë në pakicë. Noelle-Neumann beson se televizioni e përshpejton spiralen, por për të kuptuar rolin e masmedias në këtë proces, ne duhet të kuptojmë më së pari ndjeshmërinë e jashtëzakonshme të njerëzve ndaj standardit gjithnjë të ndryshueshëm, që do të tolerojë shoqëria.

Një shqisë thujse statistikore në nuhatjen e klimës së opinionit

Noelle-Neumann shprehet e mrekulluar vazhdimisht nga aftësia njerëzore për të nuhatur klimën e opinionit. Shkenca ka përcaktuar pesë receptorë truporë përmes të cilëve njerëzit shquajnë mjedisin e tyre: sytë (shikimi), veshët (dëgjimi), gjuha (shija), hunda (nuhatja), lëkura (prekja). Gjysmë me humor, studiuesja veterane e sondazheve sugjeron se njerëzit kanë edhe një organ thujse statistikor, një shqisë të gjashtë e cila kap informacion rreth asaj që shoqëria në përgjithësi mendon dhe ndjen. Duket sikur njerëzit janë të pajisur me antena, të cilat perceptojnë çdo lëvizje të rrymës sociale. Ku tjetër mund të gjejmë përgjigje sipas saj për faktin se “kur ndodh një lëkundje në klimën e opinionit pro ose kundër një partie, personi ose një ideje të veçantë, ndjeshmëria për këtë përhapet ngado pothuajse në të njëjtën kohë, te gjithkush?”³ Pa ndihmën e metodave të përzgjedhjeve rastësore, intervistave të programuara dhe dendësisë së shpërndarjeve të pyetësorëve, njerëzit në përgjithësi mund të tregojnë se nga po fryn era, përpara se sondazhet shkencore të masin opinionin publik.

¹ Elisabeth Noelle-Neumann, *The Spiral of Silence: Public Opinion-Our Social Skin*, bot. 2-të, University of Chicago Press, Chicago, 1993, f.70-71.

² Po aty. f.178.

³ Po aty. f.19

Noelle-Neumann rekomandon dy pyetje për të bërë leximet barometrike të mendjeve të njerëzve:

1. Klima aktuale: Pavarësisht opinionit tuaj personal, a mendoni se shumica e njerëzve do të....?
2. Klima e parashikuar: Pas një viti, më pak apo më shumë njerëz do të mendojnë kështu?

Njerëzit rrallë përgjigjen “Nga ta di unë?” ose “Unë nuk jam profet”⁴. Ajo beson se për njerëzit matja e klimës së përgjithshme publike, të tashme ose të ardhme, është gjëja më e natyrshme në botë. Me një përvojë më tepër se 30-vjeçare me sondazhet, ajo është e bindur se njerëzit zakonisht perceptojnë drejt. Edhe kur e lexojnë gabim të tashmen, ata mund ta dallojnë prirjen e përgjithshme të së ardhmes. Për shembull, rreth fundit të çdo viti, sondazhistët e qendrës së saj të kërkimit anketojnë një numër përfaqësues të burrave dhe grave gjermane: “A e prisni vitin e ardhshëm me frikë apo me shpresë?”. Niveli i optimizmit të shprehur nuk tregon lidhje me rritjen ekonomike gjatë vitit të lënë pas, por jep një parashikim profetik në lidhje me rritjen ose rënien ekonomike kombëtare për vitin e ardhshëm.

Aftësia njerëzore për të kapur momentin në opinionet publike nuk përdoret mendjelehtësisht. *Noelle-Neumann* thotë se nevojitet shpenzim i pabesueshëm energjie për të hetuar se cilat janë idetë që marrin mbështetje në rritje dhe ato të cilat humbasin terren. Përqendrimi i jashtëzakonshëm që kërkohet për të monitoruar prirjet sociale merr kuptim vetëm kur krahasohet me një vështirësi akoma më të madhe: rrezikun për ta izoluar veten me një opinion të cilit i ka kaluar koha. “Përpjekjet e bëra duke vrojtuar mjedisin janë me sa duket një haraç më i vogël për t’u paguar, sesa rreziku i humbjes së vullnetit të përgjithshëm të njerëzve: rreziku i të mbeturit vetëm, i përjashtuar dhe i përçmuar”.⁵

Frika nga izolimi: mekanizmi që udhëbeq spiralen e heshtjes

Sipas *Noelle-Neumann*, frika nga izolimi është një forcë centrifugale e cila përshejton spiralen e heshtjes. Për të mbështetur pretendimet e saj, ajo i referohet mjaft kërkimeve rreth konformizmit të psikologut të Swarthmore, *Solomon Asch*. *Asch* tregoi se njerëzit i fshehin evidencat e tyre vetjake për t’iu bashkuar presionit të perceptuar të grupit.⁶

⁴ Po aty, f.9.

⁵ Po aty, f.41.

⁶ Solomon E. Asch., “Effects of Group Pressure upon the Modification and Distortion of Judgments” In *Group Dynamics* Research and Theory, Drown Cartwright, Row, Peterson, Evanston, IL, 1953, f.151-162.

A _____
B _____
C _____
X _____

Shikoni vizat e mësipërme. Cila vizë: A, B, apo C, ka të njëjtën gjatësi me vizën X? Përgjigjja është e qartë, dhe një e vetme, të gjithë e vënë gishtin te viza A. Por përfshijeni një individ të caktuar në një grup eksperimental i cili njëzëri pohon se viza B është përgjigjja e drejtë dhe individit me mendimin e ndryshëm do të ndiejë një ankth të madh. Frika nga izolimi është mjaft e vërtetë për personin që këmbëngul të pohojë të vërtetën e tij: *Si do të reagojnë të tjerët ndaj kokëfortësisë së tij: do të shtrembërojnë buzët, do ta diskutojnë apo do ta hedhin poshtë atë? Dhe akoma më keq, mos do ta përqeshin apo do të tallen me mua? Nëse them atë që vërtet mendoj, do të më shohin me përçmim apo do të më përçmohen nga grupi? Asch* zbuloi se pjesa më e madhe e njerëzve që gjenden në një situatë të tillë të vështirë, do të konfirmohen me gjykimin e grupit të paktën në disa raste, në mos gjithë kohës.

A është frika nga izolimi një karakteristikë e veçantë e amerikanëve? *Noelle-Neumann* e hedh poshtë këtë mundësi duke u mbështetur në studimin vijues të psikologut të Yale *Stanley Milgram*, të zhvilluar në Evropë. *Milgram* përzgjedhi Francën dhe Norvegjinë si shtete me kultura mjaft të ndryshme- e para mjaft individualiste dhe e dyta me një sens të fortë të kohezionit. Siç e kishte parashikuar, norvegjezët u konfirmuan më shumë sesa francezët. Por ashtu si edhe amerikanët, shumica e njerëzve nga të dy vendet nuk arritën të qëndronin të vendosur përballë presionit të grupit.⁷

Noelle-Neumann konsideron gjithashtu opsionin që njerëzit konformohen më tepër me dëshirën për t’u identifikuar si fitues sesa për të shmangur izolimin. Për shembull, pas përfundimit të zgjedhjeve, janë më të shumtë ata që thonë se kanë votuar për fituesin sesa tregojnë rezultatet e votimeve. Megjithatë, ajo nuk i konsideron deklaratimet e pavërteta si përpjekje për të kapur me vonesë vagonin e lavdisë. Në fakt, ajo i interpreton gënjeshttrat e vogla si strategji mbrojtëse për të shmangur stigmën sociale, e cila shoqëron atë i cili gjykon ndryshe në lidhje me çështjet e rëndësishme. Megjithëse një qasje e tipit “bëj si bëjnë të tjerët” mund ta rreshtojë dikë te konformistët ose oportunistët, njerëzit që i përgjigjen anketimeve të *Noelle-Neumann* tregojnë se dalja kundër është edhe më e keqe.

Përrjashtimi nga grupi, izolimi afatgjatë me vetmi, dhe përqeshja e ligjëruar publike shihen si ndëshkime të tmerrshme në pjesën më të madhe të botës. *Noelle-Neumann* thotë se vetëm kriminelit ose heroit moral nuk do t’ia dijë për atë që mendon shoqëria. Të tjerët dëshirojnë paqen dhe rehatinë që buron nga përkatësia. Fituesja e çmimit Nobel për paqen, *Nënë Tereza* e miraton analizën e *Noelle-*

⁷ Stanley Milgram, *Nationality and Conformity*, Scientific American, Vëll. 205, 1961, f. 45-51.

Noemann: “Sëmundja më e keqe nuk është leproza apo turbekulozi, por të ndiesh se askush nuk të respekton, se nuk të duan, se të gjithë të largohen”.⁸ Ja përse individët përpiqen vazhdimisht të monitorojnë klimën e opinionit publik.

Roli i fuqishëm i mediave

Noelle-Neumann beson se mediat përshpejtojnë mbylljen e gojës së pakicës në spiralen e heshtjes. Megjithatë çdo qenie njerëzore është e pajisur me një organ thujse-statistikor me anë të të cilit të analizojë klimën e opinionit, ky sistem paralajmërues kërkon të dhëna për t’i përpunuar. Observimi i drejtpërdrejtë na jep vetëm një sasi të vogël të informacionit që ne përdorim, mediat e shkruara dhe ato elektronike furnizojnë pjesën më të madhe të njohjeve tona për botën që na rrethon. *Marshall McLuhan* pohonte se mediat e ndryshme janë zgjatime të shqisave fizike të caktuara. *Noelle-Neumann* i sheh të gjitha llojet e mediave si vepruese të kësaj shqise të gjashtë hipotetike, por ajo nuk është e bindur se ato janë gjithashtu gjithmonë në shërbimin tonë. Kjo pasi opinionet e mediave me influencë shpesh mbivlerësohen. Ajo dyshon që ndonjëherë njerëzit kanë idenë e gabuar në lidhje me zërin e vërtetë të opinionit publik, një rrethanë e emërtuar *injurancë e shumësisë*, - e cila buron ndoshta nga fakti që mediat nuk paraqesin një përzierje pikëpamjesh në proporcion me vendin e tyre në shoqëri.⁹

Për disa dekada me radhë pas studimit të vitit 1940 në Kontenë Erie, sociologët e mediave amerikane insistonin që ekspozimi përzgjedhës nga ana e lexuesit ose shikuesit neutralizonte çdo efekt bindës, që mund të kishte media e shkruar ose elektronike. Ashtu si edhe studiues të tjerë evropianë, *Noelle-Neumann* e përjashton idenë që mediat vetëm përforcojnë besimet paraprake të njerëzve. Ajo pranon se fuqia e fjalës së shkruar për të ndryshuar qëndrimet mund të jetë e kufizuar për shkak të ekspozimit përzgjedhës nga ana e lexuesit. Duke pasur parasysh gamën aktuale të gazetave, revistave dhe literaturës së aktualitetit, lexuesi e ka pothuaj të mundur që të evitojë opinionet e kundërta nga të tijat. Por ajo mendon se me televizionin ndodh diçka tjetër: “Efektet e masmediave shtohen për sa kohë që perceptimi përzgjedhës vështirësohet”.¹⁰ Rrëfenja për një të pasionuar pas lojës së pokerit në një qytet të vogël provincial shërben për të ilustruar pohimin e saj.

Një fermer i cili e merrte rregullisht pagën e tij pasditen e së premtes, çdo javë shkonte në tavernën lokale dhe i humbiste të gjitha paratë duke i vendosur ato në një lojë pokeri me pesë lojtarë të tjerë. Pas disa muajsh një mik e mori mënjane dhe e këshilloi “Mos luaj me ata njerëz më, duhet të jesh i verbër të mos e kuptosh që

po të mashtrojnë”. “Oh e di që loja është me hile”, -iu përgjigj fermeri, “por është e vetmja lojë që kemi në qytet”.

Televizioni është shpesh e vetmja lojë në qytet dhe megjithatë sipas *Noelle-Neumann* kërkuesit e mediave zakonisht nuk arrijnë ta njohin këtë fakt. Ata përpiqen t’i testojnë efektet e mediave në laborator, por ata nuk mund të rikrijojnë “përhapjen, jehonën dhe përforcimin” që i jep fuqinë që ka televizionit. Ajo e ka fjalën për praninë e gjendur kudo të televizionit, theksimin e zgjatur dhe përsëritjen e vazhdueshme të mesazhit të tij. Këta faktorë e asgjësojnë ekspozimin përzgjedhës, duke bërë që gjykimi kombëtar të marrë anën e opinionit mbizotërues. Sa të fuqishme mendon *Noelle-Neumann* se janë mediat elektronike?

“Nuk kam gjetur asnjëherë një spirale të heshtjes që bie ndesh me zërin e mediave, pasi vullneti për t’u shprehur varet pjesërisht nga ndjesia se ajo që themi mbështetet dhe legjitimohet nga mediat”.

Kësisoj, *Noelle-Neumann* bie dakord me vlerësimin pesimist të *Stuart Hall* në lidhje me rolin gërryes të mediave për vendimmarrjen demokratike. Ajo u njeh mediave një rol që shkon një hap përtej teorisë së përcaktimit të agjendës. Mediat në përgjithësi dhe televizioni në veçanti jo vetëm që na tregojnë se për çfarë të mendojmë, por na pajisin gjithashtu me pikëpamjen e legjitimuar të asaj që mendojnë gjithë njerëzit e tjerë.

Duke pasur parasysh rolin e mediave në kristalizimin e opinionit publik, aksesit mediatik bëhet jetik për ata që dëshirojnë të ndikojnë opinionin publik. Për liderët potencialë të opinionit nuk është më e mjaftueshme që të kenë pozicione të mirë menduara dhe kurajën për të shpallur bindjet e tyre. Ata duhet të jenë të gatshëm dhe të aftë për të tërhequr vëmendjen e mediave. Kjo krijon përparësi për këdo që ka dell revanshi, miq në pozicione të larta, ose më tepër pasuri, sesa qytetari mesatar në programimin e organit thujse-statistikor që zotërojnë lexuesit dhe shikuesit.

Si shembull të konsensusit fals të promovuar nga mediat, *Noelle-Neumann* përmend qëndrimin negativ të gazetarëve të vendit të saj ndaj karakterit gjerman në përgjithësi. Në vitet 1950 dhe 1960, komentatorët vazhdimisht flisnin keq për materializmin gjerman, ftohtësinë dhe tërheqjen nga autoriteti. Këto dhe stereotipa të tjerë negativë qarkullonin në media. Të dhënat nga kërkimet e saj tregojnë se përsëritja e vazhdueshme e bëri efektin e vet. Studimi vjetor i qendrës përfshiu edhe një pyetje në lidhje me karakterin gjerman: “Përgjithësisht, cili mendoni ju se është virtyti më i mirë i gjermanëve?” Në vitin 1952 vetëm katër për qind e të pyeturve u përgjigjën “Nuk njoh ndonjë”. Kjo shifër u rrit me 14% në vitin 1962. Deri në vitin 1972, 20% e njerëzve nuk ishin në gjendje të përmendnin asnjë karakteristikë pozitive. *Noelle-Neumann* del në përfundimin se mediat masive mund ta bëjnë shumicën të duket si pakicë. Televizioni e përcjell opinionin publik, televizioni gjithashtu e krijon atë.

⁸ Noelle-Neumann, *The Spiral*, f.182.

⁹ Po aty. f.216-217.

¹⁰ Noelle-Neumann, *Return to the concept of Powerful massmedia*, *Studies of Broadcasting*, Vëll.9, 1973. f.77.

Kohë për të folur dhe kohë për ta qepur

Meqenëse njerëzit mund ta kuptojnë kur nuk janë në një linjë me opinionin publik dhe i frikësohen izolimit për shkak të pikëpamjeve të ndryshme që kanë, është e pritshme që ata të cilët e shohin veten në pakicë të qepin gojën. Pikërisht këtë parashikon edhe *Noelle-Neumann*:

“Individët të cilët vërejnë se opinioni i tyre personal po përhapet dhe po përqafohet nga të tjerët, do ta shprehin këtë opinion me vetëbesim në publik. Nga ana tjetër, individët që vërejnë se opinionet e tyre vetjake po humbasin terren, do të prirën që të përshtatin një qëndrim më të rezervuar”.¹¹

Ajo nuk po thotë se grupi i fundit do ta braktisë me lehtësi bindjen e vet jopopullore dhe do të ndryshojë mendje. Njerëzit nuk rrotullohen si turbinat e erës. Por burrat dhe gratë që kuptojnë se janë përballë një ere të fortë, mund të kruspullosin kokat e tyre dhe të orientojnë veten. Heshtja e tyre do të kalojë ndoshta pa u vënë re ose do të merret si pranim i heshtur, kështu që ata nuk do të cenohen prej saj. Kur presidenti *George W. Bush* deklaroi luftë ndaj terrorizmit pas sulmit të 11 shtatorit, qytetarët e Shteteve të Bashkuara që dolën kundër ndërhyrjes ushtarake në Afganistan duhej të ishin ose shumë të guximshëm ose shumë budallenj. Situata ishte e ndryshme kur Presidenti *Klinton* çoi trupat amerikane në Bosnje. Duke nuhatur që opinioni publik nuk ishte në favor të ndërhyrjes, dhe se media do të nxirrte në pah rreziqet e misionit, njerëzit u ndjenë të lirë që të shprehnin mosmiratimin e tyre.

Në debatin e parë presidencial të vitit 1988, *George Bush* i madhi, shpiku fjalën me “L”. Ai e quajti *Michael Dukakis* një liberal – “një njeri të anëtarësuar në ACLU”, organizatë e cila sipas tij mbron ateizmin, kriminelët dhe pornografinë e fëmijëve. Miliona liberalë të të gjithë vendit nuk u ndjenë mirë nga përdorimi i kësaj gjuhe për të etiketuar pozicionet e tyre. Konservatizmi kishte qenë në ngjitje për më se një dekadë, liberalizmi ishte në rënie. Liberalët mund të kishin protestuar se “Unioni Amerikan i Lirive Civile” mbron gjithashtu patriotin konservator *Ollie North*, ose se pozicionet e *Bush*-it në lidhje me sigurinë sociale, kujdesin shëndetësor dhe marrëdhëniet me Kinën ishin mbrojtur fillimisht nga liberalët. Por në përputhje me parashikimin e *Noelle-Neumann*, ata e panë më të sigurt që të vuanin në heshtje.

“Qendra gjermane e kërkimeve të opinionit publik” ka zhvilluar një mënyrë për të zbuluar nëse njerëzit dëshirojnë të mbrojnë pikëpamjet e tyre. Supozoni për shembull, se tema është aborti. Pyetja që shtrojnë ekspertët e qendrës është:

Po të kishit pesë orë udhëtim me tren ose me avion për të bërë, dhe dikush (pranë jush) nis të flasë për abortin. A do të donit të flisnit me këtë person apo do të preferonit të mos flisnit?¹²

Testi i trenit/avionit zbulon një seri faktorësh që përcaktojnë probabilitetin e njerëzve për të folur. Faktori i parë është edhe më i rëndësishmi:

1. Ata që janë në krahun e pozicionit të shumicës janë më të gatshëm që të shprehin pikëpamjet e tyre, sesa ata që i përkasin pakicës. Kur ndihesh në harmoni me frymën e kohës të zgjidhet goja.¹³
2. Nëse perceptimi për klimën e opinionit nuk përputhet me parashikimin e individit për të ardhmen, gatishmëria për të folur varet më tepër nga prirja e të ardhmes.
3. Njerëzit janë më të gatshëm të flasin me ata që kanë mendime të ngjashme me ta, sesa me ata me të cilët nuk janë dakord. Kur i frikësoheni izolimit, miqtë të bëhen më të sigurt sepse janë më të sigurt sesa armiqtë.
4. Vetëvlërimi i ulët bën që njerëzit të mos flasin. Skuadra e kërkimeve të *Noelle-Neumann* i identifikon këta individë nëpërmjet pohimit të tyre në lidhje me marrëdhëniet: Unë njoh shumë pak njerëz.
5. Meshkujt, të rinjtë dhe njerëzit e shtresës së mesme dhe të lartë e kanë më të lehtë që të flasin.
6. Ligji aktual i inkurajon njerëzit që të shprehin opinionet e tyre kur ndiejnë që janë të shumtë në numër. Vendimi i Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara në lidhje me çështjen e *Roe kundër Wade* u dha kurajë grave “pro-abortit” për të shprehur pozicionet e tyre, pasi i ishin frikësuar gjatë përçmimit publik.

Spiralja përsheptuese e heshtjes

Tanimë ju i njihni konceptet bazë që përdor *Noelle-Neumann* për të ndërtuar modelin e saj të opinionit publik:

- Aftësia njerëzore për të kapur prirjet e opinionit publik.
- Frika e justifikuar e individëve nga izolimi.
- Hezitimi i njerëzve për të shprehur pikëpamjet në pakicë.

Ajo i integron këta faktorë në përshkrimin vijues që i bën çështjes së atyre që kanë statusin e pakicës. Përmbledhja që ajo i bën teorisë zbulon se ata janë me të vërtetë të kapur në “spiralen e heshtjes”.

¹² Elisabeth Noelle-Neumann, *The Spiral of Silence: Public Opinion - Our Social Skin*, bot. 2-të, University of Chicago, Chicago, 1984. F.139.

¹³ Elisabeth Noelle-Neumann, *The Spiral of Silence*, bot. i 2-të, f.26.

¹¹ Noelle-Neumann, *Turbulences in the Climate of Opinion*, *Public Opinion Quarterly*, Vëll.41, 1977, f.139.

“Njerëzit jetojnë me frikë të vazhdueshme nga izolimi i vetvetes dhe vrojnë me kujdes mjedisin e tyre për të parë se cilat janë opinionet në ngjitje dhe cilat janë në rënje. Nëse zbulojnë se opinionet e tyre predominojnë ose rriten, atëherë ata e shprehin veten lirisht në publik, nëse zbulojnë se pikëpamjet e tyre po humbasin mbështetje, atëherë ata frikësohen, i fshehin bindjet e tyre në publik dhe bien në heshtje. Ngase njëri grup shprehet me vetëbesim dhe të tjerët mbeten në heshtje, të parët duket sikur janë më të fortë në publik, ndërsa të dytët më të dobët sesa ç’regojnë në fakt shifrat reale. Kjo i inkurajon njerëzit që të shprehen ose që të ruajnë heshtjen, dhe kështu krijohet një proces spiral.”¹⁴

Të flaktët dhe avangardistët: ata që mund të ndryshojnë botën

Kritikët e parë të “spirales së heshtjes” i mëshuan faktit që gjithnjë do të ketë njerëz që kurrë nuk heshtin. Edhe nëse kauza e tyre duket e pashpresë, ata vazhdojnë që të ngrenë zërin e opinionit të tyre. *Noelle-Neumann* përshkruan në fakt dy tipa individësh që përbëjnë këtë pakicë të zëshme, e cila mbetet në krye të spirales duke sfiduar kërcënimet nga izolimi. Ajo i quan ata *të flaktët* dhe *avangardistët*.

Të flaktët jo konformistë janë ata që “kanë fituar fuqi të madhe në publik gjithnjë duke rënë në pozicion mbrojtës”.¹⁵

Pasi kanë rënë në një pozicion të tillë, ata nuk kanë më asgjë për të humbur duke u shprehur. *Noelle-Neumann* citon Don Kishotin e Servantesit si një shembull. Njeriu nga *La Mansha* që rend pas mullinjve të erës “e gjen veten të izoluar, të përqeshur, të mundur, e megjithatë mbetet besnik i idealeve të kavalerisë” të cilat i përkasin një botë e cila është zhdukur që prej 200 vjetësh. Njerëzit që i përkasin grupit të të flaktëve mbeten të lidhur pas të shkuarës dhe e shohin izolimin si çmimin që u duhet të paguajnë për këtë.

Avangarda përbëhet nga intelektualët, artistët, dhe reformatorët të cilët janë udhëheqësit e ideve të reja. Ndryshe nga të flaktët, ata kërkojnë reagimin e publikut, edhe pse ai është zakonisht negativ. “Ata që i përkasin avangardës janë të përkushtuar ndaj të ardhmes dhe kështu janë domosdoshmërisht të izoluar, por bindja se janë përpara kohës së tyre u jep kurajë për të duruar.”¹⁶ Megjithatë *Noelle-Neumann* e njeh ekzistencën e pakicave të besnikëve të flaktë dhe avangardistëve, spiralja e saj e heshtjes nuk i përfshin ata. Në këtë kuptim, ata përfaqësojnë raste ekstreme të cilat mbeten jashtë aplikimit dhe mosaplikimit të teorisë.

Noelle-Neumann i sheh të flaktët dhe avangardistët si të vetmen forcë për ndryshimet e ardhshme të klimës publike:

“Mundësinë për të ndryshuar ose devijuar opinionin publik e kanë ata që nuk kanë frikë nga izolimi. Duke thënë ose duke bërë gjëra që nuk e kanë mbështetjen popullore, duke tronditur opinionin, ata... mund t’u japin epërsi ideve të tyre”¹⁷

Psikologu social francez *Serge Moscovici* bie dakord me analizën e *Noelle-Neumann*, por ai beson se ajo duhet të pranojë që devijuesit e flaktë kanë në fakt një ndikim domethënës tek opinionin publik. *Moscovici* e ka kaluar gjithë jetën e tij profesionale duke shpjeguar sesi opinionet dhe qëndrimet e shumicës mund të ndryshojnë nën ndikimin e një pakice që reziston me vendosmëri. Ai e konsideron trajtimin nga ana e *Noelle-Neumann* të kategorive të të flaktëve dhe *avangardistëve* si një mendim të pasmë ose një “faktor hileje” për t’i paraprirë kohëve, kur karakteristikat kryesore të teorisë së saj nuk do të jenë në gjendje të llogarisin më lëvizjet në klimën publike.¹⁸

Kritika: defekte të matjes së spirales

Sociologu i Universitetit të Çikagos, *Mihaly Csikszentmihaly* e konsideron “spiralen e heshtjes” së *Elisabeth Noelle-Neumann* si teorinë “më origjinale, të qartë dhe të dobishme” të opinionit publik që është propozuar deri më sot.¹⁹ Me gjithë vlerësimin e mësipërm, ai dhe studiues të tjerë ngrenë pikëpyetje serioze në lidhje me tri praktika specifike të kërkimeve të saj, të cilat ata i konsiderojnë naive, ose thjesht të gabuara.

1. Të besuarit se frika nga izolimi është shkaku për heshtjen e njerëzve.

Noelle-Neumann e bazon spiralen e saj të heshtjes te frika e njerëzve nga izolimi, mirëpo sondazhet dhe anketimet e saj rrallë shtrojnë pyetjen nëse individët që nuk flasin e ndiejnë më shumë frikën, sesa ata që flasin. Kjo është e ngjashme me praktikën e *Leon Festinger* dhe pasuesve të tij, që besojnë se njerëzit i ndryshojnë qëndrimet e tyre në mënyrë që të reduktojnë mospajtimin konjitiv, por kurrë nuk e vunë në provë këtë testim për të provuar nëse ata e përjetojnë me të vërtetë atë ndjenjë (shiko kapitullin 16). Po kështu, duket i diskutueshëm edhe besimi total i *Noelle-Neumann* në eksperimentin e konformizmit të *Asch* për të provuar pikëpamjen e saj. Kur pjesëmarrësit në atë studim kishin të paktën një “partner të vërtetë” që ndante të njëjtin mendim, atëherë ata ishin në gjendje të përballonin presionin e grupit. Sigurisht, disa njerëz priren të qëndrojnë më të heshtur sesa të tjerët, por kjo heshtje mund të jetë e lidhur me ndjenjën e tyre të

¹⁴ Elisabeth Noelle-Neumann, Mass media and social change in Mass Media and Social Change, Elihu Katz, Sage, 1981. f.139.

¹⁵ Elisabeth Noelle-Neumann, The Theory of Public Opinion, f.274.

¹⁶ Elisabeth Noelle-Neumann, The Spiral of Silence, f.218.

¹⁷ Po, aty.

¹⁸ Serge Moscovici, Silent Majorities and Loud Minorities” in Communication Yearbook, 14, James Anderson, Sage, Newbury Park, 1991, f.298-308.

¹⁹ Mihaly Csikszentmihaly, Reflections on the Spiral of Silence, in Communication Yearbook, 14, f.297.

turpit, mungesën e interesit ose dëshirën për të mos iu kundërvënë dikujt me një pikëpamje të kundërt.

2. Mbështetja në testin hipotetik të trenit/avionit për të matur gatishmërinë për të folur. Megjithëse testi i trenit/avionit që përdori *Noelle-Neumann* duket mënyrë e zgjuar për të kuptuar entuziazmin ose lëkundjen e njerëzve për të ndarë opinionet e tyre me të tjerët, natyra artificiale e pyetjes mund t'i cenojë përgjigjet në mënyrë të atillë që të mos reflektojnë në fakt atë që njerëzit bëjnë ose nuk bëjnë në situata reale të këtij lloji. Profesori i komunikimi të Universitetit Cornell, *Caroll Glynn* dhe dy kolegë të saj zhvilluan një meta-analizë të 17 studimeve, që e lidhnin perceptimin e njerëzve për mbështetjen ndaj opinionëve të tyre me gatishmërinë e tyre për t'u shprehur hapur në një test të tipit situativ të trenit/avionit. Korrelacioni mjaft i vogël ($r=0.5$) nuk jepte garanci të qëndrueshme për ndonjë lidhje reale.

3. Përqendrimi te klima kombëtare e opinionit në vend të grupeve me influencë të opinionit. *Noelle-Neumann* e ka ndarë mendjen se opinioni publik është ai që perceptohet të jetë gjykimi i *të panjohurve në një publik anonim*, kjo është forca që na kushtëzon atë që themi. Mirëpo kritikët mendojnë se klima e opinionit kombëtar ushtron më pak presion sesa qëndrimet e familjes, miqve dhe grupeve të tjera me influencë. Për shembull, përfytyroni forcën e presionit që mund të ndiejnë brenda komunitetit të kishës disa evangjelistë të devotshëm në Shtetet e Bashkuara ose katolikë të Vatikanit nëse dalin me qëndrime pro-abortit. Fakti që aborti i legalizuar është ligj i vendit dhe që shumica e amerikanëve e mbështesin vendimin e çështjes së famshme "*Roe përballë Wade*" nuk do ta zbuste situatën për ta. Një studim i fundit në lidhje me qëndrimet ndaj veprimeve afirmative sugjeron se janë në fakt "perceptimet e opinionit në "mikroklimën" familjare dhe të miqve që janë më tepër të lidhura me gatishmërinë e dikujt për t'u shprehur".²⁰

A e bëjnë këto defekte teorinë e *Noelle-Neumann* të pavlefshme duke e izoluar atë vetë? Në asnjë mënyrë, por kritikët sugjerojnë me zgjuarsiri që të ndryshojë paradigma e kërkimit për të testuar parashikimet e saj. Një studim i fundit i zhvilluar nga *Dietram Scheufele*, një profesor i komunikimit në Universitetin Cornell trajton këto defekte kryesore në spiralen e heshtjes. Ai studioi rastet e perceptimeve të opinionit publik në lidhje me bio-teknologjinë dhe skuadra e tij e kërkimit mati frikën nga izolimi duke e trajtuar atë si një variabël për t'u testuar, pa besuar domosdoshmërisht se ajo ekzistonte. Ata e matën gjithashtu gatishmërinë për t'u shprehur me anë të përgjigjeve të dhëna nga vetë pjesëmarrësit në raste të jetës reale për t'u bashkuar diskutimeve në grupe të përqendruara pro ose

kundër manipulimit bio-teknologjik të gjeneve. Dhe së fundi, kërkuesit i pyetën pjesëmarrësit në lidhje me biseda të mëparshme që ata mund të kishin zhvilluar në lidhje me temën në fjalë në komunitetet ku bënë pjesë. Me anë të atyre procedurave korrigjuese, perceptimi i opinionit publik u provua se ishte një parashikues shumë më i mirë për t'u shprehur, sesa ç'ishte provuar të ishte nga 17 studime të referuar më lart.²¹ Spirala e heshtjes mbetet shëndoshë e mirë në shekullin e njëzetënjtë.

Noelle-Neumann nuk befasonet kur teoria e saj del jashtë binarëve të saj. Përveç kërkimeve të veta, ajo ka qëmtuar shkrimet e filozofëve dhe historianëve socialë për të mbledhur të dhëna që të mbështesin teorinë e saj. Ajo u është referuar veprave të autorëve të Iluminizmit si *Locke*, *Hume*, *Rousseau*, *Goethe* dhe *James Madison* në "*Federalist Papers*" për të ilustruar forcën dhe konsolidimin e opinionit publik. Ajo zbuloi se *Alexis de Tocqueville*, në analizat e tij të shekullit të nëntëmbëdhjetë në lidhje me rënien e fesë përpara Revolucionit Francez, ishte ndoshta i pari që përshkroi procesin e plotë të spirales:

"Njerëzit ende të lidhur pas besimit të vjetër ishin të frikësuar se mos ishin të vetmit që mbeteshin në këto pozita, dhe ndërsa ishin më të frikësuar nga izolimi se nga kryerja e ndonjë gabimi, ata iu bashkuan masave edhe pse nuk ishin dakord me to. Në këtë mënyrë, opinioni i vetëm i një pjese të popullsisë shfaqej si opinioni i të gjithëve dhe i çdokujt dhe pikërisht për këtë arsye dukej i pazezistueshëm për ata që ishin përgjegjës për këtë pamje të gënjeshtërt".²²

Po kaq tërheqëse janë edhe fjalët që jokonformisti *Henry David Thoreau* shkroi në lidhje me mosbindjen e tij civile: "Është gjithnjë e lehtë që të shkelësh ligjin, por edhe beduinët në shkretëtirë e kanë të pamundur t'i rezistojnë opinionit publik".²³

Bibliografi plotësuese

Burime të rekomanduara: *Elisabeth Noelle-Neumann*, "The theory of public opinion: The Concept of the Spiral of Silence" në *Communication Yearbook* 14, *James A. Anderson* (ed), Sage, Newbury Park, CA, 1991, F. 256-287.

Pohimet e plota: *Elisabeth Noelle-Neumann*, "The spiral of silence: public opinion, our social skin", botimi i dytë, University of Chicago, Chicago, 1993.

Presioni i konfirmimit: *Solomon E. Asch*, "Effects of group pressure upon the modification and distortion of judgments" në *Group Dynamics: Research and Theory*, *Dorwin Cartwright*

²¹ Dietram Scheufele et al. "Real Talk: Manipulating the dependent variable in spiral of silence research", *Communication Research*, Vëll.28, 2001, f.304-324.

²² Alexis de Tocqueville, *L'Ancien Regime et la Revolution*, Michel Levy Freres, Paris, 1856, f. 259.

²³ Noelle Neumann, *The Spiral of Silence*, 1984, f.184.

²⁰ Patricia Moy, David Domke et al, *The Spiral of Silence and Public Opinion on Affirmative Action*, *Journalism and Mass Media Communication Quarterly*, Vëll.78.,2001, f. 7-25.

- and Alvin Zander (eds), Row, Peterson, Evanston, IL, 1953, F. 151-162.
- Frika nga izolimi: Kurt Newwirth, Eduard Frederick dhe Charles Mayo*, "The spiral of silence and fear of isolation", Journal of Communication, Vëllimi 57, 2007, f. 450-468.
- Roli i masmediave: Elisabeth Noelle-Neumann*, "Mass media and social change in developed societies" në Mass Media and Social Change, Elibu Katz dhe Tomas Szecsko (eds), Sage, Londër, 1981, f. 137-166.
- Pakicat e flakta: Serge Moscovici*, "Silent majorities and loud minorities" në Communication Yearbook 14, James A. Anderson 9ed), Sage, Newbury Park, CA, 1991, f. 298-308.
- Mbështetje empirike: Dietram Scheufele, James Shanahan dhe Eunjung Lee*, "Real talk: manipulating the dependant variable in spiral of silence research", Communication Research, Vëllimi 28, 2001, f. 304-324.
- Dëshmi klasike: Elisabeth Noelle-Neumann*, "Public opinion and the classical tradition: a reevaluation", Public Opinion Quarterly, Vëllimi 43, 1979, f. 143-156.
- Studimi elektoral Carter-Reagan: Caroll Glynn dhe Jack McLeod*, "Public opinion du jour: an examination of the spiral of silence", Public Opinion Quarterly, Vëllimi 48, 1984, f. 731-740.
- Efektet e fuqishme dhe efektet minimale: Elisabeth Noelle-Neumann*, "The effects of media on media effects research", Journal of Communication, Vëllimi 43, Nr. 3, 1983, f. 157-165.
- Studim krahasues ndërkulturor: Huiping Huang*, "A cross-cultural test of the spiral of silence", International Journal of Public Opinion Research, Vëllimi 12, 2005, f. 324-345.
- Zhvillime shtesë të teorisë: Christopher Simpson, Elisabeth Noelle-Neumann*, "Spiral of silence and the historical context of communication theory", Journal of Communication, Vëllimi 46, Nr.3, 1996, f. 149-173.
- Kritika: Dietram Scheufele dhe Patricia Moy*, "Twenty-five years of the spiral of silence: a conceptual review and empirical outlook", International Journal of Public Opinion Research, Vëllimi 12, 2000, f. 3-28.

Përcaktuesit e politikës së jashtme tradicionale turke

Dokt. Blendi Lami

ABSTRAKT. Shumë koncepte përdoren në lidhje me parimet tradicionale të politikës së jashtme të Turqisë, të tilla si: konservatorizmi (prirja për një politikë të jashtme të fortë dhe një ushtri e fuqishme), të qenit i kujdesshëm (mosmarrja e risqeve), proteksionizmi (shfrytëzimi i resurseve në raste specifike), izolacionizmi (mosndërhyrja në çështjet politike të shteteve të tjera), ekuilibri i forcave (siguria kombëtare në atë shkallë sa kapacitetet e saj bëjnë që shteti të mos jetë aq i fortë sa të dominojnë të tjerët), autonomi (përqendrimi në vetëqeverisje), pasivitet (vëzhgim në distancë i ngjarjeve politike), neutralitet (deklarim për të qenë neutral ndaj sjelljeve të shteteve të tjera) etj.

Duke qenë se qëllimi kryesor i këtij punimi është të shtjellosh përcaktuesit e politikës së jashtme tradicionale turke, metodologjia e përdorur bazohet në qasjen cilësore – analiza e diskursit – e fokusuar në operacionalizimin e dy koncepteve thelbësore që shpjegojnë politikën tradicionale të jashtme turke: status quo-ja dhe perëndimorizimi. Tradicionalisht, politika e jashtme turke është bazuar në "ruajtjen e rendit të vendosur brenda kufijve dhe balancave ekzistuese" dhe "zbatimin e një politike të jashtme me orientim drejt perëndimit". Në funksion të përmbushjes së qëllimit të punimit, pyetjet kërkimore janë: Ç'kuptojmë me burime tradicionale dhe si këto burime që krijojnë një nënstrukturë, kanë definuar politikën e jashtme? Si materializohen konceptet gjeopolitike në ideimin e politikës së jashtme turke? Si përcaktohet pozicionimi gjeopolitik turk përkundrejt rajonit dhe më gjerë nga konteksti rajonal dhe global?

Deri në fund të Luftës së Ftohtë, Turqia ndoqi një traditë të ngurtë gjeopolitike, që u shpjegua më sipër, dhe mbulon një periudhë nga shpallja e Republikës deri në fund të Luftës së Ftohtë. Kryesisht gjatë Luftës së Ftohtë, Turqia luajti rolin e

një “garnizoni” për të penguar ekspansionizmin sovjetik për hir të Perëndimit (por duhet të përmendim vetë interesin turk). Gjithsesi, ky qëndrim gjeostrategjik është konsideruar me orientim të ruajtjes së status quo-së dhe ndjekjes së një paradigme statike.

Fjalë kyç: *status quo, perëndimorizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, referoma kemaliste, përmbajtja sovjetike, paradigma statike.*

1. Hyrje

Shumë koncepte përdoren në lidhje me parimet tradicionale të politikës së jashtme të Turqisë, të tilla si: konservatorizmi (prirja për një politikë të jashtme të fortë dhe një ushtri e fuqishme), të qenit i kujdesshëm (mosmarrja e risqeve), proteksionizmi (shfrytëzimi i resurseve në raste specifike), izolacionizmi (mosndërhyrja në çështjet politike të shteteve të tjera), ekuilibri i forcave (siguria kombëtare në atë shkallë sa kapacitetet e saj bëjnë që shteti të mos jetë aq i fortë sa të dominojë të tjerët), autonomi (përqendrimi në vetëqeverisje), pasivitet (vëzhgim në distancë i ngjarjeve politike), neutralitet (deklarim për të qenë neutral ndaj sjelljeve të shteteve të tjera) etj. (Termi “tradicional” përdoret për t’iu referuar politikës së jashtme të Turqisë deri në fund të Luftës së Ftohtë.)

Në fakt, dy koncepte thelbësore shpjegojnë politikën tradicionale të jashtme turke: *status quo*-ja dhe *perëndimorizimi*. Tradicionalisht, politika e jashtme turke është bazuar në “ruajtjen e rendit të vendosur brenda kufijve dhe balancave ekzistuese” dhe “zbatimin e një politike të jashtme me orientim drejt perëndimit” (Evendeci, 2013).

Parimet tradicionale të politikës së jashtme përcaktohen nga faktorë konjunkturalë dhe strukturorë (Aydin, 1999, fq. 155-156). Këta faktorë sendërtohen në një mjedis historik të caktuar. Në këtë kuadër teorik, Munison ofron katër burime kryesore të politikës tradicionale të jashtme. Këto burime nuk janë gjë tjetër veçse periudhat përcaktuese historike të traditës nga ku është bazuar formimi i shtetit modern turk. Ato janë:

1. përvoja historike e shtetit otoman;
2. revolucionin nacionalist kemalist dhe krijimi i Republikës;
3. orientimi perëndimor; dhe
4. perceptimi skeptik ndaj fuqive të mëdha dhe interesave të huaja. (Alexander, 2006, fq.945).

Gjatë këtyre periudhave, politika e jashtme ka marrë forma të ndryshme në varësi të këtyre variablave.

Lufta e Ftohtë, si rend i përcaktuar në marrëdhëniet ndërkombëtare, krijonte kufizime për “një frymëmarrje të lirë” të politikës së jashtme turke. Ishte sistem që nuk e lejonte Turqinë të manovronte në arenën politike në bazë të kapaciteteve të veta. Për të garantuar sigurinë e vet, Turqia u pozicionua në sistemin perëndimor dhe veproi në harmoni me interesat perëndimore.

Për arsye të zbrërthimit të koncepteve të politikës së jashtme tradicionale turke, në këtë artikull do t’i përgjigjemi pyetjes: Ç’kuptojmë me burime tradicionale dhe si këto burime që krijojnë një nënstrukturë, kanë definuar politikën e jashtme? Për t’iu përgjigjur një pyetje të tillë, do të shtjellojmë analizën e paradigmës së periudhës kemaliste dhe Luftës së Ftohtë, si dy faktorët konjunkturalë më thelbësorë.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky punim fokusohet në shpjegimin dhe në konceptet themelore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me përcaktuesit e politikës së jashtme tradicionale turke, koncepte që kanë ndikuar në formulimin e politikës së jashtme turke që nga formimi i Republikës më 1923 deri në fillim të viteve 2000, kur pushtetin në Turqi e mori AKP-ja. Prandaj punimi ka një rëndësi të veçantë sepse identifikon dhe analizon mekanizmat që shpjegojnë përse politikëbërësit turq i kanë adoptuar këto koncepte gjatë kësaj periudhe.

Në këtë aspekt, një fokus të veçantë merr perceptimi i aktorëve, diskurset e tyre dhe dokumentet strategjike të hartuara dhe të implementuara. Në funksion të përmbushjes së qëllimit, objektivat e paracaktuar në këtë punim janë:

- Analizimi dhe identifikimi i koncepteve kryesore që kanë ndikuar në formulimin e politikës së jashtme turke gjatë periudhës 1923-2002.
- Identifikimi dhe analizimi i pasojave që kanë krijuar mjedisin e ri turk. Për të matur këto implikime, mbështetemi tek sjellja e aktorëve, diskursi i tyre dhe perceptimi mbi gjeopolitikën.
- Identifikimi dhe analizimi i situatës së Turqisë, duke marrë në konsideratë pozicionin e saj për shtrirje influence rajonale dhe globale.

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Pyetjet kërkimore bazë që ngre punimi, janë:

- Ç’kuptojmë me burime tradicionale dhe si këto burime që krijojnë një nënstrukturë, kanë definuar politikën e jashtme?
- Si materializohen konceptet gjeopolitike në ideimin e politikës së jashtme turke?

- Si përcaktohet pozicionimi gjeopolitik turk përkundrejt rajonit dhe më gjerë nga kontesti rajonal dhe global?

Hipotezat bazë të punimit janë:

- Përfshirja e koncepteve gjeopolitike kanë ristrukturuar politikën tradicionale të jashtme turke.
- Konteksti ndërkombëtar gjeopolitik përcaktohet nga pozita gjeografike dhe kulturore e Turqisë.

3. Metodologjia

Duke qenë se qëllimi kryesor i këtij punimi është të shtjellojë përcaktuesit e politikës së jashtme tradicionale turke, metodologjia e përdorur bazohet në qasjen cilësore - analiza e diskursit - e fokusuar në operacionalizimin e dy koncepte thelbësore që shpjegojnë politikën tradicionale të jashtme turke: status quo-ja dhe perëndimorizimi. Për shkak të natyrës holiste të problemit, metodologjia e përzgjedhur bazohet në shqyrtimin dytësor. Për sa i përket burimeve dytësore, autori ka shfrytëzuar disa këndvështrime teorike të autorëve më të njohur të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencave politike. Në përzgjedhjen e tyre, është synuar që tezat e autorëve të njohur të fushave përkatëse të ballafaqohen me njëra-tjetrën me qëllim që të ofrohet një panoramë sa më të gjerë e komplekse e fenomenit të marrë në shqyrtim.

Një studim mbi zhvillimet e politikës së jashtme turke që gjatë periudhës kemaliste dhe gjatë Luftës së Ftohtë kërkojnë një përqendrim të vëmendjes sidomos në çështjet metodologjike. Kjo nevojë diktohet nga një sërë faktorësh. Pikësëpari, “realiteti politik është tepër kompleks dhe nuk mund të interpretohet vetëm nëpërmjet vëzhgimeve të thjeshta, pasi shpesh here, rezultatet e këtyre të fundit janë iluzive dhe aspak objektive” (Bryman, 2004, fq. 24). Zgjedhja dhe përdorimi i metodës së duhur është thelbësore për gjenerimin e dijes shkencore dhe përgjithësimin e saj. Për më tepër, studimi i realitetit nëpërmjet një metode shkencore i shërben jo vetëm interpretimit apo parashikimit të dukurive dhe të ngjarjeve, por edhe parashtrimit të mundësive njerëzore për veprim dhe ndërhyrje në realitetin social.

Sa i përket teorive të përdorura ka një gërshetim mes dy perspektivave të marrëdhënieve ndërkombëtare: realizëm dhe liberalizëm. Në këtë punim është përdorur orientimi gjeopolitik, që nënkupton se studiuesit e kësaj fushe ndërtojnë ide të caktuara për vend, këto ide kanë influencë dhe përforcojnë sjelljen politike, janë ide që ndikojnë se si ne, njerëzit, procesojmë nocionet tonë për vendet dhe politikën (Fouger et al, 2012, fq.535).

4. Themelet kemaliste

Në fazat e para të Republikës, politika e jashtme u përcaktua nga katër faktorë që qenë jashtëzakonisht transformues për Turqinë. Këta faktorë ndikuan në orientimin turk të politikës së jashtme, teksa ajo po zhvillohej në një arenë ndërkombëtare që u mbajt e koklavitur. Ata janë:

- a. Sapo kishte mbaruar Lufta e Parë Botërore dhe sistemi botëror akoma nuk qe përcaktuar. E thënë nga shumë historianë, ajo periudhë ishte si një lloj përgatitje për fillimin e Luftës së ardhshme botërore;
- b. Rrënimi i Perandorisë Otomane e kishte lënë Turqinë në një gjendje të vështirë. Gjithsesi, me njohjen e integritetit territorial të saj ndërkombëtarisht, Turqia kishte shumë probleme të brendshme, ndaj dhe u përqendrua më shumë në zgjidhjen e tyre;
- c. Revolucioni Republikan e shtoi edhe më tepër dozën e përqendrimit në çështjet e brendshme, për shkak të reformave radikale që mori Ataturku për transformimin e Turqisë;
- d. Sidoqoftë, me themelimin e shtetit të ri turk, edhe Turqia shfaqet si aktore e re në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Bazuar në këta faktorë, dalim në përfundimin se transformimet historike patën një ndikim të thellë në formulimin e politikës së jashtme turke.

Duhet të theksojmë lëvizjen çlirimtare turke pas Luftës së Parë Botërore dhe refuzimin e Traktatit të Sevres, me anë të të cilit ndaheshin territore otomane ndërmjet Fuqive Aleate, dhe më pas sukseset ushtarake turke që çuan në nënshkrimin e Traktatit të Lozanës më 1923. Pas nënshkrimit të këtij traktati të Lozanës, Turqia fitoi sovranitetin dhe pavarësinë brenda kufijve ekzistues. Këtu theksojmë rolin e politikës së jashtme turke, e cila nuk pranonte asnjë kompromis për ndryshim kufijsh. Ky ishte prioriteti i politikës në kontekstin e këtij faktori.

Referuar studiuesit të njohur të çështjeve turke, Graham Fuller, pas themelimit të Republikës së Turqisë, u formuluan prioritetet e politikës së jashtme kombëtare.

- i. Objektivi më i rëndësishëm në formimin e politikës së jashtme u transformua. Nga trendi i shtetit otoman për të rritur sferën e influencës me anë të pushtimeve territoriale u kalua në një gjallërim (rilindje) kombëtare brenda kufijve ekzistues të Republikës së re;
- ii. Krijimi i harmonisë ndërmjet politikës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare, që në fakt është një element mjaft thelbësor për shtetet e rinj në formulimin e politikës së jashtme.

iii. Çështje të sigurisë morën prioritet të lartë në agjendën e politikës së jashtme, teksa përmendëm kërcënimet që kishte dhe mund t'i shtoheshin Turqisë. (Graham, 2008, fq.19).

Procesi i transformimit turk drejt një modernizimi perëndimor natyrisht që do të ndikonte në politikën e jashtme. Fuller argumenton se agjenda e politikave të brendshme dhe të jashtme turke konsideroheshin një “zgjatim” i politikës që bëhej brenda perandorisë. (Graham, 2008, fq. 27). E kjo gjë ndodhte, argumenton më tej Bozdaglioglu (2008), sepse fuqia ushtarake në Perandorinë Otomane dhe qëndrimi i saj përkundrejt fuqive të mëdha projektoheshin në emër të përhapjes së Islamit, mbrojtjes së Shariatit dhe interesave të myslimanëve - me fjalë të tjera, politika e jashtme vepronte në emër të besimit fetar (fq.60 - 61). Por më pas, themelet e Republikës së re u bazuan në eliminimin e orientimit religjioz nga sfera publike (jo vetëm kaq, por Atatürk shkatërroi Kalifatin). Si pasojë, nacionalizmi bëhet “qendra e gravitacionit” në një shtet laik me parime perëndimore. Pra, Turqia shkëputet - duhet theksuar për hir të asaj çka do të vijojë më vonë - nga e kaluara për të hyrë në një fazë integruese drejt qytetërimit perëndimor. Por, duhet theksuar se si Perandoria (të paktën gjatë dy shekujve të fundit të historisë së saj) ashtu edhe shteti modern turk (vazhdim i perandorisë) e projektonin politikën e jashtme në raport me interesat e fuqive të mëdha.

Përkrah transformimeve drejt qytetërimit perëndimor, prioriteti i harmonizimit të programit modernizues të brendshëm dhe qëllimeve të politikës së jashtme kishte domethënie në ato vite të para, pavarësisht - siç shpjegojmë më sipër - përqendrimit në problemet e brendshme. Vizionari Atatürk e kuptoi se, pa një bashkërendim të politikës së brendshme me atë të jashtme, nuk mund të arrihej perëndimorizimi. Ndaj këtu mund të përmendim mesazhin e gjendur edhe sot e kësaj dite në çdo institucion turk “Paqe në atdhe, paqe në botë”, që më shumë se një mesazh është parim thelbësor i politikës së jashtme ose një udhërrëfyes për qëndrimin e Turqisë në arenën ndërkombëtare. Sipas kësaj perspektive, politika e brendshme lidhet ngushtë me atë të jashtme. E thënë ndryshe: ajo çka Turqia projekton për politikën e jashtme varet edhe nga stabiliteti i brendshëm, pjesë e reformave kemaliste. Sipas Fuller (2008), Atatürk po shkëputej nga “çdo gjë që bindte në kundërshtim me themelet kemaliste. Për shembull, ligjërimet otomane për hartimin e politikës së jashtme u hodhën poshtë” (fq.13) duke u zëvendësuar me orientime laike dhe ndërprerjen e synimeve ekspansioniste.

I gjithë ky “vrull kemalist” në orientimin e politikës së jashtme drejt Perëndimit bëri që Turqia të injoronte fqinjët e afërt, sidomos vendet myslimane të Lindjes së Mesme, kur në fakt prej aty i buronte edhe *identiteti i trashëguar*. Në këtë perspektivë, Fuller (2008) shprehet në lidhje me pasojat e këtyre politikave transformuese: “Pas dekadash të një historie kemaliste vendi u indoktrinua për të menduar negativisht për botën islame në përgjithësi dhe atë arabe në veçanti. Kështu, turqit krijuan një

perceptim për sferën islame si një botë prapanike dhe ekstremiste. Këto qëndrime turke bazohen më shumë në ideologji dhe paragjykime sesa në njohje të vërtetë të rajonit” (fq.13). Por, lind pyetja retorike: A kishte mundësi kasta laike kemaliste t'i jepte një identitet tjetër turkut - për ta bërë të harronte *identitetin e trashëguar*? Gjithsesi, këto orientime të politikës së jashtme u ndërmorën për t'i shërbyer konsolidimit të establishmentit republikan.

Në një këndvështrim kemalist duhet theksuar se politika e jashtme vuri në plan të parë sigurinë, koncept që shpjegohet nga disa perspektiva.

Së pari, i referohemi studiuesve Oguzlu and Kibaroglu (2009), të cilët theksojnë se Turqia vendosi të ndiqte një politikë të brendshme me elemente perëndimore për të parandaluar pushtimin e huaj. Ata e shpjegojnë këtë argument për sigurinë duke e lidhur me konceptin e “logjikës së frikës”. Kështu, orientimi turk logjikisht e shtyn politikën e jashtme të veprojë në zbatim të reformave të perëndimorizuara, por edhe të bashkëpunojë në organizata perëndimore të sigurisë (fq.579). Në fakt, këtu vëmë re një lidhje të dukshme të ideologjisë së implementuar me idenë e sigurisë. (Me fjalë të tjera, duke qenë pranë armikut, d.m.th. fuqive perëndimore, le të sillemi si armiku.) Duhet se Fuller (2008), ka një pikëshikim të përafërt me Oguzlu and Kibaroglu, kur arrin të përdorë edhe termin “paranojë turke”. Pra, ishte e rëndësishme të forcohej pozita e brendshme me një ideologji të re politike. Këtë thekson edhe Fuller më poshtë:

“Ndërkohë që republika përballej me armiq të jashtëm, ideologjia kemaliste tentoi të inkorporojë një frikë ndaj fuqive të huaja dhe konspiracionin si një element kyç në pikëpamjen për botën. Kjo paranojë përkundrejt botës ndihmoi në ruajtjen e rendit të brendshëm të Turqisë dhe në justifikimin e një qasjeje autoritare për të ruajtur vendin nga kërcënimet e jashtme”(fq.29).

Një tjetër autor, Jenkins (2001), thekson se “në një perspektivë të ngjashme, populli turk u edukua me një proces indoktrinimi duke menduar se gjendej në kërcënime të vazhdueshme të brendshme dhe të jashtme. Përvojat historike u paraqiten si realitete aktuale.” (fq.16).

Së dyti, aspekti i sigurisë lidhet me procesin reformues socio-politik, proces që u ndërmor radikalisht nga Atatürk. Në këtë proces u përjashtuan grupe sociale të asociuara me besimin fetar. Mardin (2007) shprehet se “praktika e vendosjes së urave të komunikimit ndërmjet elitës dhe masës nëpërmjet njohjes së fesë si ligjërim - themeli i shoqërisë - u shkatërrua.” (fq. 71). Në fakt, ky është një qëndrim teologjik, pasi nuk është feja (apo vetëm feja) që mundëson lidhjet ndërmjet elitës dhe masës. Shembulli i Mardin-it është dhënë për faktin se në Turqi u ndërmorën shumë reforma që në fakt e shkatërruan atë “urë komunikimi” që më parë ekzistonte në shoqërinë osmane. Pas deklaratës së pavarësisë filloi një proces gjithëpërfshirës me bazë laike. Shteti dhe sistemi ligjor u shekullarizuan pas

ndërmarrjes së reformave të shumta si p.sh. heqja e simboleve fetare, shkatërrimi i sulltanatit dhe kalifatit, heqja e Islamit si fe shtetërore - me anë të Kushtetutës së vitit 1928, vënia në zbatim e kodit civil zviceran dhe kodit penal italian, ndalimi i shamive dhe veshjeve tradicionale, përdorimi i alfabetit latin, pezullimi i tarikateve etj. (Zurcher, 2004, fq.186-195).

Natyrisht që në këtë kontekst të ri në politikën e brendshme, në arenën ndërkombëtare nuk mund të vijohej fryma otomane. Po ashtu, edhe mjedisi ndërkombëtar kishte ndryshuar konfiguracion pas Luftës së Parë Botërore. Qenë shpërbërë dhe perandori të tjera si ajo austro-hungareze dhe ruse, duke krijuar aktorë të destabilizuar ekonomikisht dhe politikisht në arenën ndërkombëtare. Mbi të gjitha, ishte tronditur ekuilibri i forcave brenda Europës, gjë që sigurisht sillte mungesë sigurie. Rrjedhimisht, në një çrregullim të tillë ndërkombëtar, pushtimet territoriale qenë më se të mundshme - siç ndodhi në Luftën e Dytë Botërore, ndaj edhe Republika Turke kishte nevojë për një orientim realist që do t'i shërbente mbajtjes në këmbë, por edhe vetë ekzistencës së shtetit (Aydin, 2000, fq.156).

E gjendur “e brishtë” në këtë sistem të ri, Turqia do ta përcaktonte politikën e jashtme duke iu referuar kushteve të brendshme dhe ndërkombëtare. Kemalizmi, i përqendruar kryesisht në punët e brendshme, parashtronte “politikën e mosndërhyrjes (mos-intervenimin), orientimin perëndimor dhe vigjilencën për të mbrojtur sovranitetin kombëtar” (Larrabie, 2003, fq.18-19). Deri pak përpara Luftës së Dytë Botërore, politika e jashtme turke bazohej tek mirëmbajtja e neutralitetit me qëllim që të shmangte konfliktet, që të bëhej pjesë e Europës dhe Perëndimit, si edhe të mbronte integritetin territorial.

Pra, del se një tjetër parim kryesor i politikës së jashtme të asaj kohe ishte ruajtja e neutralitetit, gjë që u konsolidua edhe më tepër me shfaqjen e shenjave të para të Luftës së Dytë Botërore. Sipas Jung (2003), Turqia përcaktoi disa parime për të arritur qëllimet e saj:

1. Ruajtja e aleancës dhe bashkëpunimit me Rusinë për të siguruar kufijtë në Lindje dhe në Detin e Zi (Në këtë rast i referohemi Traktatit të Moskës i nënshkruar në vitin 1921 dhe i amenduar në vitin 1925);
2. Garantimi i një plani të përbashkët për Ballkanin në rast të ndonjë kërcënimi të jashtëm, si në rastin e Antantës së Ballkanit (Në këtë rast i referohemi Traktatit të Miqësisë me Greqinë i nënshkruar më 1930, dhe Paktit të Ballkanit të nënshkruar në vitin 1934, me anë të të cilit synohej normalizimi i marrëdhënieve me vende ballkanike); dhe
3. Afrimi me Perëndimin me qëllim që të garantohej siguria kundër kërcënimeve nga ana e italianëve dhe e gjermanëve, si edhe që të garantohej siguria në kufijtë jugorë të Turqisë - me Irakun dhe Sirinë (Në këtë rast i referohemi Traktatit të Mosagresionit i nënshkruar në Saadabad më 1937) (Jung, 2003).

Në kontekstin e marrëdhënieve me jashtë dhe nënshkrimit të traktateve, duhet theksuar pjesëmarrja e Turqisë në Ligën e Kombeve me anë të së cilës Turqia u përpoq t'i përmbushte këto qëllime. Gjithsesi, edhe jashtë Ligës, Turqia formoi aleanca për të shmangur përballjen me kundërshtarë potencialë, siç jepen në pikat e mësipërme.

Pra, në periudhën ndërmjet Luftërave Botërore, iu vu rëndësi të madhe formulimit të një politike të jashtme me anë të cilës do të ruhej shteti i ri nga kërcënimet e mundshme. Turqia ndoqi një orientim realist, duke mos hasur vështirësi nga Perëndimi dhe duke u shkëputur nga e kaluara, duke krijuar - deri në një farë shkalle - edhe një strukturë perëndimore socio-politike. Për pasojë dalim në përfundimin që përmendëm më sipër: *status quo* dhe *perëndimorizimi* qenë thelbësor në përcaktimin e politikës së jashtme. Ishte një politikë e jashtme që kërkonte të ruante balancat ekzistuese me një orientim të qartë perëndimor.

5. Lufta e Ftohtë

Pas fundit të Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik u shfaqën në arenën politike si dy superfuqi rivale që përfaqësonin dy ideologji të ndryshme. Rivaliteti dhe kërcënimet për paqen dhe sigurinë në botë përbënin paradigmën e marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë Luftës së Ftohtë. Dhe sigurisht që një paradigmë e tillë do të ndikonte në politikën e jashtme të Turqisë, pjesë e këtij rendi të ri ndërkombëtar. Pra, nga sistemi i ekuilibrit të forcave u kalua në një strukturë botërore dypolare. Ky sistem i detyroi shtetet të silleshin sipas rregullave të paracaktuara nga dy superfuqitë.

Lufta e Ftohtë përbënte atë që ka deklaruar Cohen (2003), “ekuibrin strategjik ndërmjet botës detare të varur nga tregu dhe fuqisë kontinentale euro-aziatike” (fq.3). Megjithëse gjithnjë në “gjendje zjarri”, ky ekuilibër garantonte stabilitet strategjik për zona të caktuara (ku futet edhe Turqia). Rregullat e këtij ekuilibri shkeleshin nga superfuqitë vetëm kur ato tentonin të kontrollonin pika kyçe gjeostrategjike, gjë që sillte edhe destabilitet rajonal, në lidhje me vendin ku shtriheshin këto pika gjeostrategjike. Ia vlen të përmendim krizën e raketave në Kubë, luftën e Koresë, luftën e Vietnamit, pushtimin sovjetik të Afganistanit, për të cilat Davutoglu thotë se “këto kriza mbeten si marrëdhënie të kufizuara konfliktuale ndërmjet partnerëve” (Davutoglu, 1998, fq.5).

Brenda kësaj paradigme ndërkombëtare, Turqia u pozicionua në Bllokun Perëndimor. Studiuesi Aydin (2000), sqaron rrjedhojën e ngjarjeve që ndikuan në radhitjen e Turqisë në Bllokun Perëndimor. Duke iu referuar fjalëve të Stalinit gjatë bisedimeve me Çerçillin që “është e pamundur që Turqia të ketë mundësinë ta kapë në fyt Rusinë,” Aydin thekson se “pas kërcënimeve të BS në vitin 1945 për kontrollin e ngushticave, Turqia u ndje e tmerruar mos binte nën influencën

ruse” (fq.106). Nga ana tjetër duhet parë Loja e Madhe. Në vitin 1947, presidenti Truman akordoi një ndihmë të madhe për Turqinë dhe Greqinë me motivin për të luftuar komunistët në këto vende. Sipas doktrinë Truman, “mbështetja për Greqinë dhe Turqinë me ndihmë ushtarake dhe ekonomike do të parandalojë sferën sovjetike të influencës” (Truman, 1947). Ishte pra ky fjalim i Trumanit që nisi Luftën e Ftohtë, një përplasje kolosësh-“regjimet totalitare” kundër “njerëzve të lirë”, siç thotë Trumani në fjalim, që shënon fillimin e politikës amerikane të përmbajtjes së BS (në këtë rast, Bashkimit Sovjetik nuk do t’i krijohej mundësia të kishte kontroll në Mesdhe). Kjo Lojë e Madhe e bënte detyrimisht Turqinë aktore të rëndësishme.

Pas anëtarësimit të Turqisë në Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (1948), në Këshillin e Europës (1949), NATO (1952) dhe Komitetit Ekonomik Europian (1963), konsolidohet pozicioni i Turqisë në Bllokun Perëndimor. Pas anëtarësimit të saj në këto organizata të rëndësishme, por kryesisht në NATO, përcaktohet orientimi perëndimor i politikës së jashtme turke. Në këtë aspekt, rendi ndërkombëtar i Luftës së Ftohtë shtroi rrugën për përfshirjen turke në projektin e perëndimorizimit. Këtu i referohemi studiuesit turk Mufti (1998), i cili e karakterizon politikën e jashtme të Turqisë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë si “Perëndimorizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare të Turqisë”:

“Kjo fazë u karakterizua nga perëndimorizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare të Turqisë. Shfuqizimi nga Stalini i paktit të miqësisë turko-sovjetike dhe kërkesa e tij për të ngritur baza ushtarake në Bosfor dhe Dardanele ndikuan në afrimin edhe më të madh të Turqisë me Perëndimin.”(fq.41).

Sërish, pavarësisht se ç’deklarojnë studiuesit turq, në vijim të doktrinë së përmbajtjes, Turqisë nuk i mbetej të zgjidhte. E gjendur mes rivalitetit të dy superfuqive, Turqia e kishte të pamundur të përfitonte nga përplasia e fuqive europiane dhe të luante rolin e “vëzhgueses”, gjë që e kishte bërë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Veç kësaj, kapacitetet ekonomike, ushtarake dhe teknologjike turke qenë të pamjaftueshme për të ruajtur neutralitetin, edhe pse mund të thuhet përsëri që kjo gjë nuk varej nga Turqia. Mbi të gjitha, Turqia kërkonte të ruante integritetin territorial dhe sigurinë e saj që i kërcënohej nga Bashkimi Sovjetik.

Në një gjendje, ku hapësirat i kishte të pakta, pa miratimin nga Studioja Ovale (Uashingtoni), Turqia nuk e pati mundësinë të shfrytëzonte pozicionin e saj të favorshëm gjeostrategjik. Ajo i shërbeu qëllimeve të perëndimoreve sigurisht në këmbim të shumë ndihmave. Sipas Davutoglu (2001), “politikëbërësit turq e pranuan këtë pozicion si një paradigme statike dhe kjo situatë e privoi Turqinë të prodhonte paradigma alternative, gjë që rezultoi në rënien natyrale të sferës së saj të influencës” (fq.71). Edhe njëherë, Turqia nuk kishte zgjidhje pavarësisht

qëndrimeve të studiuesve turq. Politika e saj e jashtme një dimensionale miratohej nga NATO dhe Shtetet e Bashkuara. Në këtë kontekst, Aydin (2000) shton se “marrëdhëniet me aktorë të tjerë qenë në nivel minimal ... Marrëdhëniet e Turqisë me vendet e Lindjes së Mesme apo vendet e Botës së Tretë qenë veçse një zgjatim në funksion të politikës së jashtme perëndimore” (fq.111).

Që nga vitet ‘60, kur pati një zbutje të kërcënimit sovjetik, edhe pse nga njëra anë Turqia përpigjej të ruante status quo-në, hapësirat e saj për manovrim u shtuan. Veprimi për të ndërhyrë në Qipro - pavarësisht kundërshtimit të aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë - u bë një faktor i rëndësishëm në sjelljen e Turqisë. Në këtë kontekst, filluan të rishikohen edhe marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara. (Aydin, 2000, fq.111).

Megjithatë, duhet theksuar se me përjashtim të Qipros, politika e jashtme turke ka vepruar në harmoni me interesat perëndimore deri në fund të Luftës së Ftohtë.

6. Konkluzion: “Paradigma statike”

Në këtë mënyrë, qëndrimi kemalist - që ndiqte axhendën e tij për modernizimin e Turqisë me orientim drejt Perëndimit - dhe sistemi i Luftës së Ftohtë i marrëdhënieve ndërkombëtare qenë faktorët kryesorë që përcaktuan politikën tradicionale të jashtme të Turqisë. Objektivat turq në formimin e politikës së jashtme vareshin nga këta dy faktorë, madje u bënë pjesë e një “paradigme statike”, siç thotë Davutoglu.

Deri në fund të Luftës së Ftohtë, Turqia ndoqi një traditë të ngurtë gjeopolitike, që u shpjegua më sipër, dhe mbulon një periudhë nga shpallja e Republikës deri në fund të Luftës së Ftohtë. Kryesisht gjatë Luftës së Ftohtë, Turqia luajti rolin e një “garnizoni” për të penguar ekspansionizmin sovjetik për hir të Perëndimit (por duhet të përmendim vetë interesin turk). Gjithsesi, ky qëndrim gjeostrategjik është konsideruar me orientim të ruajtjes së status quo-së dhe ndjekjes së një paradigme statike.

Bibliografi

- Aydin, M. (1999). Determinants of Turkish Foreign Policy: Historical Framework and Traditional Inputs. *Middle Eastern Studies*.
Bozdaglioglu, Y. (2008). Modernity, Identity and Turkey’s Foreign Policy. *Insight Turkey*. Vol. 10, No.1.
Bryman, A. (2004). Social Research Methods (2nd edn), Oxford: Oxford University Press
Cohen, S. (2003). *Geopolitics in the World System*. New York: Rowman and Littlefield.
Davutoglu, A. (1998). The Clash of Interests: An Explanation of the World (Dis)order, *Perceptions: Journal of International Affairs*, Vol. 2, No. 4.

- Davutoglu, A. (2001). *Thellësia Strategjike*. Shkup: Logos A.
- Evedenci, Y. (2013). A General Overview on Turkish Foreign Policy. Aksesuar në: <http://en.akademikperspektif.com/2013/10/08/a-general-overview-on-turkish-foreign-policy/>.
- Fouberg, Erin H., Alexander B. Murphy, and H. J. de Blij (2012). *Human Geography: People, Place, and Culture* (10 ed.). Wiley: Brock University, Canada.
- Fuller, G. (2008). *The New Turkish Republic: Turkey, As a Pivotal State in the Muslim World*. Washington: United States Institute of Peace Press.
- Jenkins, G. (2001). Context and Circumstance: the Turekish Military and Politics. IISS.
- Jung, D. (2003). The Severs Syndrome. Aksesuar në: http://www.unc.edu/depts/diplomat/archives_roll/2003_07-09/jung_sevres/jung_sevres.html.
- Larrabee, F. (2003). *Turkish Foreign Policy in an Age of Uncertainty*. Pittsburgh: RAND.
- Mardin, S. (2007). *Projects as Methodology: Some Thoughts on Modern Turkish Social Science*. Wiley: Brock University, Canada.
- Mufti, M. (1998). Daring and Caution in Turkish Foreign Policy. *Middle East Journal*.
- Murinson, A. (2006). The Strategic Depth Doctrine of Turkish Foreign Policy. *Middle Eastern Studies*.
- Oguzlu, T., & Kibaroglu, M. (2009). Is the Westernization Process Losing Pace in Turkey: Who's to Blame? *Turkish Studies*.
- Special message to the Congress on Greece and Turkey: The Truman Doctrine, March 12, 1947. Aksesuar në: <http://www.trumanlibrary.org/publicpapers/index.php?pid=2189&st=&st1=>
- Zurcher, E. (2004). *Turkey: A Modern History*. New York.

ESE

Kulturë kombëtare, kulturë universale! —

Bashkim Shehu

ABSTRAKT. Kjo ese trajton konceptet e kulturës kombëtare dhe universale, duke vënë përballë skemat e kërkimit empirik dhe të shkencave sociale, me kuptimin kantian: iluminist dhe individualist. Ky i fundit, në gjykimin e autorit, duket se i përgjigjet një ideali modern të bashkësisë politike, i cili është refleksi i idealizuar i shoqërisë moderne urbane, i një shoqërie të karakterizuar nga diversiteti dhe nga dinamizmi i një ndryshimi të vazhdueshëm. Pikërisht në këtë kuptim të kulturës mund të flitet për kulturë kombëtare, si kulturë e një shoqërie moderne. Duke u karakterizuar nga diversiteti, duke qenë, pra, e hapur së brendshmi, një kulturë e tillë është e hapur edhe së jashtmi. Kjo na shpie tek ideja e një kulture universale. Duke iu referuar Gëtes, autori i kësaj eseje pohon se në letërsinë kombëtare hyjnë edhe vepra autorësh të huaj, dhe se një antologji e letërsisë kombëtare duhet të përfshijë edhe kryevepra të përkthyer. Pse jo, përderisa edhe ato janë pjesë e rëndësishme e kulturës së një shoqërie? Kështu, për shqiptarët kanë qenë dhe janë të rëndësishme për formimin e shijeve, duke qenë njëkohësisht edhe monumente të gjuhës shqipe, kryevepra të ndryshme botërore, nga “Hamleti” apo “Don Kishoti” i parë të përkthyer prej Nolit, deri te “Don Kishoti” i dytë i përkthyer prej Petro Zhejit, duke përfshirë këtu edhe punën e përkthyesve më të rinj. Argumentet e qasjes humaniste të autorit të kësaj eseje kanë si pikënisje një kritikë ndaj konceptimit etnicist të kulturës, që përbën pjesën e parë të shkrimit. Ky konceptim i “një të huaji”, sipas tij, “me vështrimin mbërthyer në të kaluarën, mbron individin dhe, tek e fundit, kreativitetin. I vetmi krijim [brenda kësaj qasjeje] është një identitet bunker, një identitet burg”.

Fjalët kyç: Kulturë, identitet kolektiv, diversitet individual, komb, vlera universale, bashkësi etnike, Shqipëri, Spanjë.

Një ditë, në Barcelonë, fare pranë hapësirës ku Qendra e Kulturës Kontemporane organizon periodikisht një festival të letërsisë të quajtur “Kosmopolis”, dëgjova një intelektual të shquar serb, Dragan Klaiç, të thoshte se dialog mund të ketë vetëm ndërmjet individëve, jo ndërmjet kulturave, sepse kulturat janë konceptuar në mënyrë të atillë që vetëm të përplasen. Kjo thënie, që ndoshta tingëllon e çuditshme, aq më tepër nga goja e një personaliteti të shquar pikërisht në fushën e dialogut ndërkulturor, aty për aty mu duk e goditur. Pastaj, më bëri të mendoj pse mu duk e goditur. Shpjegimi lidhet me njërin nga dy kuptimet kryesore të termit “kulturë”, të cilët duhet sqaruar sadopak nëse duam të flasim për kulturë kombëtare. Është fjala, së pari, për kuptimin që i japin këtij termi specialistët dhe shkencave sociale, sidomos antropologët dhe etnografët.

Pra, në këtë kuptim, kultura përfshin gjithçka që nuk është natyrore te njeriu: që nga feja, folklori, apo shprehitë erotike, deri te gastronomia, ose, po të përdorim një shprehje të Rezhi Dëbresë, deri te mënyra se si i drejtohem kamerierit. Dhe, çka është më e rëndësishme në këtë përdorim të termit, bartësi i kulturës është kolektiv. Thashë “bartësi”, jo “subjekti”. Sepse, në këtë përdorim, për hir të artikulimit shkencor, mjaft shpesh raporti ndërmjet njeriut dhe kulturës përmbysset: kultura bëhet subjekt dhe njeriu bëhet predikat, ose atribut i saj, duke qenë, pra, i kushtëzuar prej kontekstit kulturor. Dhe, po për hir të nevojave shkencore, një bartës i tillë kolektiv duhet të vështrohet si homogjen. Krejt i vlefshëm ky konceptim i termit “kulturë” si instrument heuristik në kërkimet empirike, për aq sa kriteret ndarëse midis komuniteteve janë komplekse, vlera e tij përcudnohet në ligjërimin e përditshëm, bisedor, si dhe në një hapësirë ligjërimore të ndërmjetme, dhe gjithashtu po aq të përditshme, siç është ajo e publicistikës. Në këto hapësira ligjërimore, kufijtë e kulturave përkojnë me vijat që ndajnë etnitë, përkatësisht kombet. Dhe kultura bëhet identitet etnik, përkatësisht kombëtar. Por në një lajthim të ngjashëm bien edhe antropologët apo etnografët, herë-herë, ndonëse jo gjithmonë, tek ndërmarrin inkursione filozofike, nëpërmjet një përgjithësimi hipertrofizues të arritjeve të tyre në fushën e kërkimit empirik, prirje hipertrofizuese ndaj së cilës, mund të themi, nuk kanë imunitet lëvrujesit e asnjë disipline shkencore. Kështu, përgjithësimi e thjeshton kompleksitetin e skemave të kërkimit empirik, dhe atëherë kultura sipas konceptimit të shkencave sociale na kthen te Herderi, domosdoshmëria gnoseologjike mund të kurorëzohet me një domosdoshmëri aksiologjike, madje moralizuese, dhe atëherë determinanti social shndërrohet pa shumë vështirësi në *Volksgeist*, në “frymë të popullit”, ose “frymë kombëtare”. Në raport me të, individët s’janë veçse shfaqje apo shprehje më shumë ose më pak të përkryera të një identiteti kulturor kolektiv. Ose më mirë jo shfaqje apo shprehje, po mishërime: sado që nuk është fjala për një ndarje sipas kriterit racor, një konceptim i tillë i kulturës ngërthen njëfarë misteri të *logos*-it të mishëruar, ose njëfarë mistike të tokës dhe të gjakut. Individët i përkasin kulturës me një fatalitet pothuajse biologjik. Dhe nuk është se thjesht kanë paraardhës të

përbashkët, po janë vëllezër siamezë të pandashëm, jo binjakë identikë për nga identiteti, jo dy nga dy, po ku e ku më shumë identikë dhe të pandashëm.

Vërtet, hapësira kulturore sipas një konceptimi të tillë të kulturës nuk e ka homogjenitetin territorial të shtetit-komb ose të gjymtyrëve përbërëse të shtetit federativ. Ajo të kujton më shumë trajtën premoderne të sovranitetit, që kishte në qendër dhe në majë monarkun dhe që vinte duke zbritur shkallë-shkallë nëpër strukturën hierarkike, si dhe duke u zbehur në drejtim të zonave marginale. Ndërsa në qendrën dhe në majën e hapësirës së identitetit kulturor nuk gjendet njëshi monarkik, por një shumësi e njësuar individësh, vëllezër siamezë të panumërt që supozohet se përbëjnë shumicën dominante, dhe që supozohet se e përfaqësojnë më mirë identitetin, domethënë kulturën si të njëjtë me vetveten, kulturën si traditë. Aty, në qendër dhe në majë, gjendet individ i tradicionalist i shumësuar dhe i uniformizuar. Diversiteti, zbehja e identitetit, largimet nga tradita (dhe kultura që i paraprin individit është traditë kulturore, zakon, konvencion i rrënjësuar, vepër e brezave në shekuj), pra, largimet nga sovraniteti i traditës (apo, siç thuhej dikur këtu, ndikimet dhe shfaqjet e huaja) përbëjnë përsëri një fenomen marginal, mundësisht për t’u dënuar e për t’u spastruar. Konceptimi etnicist i kulturës, me vështtrimin mbërthyer në të kaluarën, mohon individin dhe, tek e fundit, kreativitetin. I vetmi krijim është një identitet bunker, një identitet burg. (Të më falin filozofët nëse me këtë inkursion, apo me këtë aventurë timen në trevat e filozofisë, duke qenë autor librash fiksioni, po bie, ndoshta, në një subjektivizëm hipertrofik, ndoshta analog me atë që përmenda lidhur me shkencat empirike, nëse po bie, pra, në ekzagjerime nëpërmjet pasaktësive të pashmangshme të metaforës apo nëpërmjet ndonjë hiperbole thjeshtëzuese). Sidoqoftë, mendoj se për një kuptim të tillë të kulturës e kishte fjalën Dragan Klaiç kur thoshte se kulturat janë krijuar për t’u përplasur, jo për të komunikuar.

Tani, po shkëputem për një çast nga arsyetimet përgjithësuese dhe po rrëfej diçka prej përvojës vetiake (gjë që, natyrisht, nuk e shmang subjektivizmin). Ajo që do të rrëfej nuk është ndonjë tragjedi. E shumta, mund të konsiderohet si tragjikomike. I lindur, i rritur dhe, mund të thuhet, i formuar në Shqipëri (ndonëse formimi i njeriut nuk mbaron asnjëherë në jetë), prej vitesh jetoj në Barcelonë. Dhe, si këtu, edhe atje, në disa raste kur bëj ndonjë kritikë, përkatësisht ndaj gjërave të këtushme apo të atjeshme, nëse kritika nuk pëlqehet, kundërpërgjigja nuk është ndaj mendimit të shprehur, por ndaj gjendjes sime të supozuar prej të huaji. Më saktë, në Shqipëri, ku ndaj të huajve nderimi mjafton e tepron, reagimi *ad personam* në ndonjë rast kur ndonjë kritikë e imja i tingëllon e padrejtë njërit apo tjetrit, artikullohet si ndaj dikujt që ka qenë vendas, po s’është më i tillë, dhe prandaj nuk ka të drejtë. Sidoqoftë, goxha më të shpeshta janë këto qëndrime përjashtuese në vendin ku jetoj, dhe jo vetëm në berraritë apo duhantoret e lagjeve popullore, po edhe në mjediset e një borgjezie të iluminuar, pak a shumë të kulturuar (në një kuptim tjetër të termit “kulturë”). Për shembull, në mbyllje të një debati që u

zhvillua në një mjedis të tillë, pasi kisha shprehur një sërë kritikash ndaj qeverisë së Zapateros, dikush, që duhej të ishte politikisht i majtë, progresist, po kurrësi militant i ndonjë të djathtë arkaike ultra-nacionaliste, më tha: “Këtu, sidoqoftë, jeni i lirë të flisni!” E ritheksoj, nuk ka asgjë tragjike në këto situata. E shumta, mund të jenë tragji-komike. Dhe morali i kësaj fabule është se individ i vështuar si jo autokton, si i huaj, nuk gjykohet për atë çka bën ose çka mendon, po për atë çka është, apo më mirë çka nuk është. Gjykimi arsyetues ia lë vendin paragjykit. Kritikuesi e ka bërë kritikën, si të thuash, nga një pozicion jashtë loje. Ndoshta edhe unë jam duke paragjykuar, duke përgjithësuar mbi shoqërinë shqiptare apo spanjolle, apo katalane, në bazë të disa rasteve të veçuara. Po të jetë kështu, do t’ju lutesha që këtë pjesë nga ekspozoja ime ta konsideroni si një fabul ku autori nuk është objekt paragjykimesh kulturore, por është në rolin e subjektit të tyre, ose të bartësit të tyre. Mirëpo, edhe po të jetë kështu, prapëseprapë është një ilustrim i mënyrës së të menduarit me stereotipe dhe paragjytime kulturore.

Ndërkaq, kemi edhe kuptimin tjetër kryesor të fjalës “kulturë”, kuptimin iluminist, që lidhet me dijen, ose me librin (tani, ndoshta, edhe me internetin, por nuk jam i sigurt, kështu që po ngelem te libri). Fjala “kulturë”, në këtë kuptim, është përdorur për herë të parë nga romantikët, në mos gabohem, ndërsa Kanti ka përdorur në këtë kuptim fjalën “Bildung”: “edukim”. Është ideja e kulturës në kuptimin që individ del nga maturia, sipas shprehjes së Kantit, dhe fiton mëvetësinë. Çlirohet, mund të shtojmë, nga tutela atërore e autoritetit hyjnor dhe shtetëror, si dhe nga tutela prej nëne e kolektivit. Një kuptim i tillë i kulturës nuk ngërthen interesimin për identitetin kolektiv, po për diversitetin individual. Çdo individ, sipas Kantit, është një botë e papërsëritshme. Një kuptim i tillë i kulturës, më tepër se me vitalitetin e trashëgimisë së të vdekurve, ka të bëjë me mundësitë ndryshuese të të gjallëve, ka të bëjë me krijimin, tek e fundit me lirinë. Jo rrallë, ky kuptim i kulturës, me një përdorim në tkurrje, konsiderohet si elitist dhe aristokratik, ndërsa ai i një shkence në trajtën e divulguar jo vetëm që konsiderohet si shkencor, po edhe egalitar, edhe demokratik, sepse kulturën nuk e vështrojnë si prerogativë të atyre që studiojnë, të atyre që i kanë mundësitë për ta vrarë mendjen rreth gjërave që ndodhen përtej nevojave elementare. Sidoqoftë, Gëbelsi, njeri me ndjenja demokratike që nuk mund t’i vëmë në dyshim, kishte parasysh idenë e ashtuquajtur elitiste të kulturës tek thoshte se, kur dëgjonte fjalën “kulturë”, i vinte të nxirrte koburen. Dhe, në skajin tjetër të spektrit të vlerave, Martin Luter Kingu, në fjalimin e tij të famshëm, pikërisht këtë ide të kulturës, të anatemuar në ditët tona si elitiste, kishte parasysh tek rivendikonte arsimin dhe kulturën për të gjithë qytetarët amerikanë pavarësisht nga ajo që disa analfabetë me diploma universitare vazhdojnë ta quajnë “racë”.

Po le t’u qasemi këtyre dy koncepteve të kulturës nga një këndvështrim tjetër, nga ai i bashkësive politike të cilave u përgjigjen. Kështu, koncepti që u orvata të përshkruaj në pjesën e parë të kësaj ekspozije duket se i përgjigjet një ideali

premodern të bashkësisë politike, ndërsa kultura në kuptimin kantian, iluminist dhe individualist, duket se i përgjigjet një ideali modern të bashkësisë politike, i cili është refleks i idealizuar i shoqërisë moderne urbane, i një shoqërie të karakterizuar nga diversiteti dhe nga dinamizmi i një ndryshimi të vazhdueshëm. Dhe duket se pikërisht në këtë kuptim të kulturës mund të flitet për kulturë kombëtare, si kulturë e një shoqërie moderne. Dhe, duke u karakterizuar nga diversiteti, duke qenë, pra, e hapur së brendshmi, një kulturë e tillë është e hapur edhe së jashtmi. Kjo na shpie tek ideja e një kulture universale. Gëte ka qenë i pari që ka folur për letërsinë universale. Edhe një herë, më falni për subjektivizmin, dhe më lejoni të them se pikëpamja e Gëtes mund të ekstrapolohet, nga letërsia e libri ose kultura në përgjithësi. Cila është situata e kulturave kombëtare në kontekstin e një kulture universale, apo ndoshta më mirë kozmopolite? Në “Paqen e përjetshme”, rendin kozmopolit, të përbërë prej shtetesh demokratike, Kanti e përfytyronte në analogji me shtetin demokratik të përbërë prej individësh të mëvetësishëm. Pra, shtetet kanë një ndarje të qartë mes tyre. Ndërsa kulturat kombëtare që përbëjnë kulturën kozmopolite, po të kalojmë sërishmi nga Kanti te Gëte, janë të përziera. Fjalë e urryer, kjo, për ideologjinë identitare, dhe jo vetëm për të. Gëte sugjeronte (dhe sërishmi kërkoj ndjesë për subjektivizmin, meqë jam edhe përkthyes) se në letërsinë kombëtare hyjnë edhe vepra autorësh të huaj, dhe se një antologji e letërsisë kombëtare duhet të përfshijë edhe kryevepra të përkthyer. Pse jo, përderisa edhe ato janë pjesë e rëndësishme të kulturës së një shoqërie? Kështu, për shqiptarët kanë qenë dhe janë të rëndësishme për formimin e shijeve, duke qenë njëkohësisht edhe monumente të gjuhës shqipe, kryevepra të ndryshme botërore, nga “Hamleti” apo “Don Kishoti” i parë të përkthyer prej Nolit, deri te “Don Kishoti” i dytë i përkthyer prej Petro Zhejit, duke përfshirë këtu edhe punën e përkthyesve më të rinj (ndër të cilët edhe miku im i vjetër e i pandryshueshëm Piro Misha). E njëjta gjë mund të thuhet lidhur me përkthimin e Kadaresë në frëngjisht nga Vrioni, apo në spanjisht nga Ramón Sánchez Lizarralde.

Mbas gjithë këtyre citimeve ose perifrashimeve, po e mbyll duke perifrashuar Krishtin, dhe duke kërkuar për herë të fundit falje për mëkatën e subjektivizmit: kush e ndjen veten të paprekshëm nga ky mëkat, le ta hedhë gurin. Afërmendsh, nuk po e vë veten në rolin e Krishtit, por të njërit prej mëkatarëve të panumërt.

Ne, të tjerët dhe krejt të tjerët _____ (reflektim mbi “Tjetrin” dhe sensibilitetin moral)

_____ **Gilman Bakalli** _____

ABSTRAKT. Njerëzit si primatë sociale bashkohen në grupe dhe rrjete sociale. Përmes komunikimit ato ndajnë qartazi kush është pjesë e grupit dhe kush nuk duhet t’i përkasë atij. Anëtarët e një grupi përdorin kritere vlerësuese të ndryshme nga ato që përdorin anëtarët e një grupi tjetër. Për shkak të natyrës sonë disa probleme i perceptojmë fare mirë, ndaj të tjerëve jemi indiferentë sepse nuk na përkasin, nuk i konsiderojmë si “problemet tona”. Reagimet e disa grupeve sociale shqiptare (facebook p.sh) ndaj ngjarjeve tragjike në Francë në nëntor 2015, ishin shumë më të forta emocionalisht në krahasim me sulmet e vazhdueshme ndaj civilëve në Siri. Punimi i mëposhtëm synon të kuptojë më shumë në lidhje me mënyrën e diferencuar perceptuale dhe ndjeshmërinë e anëtarëve brenda grupeve dhe të grupeve të ndryshme sociale në raport me njëri-tjetrin.

Fjalët kyç: Tjetri, parokializmi, empatia, altruizmi, morali, imperativi kategorik, bashkëpunimi, i huaji.

Hyrje

Si tek të gjithë primatët e tjerë, edhe sjellja e njeriut i bindet ligjeve të grigjës. Për të cilat vlen motoja: “Kush nuk është pjesë e jona, është pjesë e tyre”. Kush nuk është me ne, është me ata. Me të tjerët. Por kjo aftësi lidhet me një disavantazh të dukshëm e të rrezikshëm: kush thotë “Ne” pranon njëkohësisht në

mënyrë të pamohueshme se i njeh ato, të cilët nuk i përkasin kësaj “Ne”, pranon pra ekzistencën e “Të tjerëve”. Lidhja në grupe është pjesë e sjelljes sonë të natyrshme. Kësisoj, ekzistenca e “Tjetrit” nuk është një keqkuptim moral. “Të tjerët” janë të paevitueshëm.

Si rregull, te rrethi i ngushtë i vlerësimit bëjnë pjesë të afërmit tanë. Ka përjashtime, sigurisht. Ka prindër që lënë pas dore fëmijët, ashtu siç ka edhe fëmijë që shumë shpejt u kthejnë shpinën prindërve. Ka vëllezër e motra që urrehen dhe që ndërpresin çdo lloj kontakti me njëri-tjetrin. Nuk ekziston pra një rregull matematikor, sipas të cilit vlerësimi dhe përkujdesja jonë më e madhe i shkon të afërmeve tanë më të ngushtë. Sidoqoftë përkujdesja jonë për to është një fenomen më i shpeshtë se sa indiferenca apo neglizhenca jonë ndaj tyre.

Po kaq pranë rrethit të ngushtë të ndjenjave dhe simpative tona janë edhe miqtë tanë. Më pas vijnë të njohurit e më pas njerëz ndaj të cilëve jemi indiferentë. Ndjeshmëria jonë nuk është në gjendje të rrokë gjithë njerëzimin, por një numër të kufizuar njerëzish. Siç e thotë Metusaliksi tek libri për fëmijë “Asterix”: “Nuk kam asgjë kundër të huajve. Disa nga shokët e mi, më të mirë janë të huaj. Por këta të huaj, s’janë prej këtej!” Të afërm, të huaj, të cilët bëjnë pjesë tek miqtë tanë dhe pastaj ato, të cilët “nuk janë prej këtej”! Më saktë se kaq nuk mund të përshkruhet hierarkia e sensibilitetit tonë moral në raport me tjetrin.

Parokializmi

Ekonomisti Samuel Bowles përdor termin “parochialism” (Bowles:2000) për të përshkruar një mentalitet të caktuar, të cilin Bowles e gjen të pranishëm tek një famulli fshati. Njerëzit e një famullie të vogël fshati sigurisht që janë të gatshëm për të ndihmuar pjesëtarët e komunitetit të tyre, por njëkohësisht janë tejet mendjengushtë, dyshues e mosbesues ndaj të tjerëve që s’i përkasin grupit të tyre:

Individuals implement their desires to limit social distance in their interactions with friends, neighbors, co-workers, and business associates by means of what we term parochial practices. These practices may take the form of shunning, refusal to trade or to extend friendship, verbal or physical assaults or other behaviors that preclude ongoing interaction. Members of networks often adopt parochial practices with the result that networks are more homogeneous and/or smaller than they would otherwise be (Bowles: 2000, fq.5).

Kush më shumë e kush më pak, njerëzit priren drejt “parokializimit”. Gatishmëria jonë për ndihmë dhe përkujdesje është e kufizuar dhe e fokusuar kryesisht ndaj

njerëzve që kemi pranë. Sigurisht që kjo cilësi nuk na pengon që, nën flamurin e një ideje morale të angazhohemi për t'u ardhur në ndihmë njerëzve të huaj e që jetojnë larg nesh. Mund të angazhohemi me "amnesty internacional" dhe të solidarizohemi me të burgosur që s'i kemi parë e takuar asnjëherë. Mund të dhurojmë parë për një organizatë bamirësie, e cila investon për fëmijë jetimë që ndoshta s'do t'i shohim asnjëherë. Mund të përkrahim instalimin e sistemeve demokratike për popuj që janë larg nesh, dhe për njerëz që s'i njohim. E megjithatë e gjitha kjo nuk është në kundërshtim me thelbin tonë primitiv "parokialist". I njëjti person që angazhohet me një organizatë bamirësie nuk ka pse i do dhe i vlerëson të gjithë njerëzit që njeh. Nëse ky do të ishte kushti, atëherë me siguri të gjitha organizatat e bamirësisë në mbarë botën do ngeleshin pa anëtarë.

Thelbi është ky: mund të duash dhe vlerësosh disa njerëz, që i njeh dhe i ke pranë. Por mund të duash dhe të vlerësosh idenë se, mund të duash dhe vlerësosh të gjithë njerëzit. Në parim ama. Sepse në realitet nuk mund t'i duash dhe vlerësosh të gjithë njerëzit. Bile edhe vetë fetë të cilat valëvisin flamurin e dashurisë për tjetrin, tradicionalisht përjashtojnë disa njerëz nga rrethi i tyre, zakonisht jo besimtarët. Altruizmi është një resurs i kufizuar, të cilin nuk mund ta shpërndash pa hesap andej-këtej. Kushdo që është i mirë gjithmonë dhe gjithandej mund të jetë e keqja e vetes.

Për ta ilustruar këtë logjikë sot përdoret një model i thjeshtë biologjik. Sipas këtij modeli, refuzimi i tjetrit apo grupeve të tjera është çmimi i betejës evolucionare, për hir të së cilës është zhvilluar aftësia jonë për të bashkëpunuar. (Samuel Bowles: 2008, fq.326-327). Kjo teori e Bowles është aktualisht në modë. Por në thelb ajo është spekulative. Bowles gjykon se paraardhësit tanë kanë qenë tejet të përfshirë në luftëra të përgjakshme. Dhe i referohet gjetjeve të shumta arkeologjike të kafkave dhe krahëve të shkërmoqur të skeleteve njerëzore. Por a mund të konsiderohen këto gjetje realisht thjesht si rezultat i përplasjeve të dhunshme midis grupeve apo kulturave të ndryshme? Në një kafkë të dërrmuar 10 mijë vjeçare s'mund të dallosh nëse e ka prekur sëpata e një të njohuri, e një të huaji apo nëse bëhej fjalë për një sherr privat apo luftë ndërfisnore.

Më pas Bowles spekulon se për paraardhësit tanë bashkëpunimi nuk i sillte vetëm avantazhe sociale por edhe ushtarake. Kush qëndron i bashkuar, e ka më të kollajtë të pushtojë territore të huaja, të zotërojë edhe shumë femra dhe të riprodhojë gjenet luftarake. Për t'i provuar hipotezat e tij Bowles përdor simulacione të panumërta kompjuterike. Por vlera ilustruese e modeleve kompjuterike për sjelljen njerëzore mbetet e dyshimtë. E megjithatë mbivlerësohen aktualisht nga shumë studiues. Por një raport direkt midis altruizmit, parokializmit dhe luftës duket një spekulim i mirëfilltë. Nëse ky trinitet do të merrej si rregull fiksi kulturës sonë, lind pyetja se pse ka kaq shumë përjashtime?

Duke lënë mënjanë spekulimet mund të bëjmë një konstatim të esëllt: ambienti i natyrshëm e social i njeriut është tufa, turma, grigja e tij. Është ambienti ynë

emocional, streha e dashurisë e urrejtjes, e mirëkuptimit, e bashkëpunimit, e shkëmbimit dhe e empatisë. Gjithçka shtrihet jashtë rrezes sonë të simpatisë dhe vëmendjes e perceptojmë si diçka të largët. Kjo rreze e simpatisë dhe përgjegjësisë sonë morale i ngjan gurit që hedhim në ujë rreth të cilit formohen rrathë. Rrathët e brendshëm janë të afërmit tanë, me të cilët, shpesh identifikohemi fort.

Marc Hauser, psikolog në Harvard, ka bërë një eksperiment virtual në formën e një pyetësi të shpërndarë në rrjet me rreth 300 mijë vetë nga e gjithë bota. (Hauser, 2008). Të pyeturit duhet të përfytyrojnë sikur janë në shinat e një hekurudhe. Para tyre, po afrohet me shpejtësi një vagon pa drejtues. Nëse lihet i lirë, vagoni vazhdon me shpejtësi drejt e në një zonë ku po punojnë 5 punëtorë mirëmbajtjeje. Por ju e keni mundësinë ta ndaloni një aksident të tillë. Nëse i ndryshoni pozicionin një leve që keni aty pranë, mund t'ia ndryshoni drejtimin vagonit në shinën ngjitur dhe, kështu, vagoni do merrte me vete vetëm një punëtor. Çfarë do bënit? Tre çereku i të pyeturve në të gjithë botën përgjigjet se do ta lëvizte levën. Jeta e 5 njerëzve u dukej më me vlerë se jeta e një njeriu të vetëm. Megjithatë ky rezultat ndryshon radikalisht, nëse për të pyeturit ndryshohet një detaj. Në shina vazhdojnë të jenë po ato pesë punëtorët e mirëmbajtjes, kurse në shinën ngjitur nuk është më ai punëtori i panjohur por një fëmijë që luan i shkujdesur. Pyetja në këtë rast është: Do ta lëviznit levën, duke e ditur që do të shpëtonit pesë punëtorë, por do mbysnit një fëmijë? Sa herë dhe ku do që është bërë kjo pyetje, përgjigja ka qenë e njëjtë: askush!

Nuk mund të ilustruhet më qartë, besoj, dallimi midis moralit të përgjithshëm që buron nga arsyeja dhe ndjesive subjektive morale të secilit prej nesh. Me shumë gjasa ndajmë të gjithë pikëpamjen racionale se jeta e çdo njeriu parimisht ka të njëjtën vlerë. Vetëm parimisht ama! Në fakt ne bëjmë dallime tepër të forta midis vlerës së jetës të njerëzve që kemi pranë dhe atyre që nuk ndjemë afër. Imperativi kategorik i Kantit, sipas të cilit veprimet tona morale duhet të synojnë të kenë nivel universal, nuk i shkon aspak përshtat realitetit të instinkteve tona sociale. Sado që imperativi kategorik kantian mund të tingëllojë bukur e bindshëm, ai s'ka lidhje aspak me realitetin e përditshëm njerëzor. Siç thotë Peter Sloterdijk:

"Vlera praktike e imperativit kategorik kantian qëndron në madhësinë e tij sublime, e cila garanton mospërdorimin e tij" (Sloterdijk: 2005, fq 102).

Kur vlerësojmë moralisht njerëzit e tjerë, përdorim matës të ndryshëm. Dhe nuk është gjithmonë arsyeja që shpall gjykimin tonë, por shpesh është simpatia. Psikologu i evolucionit Eckart Voland flet në këtë kontekst për moralin e dyfishtë: "moralin bën përherë dallim midis atyre që bëjnë pjesë tek ai dhe asaj pjesës tjetër. Strukturalisht, morali është njëkohësisht moral i dyfishtë" (Intervistë dhënë gazetës Süddeutsche Zeitung" 19.02.2009).

A ka të drejtë Volland? Ç'është morali i dyfishtë? Përgjithësisht me moral të dyfishtë nënkuptojmë rastin kur dikush predikon diçka dhe bën diçka tjetër. Një politikan demokristian, i cili publikisht e deklaron si të shenjtë vlerën e familjes dhe njëkohësisht ka një lidhje të fshehtë jashtëmartesore, e konsiderojmë si moralist të dyfishtë. Po kështu edhe një ekologjist, i cili lëviz nëpër qytet me fuoristradë. Por a mund ta shtrijmë këtë koncept për të gjithë moralin? Sigurisht që fëmijën tim e preferoj më tepër në krahasim me të tjerët. E megjithatë nuk më shkon mendja t'ia kërkoj ta pres këtë edhe prej mësuesit në shkollë. Bile e mirëpres faktin që në shkollë, mësuesi ta trajtojë atë njëlloj si të tjerët dhe nuk do të më pëlqente sikur mësuesi ta trajtonte atë dukshëm më mirë se të tjerët. Në këtë pikë motoja “të predikosh diçka dhe të veprosh ndryshe” nuk hyn. Moral i dyfishtë do të ishte, sikur të tundja lart flamurin e barazisë dhe njëkohësisht të pretendoja që fëmija im të trajtohej në mënyrë preferenciale nga të tjerët.

Fakti që njerëzit që kemi pranë nesh i vlerësojmë ndryshe nga të huajt është instikt natyror. Dhe nuk ka lidhje me konceptin e “moralit të dyfishtë”. Kur fëmijët nuk i trajtojmë me të njëjtën masë, nuk është se po veprojmë në kundërshtim me një bindje të deklaruar.

Edhe edicionet e lajmeve funksionojnë sipas këtij parimi. Më parë ne, grupi ynë, shoqëria jonë pastaj të tjerët dhe pastaj krejt të tjerët. Më parë lajmet nga Shqipëria, pastaj nga rajoni (Kosovë, Maqedoni) e më pas lajmet ndërkombëtare. Dorëheqja e një ministri shqiptar është më e rëndësishme se një luftë civile në Ruanda. E çuditshmja është se koncepti “popull” apo “komb” është tepër gjigand për të kërkuar ndjeshmërinë tonë. Shqiptar apo francez, është thjesht një identitet iluzor. Në jetën e përditshme unë nuk e njoh “shqiptarin”, bile as “shkodranin” apo “tiranasin”. Kur grindem me dikë në rrugë, s'më intereson aspak nëse tjetri është shqiptar, shkodran apo francez e gjerman. Sigurisht që rrezja e veprimit të ndjesisë së përkatësisë mund të zgjatohet në rrethana specifike. Por veçse për një kohë të shkurtër. Siç edhe ndodh kur kombëtarja e futbollit shqiptar luan me serbët apo grekët. Abraham Lincoln thoshte: “mund të mashtrosh për shumë kohë pak njerëz. Mund të mashtrosh shumë njerëz për pak kohë. Por nuk mund t'i mashtrosh të gjithë përgjithmonë.” E njëjta gjë mund të thuhet edhe për grupet. Mund ti bashkohesh për shumë kohë grupeve të vogla. Mund t'i bashkohesh për pak kohë grupeve të mëdha. Por është e pamundur të jesh përgjithnjë pjesë e një grupi të madh.

Gjashtë persona nga i njëjti qytet që bëjnë pushimet rastësisht në të njëjtin plazh nuk përbëjnë një grup. Nëse bashkohen dhe ndërmarrin aksione të përbashkëta, mund të konsiderohen grup. Interesi i ndërsjellë dhe një farë mase solidariteti janë lënda ngjitëse e strukturës së grupit. “Kush nuk është me ne, është kundër nesh” – thoshte me një logjikë të pastër primatësh diktatori Enver Hoxha. Një dëshmi e faktit se mund të qëllosh në shenjë edhe kur flet në tym.

Kush është pjesë e një grupi njih edhe “të huajt”. Pa pasur nevojë detyrimisht për “armi”. Shpesh “të huajt” apo edhe “armiqtë” mund të jenë të dobishëm për

solidaritetin e grupit. Ato shënjojnë një kufi të rëndësishëm të identitetit tim. Historia e kulturës politike të njerëzimit tregon se si kufijtë krijojnë identitete. Kufijtë e territorit, kufijtë e gjuhës, kufijtë e fesë. Prandaj është kaq e vështirë të heqësh kufijtë. Ku do të zhduken ato, kufijtë? Me gjase, kurrë! Ato do të mbijnë diku tjetër, sepse njerëzit dhe kulturat kanë nevojë për “të tjerët” për të kuptuar se kush janë ato vetë. Pas rënies së komunizmit në Evropën Lindore, Perëndimi i lirë zbuloi tashmë një kufi tjetër, “vlerat perëndimore” kundër fundamentalizmit islam.

Referenca

- Bowles, Samuel, & Gintis, Herbert (2000). *Optimal Parochialism: The Dynamics Of Trust And Exclusion In Networks*, Working Paper. University of Massachusetts.
- Bowles, Samuel (2008). *Conflict: Altruism's midwife. Generosity and solidarity towards one's own may emerged only in combination with hostility toward outsiders*. In: Nature, 456.
- Hauser, Marc (2008). *Moral Minds. How Nature Designed Our Universal Sense Of Right And Wrong*. Abacus.
- Sloterdijk, Peter (2005). *Im Weltinnenraum des Kapitals*, Frankfurt/Main: Suhrkamp.
- Interview mit Eckart Volland in Süddeutsche Zeitung.

Në optikën e studiuesve të fushës (shih Cosenza, G. 2014), kur flitet për “media” shpesh është e nevojshme të bëhen një sërë dallimesh. Fjalët që e shënojnë atë, mbartin në fakt një farë ambiguiteti. Radio, për shembull, ose televizor, themi për të shënuar herë aparatin marrës që kemi në shtëpi dhe herë entin që i prodhon. Ndërkaq, me Internetin situata është edhe me e ndërlikuar, ngase kur flasim për të, në disa kontekste u referohemi rrjeteve llogaritëse, në disa të tjera protokolleve të ndërlidhjes mes rrjeteve e në të tjera akoma hapësirave të shumëllojshme të komunikimit online, të cilat përfundojnë dashur pa dashur në të njëjtin kazan. Detyra e analizës semiotike të medias, është ta shohisë këtë ambiguitet të brendshëm të saj, duke vendosur kufij dhe përcaktuar ngjashmëritë apo ndryshimet.

Por cilit përkufizim të medias i referohet semiologu? Mes përkufizimeve të ndryshme mbi median, studiuesit i referohen përgjithësisht njëres, mirëpranuar në gjirin e sociologëve të medias (shih Meyrovitz, 1985), e cila ndihmon në shquarjen e menjëhershme të një lëmi hetimi të përshtatshëm edhe për semiotikën. Ai lidhet ngushtë me dallimin mes mediave nënkuptuar si *teknologji* dhe mediave nënkuptuar si *forma komunikimi*, pra si një tërësi rregullash, konvencioneve e formash organizative-kulturalisht, sociologjikisht dhe historikisht të përcaktuara-që njerëzit ndjekin teksa komunikojnë përmes teknologjive. Kështu, për semiologun që dëshiron të studiojë televizionin apo radion, s’janë të rëndësishme teknologjitë e marrjes dhe transmetimit, as organizimi i njerëzve, hapësirës apo mjeteve që përbëjnë një redaksi, por larmia e *llojeve* dhe *formateve* të programeve televizive e radiofonike (lajmet, talk show, gazeta radiofonike etj.), si dhe tipet e komunikimeve që secili format mundëson, stimulon apo shkurajon. Në rastin e shtypit, mediat me rëndësi semiotike, s’janë teknologjitë që mundësojnë procesin e shtypit e as etnitetet abstrakte si “libri”, “gazeta”, por *llojet* e ndryshme të librave (nga librat vizatimorë, tek romanet, për shembull), *llojet* e ndryshme të periodikëve (javorë, mujorë, femërorë etj), *llojet* e ndryshme të përditshmeve (politike, financiare etj.) e kështu me radhë.

Në të njëjtën logjikë, edhe sa i përket qasjes semiotike ndaj Internetit, s’janë aspak të rëndësishme teknologjitë *hardware* apo *software*-ët e ndryshëm që lejojnë komunikimin ndërpersonal në Internet (përmes emailit, *chat*-it, *social media*-s etj), e ca më pak *web*-i si i tillë. Për një studim semiotik të tij (duhet t’u qasemi dora-dorës mbi *llojeve të ndryshme* të sajteve web, *tipeve të ndryshme të veprimeve* që mund të bëhen aty: pra që nga leximi i një të përditshmeje, tek shfaqja e një filmi në *streaming*, nga blerja e një palë pantallonave, tek dëgjimi i një kënge, nga një video-thirrje, tek pagesa e një fature banke. Ndërkaq, sa u përket studimit semiotik

RECENCË

Recencë e tekstit të Giovanna Cosenza: “Hyrje në semiotikën e mediave të reja”, shtëpia botuese Laterza, Romë, 2014 _____

_____ *Albana Nexhipi, Msc*¹ _____

ABSTRAKT. *Leximi semiotik i mediave të reja përfaqëson sot dita një sfidë mjaft interesante dhe kjo për motivin se objekti i studimit, pra vetë mediat e reja, janë në ndryshim të vazhdueshëm. Një proces i tillë, i kushtëzon studiuesit ta përshtatin vazhdimisht aparatin e nevojshëm konceptual që nevojitet për studimin e tyre, çka në vetvete e bën edhe më delikat procesin e leximit semiotik të këtyre mediave. Por cilat janë mekanizmat që na ndihmojnë t’i lexojmë semiotikisht mediat e reja? Si mund t’i vëmë në përdorim ato?*

Ky artikull synon të rendisë elementët e nevojshëm konceptualë për një lexim semiotik të mediave të reja, çka do të ndihmonte drejt një kuptimësimi më të mirë të mesazhit të ofruar prej tyre.

Fjalë kyç: *semiotikë, medie të reja, përdorues model/empirik, autor model/empirik, Internet, sajt.*

¹ Pedagoge, Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike, UET. Përkthyes e një sërë teksteve, mes së cilave *Erosi i Qytetërimit* i Herbert Marcuse, si dhe *Homo Videns. Televizioni dhe postmendimi* i Umberto Eco-s.

të mediave të reja, një proces i tillë është shumë më i ndërlikuar dhe kjo për hir të objektit që shqyrton i cili është në ndryshim të vazhdueshëm.

Mediat të reja dhe lëmi semiotik. Vështirësitë e punës analitike

Siç edhe e thamë më sipër, për sa u përket mediave të reja, puna analitike e semiologut vështirësohet së tepërmi krahasuar me punën e tij me mediat klasike, e kjo sidomos për dy arsye (Cosenza, G, 2016, f 16): *Së pari*, larmia e praktikave të mediave të reja s'është i njëjtë me atë të mediave klasike: ajo është shumë më shumë e gjerë e me kufij më të sfumuar, ngase informatika ka i shumëfishuar pafund format e komunikimit dhe përdorimet sociale që mund të lejojë çdo teknologji në vetvete, pa harruar këtu edhe *multi-medialitetin* dhe *konvergjencën e mediave* që lulëzojnë ngado në komunikim. *Së dyti*, përkufizimi i “të resë” ndryshon vazhdimisht ditët e sotme sidomos tek vetë mediat e reja, për shkak shpejtësisë me të cilën zhvillohen teknologjitë e informacionit. Kështu, teksa u referohesh atyre, nevojitet të ripërkufizosh vazhdimisht të renë.

Por si ta përkapim “të renë” në këndvështrimin semiotik të mediave të reja? Parimisht, biem dakord që e reja është diçka me të cilën s'jemi mësuar, që s'e njohim ende mirë, që s'e menaxhojmë dot as plotësisht e as pjesërisht. Viteve të fundit, mediat që enciklopedia e përbashkët e vendeve më të zhvilluara të botës regjistron si të reja, ndryshon me një shpejtësi tejet të madhe (po aty, fq.18). Ky fenomen nuk varet vetëm nga shpejtësia me të cilën zhvillohen teknologjitë e komunikacionit, por edhe nga strategjitë e komunikimit dhe shitjet e produkteve të ndryshme teknologjike, për të cilat shpesh industritë krijojnë moda e tendenca vetëm e vetëm që të stimulojnë blerjet, duke promovuar si të re edhe atë që e re s'është. Pra, ndryshimet e sjella prej informatikës dhe strategjive të saj të marketingut, na kanë vënë në kushte ku praktikisht s'mund të mësohemi thujse më me asgjë, sepse ritmet e zëvendësimit të çdo teknologjie janë aq të shpejta, saqë s'arrijmë të ndihemi rehat me asnjë prej tyre e ta perceptojmë si të vjetër. Në të tillë kontekst (Cosenza, G., fq.24) e vetmja gjë mund të marrin për të mirëqenë kur flasim për mediat e reja, është bazimi i tyre tek teknologjitë informatike dhe fakti që për këtë motiv janë të dënuara “të jenë të reja” vazhdimisht.

Kështu, në një situatë të tillë, ku e reja është ngado dhe ndryshon gjithnjë e më shpesh, shpëtimi i semiologut janë modat mediatike të momentit (po aty), pra ajo që diskutohet kudo e ngado në një moment të dhënë, si rasti i Web 2.0 në 2004-n. Kështu, meqenëse perceptimi i së resë lidhet ngushtë në ditët e sotme me to, edhe reflektimi semiotik mund të mbështetet aty, për sa do të analizojë diskutimet dhe praktikatat më të përhapura në publikun e masave, në një kontekst të dhënë socio-kulturor, e në një moment historik të caktuar. Për këtë arsye, teksa flet për mediat e reja, semiologu e ka praktikisht të pamundur të mos konsultojë edhe periodikët, të përditshmet, të shohë emisionet televizive, vëzhgojë librat që nxjerrin vitrinave apo

sajteve të ndryshme shtëpitë botuese, të ndjekë gjurmët e fenomeneve që pushtojnë internetin: të gjitha janë tregues të çmuar të asaj që enciklopedia e përbashkët e konsideron si më të re, se vetë e reja.

Ç'është e vërteta, disa prej këtyre modave diktohen edhe prej strategjive tregtare të ndërmarrjeve të mëdha informatike, të tjera prej mjeteve të komunikimit masiv, e të tjera akoma nga praktika sociale që nisin së pari mes grupeve të vogla për t'u përhapur pastaj nëpër rrjet, rrugë që është në jetën e përditshme të gjithë secilit. Është pikërisht detyra e semiologut, të shquajë tipat e ndryshme të diskurseve në mediat e reja, e po ashtu të seleksionojë si objekte të vetat të studimit vetëm ato që shfaqen më kalimtare, krahasuar me ato më të rrënjosurat në praktikatat sociale të përhapura, proces që siç edhe e përkshkuam më sipër, nuk është aspak i lehtë, por jo i pamundur. Më poshtë do të sjellim disa prej zërave ku mund të fokusohet një semiolog teksa studion mediat e reja, e po ashtu, edhe disa prej mekanizmave të qëndrueshëm të kësaj qasjeje, të cilat e përballojnë më së miri këtë vorbull marramendëse të së resë, në ardhje e ikje të rrufeshme.

Mekanizma të leximit semiotik të mediave të reja

Në librin e vet *Hyrje në semiotikën e mediave të reja* (2014), studiuesja italiane Giovana Cosenza, ofron një sërë mekanizmash e metodologjish me të cilat mund t'i qasemi semiotikisht mediave të reja, të cilat, siç edhe do ta vëmë re, nuk ndryshojnë shumë nga mekanizmat dhe metodologjitë e studimit semiotik të tekstit, në mos po janë thujse të njëjtat. Sipas saj (fq.118), analiza semiotike e një sajti duhet nisur së pari prej identifikimit të *hapësirës së para-tekstit* dhe asaj të *përmbajtjeve*. Në *hapësirën e përmbajtjeve* sqaron ajo, bëjnë pjesë krejt tekstet verbale, imazhet e objektet multimediale që sajti do t'i paraqesë *përdoruesit model*, të cilat semiologu i analizon për të, për të kuptuar në lexohen, shfletohen, shihen apo dëgjohen, në janë audiovizivë e kështu me radhë. Prej kësaj hapësire, sqaron ajo, mund të ndërmerren më pas edhe një sërë veprimesh prej përdoruesëve empirikë, si blerjet online, prenotime të ndryshme, kërkime, seksione çati etj. Për ta pasur më të lehtë procesin e identifikimit të *hapësirës së përmbajtjes*, Cosenza i sugjeron semiologut të bëjë vazhdimisht pyetjen: *ç'dëshiron ky sajt që unë të lexoj/të më tregojë/dëgjoj?* dhe gjithçka që i përgjigjet kësaj pyetjeje, i përket ekskluzivisht hapësirës së përmbajtjes.

Siç edhe vihet re, shquhen një sërë konceptesh përdorur prej Umberto Eco-s gjatë analizës së teksteve letrare (Eco, U. *Lector in fabula*, 1985), vetëm se në vend të lexuesit model/empirik, në analizën semiotike të mediave të reja, kemi tashmë *përdoruesin model/empirik*.

Sa i përket *para-tekstit*, ky është një koncept i futur së pari prej gjuhëtarit e semiologut Gerard Genette (*Soglie. I dintorni del testo*, 1989), gjatë studimeve kryer në lëmin e letërsisë. Me këtë term ai shënonte gjithçka që i paraprinte tekstit të shkruar

dhe mundëson praninë e tij. Për analogji, edhe në analizën semiotike të sajtit, nën këtë term përfshihet gjithçka (*pulsantët, baret e komandat* e çdo tipi), që mundëson *tipin, numrin* dhe *rendin* e veprimeve të mundshme të shfletimit të sajtit dhe ndërveprimin me të, si leximin e materialeve, parjen apo dëgjimin e tyre, prej çdo përdoruesi empirik (po aty). Në studimin e vet, në para-tekstin e një sajti, Cosenza përfshin:

- a) *linqet strukturore apo mjetet e lundrimit*, organizuar ose në fashën horizontale që ndodhet sipër a poshtë, ose në atë vertikale në të majtë a në të djathtë;
- b) *linqet shoqëruese*, shpërndarë nëpër hapësirën e përmbajtjeve të sajtit (fjalë të nënvizuara, hapësira të ndjeshme imazhesh, video, tabela etj.)
- c) *linko-grafitë*, që janë listat e organizuara e të komentuara të linkut, me tekste nga më të fundit apo materiale të tjera mbi të njëjtin argument;

Duke e konsideruar sajtin si një tekst sinkretik (sipas semiotikës greimasiane), për shkak se përfshin një shumësi gjuhësh, që përbëhen nga sisteme semiotike artikuluar mbi dy substanca të shprehjes, vizive e tingullore, si dhe nga simulimi i mediave të tjera, të reja a të vjetra qofshin, Cosenza sqaron se përgjithësisht para-teksti i një sajti kombinon sistemet e mëposhtme semiotike:

1. *sistemin e gjuhës* (anglisht, frëngjisht, shqip etj.)
2. *sistemin e konvencioneve vizive* (të cilat në planin e shprehjes lejojnë të shquash nga njëra anë ku gjenden pikat e ndërhyrjes, dhe nga tjetra të dallos ku ndodhen potencialet virtuale, aktuale, të realizuara),
3. *sistemin e konvencioneve vizive*, (të cilat, në planin e shprehjes të lejojnë të shquash ikonat, baret, pulsantet e t'i lidhësh, në planin e përmbajtjes, me disa programe veprimesh dhe efektet e tyre),
4. *sistemin e konvencioneve akustike*, të cilat në planin e shprehjes të lejojnë të rinjohësh e në atë të përmbajtjes t'i japësh një funksion e kuptim tingujve që mund të aktivizohen hera-herës.

Dhe ashtu si për hapësirën e përmbajtjes, edhe për identifikimin e hapësirës së para-tekstit, ajo i sugjeron semiologut pyetje të tipit *ku jam? ku po shkoj? nga vij?* Gjithçka që u përgjigjet atyre pyetjeve, ndihmon në shquarjen e para-tekstit (fq.119-122)

Edhe analiza e *hapësirave të komunikimit* që para-teksti i sajtit vë në dispozicion duke përdorur metaforat e vizive, është tejet i rëndësishëm në analizën semiotike. Sipas Cosenza-s (po aty), s'duhen analizuar aspak metaforat e njohura (si pulsantët, koshat, lentet e zmadhimit), por sidomos ato që s'janë testuar ende mirë, për të parë koherencën e përdorshmërisë. Duke iu referuar konceptit semiotik të tekstit si marrëdhënie inter-tekstuale, ajo thekson se në analizën semiotike të një sajti, duhet analizuar gjithçka që dihet rreth tij: gjithë dijet e kompetencat për të cilat sajti pretendon të lexohet prej lexuesëve/përdorues të tij, në një hapësirë të

caktuar gjuhësore kulturore e në një moment të dhënë historik. Për të, kjo do të thotë *së pari* të verifikosh në ç'masë e si i ndjek sajti standardet web të lundrimit, organizimit dhe prezantimit të përmbajtjeve, *së dyti*, kërkon njohjen e mënyrës së veprimit, si dhe njohjen e konvecioneve tekstuale, para-tekstuale e inter-tekstuale, që ndihmojnë në dallimin e *llojit të webit*, të cilit sajti i përket (kjo e fundit mund të bëhet edhe krejtësisht në mënyrë empirike, sugjeron ajo, duke kërkuar në Google apo në ndonjë motor tjetër kërkimi, mbi numrin e sajteve që në panoramën ndërkombëtare e kombëtare u drejtohen të njëjtëve lexues (pyetja *për kë* që përmendëm më sipër), me të njëjtat objektiva (pyetja *për çfarë*), për bërjen e gjërave të ngjashme, në kontekste të ngjashme (pyetja *për ç'përmbajtjeje*).

Por ç'është *përdoruesi model* në këtë qasje semiotike ndaj sajtit? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, Cosenza i referohet atij procesi që në marketing quhet "profilizim dhe segmentim i targetit" e që bëhet, parimisht, përpara se një produkt apo shërbim të projektohet, realizohet dhe komunikohet. Në rast se një semiolog përfshihet në stafin e projektimit të një sajti, analiza semiotike e lexuesit/përdoruesit model, mund të integrohet mjaft dobishëm me metodologjitë e profilizimit dhe segmentimit të targetit të synuar, kurse në rastin kur analiza semiotike bëhet pasi krijimi i sajtit ka përfunduar, t'i përgjigjesh pyetjes *për kë?* nënvizon ajo, do të thotë të analizosh në detaj karakteristikat e lexuesit/përdorues model apo të shumësisë së lexuesëve/përdoruesve, siç është e udhës të ndodhë nëpër shumë sajte gjeneraliste, ku brenda një sajti mund të identifikojmë një sërë lexuesish/përdorues, si ata të lajmeve, ata që janë në kërkim të partnereve, fansat e rrymave të ndryshme muzikore etj.

Analiza e sistemeve semiotike, pra e konvencioneve të lundrimit nga njëra anë dhe ajo e kompetencave enciklopedike si dhe llojit mbi të cilin është ngritur sajti nga ana tjetër, përbëjnë kompetencat bazike mbi të cilat ky sajti ndërton lexuesit e vet modelë, duke na ndihmuar së pari të kuptojmë se si janë ngjizur ata. Pra gjithçka, seksi, moshë mesatare, gjendja civile, niveli i formimit, prejardhja gjeografike, etnia, gjuha, kompetenca e përdorimit të kompjuterit, tabletave, smartfonave, zakonet lundrimit, familjariteti me lloje të tjera në web e të tjera media, dëshirat e vlerat në bazë të së cilave kryen veprimet dhe sjelljet online të lexuesit/përdorues model, nevojiten të dihen prej semiologut, për t'iu përgjigjur pyetjes "për kë".

Gjasat janë që nëse analiza semiotike aplikohet mbi një sajti të bërë, përdoruesi model i rindërtuar prej semiologut në bazë të gjurmëve gjendur në sajti, mund të jetë i ndryshëm nga ai i presupozuari. Ndërkaq, për t'iu përgjigjur pyetjeve *për çfarë* e *për cilin kontekst*, Cosenza thotë se nevojitet organizimi i përshkrimeve të veprimeve dhe ai i hierarkive të veprimeve, duke përdorur strukturat narrative të Greimas-it, të cilat lejojnë skematizimin e veprimeve në programe narrative: qysh prej atyre xhestuale që kryhen në ndërfaqen e sajtit, tek tërësia e atyre që përhapen në ambientin përreth, pasi kemi kryer një veprim të caktuar mbi këtë inter-faqe.

E nëse do të duam të thellohem më tej në analizën tonë semiotike, thotë Cosenza, atëherë pyetja e radhës do të jetë se *ç'vlera* mëton sajti tek përdoruesi

i vet model, *ç'dëshira* merr për të mirëqena e cilat do të ngjallë tek lexuesit e vet i parapëlqyer, për të vazhduar më pas me pyetjen se *ç'vlera ndjekin në realitet përdoruesit empirikë, ç'dëshira përjetojnë teksa lundrojnë në sajti?*

Për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve, sqaron kjo studiuese, mund të përdoren më së miri disa prej instrumenteve tipike të kërkimit kualitativ: vëzhgim i drejtpërdrejtë, intervista të strukturuar, gjysmë të strukturuar ose të pastrukturuar, pyetësorë, fokus grupe etj. Dhe vetëm duke i krahasuar veprim për veprim, objektiv për objektiv, histori për histori vlerat dhe dëshirat e presupozuara dhe ndërtuara nga sajti nga njëra anë, me vlerat që përdoruesit gjejnë në të vërtetë nga ana tjetër, mund të nisim të kuptojmë nëse sajti është jo vetëm i kuptueshëm, por edhe nëse është interesant e i dobishëm, pra a ia vlen barra qiranë për këtë përdorues empirik që ta shënjojë për t'ju rikthyer sërish apo të mjaftohet veç me një herë.

Por nëse deri në këtë pikë gjithçka u vërtit rreth lexuesit/përdoruesit model e empirik (pra njërit prej zërave më të rëndësishëm të marrëdhënies semiotike të leximit, nuk ka sesi të mungojë edhe elementi tjetër, *autorin model/empirik*, nisur prej të cilit semiologu i mediave të reja mund t'u qaset atyre për një analizë semiotike. Duke iu referuar sërish trashëgimisë semiotike të Umberto Eco-s (1979, 1994), sipas së cilit figura e formuluesit (*enunciatorit*) është *autori model* i tekstit, kurse figura e përdoruesit është lexuesi model, Cosenza përpiqet të identifikojë gjithë gjurmët që krijuesi empirik i sajtit lë mbi sipërfaqen e tekstit, i cili nga ana e vet krijon një të tërë të organizuar, me gjurmë apo shenja që simulojnë vetë atë. Sipas saj, analiza e kësaj tërësie të organizuar gjurmësh, është tejet e rëndësishme në një sajti web për motive të ndryshme, por mbi të gjitha për të rindërtuar autorin model të sajtit, pra imazhin që autori empirik jep përmes tij, si dhe për ta krahasuar me *imazhin e tij* me atë empirik, i cili rezulton nga tërësia e teksteve në sajti. Analiza e strategjive formuluese është e gjithashtu e rëndësishme, sepse shquan mënyrën me të cilën autori model i sajtit vendos marrëdhënien me lexuesin/përdoruesin model, duke kontribuar në finale për karakterizimin e kësaj figureje kyçe për çdo projektim web-i. Teksa u referohet një sërë studiuesve të tjerë të fushës si Maria Pia Pozzato (1994), Veron-it (1984), Fisher e Veron (1986), Marmo (2003) ajo sjell përmbledhtazi në tekst pesë mënyra thelbësore përmes së cilave formuluesi i një sajti mund të krijojë/vendosë marrëdhënie me lexuesin/përdoruesin e vet.

E para, është *distanca e papërcaktuar*: formuluesi i web-it flet për veten në vetë të tretë, duke iu referuar po në vetë të tretë edhe lexuesëve/përdoruesëve të vet. Për shembull: “Fiati u ofron klientëve të vet avantazhe të panumërta”.

E dyta, është *distanca institucionale*: formuluesi flet në vetë të parë njëjës ose në shumës, duke përdorur “ne”-në ekskluzive, pa u bërë apel të drejtpërdrejtë lexuesëve/përdoruesëve të vet, por duke iu drejtuar atyre në mënyrë implicite, përmes vetës së tretë. Shembull: “Vetëm ne të Ikeas i krijojmë klientelës sonë një hapësirë për fëmijët”.

E treta, renditet *distanca pedagogjike*: formuluesi flet në vetë të parë njëjës ose shumës, po me “ne” në ekskluzive, dhe u bën apel të drejtpërdrejtë lexuesëve/përdoruesëve të vet duke përdorur vetën e dytë njëjës a shumës. Shembull: “Ne të ndihmojmë se cila kafë është e rëndësishme për ditën tënde”

Katër, duke u shkelur syrin: lexuesit/përdoruesit i bëhet thirrje drejtpërsëdrejti përmes vetës së dytë njëjës ose shumës, prej një formuluesi që qëndron i brendshëm dhe shfaqet objektivisht përmes vetës së tretë. “Barilla është me ty”.

Pesë, *bashkëpunimi*: formuluesi e përfshin mjaft ngushtë edhe lexuesin/përdoruesin, duke përdorur ose “ne” në ekskluzive, ose vetën e parë që përfaqëson zërin e lexuesit/përdoruesit e jo të formuluesit, a thua se ky i fundit heq dorë e në vend të tij flet i pari. Shembull: “Së bashku do bëjmë gjëra të mëdha” apo “Ndërmarrja ime”.

Por analiza semiotike e një sajti nuk përfundon aspak këtu. Pas identifikimit të hapësirës së përmbajtjes, së para-tekstit, identifikimit të lexuesit model apo atij empirik, analizës së autorit model e atij empirik, një tjetër pikë e kësaj analize është edhe ajo e sajtit si hapësirë vizive, të cilin Cosenza e sugjeron vetëm në fund, pasi të jenë analizuar gjithë sa thamë më sipër. Kjo lloj analize e sheh sajtin mirëfilli si hapësirë vizive (pra krejt grafikët dhe imazhet që inter-faqja shfaq), për të kuptuar nëse zgjedhjet grafike e vizive komunikojnë atë për të cilin sajti është krijuar. Për një qasje të tillë thotë ajo mund të përdoren më së miri gjithë mjetet e semiotikës vizive, plastike e figurative.

Pikërisht në këtë pikë mund të vlerësojmë edhe koherencën e një sajti, e cila është edhe zëri i fundit i analizës semiotike në fjalë. Ashtu si në çdo tekst, edhe në qasjen semiotike për të cilën po flasim, një gjë të tillë mund ta bëjmë përmes *izotopive semantike* (tepricës së disa treguesve në një tekst, që mund të jenë *njësi të vetme semantike* apo *çifte të njëjësve semantike*, të kundërta apo kontradiktore). Kërkimi i izotopive lidhet me gjithë pasazhet analitike të renditura deri më tani: sistemet e ndryshme semiotike që sajti përfshin, mediat që simulon, përmbajtjet e teksteve të shkruara, proceset narrative të veprimeve që propozon, vlerat dhe dëshirat që presupozon se nxit/ngjall tek lexuesi model, imazhin e autorit model, mënyrën me të cilën ky i fundit përcakton marrëdhënien e tij me lexuesin model, e në fund grafika dhe elementët plastiko-figurativë të sajtit.

Konkluzione

Analiza semiotike e mediave të reja është një proces më i ndërlikuar se sa analiza e mediave klasike, kjo për vetë natyrën e tyre, e cila është në ndryshim të vazhdueshëm. Gjithsesi, pavarësisht vështirësive, janë një sërë konceptesh që mund

të aplikohen për këtë lloj analize, të cilat i gjejmë të përdorura gjerësisht edhe në analizën semiotike të teksteve letrare. Kjo lloj analize nisët fillimisht nga ajo çka ne shohim në sipërfaqen e ekranit të kompjuterit, smartfonit etj., (*para-tekstit dhe përmbajtja*), për të mbërritur në thellësi, tek vlerat apo dëshirat që kërkon të kënaqë/nxisë tek përdoruesit e vet, pa përjashtuar përmes saj edhe identifikimin e tipit/llojit të përdoruesit e autorit model e empirik, po ashtu analizimin e hapësirës vizive apo nivelin e koherencës së përdorur. Përdorimin e vet më të gjerë, një analizë e tillë, mund ta gjejë më së miri edhe në projektimin e sajteve të ndryshme, ku përmes elementëve të kërkuar, të ofrojë/sugjerojë ide e mënyra për sigurimin e sa më shumë lexuesëve modelë të mundshëm.

Bibliografi

- Bignell, Jonathan. (1997; 2000). *Media Semiotics: An Introduction*, Manchester University Press: Manchester, botimi i dytë.
- Cosenza, Giovanna. (2014). *Introduzione alla semiotica delle nuovi media*. Editori Laterza: Roma.
- Cosenza, Giovanna. (2008). *Semiotica delle nuovi media*, Editori Laterza: Roma.
- Cobley, Paul & Jansz, Lisa. (2012) *Semiotics*. Icon Books Ltd: USA.
- Eco, U. 1964. *Apocalitici e integrati. Comunicazioni di masa e teorie della cultura di masa*. Bompiani: Milano.
- Eco, U. (1984). *Tratatto di semiotica generale*. Bompiani: Milano.
- Eco, U. (1994). *Sei pasegiate nei boschi narrativi*. Bompiani: Milano.
- Eco, U. (1985). *Lector in fabula*, Milano: Bompiani.
- Genette, G. (1989). *Soglie. I dintorni del testo*, Einaudi, Torino. (titulli original: *Seuils, Editions du Seuils*, Paris, 1987).
- Sartori, G. (1997) *Homovidens, televisione e postpensiero*. Edizioni Laterza: Roma.
- Sartori, L. (2006). *Il divario dixhitale*. Mulino: Bologna.
- Meroyvitz, J. (1986). *No sense of place. The impact of electronic media on social behavior*. Oxford University Press: Oxford.

RECENCË

Recencë e monografisë së Prof. Dr. Fatos Tarifa: “Hakmarrja është imja; Morfologjia sociale dhe Gramatika morale e Gjakmarrjes” Tiranë: Onufri, 2014 _____

_____ *Prof. Dr. Aleksandër Dhima*¹ _____

Eprita me kënaqësi të veçantë botimin e punimit të fundit monografik të prof. Fatos Tarifës mbi një plagë të kahershme shoqërore të shqiptarëve, si dukuria e *gjakmarrjes*. Tema e shtjelluar në të ka rëndësi, mbi të gjitha, në pikëpamje të metodës së kërkimit, sepse ajo e tejkalon në princip “mbylljen” në korniza të paracaktuara të kërkimit, përkitazi me mjete të një shkence të vetme, qoftë kjo e zbatuar edhe në rrafsh kombëtar. Shtyllat, në të cilat mbështetet studimi, janë: *e drejta kanunore* mbi *gjakmarrjen* dhe *strukturimi social* që lidhet me të dhe që imponon një impakt të anasjelltë. Në plotësim të kësaj strukture të tekstit vjen këndvështrimi i autorit mbi mundësitë reale të ndërhyrjes së *të drejtës shtetërore* mbi *normat kanunore*, të mësura e të zbatuara kolektivisht në marrëdhëniet gjinore, martesore e familjare në rrjedhë të shekujve.

Me tagrin e një antropologu, do të ndalem në këtë trajtesë në disa momente që mendoj se mund të nxjerrin më mirë në pah ndihmesën e vyer të autorit në kërkime të kësaj natyre, sa të ndërlikuar aq edhe me përgjegjshmëri për prognozën socio-kulturore, pse jo edhe institucionale, të një dukurie të tillë si *gjakmarrja*, shpjegimit socio-antropologjik të së cilës i janë kushtuar breza të tërë studiuesish. Sa për

¹ Lektor i lëndëve të *Antropologjisë social-kulturore* në UET.

fillim, dëshiroj të theksoj se kjo vepër e trajton problemin e *gjakmarrjes* në plan shumëdimensional, çka i jep asaj “certifikatën” e një studimi të karakterit *holistik*, që rrallëherë (dhe duhet thënë: për fatin tonë jo të mbarë) haset në shkencat tona humane bashkëkohore.

“*Hakmarrja është imja*” përbën një ngrehinë shkencore të rëndësishme mbi të *Drejtën zakonore*, ku gjen “strehën” e tij të natyrshme institucioni i *gjakmarrjes*, sa irracional aq edhe i njëmendët, pra i natyrshëm për kushtet historike lokale, në të cilat kanë qenë të detyruar të (mbi) jetojnë banorët e malësive të thella të veriut të Shqipërisë.

Antropologët socialë, pak më ndryshe nga sociologët e mirëfilltë, e konsiderojnë *gjakmarrjen* vërtet si një dukuri tipike të shoqërive para-moderne, të organizuara mbi baza fisnore (çka përbën një objekt studimi parësor edhe për ta), por gjithashtu si një *proces* që zgjat në kohë dhe ngulet në mentalitetin e brezave pasardhës si “strukturë e ngurtësuar” dhe e mirë kodifikuar, deri sa vjen në kohën e sotme si një *dukuri e kristalizuar* që nuk mund të “shkulet” thjesht me imponimin e ligjit, si forma më e lartë e kontrollit social, dhe që vazhdon të marrë jetë njerëzish, duke tronditur në një masë të caktuar *kohezionin social*.

Gjakmarrja është, mbi të gjitha, një dukuri specifike që lidhet me praninë e përhershme të një procesi të stërzgatur të “të qenit gjallë” (angl.: *being*), që synon të përcjellë tek e fundit “fjalë për fjalë” mënyrën se si një burrë (sepse gjakësi/viktima kanë qenë kurdoherë meshkuj) ndërvepron kulturalisht me anëtarët e mjedisit shoqëror përreth tij. Kjo ka qenë arsye madhore pse një mashkull i *fisit*, që tutet të vrasë gjakësin (për motive të natyrave të ndryshme) e ka të pamundur t’i kundërvihet opinionit shoqëror të komunitetit ku bën pjesë, për shkak të sanksioneve të rrepta që e presin nga strukturat penalizuese që sigurojnë *nderin* e familjes ose *pronën* e një *personi në gjak* (R. Elsie, *A Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture*, 2001). Sidoqoftë, pjesa më e madhe e vrasjeve për *gjakmarrje* e kanë prejardhjen, si kundërpërgjigje, nga një vrasje paraprake e palës “kundërshtare”.

Pavarësisht se ligjet zakonore e kanë hiperbolizuar “vrasësin e parë”, praktika lokale duket se bie shpesh herë në kundërshtim me tekstin e *Kanunit*, përderisa vlerësimet etnografike dhe historike e bëjnë të qartë që “poli” aktual i shënjestrës potenciale lejohet të shtrihet ndaj çdo mashkulli që ka lidhje gjaku me vrasësin, në emër të të ashtuquajturit “shpagim social” (R.C. Kelly, *Warless Societies and the Origin of War*, 2000).

Në një farë mënyre, kufizimi i vrasjeve për shkak të *gjakmarrjes* në kohën e sotme (përtej spekulimeve të shoqatave fantazmë) pasqyron ndryshimet kulturore që kanë ndodhur në *diskursin* e domethënies së *nderit*, në kuptimin se çfarë nuk po “urdhëron” dot *strukture* dikur e plotfuqishme, duke marrë parasysh natyrën e çdo *gjakmarrjeje*, pa iu referuar detyrimisht rastit të saj primordial. Kjo do të thotë që grupet malësore në fjalë janë adaptuar tashmë më tepër ndaj rrethanave të reja

sociale se sa të vazhdonin t’i mbeteshin strikt traditës tekstuale të *Kanunit* (S. Schwandner-Sievers, *The Enactment of Tradition*, 2001).

Në kapitujt që lidhen me *universin zakonor* (praktikisht pjesë të konstruktit vleror) të shqiptarëve të Veriut, më tej me shtrirjen territoriale të *shoqërisë fisnore* si dhe me motivet, rregullat dhe ritualin e *gjakmarrjes*, shumica e argumenteve të sjella në punim nuk përbëjnë ndonjë “zbulim” të ri për shkencat albanologjike, sepse këta indikatorë kulturorë e socialë janë trajtuar në vepra dhe artikuj të panumërt nga autorë shqiptarë dhe të huaj madje, jehona e tyre ka mbërritur deri në Japoninë e largët, falë trajtesave të Jamamotos! (K. Yamamoto, *The Origin of Ethic and Social Order in a Society without State Power*, 1999). Por, merita e prof. Tarifës qëndron në faktin se të gjitha këto nozologji- përtej burimit të legjitimitetit dhe shkallës së autoritetit të tyre- ai i ngërthen në një tërësi të përbashkët, duke i dhënë akses mundësisë për të zbuluar “*tokën e së kaluarës ende të gjallë*”, sipas shprehjes së Edith Durhamit. Dhe, me këtë, autori na “grish” të gjithëve për t’i hyrë më thellë studimit të *praktikave zakonore të komunitetit* që janë realizuar përmes njohjes dhe pranimi të përbashkët të tyre.

Në këtë vepër, më tërhoqi vëmendjen kundërthënia e karakterit dihotomik se “*Kanuni ka karakter sekular, por është njëkohësisht i shenjtë*” (f.80). Natyrisht, autoriteti i *Kanunit* ishte i padiskutueshëm, si “vendosës i rendit në një shoqëri pa rend”, pra, si pasojë, edhe i plotfuqishëm, si për malësorët e krishterë, ashtu edhe për ata myslimanë. Por këto dy prerogativa s’mund të shpjegojnë plotësisht “shenjtërinë” e tij, aq më pak ato s’mund të përligjen thjesht me faktin se *Kanuni i maleve shqiptare* rezulton “mjaftueshmërisht i ngjashëm me sistemet perëndimore”. Këtë “ngërç” autori kërkon ta zgjidhë me faktin se *Kanuni* kishte një autoritet më të madh se sa të dyja fetë kryesore në Shqipëri, duke iu referuar Edith Durhamit. Kjo mund të rezultojë pjesërisht e vërtetë, po të kemi parasysh se edhe në ditët e sotme dëgjojmë të vriten njerëz “në emër të Kanunit”, jo vetëm ndër banorët e trevave katolike, si *Malësia* dhe *Dukagjini* (ku pretendohet se *Kanuni* gjallon ende në memorien kolektive), por edhe në Kukës, Dibër, Mat etj., ku banorët i takojnë më së shumti fesë myslimane. Megjithatë, kjo ende nuk mjafton për të përligjur “shenjtërinë” e *Kanunit* (p.sh. si te shprehja “Leka e ka thân”, sipas modelit të librave të shenjta), aq më tepër që autori sjell dëshmi të gjalla nga etnologët e huaj për të vërtetuar pragmatizmin e shqiptarëve në çështje të fesë dhe mungesën e fanatizmit fetar ndër ta.

Më origjinale më duket ideja e prof. Tarifës se *Kanuni* ishte një “*kushtetutë*”, një *ligj themelor*, të cilit i bindeshin në mënyrë të padiskutueshme të gjithë banorët e zonave ku ai aplikohet” (f.87-88). Në këtë funksion dhe me të njëjtën forcë detyruese, ai ka shërbyer vërtet si një instrument i fuqishëm për të krijuar mënyra sjelljeje rigorozisht të përcaktuara, duke u bërë përgjithësisht pengesë për ndryshime të shpejta sociale dhe kulturore në një shoqëri, anëtarët e së cilës “*mësoheshin qysh në fëmijëri që të besonin në autoritetin e tij të pagabueshëm*” (f. 89).

Në kapitujt që lidhen me *stukturën e shoqërisë fisnore shqiptare* trajtohen çështje që gjithashtu janë mjaft të njohura për publikun shkencor vendas, aq më tepër për antropologët social-kulturore, pavarësisht se autori ka shfrytëzuar për këtë qëllim kryesisht ndihmesën e figurave të huaja, historike apo bashkëkohore, si M. E. Durham, F. Nopcsa, C. S. Coon, M. Sahlins, A. Young etj. Megjithatë, më duhet të pohoj se autori, si askush më parë, ka qenë jo vetëm racional në vjeljen dhe përshkrimin e të dhënave të autorëve të mëparshëm, por mbi të gjitha ky racionalitet i ka shërbyer atij për të shpalosur në vazhdim mendimin e tij mbi *kufijtë socialë të gjinisë* në kontekstin e së *Drejtës zakonore*, mbështetur kryesisht në *teorinë e shkëmbimit shoqëror*: “*Supozimi se gjinia mund të zgjidhet ose të modifikohet nga individit duket se nuk është thjesht ose vetëm një produkt i Perëndimit tolerant dhe multikulturor*” (f.198).

Nuk besoj se një rekomandim i mundshëm për zbatimin rigoroz të *ligjit* kundër praktikës së *gjakmarrjes* në vend do të zinte vend në trajtimin e një teme të tillë delikate. Po t’i referohemi legjislacionit të kohës së regjimit komunist, ai solli për hir të së vërtetës rezultate pozitive edhe në këtë drejtim, në kuadrin e “luftës kundër zakoneve prapanike”. Këto arritje pozitive, autori duket se i ka pasur parasysh kur i transpozoi në të sotmen: “*Në kushtet e një sistemi politik, juridik, ekonomik e shoqëror krejt të ndryshëm nga ai fisnor e patriarkal i së kaluarës, vrasjet “për gjakmarrje” sot nuk mund të motivohen, as të justifikohen mbi bazën e një të drejte zakonore, kodi dhe procedurat penale të së cilës janë nxjerrë jashtë funksionit, madje janë shpallur të paligjshme*” (f.258). Por, si mund të shpjegohet fakti që, pikërisht mbas “hapjes” së vendit ndaj botës së qytetëruar në vitet ‘90, shqiptarët e trevave të Veriut iu “rikthyen” kësaj praktike tradicionale, pa pritur ndonjë “ndërhyrje” të pushtetit të ri demokratik? Një analizë e thelluar, e dokumentuar me fakte sociologjike dhe antropologjiko-kulturore, e kësaj dukurie të re mbetet një sfidë e hapur për të gjithë studiuesit e sotëm të shkencave sociale.

Së fundi dua të shpreh admirimin tim për guximin e prof. Tarifës për të “ndërhyrë” në një lëmi të tillë, si e *Drejtës zakonore*, që nuk i përket domenit të një sociologu klasik. Sidoqoftë, kundërshtitë e tij ndaj opinionit të autoriteteve shkencore vendase në fushë të *antropologjisë së ligjit*, si prof. Nebi Bardhoshi, në çështje që lidhen me marrëdhëniet mes *ligjit* dhe shoqërisë, si p.sh. për *prerjen e besës* (f.74), për *sistemin e socializimit shtetëror* (f.114), për *natyrën egalitariste të shoqërisë patriarkale shqiptare* (f.148), për *familjen patrilinare* (f.163), për *legjitimitetin e njeriut të Kanunit* (f.245–246) apo për konceptin e *cultural survivalism* (f.258), janë të mirëpritura dhe meritojnë debat të mëtejshëm. Faktet logjike janë parashtruar qartë në vepër dhe mund të kundërshtohen, po qenë të arsyeshme, të mbështetura në fakte plotësuese nga terreni dhe nga përvoja e blatur në memorien kolektive të popullit. Jo më kot, autori i ka dhënë titullit një kuptim simbolik: “*hakmarrja*” [nënkupton gjithashtu *gjakmarrjen*] është *imja*, d.m.th. e *jona*, sepse kjo është një “simbolikë universale e gjakut”, sipas shprehjes së thukët të prof. Tarifës, ajo është blatur në rrjedhat

historike dhe sendërtuar në *tabu-të* kulturore të malësorëve shqiptarë.

Sipas meje, tre janë kumtet shkencore më të rëndësishme që përcjell ky punim me vlerë:

1. *Domosdoja e një bazamenti të shëndoshë teorik*. “Filli” që përshkon veprën ka fund e krye karakter teorik. Analiza e modeleve sociologjike dhe antropologjiko-kulturore, në bashkëlidhje me shqyrtimin objektiv të fakteve historike dhe atyre të natyrës narrative kanë siguruar suksesin e një pune të tillë shumë përmasore, e cila mban vulën e një metodologjie bashkëkohore në trajtimin e dukurive me natyrë të mprehtë sociale. Veprës i shtohen vlerat përmes ekzaminimit kritik nga ana e autorit të disa prej teorive dhe interpretimeve të derisotme mbi *gjakmarrjen* në trevat e Shqipërisë së veriut (f. 199–230).

2. Për *gjakmarrjen* dhe përligjien e saj institucionale në të *Drejtën zakonore* (në mënyrën më të plotë të *Kanuni i Lekës*) është shkruar mjaft prej autorëve vendas dhe të huaj, por ata e kanë vështuar këtë dukuri dhe pasojat e saj “natyrore” janë mbështetur kryesisht në narrativën kulturore të malësorëve, në analizën tekstore të *Kanunit* dhe në kriteret e etnografisë klasike një planëshe. Ndryshe nga ta, prof. Tarifa e shtjellon *gjakmarrjen* si një *dukuri sociologjike e njëkohësisht kulturore* mbi bazën e *teorisë funksionaliste*. Me ndihmën e kësaj teorie, përmes parimit të *reciprocitetit*, autori rreket të shpjegojë mekanizmin që e ka mbajtur gjallë në shekuj zakonin e *gjakmarrjes*, si një mekanizëm për ruajtjen e *stabilitetit* të atij sistemi shoqëror që e krijoi (f.259).

3. Një tjetër përparësi të studimit përbën mendimi i autorit, mbështetur në *relativizmin kulturor*, se, përkundër *normave* që rregullojnë (*hak*) *gjakmarrjen*, që janë shumë të ngjashme nga njëri popull te tjetri, duhet të studiohen edhe shprehjet/ nuancat lokale të kësaj dukurie universale, për të kuptuar më mirë zhvillimin historik e kulturor të një shoqërie të dhënë (f.21), në rastin konkret të trevave të mëdha etno-kulturore në veri të vendit, si *Malësia* dhe *Dukagjini*.

Librit ia shtojnë vlerën komentet e kolegëve të huaj, miq të vjetër të autorit, si prof. Judith Blau nga Universiteti i Karolinës Veriore në Chapel Hill, Rory J. Conces nga Universiteti i Nebraskës në Omaha dhe prof. Karen P. Sinclair nga Universiteti i Miçiganit Lindor në SHBA. S’mund të lihet pa përmendur gjithashtu shfrytëzimi i një literature të bollshme nga fusha të ndryshme të shkencave humane, si sociologjia, antropologjia, etnografia, shkencat e ligjit, psikologjia etj.

Me këtë libër, prof. Tarifa dëshmon një formim të spikatur poliedrik. Ndaj dëshiroj ta falënderoj për këtë vepër të re që na takon të gjithëve ta vlerësojmë. Ajo është shkruar mjaft mirë dhe qartë, me përgjegjësi shkencore dhe intelektuale, me idenë për të ndriçuar sa të jetë e mundur aspekte të rëndësishme të vlerave dhe të përmbajtjes shoqërore të *gjakmarrjes*, të sanksionuara në të *Drejtën kanunore*.

Polarization without radicalization: Political radicalization in Albania, comparative approach

Blendi Kajsii, PhD

Since the collapse of communism, political radicalism has been an important part of the political scene in Europe. The 2008 financial crisis furthered this trend, giving rise to new waves of radicalization. Albania appears to be a curious exception to this trend. Unlike most other countries in Eastern Europe there have been no successful radical parties in Albania since the collapse of communism in 1991. In the same fashion, social protests in Albania in recent years have been fleeting and far less radical than other protest movements in other countries in the region (Bulgaria, Greece and Turkey). This article argues that the relative lack of political radicalization in Albania is due to its traumatic communist past combined with a high level of bipolarization. The bitter experience with national-communism reduced the attractiveness of both far right and far left discourses in Albania. The high levels of political bipolarization, on the otherhand, divided the Albanian political sphere into two antagonistic camps. Such a deep division subsumed other possible cleavages.

The Constant Discourse of Albanian Abnormality in Time Magazine (1923-2013)

Dr. Belina Budini

The main argument of this paper focused on the western media representations of Albania, is that the subject of Albania is constructed and represented in a constant pathway between the years 1923-2013 and also during the years of transition. Time Magazine sets out as a case study on this regard. The object of study is systematically researched and investigated building on the media content analysis and the analysis of the media agency *per se*. With regard to the content analysis, the quantitative data show that the place and space given to the subject of Albania in rubrics, topics, frequency and angles of coverage are constant over time. The textual analysis in qualitative terms speaks of similar textual constructions and representations from one period of study to the other. The dominant discourse is that of an Albanian abnormality combined with the broader discourse of the American Superiority. A range of consistent media frames and repetitive topics have been identified, surpassing the historical time lag. Such a similarity is found in the journalistic writing and the language used to speak about the subject of Albania in the articles of Time Magazine in terms of synonymy, epithets, metaphors, key words and phrases.

Key words: Western Press Representations of Albania; International Report, Time Magazine, Discourse of Albanian Abnormality, Media Construction of Foreign News

Cognitive Interaction Between Media and Politics in the Cultural Context of Albania Today

Prof. Dr. Aleksandër Dhima

This article tries to assess some of the absences of the Albanian medial reality related with the political meaning, giving some ideas and recommendations on how to improve the image in this field. In this paper we are going to deal with some theoretical and practical issues that have to do with the essential elements of the political communication and with the gap of communitarian communication in the Albanian cultural reality. Through an anthropological analysis of the actual performance of the political actors, this study tries to make a connection between cultural “cut” and the so called transparent “regime” of the political message publicity, especially during electoral campaigns. It also tries to see if there are any real chances for an effective change in the connection between media and politics and if so which are those mechanisms that can guarantee such a change. The findings might serve as methodological basis for explaining the actual state of relationship between media and politics

Key words: political communication, political actors’ communication, political message publicity

Cultural Policies and folklorist studies in communist Albania

____ *Corina Iosif Sîrbu, PhD* _____

____ *Inis Shkreli, PhD* _____

Even nowadays, folklorist studies compound one of the main disciplines in the post-communist countries. From a historical point of view, this is related with the process of national state building and as a consequence the study of folklore is instrumentalized and improved from the communist power to build its own strategy. Folkloric studies and traditional music especially, were taught in schools and universities as part of national culture. The way how are perceived and constructed these books emphasizes the idea of folklore as an ideological and political structure. We could say that the lessons of traditional music have influenced the culture of masses that was developed after the fall of communism. This article studies the period of communism when knowledge on folklore was instrumentalized in favor of the national state building.

Key words: cultural politics, academic curricula, folklore, communism and national –communism

The role of Political Public Relations in the Promotion of The Albanian Government

____ *Lorena Liçenji, PhD* _____

After 2013 the Albanian government has used different techniques and instruments of Public Relation as an attempt to create a positive image within and outside the country. This paper tries to assess the role that PR has played in improving the image of Albania in the eyes of the EU and to identify the communication strategies that were used by the Prime minister. Who were the selected audience and which techniques were used to transmit a positive image in the international arena? Through the identification of these techniques we will analyze the efficacy of these strategies and see if they have played any role in promoting a better image of Albania. The main hypothesis is that the application of public relation strategies and techniques has positively influence the image of Albania in the international arena. Based on the analysis of the communicative strategies used by the Prime minister during the foreign TV stations programs in which he has been invited during the last year. Some of the programs taken for analysis are “Conflict zone”, “Agora”, “France 24”, “the Convent of New Industrialists” and “Invasioni Barbariche”. Combining qualitative methods with a detailed theoretical framework on political public relation, we are going to identify key words that were used to describe Albania and the way how was communicated the main objective of this campaign.

Key words: Public relations, communication strategies, political communication, managing reputation.

The Evolution of Conflicts and the new paradigm of war generation _____

_____ *Prof. Dr. Kristaq Xharo* _____

The fourth generation warfare is obviously one of the most debated theories in several books and studies. It is based on conflicts, preferred by non –state actors and is characterized by a mixture of war and politics, military army and civil, issues of peace, conflict and security processes. 4GW was first introduced by the military historian William Lind, in 1989 and it is considered as one of the “greatest ideas “or “greatest forecasts” in the contemporary strategic discourse. It has two main perspectives. Firstly, according to this theory creates a distance with the legacy of the Klausewitz’s doctrine on “War trinity” that limits the war discourse within states, which seems not to be identifying for the modern conflicts. The second perspective lies on the idea that states with their well-trained army to fight conventionally among states are going to be challenges by this new paradigm.

Even though it did not earn that much of attention, this theory has gained some relevance after the assaults in 11th September. States have failed in preventing and later on winning the conflict and non-national actors, including terrorist groups are still active. Being faced with such a situation, our country is vulnerable to possible attacks and methods appeared in 4GW. Security structures are still organized based on the concept of confrontation and victory among states. In these conditions, security structures have to get acquainted with a new war scheme and attitude, as a precaution for the future.

Key word: 4GW, security, terrorism, strategy evolution

Public Opinion and the Spiral of Silence _____

_____ *Prof. Elisabeth Noelle-Neumann* _____

The spiral of silence theory, proposed by the communication professor Elisabeth Noelle-Neumann, is one of the most prominent theories on public opinion. It explains the outgrowing of public opinion, referring to the increasing pressure that people feel to hide their perspectives because they fear being a minority. This material is taken by the book of Em Griffin, “A first look at Communication Theory, 7th edition. As the last edition of this book, translated already in Albanian, did not include this theory, we thought to bring this material for interested readers and researchers. This theory can have valuable application in several studies, especially those dealing with political communication, public opinion and sociology of communication, in the Albanian context where silence is often shaped as a spiral, reserving surprises for politicians, media and the audience.

Definers of traditional foreign policies of Turkey _____

_____ *Blendi Lami (Dokt.)* _____

We use many concepts to relate with Turkey's traditional foreign politics such as conservatism, protectionism, isolation, power balances etc. Based on a qualitative method- discourse analysis- operationalizing the concepts of status quo and westernization, this article analyses the traditional foreign politics of Turkey, which traditionally is based on "preserving the regime" and "applying a western oriented politics in foreign affairs". Some of the research questions are: what do we understand with traditional resources and how have they defined foreign politics? Which is the geopolitical positioning of Turkey in the region and globally? Till the end of the Cold war, Turkey had a rigid geopolitical tradition because during that period it played the role of "army" to prevent the further Russian expansionism towards the western countries.

Key words: status quo, westernization, Kemalist's reform, static paradigm, soviet prevention

National Culture vs Universal Culture _____

_____ *Bashkim Shehu* _____

This essay deals with the concepts of national and universal culture by comparing the schemata of empirical social sciences research with the Kantian approach, as a more illuminist and individualist perspective. The culture as a national concept borrows from the universal modern culture characterized by diversity and the dynamism of a continual change. Through being opened from within, such a culture is opened to the outside world as well. This brings to the idea of a universal culture. For example, the national culture comprises the work of foreign authors translated in the language of that culture and the national literature of a country should comprise translated master pieces. The author of this essay is critical to an ethnicist conception of culture.

Key words: Culture, collective identity, individual diversity, nation, universal values, ethnic community, Albania, Spain

Me, the other and all the others __________ *Gilman Bakalli* _____

People as social primates unite in groups and social networks. Through communication they separate who is part of the group and who cannot be part of it. Members of a group use different assessing criteria from other groups and that's why some problems are better perceived by us than others because we don't not consider them as ours. The reactions of some Albanian social groups about the terrible events that took place in France in November 2015 were emotionally stronger in comparison to the continuous assaults in Syria. This article tries to understand the reasons that stand behind such a differentiated perception and the sensitivity of these groups' members and other social group in relationship with each other.

Key words: the other, empathy, altruism, moral, the categorical imperative, collaboration, the stranger

*Review of the text book of
Giovanna Cosenza: "Introduction
to the semiotics of new media",
Editions Laterza, Romë, 2014* _____

_____ *Albana Nexhipi, Msc* _____

The semiotic reading of new media today represents an interesting challenge due to their changing nature. Said this, researchers are always adapting their conceptual study structure, what makes difficult the process of analysis. Which are those mechanisms that can facilitate their semiotic reading and how can we use them? This article creates a list of conceptual elements that can be used to read and better understand the messages emitted by the new media.

Key words: semiotic, new media, empirical model, empirical author, internet, website.

BOOK REVIEW

*Review of the Fatos Tarifa's book
"Hakmarrja është imja; Morfologjia
sociale dhe Gramatika morale e
Gjakmarrjes" Tirana: Onufri, 2014* _____

_____ *Prof. Dr. Aleksandër Dhima* _____

The social anthropologists, not exactly like the sociologists, consider the vendetta as a phenomenon typically related to pre-modern societies. They see it as a process that surpasses time and is installed in the mentalities of future generations as a "rigid structure", "well codified". As such, the phenomenon survives and continues to exist, because it cannot fade suddenly with law enforcement rules and practices. As a superior form of social control, vendetta ruins also at a certain measure the social cohesion. The book of Fatos Tarifa builds on these perspectives and is well supported by works on sociology, anthropology, psychology and even law studies. His book is well written, very clearly, with both scientific and intellectual competence.

